

Rade Rajkovçevski

**NDËRTIMI I POLITIKËS SË SIGURISË:
RASTI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

*Bashkëshortes sime Elena,
për dashurinë, mirëkuptimin dhe tolerancën e saj*

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE/ABREVIATIONES.....	8
Lista e tabelave, grafikëve dhe skemave.....	9
Parathënie.....	12
1 SHËNIME HYRËSE PËR PROBLEMIN DHE PËR QËLLIMET E PUNIMIT.....	15
2 GJENDJA E SIGURISË.....	25
3 SFIDAT E SIGURISË.....	40
3.1 Sfidat evropiane.....	41
3.2 Sfidat rajonale (ballkanike).....	48
3.3 Sfidat dhe kërcënimet e brendshme.....	54
3.3.1 Kërcënimet politike dhe etnike.....	60
3.3.2 Kërcënimet ekonomike.....	75
3.3.3 Kërcënimet demografike.....	77
3.3.4 Kërcënimet ushtarake.....	78
4 POLITIKA E SIGURISË.....	79
4.1 Nocioni.....	79
4.2 Qëllimet.....	91
4.3 Parimet e politikës së sigurisë.....	100
4.4 Procesi i krijimit dhe rregullimi ligjor i politikës së sigurisë në Republikën e Maqedonisë.....	103
4.4.1 Analiza e procesit dhe e qasjes në miratimin e dokumenteve strategjike nga fusha e sigurisë.....	113
4.4.2 Analiza e përmbajtjes dhe kualitetit të dokumenteve të miratuara strategjike.....	118
5 PARANDALIMI I KONFLIKTEVE.....	121
5.1 Karakteristikat e kuadrit kombëtar për zbatimin e parandalimit të konflikteve.....	128
5.2 Përvoja e Republikës së Maqedonisë në parandalimin e konflikteve.....	129
6 ZBATIMI I POLITIKËS SË SIGURISË.....	141
6.1 Struktura dhe funksionet e sistemit të sigurisë kombëtare.....	141
6.2 Ballafaqimi me sfidat e sigurisë.....	166

6.2.1 Ballafaqimi me potencialin e konfliktit të armatosur ndëretnik.....	167
6.2.2 Ballafaqimi me sfitat e tjera të sigurisë.....	180
6.2.2.1 Ballafaqimi me sfitat e brendshme.....	181
6.2.2.2 Ballafaqimi me sfitat rajonale dhe globale.....	184
7 REKOMANDIME PËR POLITIKËN E SIGURISË NË	
MAQEDONI	189
7.1 Rekomandime politike.....	189
7.2 Rekomandime për sistemin e sigurisë.....	202
KONKLUZION.....	207
Shtojca nr.1: Pytësor anketues nga hulumtimi	209
Shtojca nr.2: Maqedonia në marrëdhëniet me BE-NATO.....	214
BIBLIOGRAFIA.....	217

LISTA E SHKURTESAVE/ABREVIATIONS

SHP i ARM	Shtabi i Përgjithshëm i Armatës së Republikës së Maqedonisë
PESM	Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP)
KE	Komisioni Evropian
PEF	Politika Evropiane e Fqinjësisë (ENP)
BE	Bashkimi Evropian
PPSM	Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP)
PPJS	Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (CFSP)
EJL	Evropa Juglindore
CARDS	Ndihmë Bashkësisë për Rikonstruksion, Zhvillim dhe Stabilizim (CARDS)
KFOR	Forcat e OKB (më vonë NATO) për Ruajtjen e Paqes në Kosovë (KFOR)
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF)
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MB	Ministria e Mbrojtjes
NATO	Pakti i Atlantikut - Verior (NATO)
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE)
UÇK	Ushtria Çlirimtare Kombëtare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara (UN)
RM	Republika e Maqedonisë
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
KIE	Këshilli i Evropës
SFOR	Forcat e NATO për Stabilizim në Bosnjë e Hercegovinë (SFOR)
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
UNPREDEP	Forcat e Shpërndara Parandaluese të OKB (UNPREDEP)

LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE DHE SKEMAVE

Tabela 1: Përgjigjet e të anketuarve në pyetjen: “Sipas Jush, cili nga qëndrimet e thesuara e pasqyron më së miri qëndrimin Tuaj për gjendjen stabile të sigurisë?”.....	35
Tabela 2: Përgjigje e të anketuarve në pyetjen: “Sipas Jush, cili nga qëndrimet e theksuara e pasqyron më së miri qëndrimin Tuaj për gjendjen stabile të sigurisë?”.....	36
Tabela 3: Temat kryesore në strategjitë kombëtare të sigurisë (Ungerer 2011: 5).....	47
Tabela 4: Ekzistimi i koncensusit politik ndërmjet partive politike në Republikën e Maqedonisë për kërkesat e bashkësive etnike (2009).....	69
Tabela 5: Ekzistimi i koncensusit politik ndërmjet partive politike në Republikën e Maqedonisë për kërkesat e bashkësive etnike (2013).....	69
Tabela 6: Ndikimi i solidaritetit shqiptar në rajon (2009).....	72
Tabela 7: Ndikimi i korrupsionit mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë (2009).....	77
Tabela 8: Pasqyrë e miratimit të dokumenteve strategjike nga fusha e sigurisë në periudhën kohore 1998-2013.....	105
Grafiku 1: Struktura gjinore e të anketuarve	23
Grafiku 2: Struktura etnike e të anketuarve.....	23
Grafiku 3: Struktura arsimore e të anketuarve.....	23
Grafiku 4: Gjendja e sigurisë në Republikën e Maqedonisë (2009)..	37
Grafiku 5: Gjendja e sigurisë në Republikën e Maqedonisë (2013)...	37
Grafiku 6: Perceptimi i sfidave më të rëndësishme të sigurisë në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së në bazë të të dhënave nga 27 vende-anëtare të BE-së (EC 2011: 10, 18).....	44
Grafiku 7: Ndikimi i ndarjes etnike të shoqërisë mbi gjendjen e sigurisë	61
Grafiku 8: Ndikimi i marrëdhënieve të çrregulluara ndëretnike mbi gjendjen e sigurisë.....	62
Grafiku 9: Ekzistimi i konsensusit politik ndërmjet partive politike në Maqedoni për negociatat me Greqinë në kontestin me emrin kushtetues të Republikës së Maqedonisë.....	64

Grafiku 10: Ekzistimi i konsensusit politik ndërmjet partive politike në Republikën e Maqedonisë për anëtarësimin në BE dhe NATO si përcaktim strategjik.....	64
Grafiku 11: Ndikimi nga integrimi në NATO mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë.....	65
Grafiku 12: Ndikimi i mungesës së ftesës për negociata për anëtarësim në BE mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë.....	66
Grafiku 13: Ndikimi i kontestit për emrin kushtetues të Maqedonisë..	66
Grafiku 14: Ndikimi i marrëdhënieve fqinjësore në R. të Maqedonisë...	67
Grafiku 15: Ekzistimi i konsensusit politik ndërmjet partive politike në Republikën e Maqedonisë për prioritetet e politikës së jashtme (marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, pozita e maqedonasve në fqinjësi, marrëdhëniet me Kosovën dhe ngjashëm).....	68
Grafiku 16: Ndikimi i përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja Kornizë.....	70
Grafiku 17: Ndikimi i diskriminimit etnik mbi gjendjen e sigurisë...	71
Grafiku 18: Ndikimi i mosrespektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë.....	73
Grafiku 19: Ndikimi i shkallës së lartë të papunësisë mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë.....	76
Grafiku 20: Ndikimi i zhvillimit të ngadalshëm ekonomik mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë.....	76
Grafiku 21: Pasqyrë e përgjigjeve në pyetjen: "A konsideroni se Republika e Maqedonisë ka partnerë të mirëfilltë/të cilët e mbështesin në proceset integruese për anëtarësim në BE dhe në NATO?" (2009).....	190
Grafiku 22: Pasqyrë e përgjigjeve në pyetjen: "A konsideroni se Republika e Maqedonisë ka partnerë të mirëfilltë/të cilët e mbështesin në proceset integruese për anëtarësim në BE dhe në NATO?" (2013).....	191
Grafiku 23: Pasqyrë e përgjigjeve në pyetjen: "Sipas Jush, siguria dhe marrëdhëniet stabile ndëretnike në Republikën e Maqedonisë a mund të çrregullohen nëse së shpejti Republika e Maqedonisë nuk bëhet anëtare e NATO-s dhe nëse nuk merr ftesë për negociata me BE?" (2009).....	195
Grafiku 24: Pasqyrë e përgjigjeve në pyetjen: "Sipas Jush, siguria dhe marrëdhëniet stabile ndëretnike në Republikën e Maqedonisë a mund të çrregullohen nëse së shpejti Republika e Maqedonisë nuk	

bëhet anëtare e NATO-s dhe nëse nuk merr ftesë për negociata me BE?" (2013).....195

Skema 1: Përcaktimi i nevojave të jashtme dhe të brendshme (Luethold në Albrecht & Barnes 2008: 3).....83

Skema 2: Modeli për formulimin e Strategjisë së SHBA-ve (Boone Bartholomees, Jr. 2010: 397).....89

Skema 3: Pyetje që duhet të parashtrihen gjatë zhvillimit të politikave të sigurisë (Luethold në Albrecht & Barnes 2008: 2).....103

Skema 4: Skema e sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë (Bela kniga na odbranata 2012: 23).....141

Skema 5: Struktura organizative e sistemit për siguri kombëtare të Republikës së Maqedonisë (Kotovčevski 2012: 24).....147

PARATHËNIE

Siguria është nevojë dhe gjendje të cilën në mënyrë të drejtpërdrejtë e kanë ndier shumë popuj dhe kombe të botës. Fuqia dhe rëndësia e saj për qytetarin e zakonshëm dhe për shtetin i motivon njerëzit për gjetjen e korrelacionit të sigurisë me ekzistencën e njeriut dhe me mbijetesën e shtetit. Së këtejmi, duhet të krijohet politikë e sigurisë kombëtare, e cila sigurisë do t'i jap konotacion politik dhe do ta bëjë vegël strategjike për realizimin e interesave kombëtare.

Kjo qasje, e cila në esencë i përfshin studimet e mia dhjetëvjeçare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes (në Akademinë Ushtarake dhe në Fakultetin e Sigurisë-Shkup) më inkurajoi që në detaje ta hulumtoj politikën e sigurisë në Republikën e Maqedonisë.

Gjatë konceptimit të punimit u nisa nga supozimi se korniza e konceptit të sigurisë kombëtare nuk i prek tërësisht çështjet thelbësore të sigurisë në Republikën e Maqedonisë. Republika e Maqedonisë, pas një varg turbulencash të sigurisë, meriton një koncept autentik të politikës së sigurisë, i cili do të ofrojë zgjidhje konkrete për ballafaqimin me kërcënimet dhe sfidat e sigurisë. Në këtë kontekst, politika e sigurisë së brendshme, politika e mbrojtjes dhe politika e jashtme janë bërthamat kryesore në të cilat duhet të inkorporohen mekanizmat për parandalimin e konfliktit ndëretnik, për zgjidhjen e krizave politike që kanë të bëjnë me interesat dhe vlerat kombëtare dhe për tejkalimin e implikimeve të sigurisë nga integrimet e bllokuara euroatlantike.

Përpjekjet e para për teoritizimin e problemit të politikës së sigurisë datojnë nga viti 2008 kur si student në studime pasuniversitare në Akademinë Policore të atëhershme (tani Fakulteti për Siguri-Shkup) i fillova përgatitjet për paraqitjen e tezës së magistraturës në lidhje me politikën e sigurisë dhe me parandalimin e konflikteve në Republikën e Maqedonisë.

Libri është fryt i mirëfilltë i bashkëpunimit tonë shumëvjeçar i cili e nënkupton participimin tim në botimin: "Mendimi politik" dhe prezencën në kuadër të paneleve akademike, në debate profesionale dhe në konferenca të organizuara nga Fondacioni. Libri, ofron bazë të fuqishme për bashkëpunim të mëtutjeshëm dhe me të vërtetë jam

krenar që me një marrëdhënie shumëvjeçare partneriteti arritëm këtu ku jemi. Po ashtu, sinqerisht e falënderoj znj. Anja Çimek e cila vendosi që si bashkë-botues dhe si bashkë-promotor i librit ta përfshijë institucionin tim amë – Fakultetin për Siguri në Shkup.

Gjithsesi, dua t'u shpreh falënderim të madh recensentëve: Prof. Dr. Tome Batkovski dhe Prof. Dr. Pere Aslimoski, të cilët pa u kursyer investuan shumë që libri të fitojë në cilësi. Duke e vënë në funksion përvojën e tyre profesionale, akademike dhe krijuese ata më orientuan dhe më ndihmuan në krijimin e këtij punimi gjithëpërfshirës shkencor.

Autori

*Me diplomaci mund të bësh shumë, por akoma më shumë mund
të bësh me diplomaci të mbështetur me forcë dhe fuqi
Kofi Anan*

1 VËREJTJE HYRËSE PËR PROBLEMIN DHE QËLLIMET E PUNIMIT

Çështja e sigurisë së Maqedonisë dhe gjendja e sigurisë në Ballkan, si një tërësi e sigurisë, gjithmonë kanë zënë vend të rëndësishëm në pasqyrën gjeopolitike të Evropës. Dinamika e ngjarjeve të sigurisë në Republikën e Maqedonisë, veçanërisht në periudhën pas pavarësisë, rezulton nga marrëdhëniet ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike dhe faktorëve politikë – në planin e brendshëm dhe ndikimi i vendeve fqinje, SHBA-ve, vendeve të fuqishme në BE dhe BE si tërësi – në planin e jashtëm. Ndikimi i faktorëve të jashtëm u tregua veçanërisht i rëndësishëm në integrimet euroatlantike të shtetit – si proces unikal i cili zgjatë më shumë se dy dekada dhe ka implikime të fuqishme mbi sigurinë e vendit. Në këtë periudhë, Maqedonia në mënyrën më të mirë të mundshme i ndjeu efektet të cilat rezultojnë nga diversiteti i interesave të forcave më të fuqishme në Evropë dhe në BE-së si tërësi politike. Ky proces zgjatë nga çasti kur Republika e Maqedonisë e fitoi pavarësinë nga ish-Jugosllavia, u intensifikua në procedurën për njohje ndërkombëtare të shtetit dhe e ruajti intensitetin, si dhe i tejkaloi kushtet e proceseve integruese të zakonshme euroatlantike.

Në rrethana të këtilla, Republika e Maqedonisë u gjet e papërgatitur që ta ridefinojë konceptin e sigurisë në kushte kur në Evropë ishin më se të qarta tendencat për një bashkim më të gjerë të shteteve evropiane në frymën e afirmimit të vlerave evropiane dhe ruajtjes së paqes e stabilitetit dhe në aktivitetet për një bashkëpunim rajonal dhe më të gjerë (trans-atlantik) dhe zhvillim ekonomik. Si rezultat i këtyre ngjarjeve, koncepti nacional i sigurisë është vendosur në korrelacion me integrimin evropian të sigurisë, por në përgjithësi edhe me integrimin i cili vlen për të gjitha segmentet e jetës shoqërore.

Nevoja për përkufizimin e konceptit të sigurisë e imponoi nevojën për vendosjen e bazave të politikës për menaxhimin me sigurinë ose politikën e sigurisë. Autoritetet politike dhe sistemi i sigurisë morën detyrë që në konceptin e sigurisë t'i inkorporojnë masat e politikës së sigurisë në formë të instrumenteve të cilët kontribuojnë që të garantohet ekzistenca, vlerat kushtetuese dhe

shoqërore, stabiliteti dhe zhvillimi i shtetit. Njëherësh, ndërtimi i politikës së sigurisë nënkupton një proces gjatë të cilit shfrytëzohen të gjitha konceptet e sigurisë, pozita gjeostrategjike, interesat kombëtare dhe një sërë faktorë të tjerë të cilët mund të ndikojnë mbi parandalimin e konflikteve ndëretnike, rrezikimin e vlerave kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, si dhe shfaqjen dhe zhvillimin e kërcënimeve të tjera të sigurisë.

Së këtëjmi, analizat dhe rekomandimet, që i përmban punimi, përkojnë me statusin e Republikës së Maqedonisë sa i përket progresit të saj dhe perspektivave në kuadër të integritimeve euroatlantike, në lidhje me gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike dhe sa i përket gjendjeve politike. Punimi e inkorporon mënyrën e teoretizimit të politikës së sigurisë dhe funksionin e saj në parandalimin e konflikteve në shtet.

Qasja gjithëpërfshirëse ndaj çështjeve lidhur me sigurinë kombëtare nënkupton trajtim të çështjeve të sigurisë në formë të një fenomeni multi-disiplinor, i cili në masë të madhe e nënkupton krijimin e kushteve politike dhe ligjore për menaxhimin me sigurinë kombëtare dhe përshtatjen ndaj kriterëve të cilat vlejné në komunitetin më të gjerë të sigurisë (ose në komunitetin e sigurisë tek i cili shteti synon të bëhet pjesë përbërëse e tij ose të vendos marrëdhënie partneriteti).

Gjatë formulimit të problemit të hulumtimit është e domosdoshme të bëhet distinkcion i politikës së sigurisë nga nocionet e tjera të përafërta (koncept, strategji, plan, doktrinë dhe ngjashëm), përkatësisht të bëhet një sqarim për dallimet terminologjike dhe për ato esenciale ndërmjet politikës së sigurisë dhe nocioneve të tjera. Politika e sigurisë ka pozitë më të lartë në raport me dokumentet e tjerë strategjikë me të cilët rregullohet siguria e shtetit, nga aspekti i asaj që politika e sigurisë është dokument i integruar strategjik në të cilin janë përfshirë më shumë tema të sigurisë të cilat janë objekt i bashkëpunimit integruës kombëtar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të komunitetit më të gjerë të sigurisë.

Nga aspekti i kuadrit ligjor, si objekt sekondar i hulumtimit, Maqedonia miratoi një sërë ligjesh dhe ratifikoi një numër të madh të konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare nga fusha e sigurisë. Me procesin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar dhe me standardet që aplikohen në vendet anëtare të NATO-s, përmes

nënshkrimit të marrëveshjes aderuese me NATO-n për pjesëmarrje në "Partneritet për Paqe" në vitin 1995, shteti arriti një shkallë të lartë të kompatibilitetit me politikat e sigurisë dhe me strategjitë e Aleancës dhe BE-së, që është parakusht për partneritet dhe anëtarësim në këto organizata ndërkombëtare. Njëkohësisht, kjo mënyrë e konceptimit të politikës së sigurisë është projektuar në atë mënyrë që të mundet në masë të madhe të garantojë një ballafaqim më efikas, më ekonomik dhe më racional me rreziqet e sigurisë të karakterit të brendshëm dhe të jashtëm. Krijimi dhe zbatimi i konceptit të sigurisë kombëtare përkon me procesin e integrimi euroatlantike të shtetit.¹ Në rrethana të këtylla, Maqedonia vazhdimisht e ndërton modelin e politikës së sigurisë i cili, përveç asaj që duhet t'i përgjigjet ballafaqimit me çështjet e sigurisë së brendshme, duhet të jetë kompatibil me nevojat të cilat janë pjesë përbërëse e partneritetit aktual me BE (edhe statusi i fituar i kandidatit në vitin 2005), me NATO-n dhe me organizata të tjera ndërkombëtare të cilat veprojnë në fushën e sigurisë.

Në këtë mënyrë, duke i marrë në konsideratë të gjitha karakteristikat e shoqërisë maqedonase dhe të sistemit të sigurisë, politika e sigurisë perceptohet si një veprimtari gjithëpërfshirëse për realizimin e qëllimeve politike, të cilat mund të ndikojnë mbi parandalimin e konflikteve të brendshme në vend (para së gjithash ndëretnike dhe ndërpolitike sa i përket çështjes së konsensusit politik për çështjet kryesore të sigurisë), por njëkohësisht duke e marrë në konsideratë rëndësinë e politikës së sigurisë dhe kontributin e saj në kuadër të komunitetit ndërkombëtar të sigurisë.

Në këtë pjesë, në mënyrë komparative analizohen konceptet e përafërta të sigurisë kombëtare të shteteve të tjera dhe përcaktimi i elementeve të politikës së sigurisë në to. Numri më i madh i shteteve kanë ndërtuar koncepte të veta dhe autentike të sigurisë kombëtare. Disa shtete, siç është Britania e Madhe, Franca dhe Kina nuk kanë një dokument të përbashkët për politikën kombëtare të sigurisë, por mbështeten mbi politikat e mbrojtjes ose mbi Libra

¹ Integrimet në shtet akoma janë të bllokuara (fondi i muajit dhjetor 2013) për shkak të kontestit me emrin, edhe pse përmbushja e kriterëve politike, sa i përket çështjes së anëtarësimit në NATO, është konfirmuar në Samitin e NATO-s në Bukuresht në vitin 2008, ndërkaq në lidhje me BE-në shteti tanimë nga viti 2009 i ka plotësuar kushtet për fillimin e negociatave mbi bazë të Raporteve pozitive për progresin e Republikës së Maqedonisë në procesin e aderimit në BE.

të Bardhë të cilët janë orientuar vetëm ndaj mbrojtjes kombëtare. Shtetet e tjera nuk i prezantojnë para opinionit publik dokumentet e tyre politike ose nuk kanë politika të shkruara gjithëpërfshirëse lidhur me sigurinë ose mbrojtjen (Hagmann & Stocker 2007: 1).

Nga aspekti i qasjes teorike ndaj çështjeve lidhur me politikën e sigurisë, nga aspekti i përgjithshëm siguria dhe politika e sigurisë analizohen përmes **konstruktivizmit** dhe **teorisë kritike**, ndërkaq ndryshimet sa i përket sigurisë perceptohen përmes **realizmit**, **liberalizmit** dhe përsëri përmes **konstruktivizmit**. Formulimi teorik i shkencës për sigurinë bie ndesh me konceptet e ndryshme të cilat ekzistojnë në Evropë dhe në Amerikën Veriore. Si rezultat i kësaj, shkenca mbi sigurinë në Amerikën Veriore veçohet si një tërësi e veçantë, ndërsa në Evropë ajo është pjesë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në Evropë ka debate energjike ndërmjet shkollave të shumta të cilat garojnë në fushën e studimeve të sigurisë, siç janë përfaqësuesit e: studimeve kritike të sigurisë (shkollat nga Kopenhaga, nga Aberisviti dhe nga Parisi), postmodernistët radikalë, feministët, qasje të inspiruara nga Burdju (Bourdieu) dhe më shumë pozita tradicionale, realiste. Disa nga këto fare nuk janë të njohura për shumicën e shkencëtarëve amerikanë (Wæver 2004: 3-4, ekstrakt). Për shembull, sa i përket çështjes së sigurisë së njeriut, si një nga përmbajtjet e teorive të sigurisë, Kanadaja është më shumë evropiane sesa amerikane dhe pjesërisht është e veçantë sa i përket literaturës së saj për sigurinë e njeriut. Atëherë, dallimet thelbësore në qasjet teorike të studimeve të sigurisë nuk janë ndërmjet Evropës dhe Amerikës Veriore por ndërmjet Evropës dhe SHBA-ve.

Krahas asaj që Evropa ndërton qasje të përafërt ndaj çështjes së shkencës për sigurinë, megjithatë edhe ndërmjet shkollave evropiane ekzistojnë dallime të caktuara. Shkolla e Parisit nuk mbështetet mbi teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Qasja e saj bazohet mbi teorinë sociologjike, përkatësisht krijuesit dhe dishepujt e saj konsiderojnë se siguria është koncept i

krijuar sociologjik.² Shkolla e Kopenhagës e apostrofon teorinë e sekjuritizimit, ndërsa përfaqësues të saj më eminent janë Beri Buzan (Barry Buzan) dhe Ole Viver (Ole Wæver). Aplikimi i kësaj teorie, në kushte të nevojës së theksuar për siguri pas vitit 2001, e nxitur nga sulmet terroriste në SHBA dhe në Britaninë e Madhe, kontribuoi seriozisht të çrregullohet privatësia e qytetarëve dhe rezultoi me rrezikimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë mënyrë shkolla e Parisit pohon se procesi i sekjuritizimit, në vend që t'ju sigurojë qytetarëve siguri rezultoi me pasiguri, e cila buron nga sistemi shtetëror i sigurisë dhe me rrezikimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në pasqyrën e përkufizimeve të shkollave teorike në SHBA dhe në Evropë, shkenca e sigurisë mbështetet mbi **teorinë kritike** dhe bën pjesë në shkencat shoqërore (i bashkon kriminologjia, sociologjia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare). Teoria kritike vendos baza deskriptive dhe normative për hulumtimet sociologjike, e redukton dominimin e rolit të autoritetit (siç është për shembull, shteti) dhe i jep përparësi lirisë në të gjitha format e saj.

Teoria e konstruktivitetit i aktualizon çështjet e natyrës së shtetit, konceptin e shtetësisë dhe sovranitetit. Konstruktivistët pranojnë se fuqia ekziston në çdo bashkëveprim midis aktorëve, ndërsa objektivi i konstruktivistëve është të gjendet burimi i asaj fuqie. Në përpjekjet e tyre për t'i zhveshur idetë dhe për të treguar se si idetë e krijojnë dhe ndryshojnë identitetin, konstruktivistët bëjnë përpjekje t'i monitorojnë se si krijohen dhe formulohen interesat shtetërore apo se si rrjedh ai proces në disa struktura joshetërore (Vukadinović 2004: 63). Teoria e konstruktivitetit i bën vështrim edhe rolit të shtetit në vendosjen e paqes, në komunitetin më të gjerë. Kjo teori, gjatë perceptimit të interesave kombëtare, në kuadër të strukturës komplekse multinacionale të sigurisë, është e dëshirueshme të analizohet në kontekst të ndikimit

² Përfaqësues më të rëndësishëm janë: Mishel Fuko (Michel Foucault), Pjer Bordje (Pierre Bourdieu) dhe Didier Bigo (Didier Bigo). Ky i fundit sugjeron se "aktet e fjalës" (speech acts) vetvetiu nuk janë të mjaftueshme për zgjidhjen e problemeve të sigurisë, kështu që nevojitet përfshirja e strategjive dhe teknologjive me ndihmën e profesionistëve. Në këtë mënyrë do të arriheshin efektet e njëjtë nga "aktet e fjalës", të cilat do ta rrezikonin sigurinë, të drejtat dhe liritë e qytetarëve (Fierke 2007: 174). Bigo, gjatë zbatimit të konceptit të sigurisë nuk e limitoi rolin e politikanëve, të ushtrisë dhe të policisë. Aq më tepër, ai në zbatimin e konceptit përfshin edhe ndërmjetësues, siç janë: patrullat kufitare, agjencitë e inteligjencës dhe kompanitë private (Bigo 2008: 125 - 127).

të komunitetit më të gjerë të sigurisë mbi interesat e shtetit (Tusicsny 2007). Realizimi i interesave kombëtare dhe garantimi i sigurisë i të gjithë subjekteve në shtet, që kufizohet në veprimin e sistemit të sigurisë vetëm përbrenda (në kuadër të kufijve të shtetit), pa bashkëpunim me sisteme të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë, paraprakisht është gjykuar me sukses të pjesshëm, për shkak të limitimit të resurseve kombëtare në ballafaqimin me kërcënimet e sigurisë.

Tradicionalisht, një numër i madh i njerëzve konsiderojnë se analizimi i sigurisë u përket marrëdhënieve ndërkombëtare. Si rezultat i kësaj, shumë shpesh, siguria konsiderohet se i takon kuadrit të kontekstit të ngushtë të **realizmit** në të cilin: shteti është objekt referent; nëse shteti është i sigurt, atëherë edhe qytetarët e tij janë të sigurt; dhe kërcënim kryesor për sigurinë janë shtetet e tjera (Dunne & Schmidt 2008). Shkolla realiste u themelua mbi supozimin se interesi kombëtar, si vegël për krijimin e politikave, është dedikuar për ta identifikuar interesin më të mirë të shtetit në marrëdhëniet e tij me shtetet e tjera (McLean 1996: 333). Nocioni "më i mirë" është përkufizuar në aspektin e fuqisë dhe të sigurisë. Realistët, sigurinë kombëtare e shohin si bazë primare të interesave kombëtare të një shteti për shkak të kërcënimit nga anarkia dhe nga kufizimet e shteteve sovrane, të cilët janë pjesë të sistemit ndërkombëtar (Stolberg 2010: 6).

Teoria liberale bazohet mbi zhvillimin ekonomik si mjet për tejkalimin potencialit të konflikteve dhe luftës (Navari 2008: 29-43). Teoria liberale dhe rrjedhimisht me këtë edhe teoria neolibérale, e hap edhe çështjen e (pa) rëndësisë së sovranitetit, ndërsa zhvillimin ekonomik, të bazuar në marrëveshje për bashkëpunim ndërqeveritar, e sheh si instrument për tejkalimin e problemeve bilaterale në fushën e sigurisë.

Politika e sigurisë, si objekt i hulumtimit të këtij punimi, bazohet në realizmin dhe teorinë kritike, ndërsa pjesërisht mbështetet edhe në teorinë liberale kur bëhet fjalë për kapërcimin e konfliktit të brendshëm me masat për zhvillim ekonomik dhe me bashkëpunim ndërqeveritar në fushën e sigurisë. Prandaj, politika e sigurisë shihet si mjet për realizimin e dy qëllimeve kryesore: parandalimin e konflikteve të brendshme dhe tejkalimin e implikimeve të sigurisë nga integrimet e bllokuara euroatlantike. Dy qëllimet e cekura vënë në pah se fokusi kryesor i politikës së sigurisë ndërlidhet me sigurinë e brendshme, të mbrojtjes dhe me sigurinë e jashtme.

Parandalimi i konflikteve është esenca dhe determinuesi i një politike të sigurisë, e cila duhet ta bëjë më të qartë përcaktimin konceptual të shtetit në lidhje me çështjet e brendshme të sigurisë. Në këtë kontekst, nevojitet të përcaktohen orientimet në të cilat lëvizë politika e sigurisë sa i përket qëllimit – parandalimi i konflikteve.

Orientimet e politikës së jashtme të sigurisë në Republikën e Maqedonisë kushtëzohen nga zgjidhja e kontestit me emrin, marrëdhëniet me fqinjët dhe me zgjidhjen/përmirësimin e statusit të minoritetit maqedonase i cili jeton në vendet fqinje.

Dimensionin e tretë i qëllimeve të politikës së sigurisë e paraqet korrelacionin ndërmjet dy qëllimeve të mëparshme, përkatësisht:

– Ndikimi i politikës së jashtme të sigurisë mbi politikën e brendshme të sigurisë, përkatësisht si ndikon bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare në luftën e koordinuar kundër kërcënimeve përgjithësisht të pranuar, të përkufizuara nga bashkësia ndërkombëtare, mbi punën e sistemit të sigurisë në drejtim të parandalimit të konflikteve. Në këtë pjesë, rëndësi të madhe i kushtohet identifikimit të politikave, aktiviteteve, reformës dhe masave sistimore të cilat ndikojnë në parandalimin e konflikteve.

– Ndikimi i politikës së brendshme të sigurisë mbi politikën e jashtme të sigurisë, përkatësisht, harmonizimi i qëllimeve të shtetit dhe sistemit të sigurisë, të ndërlidhura me sigurinë e brendshme reflektohen mbi procesin e Europeizimit ose Natoizimit. Në këtë mënyrë analizohet ndikimi i procesit të adaptimit të sistemit të sigurisë me sistemet ndërkombëtare në ndërtimin e kapaciteteve dhe kulturës për parandalimin e konflikteve.

Në bazë të përcaktimit të disa çështjeve kyç, siç janë: nocioni "politika e sigurisë" qasja teorike, çështja e politikës së sigurisë dhe procesi i konceptimit të saj, ky libër ka për qëllim ta analizojë politikën e sigurisë së jashtme, të mbrojtjes dhe politikën e sigurisë së brendshme, si elemente kryesore të politikës së sigurisë në Republikën e Maqedonisë dhe ndikimin e tyre mbi gjendjet aktuale lidhur me sigurinë kombëtare, nga aspekti i: procesit të miratimit të dokumenteve strategjike, ndikimit të marrëdhënieve ndëretnike mbi sigurinë e shtetit dhe perceptimit të përparësive nga anëtarësimi në NATO dhe në BE me identifikimin e partnerëve strategjikë të Republikës së Maqedonisë në proceset integruese.


Në bazë të analizave kualitative dhe kuantitative, punimi ka edhe qëllim plotësues, i cili ka të bëjë me gjetjen e lidhjes midis politikës së sigurisë dhe ndikimit të saj në krijimin e masave vendase për parandalimin e konflikteve.

Dy qëllimet përkojnë me gjetjen e interesave të Republikës së Maqedonisë në fushën e sigurisë me miratimin e politikave dhe strategjive evropiane të sigurisë, si pjesë të proceseve eurointegruese, përkatësisht harmonizimin e standardeve të sigurisë me standardet që i përmban modeli evropian. Gjithsesi, në mënyrë që të ruhet autenticiteti, koncepti i politikës së sigurisë i merr parasysh të gjitha ndikimet lokale dhe rajonale mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë.


Për realizimin e qëllimeve të punimit, u realizuan hulumtime në vitin 2009³ dhe në vitin 2013⁴, me aplikimin e metodave shkencore karakteristike për shkencat shoqërore, siç janë: **historike, logjike, metoda e analizës, metoda deduktive, analiza e përmbajtjes, metoda krahasuese dhe statistikore.**

³ Për hulumtimin e realizuar në territorin e mbarë Maqedonisë, gjatë periudhës kohore nga 20.5.-5.6.2009 u përdor pyetësori anketues me shkrim me pyetje të llojit të mbyllur. Pyetësori anketues iu dërgua të anketuarve përmes studentëve të Fakultetit të Sigurisë – Shkup, ndërkaq target grup i anketimit ishin 528 të anketuar nga publiku i përgjithshëm.


⁴ Hulumtimi i realizuar gjatë periudhës kohore 1-15.12.2013 ka përfshirë 323 të anketuar nga publiku i përgjithshëm, ndërsa si teknikë për grumbullimin e të dhënave u përdor pyetësori anketues elektronik me pyetje të llojit të mbyllur, thuaja se identik me pyetësorin e hulumtit të realizuar në vitin 2009. Të anketuarve, përmes adresës elektronike, iu dërgua linku për akses deri tek pyetësori në veglën e kërkuesit Google, e emërtuar Google Drive. Me akordimin e veglës, pyetësori u konceptua në atë mënyrë që në të gjitha pyejtet detyrimisht duhej të jepen përgjigje, me përjashtim të dy pyetjeve të fundit.



Grafiku 1: Struktura gjinore e të anketuarve



Grafiku 2: Struktura etnike e të anketuarve



Grafiku 3: Struktura arsimore e të anketuarve

Pyetëtori u nda në disa bateri sipas fushave, në përputhje me fushat të cilat janë objekt të hulumtimit, siç janë: *marrëdhëniet ndëretnike, sfidat të cilat burojnë nga integrimet euroatlantike dhe*

identifikimi i përgjithshëm i kërcënimeve mbi sigurinë dhe mbi stabilitetin e Republikës së Maqedonisë.

Objekti i hulumtimit e përfshiu periudhën kohore 1998-2013. Në këtë periudhë kohore, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ka miratuar dokumente kyç për politikën e sigurisë, por njëherësh në këtë periudhë ndodhi edhe konflikti i armatosur ndëretnik (në vitin 2001). Përcaktimi kohor dhe hapësinor i objektit të hulumtimit është në korrelacion me ngjarjet e sigurisë në rajon dhe me zhvillimin e dinamikës së sigurisë në kuadër të bashkësisë transatlantike të sigurisë.

2 GJENDJA E SIGURISË

Gjendja e sigurisë paraqet fenomen kompleks, i cili jep pasqyrë të vëllimit dhe intensitetit të më shumë elementeve të kërcënimit të sigurisë kombëtare (rreziqe, kërcënime dhe sfida), të cilat në një kohë të caktuar veç e veç ose të kombinuara ndikojnë mbi sigurinë e qytetarëve, komunitetit ose mbi një çështje konkrete të rrezikimit dhe mbi shtetin. Gjendjen e sigurisë e përbëjnë më shumë faktorë ose indikatorë. Ata tregojnë se si është gjendja e sigurisë sa u përket pyetjeve në lidhje me rendin dhe qetësinë publike, dinamikën e krimit (e cila ndikon mbi sigurinë personale, mbi sigurinë e të mirave të fituara materiale të qytetarëve dhe mbi pronën shoqërore), ndikimin e elementit të huaj mbi sigurinë e brendshme, kërcënimet të cilat rezultojnë nga organizata ekstremiste, zhvillimin e ngjarjeve të sigurisë në rajon dhe në botë, marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit e të tjera. Gjendja e sigurisë në Republikën e Maqedonisë është rezultat i marrëdhënieve në shoqëri, të cilat në thelbin e tyre i kanë ngjarjet historike, dinamikën e zhvillimit shoqëror, marrëdhëniet brenda në shtet (midis qytetarëve dhe subjekteve politike), marrëdhëniet me fqinjët dhe karakteristikat e gjendjes së sigurisë së përgjithshme në Evropë.⁵ Gjendja e sigurisë bazohet mbi vlerësimet e sigurisë të cilat nënkuptojnë analizimin e gjendjeve të sigurisë me metoda të cilat janë karakteristike për shkencën e sigurisë, politike dhe shkenca të tjera shoqërore. Përkufizimi i gjendjes së sigurisë është veçanërisht i dobishëm për shkak të parandalimit të kërcënimeve të sigurisë, për shkak se mundëson krijimin e skenarëve të sigurisë mbi bazë të parametrave të përcaktuar paraprakisht.

Si momente veçanërisht të rëndësishme, të cilat ndikojnë mbi gjendjen e sigurisë së Republikës së Maqedonisë, veçohen: *shpërbërja e RSFJ-së dhe prezenca dydekadëshe ndërkombëtare e sigurisë në rajon, kriza në Kosovë (1999), konflikti i armatosur në Maqedoni (2001), ngjarjet në lidhje me integrimet euroatlantike, presionet e vazhdueshme dhe propaganda e fqinjëve me të cilat preken çështjet e brendshme të shtetit dhe çështjet që kanë të*

⁵ Nuk është në konflikt me realitetin nëse thuhet se kuptimi më i gjerë për sigurinë në Evropë, i cili ka të bëjë me sigurinë e bashkësisë transatlantike, ka ndikim mbi sigurinë e Republikës së Maqedonisë.

bëjnë me realizimin e të drejtave të maqedonasve të cilët jetojnë në vendet fqinje.

Luftërat në territorin e ish-RSFJ-së dukshëm e ndryshuan esencën e kërcënimeve të sigurisë në Evropë. Veprimet ushtarake në Ballkan patën karakterin e konflikteve lokale. Kohëzgjatja e tyre, intensiteti dhe përshkallëzimi në fillim vështirë mund të parashikoheshin. Qëllimet e veprimeve të armatosura u drejtuan kah përmbushja e nevojave të identiteteve të ndryshme etnike, kulturore dhe fetare. Disa prej tyre përmbanin elemente të caktuara retrograde dhe ekstremiste dhe u shndërruan në kërcënim serioz me karakter lokal dhe rajonal. Luftërat në ish-RSFJ treguan se në vend që diversitetet etnike, kulturore dhe fetare të grupeve të paraqisnin ura bashkëpunimi, ato në periudha të caktuara kohore u treguan si burime serioze ndaj kërcënimeve të sigurisë dhe rrezik për paqen.

Duke e pasur parasysh faktin se një pjesë e luftërave, në vitet e hershme të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, kishin si qëllim pavarësimin e ish-republikave të RSFJ-së (në rastin me Slloveninë dhe Kroacinë), rrjedha e tyre ishte determinuar nga rëndësia gjeopolitike e shteteve të prekura dhe perspektivave ekonomike të tyre, ndërkaq marrëdhëniet me BE dhe NATO-n ishin faktorët kryesor për përcaktimin e relacioneve strategjike dhe për mbështetje nga vendet-liderë në politikën ndërkombëtare. Mbështetja strategjike, nga shtetet e fuqishme të Evropës dhe SHBA-ve, u tregua si kryesore për kohëzgjatjen e luftërave (dhe realizimin e qëllimit) dhe e diktonte shpejtësinë e procesit të përshtatjes së çdo shteti në gjendjen e krijuar të re të sigurisë.

Konfliktet në ish-RSFJ rezultuan me prezencë jashtëzakonisht të madhe ndërkombëtare politike, humanitare, ushtarake dhe policore (NATO 2013; CIC 2013; Oliver 2002: 99-117) me qëllim të garantimit të paqes, stabilitetit dhe të zhvillimit ekonomik të shteteve dhe të rajonit. Në hapësirat e ish-RSFJ-së (në BeH dhe në Kosovë) ende janë aktive misionet ushtarake dhe civile të BE-së dhe NATO-së, por edhe krahas domosdoshmërisë së tyre, megjithatë prezenca e gjatë e subjekteve të sigurisë ndërkombëtare në rajon nuk është indikator i mirë i sigurisë për sigurinë kombëtare dhe rajonale.

Sindroma “fuçi baruti” në rajonin violent dhe primitiv-fisnor i ka rrënjët e thella në vetëdijen dhe stereotipat për Ballkanin në publikun ndërkombëtar, shkencë dhe politikë pavarësisht nëse një gjë e tillë është e merituar ose jo. E pamërituar, sepse asnjëherë nuk ka pasur konflikt ose ngjarje të rëndësishme në Ballkan, ndërkaq faktori i huaj të mos ketë pasur ndonjë rol shpeshherë primarë në inicimin ose zhvillimin e atyre ngjarjeve ndërsa, e merituar, sepse me të vërtetë çdoherë shkaqet dhe realizimi kanë qenë autokton ballkanik. (Mirčev 2012: 19).

Maqedonia **pavarësinë** e saj e fitoi në rrugë paqësore, me lëshime të caktuara të cilat kontribuuan në ruajtjen e paqes në vend dhe të mos përsëritet skenari nga ish republikat e tjera të RSFJ-së (Sllovenia, Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina).

Gjithashtu, edhe sot e kësaj dite polemizohet mënyra në të cilën u formulua pyetja e referendimit⁶ për pavarësi, gjë që u tregua kyç për përqindjen e lartë (95,26%) të qytetarëve të cilët u pajtuan që Republika e Maqedonisë të bëhet shtet i pavarur (Republička izborna komisija 1991: 2).

Edhe pse duket paradoksale, Maqedonia pavarësinë e saj e fitoi falë politikës së Slllobodan Millosheviqit. Po të mos ishin gabimet e shumta politike të zhvillimit të politikave agresive nacionaliste, nga ana e regjimit të tij ndaj të gjitha shteteve joserbe, populli në Republikën e Maqedonisë ende do të besonte në mbijetesën e RSFJ-së (Liotta & Jebb 2002, ekstrakt). Politika hegjemoniste e qeverisë në Beograd e forcoi dëshirën për pavarësi tek qytetarët e Maqedonisë, e cila atëbotë u plotësua me mbështetjen dhe me simpatinë e një pjese të madhe të bashkësisë ndërkombëtare. Fitimi i pavarësisë, në kohëra aspak të qeta në rajon, ishte më pak i dhimbshëm dhe tragjik⁷ për qytetarët e Maqedonisë.

Ruajtjen e paqes disa ia përshkruajnë presidentit të parë të shtetit – Kiro Gligorov, i cili konsideronte se humbjet e jetëve të njerëzve nuk kanë vlerë, prandaj ra dakord që Armata Popullore e Jugosllavisë të largohet nga shteti dhe me vete ta marr tërë armatimin dhe pajisjen nga kazermat dhe depot. Për këtë hap të

⁶ Pyetja ishte: “A jeni për Maqedoni të pavarur me të drejtë që të hyjë në një federatë të ardhshme të shteteve sovraane të Jugosllavisë?”

⁷ Në fushëbetejat e ish-Jugosllavisë, përkatësisht në Slloveni dhe në Kroaci, humbën jetën 54 ushtarë maqedonas, pa e ditur se për kë luftojnë.

Gligorovit edhe sot e kësaj dite ekzistojnë kundër qëndrime dhe kritika, të cilat më së shpeshti adresohen nga politikanët dhe nga opinioni publik ekspert.

Pas luftërave të përgjakshme në Ballkan, në vitin 1999, u formua Pakti i Stabilitetit⁸ (ndërsa nga viti 2008 punën e tij e vazhdoi pasuesi i tij Këshilli Rajonal për Bashkëpunim), **si një sinjal i qartë për interesin dhe për vullnetin e BE-së, të SHBA-ve dhe vendeve të treta për integrimin, stabilizimin dhe tejkalimin e zhvillimit të prapambetur ekonomik dhe demokratik të vendeve nga EJT.** Përmes Paktit të Stabilitetit, forcat e mëdha në mënyrë të qartë bënë me dije se Ballkani zë një vend të rëndësishëm në interesat e tyre kombëtare. Nga ky aspekt, shteteve të rajonit, përmes mbështetjes ndërkombëtare në proceset integruese, iu përcaktua monitorim ndërkombëtar i cili ka për qëllim pamundësimin e çfarëdo qoftë shmangie nga tendencat dhe proceset demokratike. Iniciativat e formuara në kuadër të Paktit të Stabilitetit përparësi i japin qasjes rajonale në zgjidhjen e çështjeve të sigurisë, shoqërore, politike, ekonomike dhe çështjeve të tjera. Kjo mënyrë u ofroi vendeve mundësi që t'i tejkalojnë dallimet bilaterale përmes formimit të bashkëpunimit rajonal me mbështetje ndërkombëtare.

Disa vjet më vonë, angazhimet për integrimet evropiane dhe euroatlantike të rajonit rezultuan me aksione konkrete nga ana e BE-së, Këshillit të Evropës⁹ dhe NATO-s. Faktori ndërkombëtar kërkonte inkorporimin e qasjes rajonale dhe të reformave gjatë gjithë procesit të integrimit euroatlantik në politikat e sigurisë dhe përgjithësisht në politikat shtetërore. Reforma mundësoi një ballafaqim më të lehtë me rrethanat e krijuara të reja të sigurisë

⁸ Si paketë e masave dhe marrëveshjeve, në interes të stabilitetit rajonal dhe zhvillimit ekonomik, Pakti i Stabilitetit u formua nga ana e Bankës Botërore, në koordinim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si instrument për përforcimin ekonomik të shteteve dhe stabilitetin në rajon. Pakti i Stabilitetit përmban komponentë ekonomike, humane, politike dhe të sigurisë.

⁹ Përfitimi nga Samiti i KE në Selanik, i mbajtur nga 19-23.6.2003 është ajo që për të parën herë, vendeve të Ballkanit Perëndimor u lejohet qasje në programet interne të BE-së, vendim i cili hyri në fuqi në vitin 2005. Me këtë përfitim mundësia për bashkëpunim ndërkufitar u bë gjithnjë e më e mundshme dhe më e qëndrueshme. Duke u nisur nga informata se rajonet kufitare të Ballkanit paraqesin tokë pjellore për tensione dhe konflikte dhe se ata janë një nga rajonet e vendeve më të lëna pas dore dhe pamjaftueshëm të zhvilluara, në periudhën kohore nga muaji qershor 2003 deri më sot, Greqia dhe Maqedonia inciojnë dhe e mbështesin bashkëpunimin ndërkufitar, i cili ka për qëllim t'i implementojë në nivel lokal marrëdhëniet e mira fqinjësore në fushat ku ekziston rreziku nga shfaqja e problemeve (Sentik - Gaber 2005:179-180).

meqë ishin të pashmangshme ndryshimet në ekonomi, në politikë dhe në përgjithësi në shoqëri. Reforma në sektorin e sigurisë në Republikën e Maqedonisë fillimisht filloi të zbatohet me ndihmën e huaj, të mbështetur mbi bashkëpunimin bilateral, ndërsa me kalimin e kohës institucionet e sistemit të sigurisë në Republikën e Maqedonisë filluan të planifikojnë mjete buxhetore për zbatimin e reformave. Me progresin në proceset integruese shteti filloi t'i shfrytëzojë fondet para-aderuese të BE-së dhe vazhdoi të shfrytëzojë mjete nga organizata të tjera ndërkombëtare. Maqedonia dhe vendet e rajonit gjenden në fazën e dytë të reformës në sektorin e sigurisë.

Këshilli i Evropës insistonte në aplikimin e modelit "eurorajoni" (në bazë të përvoja të mira gjatë aplikimit të tij në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore) përmes së cilit u vendos bashkëpunimi ndërkufitar i sigurisë, i cili më vonë u bë pjesë e politikës shtetërore dhe rajonale të sigurisë.

BE përmes KE insistonte për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit¹⁰ me qëllim të përsheptimit të procesit eurointegruer të vendeve përmes përmbushjes së detyrave konkrete.

NATO, sipas shembullit të Grupit të Balltikut, e formoi Grupin e Adriatikut,¹¹ në vitin 2003 përmes së cilit u mundësua një progres më i shpejtë i vendeve gjatë përmbushjes së standardeve të NATO-s deri në fitimin e anëtarësisë me të drejta të plota në Aleancë.

Marrë në përgjithësi, disa vjet pas angazhimeve për integrimin e rajonit, Republika e Maqedonisë dhe shtetet e rajonit akoma nuk ia dalin që në masë të mjaftueshme të imponohen në kartën gjeopolitike të Evropës dhe në kuadër të bashkësisë transatlantike të sigurisë. Shkaqet kryesisht konsistojnë me mënyrën e menaxhimit të shteteve dhe shfrytëzimin e pamjaftueshëm të kapaciteteve për bashkëpunim rajonal. Në këtë kontekst, shtetet në masë të pamjaftueshme i shfrytëzojnë përparësitë e pozitës gjeostrategjike të rajonit edhe pse përmes Maqedonisë dhe rajonit kalon Korridori 8 dhe Korridori 10. Krahas asaj që rajoni është relativisht stabil

¹⁰ Republika e Maqedonisë e nënshkroi këtë Marrëveshje në muajin prill të vitit 2001, mes vendeve të para të rajonit.

¹¹ Karta u nënshkrua më 2.5.2003 në Tiranë, nën patronazhin e SHBA-ve. Fillimisht grupi përbëhej nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kroacia, ndërsa më vonë, në vitin 2008, grupit iu bashkëngjiti Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina, Serbia ishte vëzhguese, ndërkaq në vitin 2012 Kosova paraqiti aplikim për anëtarësim.

(nuk ka rrezik nga luftëra, ndërsa vatrat e krizës kontrollohen me prezencën dhe ndikimin ndërkombëtar të sigurisë), atraktiviteti që të investohet në vendet e rajonit ende përballet me probleme të cilat në shtete të caktuara, në masë më të vogël apo më të madhe, janë si rezultat i reputacionit të pavolitshëm të sigurisë, shkallës së ulët të sigurisë humane, pasigurisë juridike, nivelit të korrupsionit politik dhe krimin të organizuar, si dhe faktorë të tjerë të cilët rezultojnë nga proceset e tranzicionit.

Në vitin 2001 në kohën e hapave të parë konkret të eurointegritimit dhe saktësisht një dekadë pasi që presidenti i parë i Republikës së Maqedonisë, z. Kiro Gligorov e emërtoi vendin “Oazë e Paqes”, filloi **konflikti i brendshëm i armatosur në Maqedoni**. Promotor i konfliktit ishte nacionalizmi radikal shqiptar¹² i cili pas vetes fshihte një sërë kërkesash, të cilat çonin drejt federalizmit të shtetit. Përmes konfliktit një pjesë e minoritetit shqiptarë e detyroi Shkupin të kërkojë ndihmë ushtarake (si armë ashtu edhe mbështetje politike) nga fqinjët e njëjtë të cilët e mohojnë identitetin maqedonas (MKG 2001: i). Përveç humbjeve njerëzore, dëmeve materiale dhe problemit me personat e zhvendosur, konflikti në mënyrë serioze i frenoi proceset e filluara reformiste në shtet meqë Republika e Maqedonisë, në muajin prill të vitit 2001, e nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE-n.

Edhe pse motivet e shfaqjes së konfliktit ishin politikisht të motivuara dhe ishin pjesë të një skenari më të gjerë të sigurisë, megjithatë ekspertët politikë dhe të sigurisë, më shumë se një dekadë pas konfliktit, akoma nuk janë mjaft të qartë sa i përket përkufizimit të tij.

Sipas një hulumtimi, nga viti 2006 (Tashevskia Remenski 2007: 192-193, ekstrakt) “pala shqiptare” sqarimet e veta lidhur me konfliktin i mbështet në pohimet se: a) konflikti është luftë për mbrojtjen e të drejtave dhe pozitën e shqiptarëve në Maqedoni, dhe b) konflikti është luftë për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të popullatës shqiptare e cila jeton në territoret e Ballkanit të

¹² Nacionalizmi i Ballkanit kuptohet si lëvizje ideologjike aktiviste që synon bashkimin e të gjithë njerëzve të një populli mbi bazë të kulturës së caktuar të përbashkët të supozuar. Si e tillë, lëvizja pretendon se e përfaqëson gjithë kolektivin, pavarësisht se si është përkufizuar, dhe ka prirje antagoniste ndaj pretendimeve të kulturave konkurrenente, në raport me kolektivin në përgjithësi ose të një pjesë të këtij kolektivi, ithtarët e të cilit konsiderojnë se përbën një komb real ose potencial (Poulton 2000: 6).

populluara me shqiptarë. Të dy pohimet përkojnë me angazhimin "i tërë populli shqiptarë të jetojë në një shtet të vetëm, në kufijtë e tij etnik" - e ashtuquajtur Shqipëri e Madhe, me thënien se konflikti ushtarak është konflikt i brendshëm i cili ka rezultuar nga frustracionet meqë shqiptarët janë qytetarë të rendit të dytë në Republikën e Maqedonisë. Sqarimet e "palës maqedonase" (qarqet politike, ushtarake, shkencore-analitike) për motivet e konfliktit janë se: a) Republika e Maqedonisë ishte objekt i agresionit nga krahina veriore Kosovë, b) Shqiptarët radikal në Maqedoni, të pakënaqur nga statusi i tyre shoqëror ("qytetarë të rendit të dytë"), të organizuar politikisht dhe si paramilitarë filluan me sulme të armatosura ndaj institucioneve të shtetit, me qëllim të krijimit të kushteve për pozita negociuese fleksibile me përfaqësuesit qeveritar të Republikës së Maqedonisë, dhe c) kthimi në histori dhe thirrje për idealin e ringjallur romantik për "Shqipëri të Madhe", ideal i cili asnjëherë nuk u shua në mesin e platformave politike dhe liderëve radikalë politikë të shqiptarëve në rajon.

Në pyetjen *Kush duhet t'i ndalojë luftëtarët e UÇK-së nga Kosova?*, koordinatori i Paktit të Stabilitetit për EJK – Bodo Hombach u përgjigj: "Ai që e ka fuqinë në Kosovë. Ai është KFOR-i. Ai e ka obligim, sipas të drejtës ndërkombëtare të sigurojë që asnjë kërcënim të mos vijë nga ai territor." (Macedonia: Stability Pact Coordinator on Prospects for Peace 2001). Krahas rolit të përcaktuar të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare (para së gjithash NATO) asnjëherë nuk do të pajtohet me përkufizimin e konfliktit si agresion nga Kosova. Në këtë mënyrë u vu në pikëpyetje mandati dhe qëllimet e NATO-s në Kosovë, para dhe gjatë kohë së konfliktit në Maqedoni. Po ashtu, përkufizimi i konfliktit si agresion nga Kosova nuk ka mbështetje të argumentuar (Batkovski 2012: 1-9) sepse konflikti lokal nuk ndodhi në mënyrë të paplanifikuar dhe për një kohë kaq të shkurtër nuk do të fitonte në intensitet pa mbështetjen aktive të popullatës lokale. Me nënshkrimin e Marrëveshjes, pjesëtarët e bashkësisë shqiptare duhej ta ridefinonin qëllimin e tyre në lidhje me kërkesat separatiste, kështu që angazhimet e tyre të mbeten të fokusuar në realizimin legjitim të të drejtave të specifikuar në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, të nënshkruar në formë të marrëveshjes paqësore

në gusht të vitit 2001. Nga aspekti i distancës kohore (më shumë se 12 vjet pas konfliktit), maqedonasit nuk janë të bindur se me Marrëveshjen janë përmbushur të gjitha aspektet e shqiptarëve në Maqedoni. Marrëveshja prodhoi përmbushjen e dëshirave të një grupi etnik kundrejt kërcënimit për rrezikimin e identitetit të shtetit dhe të drejtave të grupit etnikë shumicë. Në bazë të pasojave nga konflikti duhet të mendohet për detektimin e shkaqeve të tij dhe gjetjen e zgjidhjeve për parandalimin e konfliktit të ardhshëm, ndërtimin e qasjes rajonale të sigurisë sa i përket materies në lidhje me konfliktet ndëretnike dhe ndërtimin e kapaciteteve shtetërore për eliminimin e mundësisë për manipulime dhe keqpërdorime të fakteve reale për pozitën e bashkësisë shqiptare në Maqedoni.

Politikanët, e shfrytëzojnë Marrëveshjen për realizimin e qëllimeve politike dhe për zbatimin e objektivave të tyre mbi qytetarët, pa respektimin konsekuent të parimeve të kulturës së sigurisë, me nxitjen e tensioneve të politikës ditore dhe tensioneve ndëretnike. Marrëveshja çdoherë do të jetë temë për të cilën do të nevojitet angazhim i madh që të binden qytetarët e Republikës së Maqedonisë të flasin haptas - diçka për të cilën shoqëria maqedonase akoma nuk është e maturuar që ta pranojë edhe përkrah distancës kohore nga përfundimi i konfliktit. Mesazhi thelbësor nga nënshkrimi i Marrëveshjes konsiston në atë se gjeneratat e ardhshme duhet të nxjerrin mësim që të mos përsëriten gabimet nga e kaluara.

Marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me fqinjët janë marrëdhëniet më komplekse në Evropë. Në periudhën e pavarësisë, përveç Maqedonisë, të gjitha shtetet e pjesës Juglindore të Ballkanit ekzistojnë para saj. Maqedonia është çështja e vetme komplekse në të cilën të gjithë fqinjët e kanë hisen e tyre në përkufizimin e saj. Grekët insistojnë për "Maqedoni" si emër i provincës së tyre, bullgarët Maqedoninë e perceptojnë si "Bullgari Perëndimore", serbët e perceptojnë si pjesë të projektit Jugosllav,¹³ shqiptarët kanë interes për shkak të minoritetit me numër të madh të shqiptarëve dhe në fund Turqia inkuadrohet kur tanimë edhe Greqia është në lojë (Buzan & Waeber 2003: 380). Ndërtimi i paradokohshëm i kombit në Maqedoni, në mënyrë të pashmangshme

¹³ Deklarata është dhënë gjatë kohës së ekzistimit të Republikës Federative të Jugosllavisë, si Federatë e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi.

i antagonizoi grupet e tjera etnike, meqë procesi fundamental për afirmimin e një identiteti shpeshherë i provokon të tjerët që ta mbrojnë dhe afirmojnë identitetin e tyre të veçantë (Tranca 2008: 32). Është e pamundur të zhvillohet diskutim serioz për Maqedoninë pa u shqetësuar dikush apo, që është akoma më e besueshme, pa u shqetësuar të gjithë popujt ose shtetet e Jugut të Ballkanit (Glenny 1995: 24-28). Pavarësimi i shtetit prodhoi një serë konteste me fqinjët të cilët edhe sot e kësaj dite janë aktuale. Bullgaria nuk e njeh identitetin e popullit maqedonas dhe minoritetin maqedonas që jeton në Bullgari, kisha serbe nuk e njeh autoqefalitetin e Kishës Ortodokse Maqedonase, Kosova nuk i garanton kurrfarë të drejtash kushtetuese minoritetit maqedonas i cili jeton në zonën e Gorës, Shqipëria vazhdimisht i shmanget regjistrimit të popullsisë në bazë etnike, të drejtat e minoritetit maqedonas i ndërlihd me rajone të caktuara kufitare në të cilat jeton një pjesë e vogël e tij dhe instalon politika mbi baza diskriminuese ndaj popullatës joshqiptare dhe Greqia nuk e njeh as identitetin e popullit maqedonas, as emrin e shtetit, as kishën, as minoritetin maqedonas i cili jeton në atë vend.

Sipas Grupit Ndërkombëtar të Krizës (MKG 2001: 10, ekstrakt), konflikti i armatosur me shqiptarët jo vetëm që e shqetësoi bazën e marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni, por u dha një formë ndryshe marrëdhënieve të shtetit me fqinjët më të fuqishëm. Nëse politika fillestare e autoriteteve shtetërore nga vitit 1991 deri në vitin 1998 bazohej mbi politikën rajonale të "ekuidistancës" nga fqinjët e vet, për shkak të kërcënimeve të dyfishta ndaj Maqedonisë, nga ana e nacionalizmit shqiptar dhe pretendimeve tradicionale territoriale të fqinjëve, pas vitit 1998 kryeministri i atëhershëm Georgievski e përjashtoi konceptin e "ekuidistancës" dhe instaloi një koncept të ri "parimi i energjisë pozitive" (Georgievski 2001: 113). Politika e ekuidistancës nuk ofroi zgjidhje dhe i heshti dhe shtresoi sfidat e sigurisë. Më së shumti habit fakti se autoritetet maqedonase, si faktorë kryesorë për miratimin e vendimeve lidhur me sigurinë kombëtare, "aktronin" paqe në kushte kur në Maqedoni kishte propagandë aktive të huaj, prezencë ushtarake ndërkombëtare dhe tensione të theksuara ndëretnike. Qasja e Georgievskit, po ashtu, tregoi se energjia pozitive është në dëm të popullit maqedonas dhe se ka implikime afatgjata dhe serioze ndaj destruksionit të

identitetit maqedonas. Georgievskit i atribuohet se ka qenë ithtarë i krahut pro-bullgar të nacionalizmit maqedonas¹⁴ dhe opinionin publik u befusua kur në muajin shkurt të vitit 1999 ai pranoi që Bullgaria në aspektin formal t'i shmangte njohjes së gjuhës maqedonase¹⁵ (MKG 2001: 10). Ky akt mund të kualifikohet si vetëmosnjohje të kombit maqedonas (nga ana e autoriteteve zyrtare maqedonase), ky akt ishte hyrje në degradimin e identitetit të popullit maqedonas, i cili fitoi bazë formale me ndryshimet kushtetuese të cilat rezultuan nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe ky akt krijoi parakushte për obstrukcione të proceseve eurointegruese të Republikës së Maqedonisë nga ana e Bullgarisë.¹⁶

Karakteristikave të lartpërmendura u ndërlihet **reputacioni i shtetit dhe rajonit në marrëdhëniet ndërkombëtare**. Maqedonia dhe vendet e tjera të rajonit, manifestojnë kapacitetin periodik dhe të pamjaftueshëm për fitimin e marrëdhënies strategjike me shtetet – liderë në sigurinë ndërkombëtare. Meqë në rajon nuk ka vend në të cilin mund të identifikohen atributet e liderit, shumica e vendeve janë kualifikuar si “demokraci të reja” dhe “shtete të dobëta”. Ato janë të dobëta për shkak të kapacitetit të tyre institucional për qeverisje efektive dhe për shkak të shkallës së tyre të kohezionit të brendshëm dhe legjitimitetit. Faktorë plotësues, të cilët ndikojnë mbi kualifikimin e lartpërmendur, janë: struktura organizative e kontrollit të fuqisë dhe pozita e subjekteve politike të formuar në bazë etnike qysh në periudhën e hershme të pluralizmit politik demokratik. Dobësia e shtetit konfirmohet me dallime të mëdha ndërmjet interesave të shtetit dhe grupeve etnike, politike ose shoqërore të tij.

¹⁴ Në artikullin e tij (Georgievski 1995), ku Andovi e sulmoi për deklaratën se Bullgaria është armiku kryesor i Maqedonisë.

¹⁵ “Deklarata e përbashkët e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Bullgarisë”, përfundoi me një frazë ekuivalente: “Nënshkruar në Sofje më 22.2.1999, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën zyrtare të dy shteteve, gjuhën maqedonase në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe gjuhën bullgare në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Bullgarisë.” Praktika standarde në marrëveshjet ndërkombëtare konsiston me atë që të theksohet “në gjuhën maqedonase dhe bullgare”. Në këtë mënyrë Deklarata e dëshmon intencën bullgare për mohimin e gjuhës maqedonase.

¹⁷ Republika e Bullgarisë iu bashkëngjiti bllokimit të eurointegrimi të Republikës së Maqedonisë në Këshillin e BE-së, me atë që kërkoi nga Maqedonia të nënshkruaj marrëveshje për marrëdhënie të mira fqinjësore nën kushte të cilat janë të pranueshme vetëm për Bullgarinë dhe me të cilat mohohet identiteti maqedonas.

Analiza:

Në hulumtimin e vitit 2009 të anketuarit u përcaktuan për dy nga shtatë përgjigjet e ofruara lidhur me përkufizimin e gjendjes stabile të sigurisë. Së këtejmi, si grupe me numër më të madh të cilët janë përgjigjur në këtë pyetje u veçuan përgjigjet e të anketuarve – maqedonas dhe shqiptarë.

2009	Maqedonas	Shqiptarë
Gjendja stabile e sigurisë është mungesë e kërcënimeve të cilat do ta cenonin integritetin territorial të RM-së;	136 18,0%	18 10,8%
Gjendja stabile e sigurisë është mungesë e veprimeve të ngjashme të ngjarjeve nga viti 2001;	79 10,0%	17 10,2%
Gjendja stabile e sigurisë është shkalla e reduktuar e krimit të organizuar dhe korrupsionit;	65 8,0%	13 7,8%
Gjendja stabile e sigurisë është veprim i harmonizuar politik i partive politike me proveniencë të ndryshme etnike në procesin e integrimeve euroatlantike të RM-së;	42 5,5%	6 3,6%
Gjendja stabile e sigurisë janë marrëdhëniet e mira ndëretnike;	71 9,2%	21 12,7%
Gjendja stabile e sigurisë është gjendja e mirë ekonomike, standardi më i lartë i qytetarëve dhe siguria më e madhe sociale;	146 19,0%	26 15,7%
Gjendja stabile e sigurisë është respektimi i parimeve të sundimit të së drejtës dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.	154 20,0%	27 16,3%
Nuk janë përgjigjur	77 10,0%	38 22,9%
Gjithsej	770 100,0%	166 100,0%

Tabela 1: Përgjigjet e të anketuarve në pyetjen:
“Sipas Jush cili nga qëndrimet e theksuara më së miri e pasqyron qëndrimin e Juaj për gjendjen stabile të sigurisë?” (2009)

Edhe pse u ofruan më shumë qëndrime, si përgjigje në këtë pyetje, përgjigjet më të shpeshta të të anketuarve-maqedonas janë se “gjendja stabile e sigurisë nënkupton gjendje e cila e përjashton rrezikimin e integritetit territorial, konfliktet etnike,

krimin e organizuar dhe korrupsionin.“ Tek të anketuarit – shqiptarë bën përshtypje shumëllojshmëria e përgjigjeve të dhëna, që shpie në mungesë të perceptimit të qartë për gjendjen stabile të sigurisë. Megjithatë, përgjigjet kryesisht i fokusojnë mbi rrezikimin e integritetit territorial, çështjet ekzistenciale, marrëdhëniet ndëretnike dhe mundësisë për konflikt etnik.


2013	Maqedonas	Shqiptarë
1. Gjendja stabile e sigurisë është mungesë e kërcënimeve të cilat do ta cenonin integritetin territorial të Republikës së Maqedonisë.	78 28,9%	4 12,1%
2. Gjendja stabile e sigurisë është mungesë e veprimeve të ngjashme të ngjarjeve nga viti 2001.	8 3,0%	0 0%
3. Gjendja stabile e sigurisë është shkalla e reduktuar e krimit të organizuar dhe korrupsionit.	15 5,6%	6 18,2%
4. Gjendja stabile e sigurisë është veprim i harmonizuar politik i partive politike me proveniencë të ndryshme etnike në procesin e integriteteve euroatlantike të Republikës së Maqedonisë;	11 4,1%	0 0%
5. Gjendja stabile e sigurisë janë marrëdhëniet e mira ndëretnike;	16 5,9%	8 24,2%
6. Gjendja stabile e sigurisë është gjendja e mirë ekonomike, standardi më i lartë i qytetarëve dhe siguria më e madhe sociale;	49 18,1%	6 18,2%
7. Gjendja stabile e sigurisë është respektimi i parimeve të sundimit të së drejtës dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.	93 34,4%	9 27,3%
Gjithsej	270 100,0%	33 100,0%

Tabela 2: Përgjigjet e të anketuarve në pyetjen:
“Sipas Jush cili nga qëndrimet e theksuara më së miri e pasqyron qëndrimin e Juaj për gjendjen stabile të sigurisë?” (2013)


Në hulumtimin nga viti 2013 janë ofruar thuaja se përkufizime identike.

Të anketuarit - shqiptarë (27,3%) dhe maqedonas (34,4%) konsiderojnë se sundimi i së drejtës dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut janë kryesorë për gjendjen stabile të sigurisë.

Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve - maqedonas (28,9%) gjendjen stabile të sigurisë e ndërlidhin me mungesën e kërcënimeve ndaj integritetit territorial të shtetit, ndërsa 24,2% e të anketuarave – shqiptarë konsiderojnë se gjendja stabile e sigurisë kushtëzohet nga marrëdhëniet e mira ndëretnike.



Grafiku 4: Gjendja e sigurisë në Republikën e Maqedonisë (2009)



Grafiku 5: Gjendja e sigurisë në Republikën e Maqedonisë (2013)

Përafërsisht, gjysma e të anketuarve – maqedonas dhe shqiptarë konsiderojnë se gjendja aktuale në Maqedoni, e cila ka

të bëjë me vitin 2009, është "pjesërisht stabile", ndërsa notë e dytë tek maqedonasit është "stabile", ndërkaq tek shqiptarët është gjendja "jostabile" e sigurisë, me tendencë përmirësimi. Përmes këtyre qëndrimeve, lidhur me pasqyrën e përgjithshme të gjendjes së sigurisë, të anketuarit e manifestojnë ndjenjën individuale sa i përket sigurisë në Maqedoni. Në vitin 2013, 55,2% e të anketuarve – maqedonas dhe 60,6% e të anketuarve – shqiptarë e kanë përsëritur qëndrimin e tyre, përkatësisht gjendjen e sigurisë e konsiderojnë si "pjesërisht stabile". Kjo mbështetet në mungesën e konfrontimeve të drejtpërdrejta ndërmjet dy bashkësive më të mëdha etnike në Maqedoni, vetëm në rastet që janë nën regjinë e subjekteve politike për shkak të përfitimit të pikëve politike. Dallimi, tek shqiptarët dhe maqedonasit, sa i përket perceptimit kolektiv të gjendjes së sigurisë, mbështetet vetëm mbi gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike dhe mbi shkallën e kriminalitetit në vendet ku jetojnë të anketuarit.

Në intervistën me z. Bernard Valero (Bernard Valero), ish-ambasador i Francës në Republikën e Maqedonisë qëndrimi i tij, nga viti 2009, lidhur me gjendjen e përmirësuar të sigurisë në shtet bazohet në argumentet si vijojnë:

- Përmirësimi i gjendjes në rajon për dallim nga dekada e kaluar dhe fillimi i kësaj dekade;
- Pranimi i zgjedhjes së vetme të Republikës së Maqedonisë për integrimin euroatlantik, i cili ofron stabilitet sigurie dhe ekonomik në afat më të gjatë kohor;
- Reforma të implementuara strategjike në administratën publike (para së gjithash në subjektet e sistemit të sigurisë) dhe pushtetin lokal; dhe
- Nuk shfrytëzohen shërbimet ndërkombëtare të sigurisë (misione të cilat janë të pranishme në Maqedoni) për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Republikën e Maqedonisë. Përkundrazi, Maqedonia nga importues u bë eksportues i shërbimeve të sigurisë në kuadër të organizatave ndërkombëtare të sigurisë dhe sistemeve kolektive të sigurisë.

Në Maqedoni, nuk pritet të kthehet dhuna nga lufta qytetare prej para një dekade. Megjithatë, kontestet ndërmjet bashkësisë shqiptare dhe maqedonase mund të polarizohen në masë më

të madhe në vitin e ardhshëm. Tensioni ndërmjet Maqedonisë dhe Bullgarisë kërkon kujdes, përveç kësaj Greqia vazhdon ta kundërshtojë përdorimin e emrit "Maqedoni". Ky është edhe një burim i tensioneve dhe i njëjti i bllokon aspiratat e Maqedonisë për anëtarësimin në BE dhe NATO (Clapper 2013: 30).

Procesi i fillimit të negociatave për anëtarësimin në BE dhe pranimi i vendit në NATO dukshëm i zvogëlon rreziqet dhe mundësitë për konflikt në shtet. Prandaj, që të ketë një gjendje stabile të sigurisë, shteti duhet të gjejë mënyrë që të ballafaqohet me numrin e madh të problemeve ekonomike dhe sociale, si burime kryesore për shfaqjen e konfliktit.

3 SFIDAT E SIGURISË

Në kohën e lidhjeve globale midis shteteve, në të cilën është e shprehur nevoja për integrim më të madh (të përgjithshëm) në Evropë, është e pamundur që ndonjë shtet evropian të ndërtojë qasje të pavarur dhe të izoluar sa u përket çështjeve të sigurisë. Prandaj, sfidat e sigurisë dhe kërcënimet me të cilat përballeti shteti janë në korrelacion me ngjarjet e brendshme dhe të jashtme, si parametra kyç për përkufizimin e gjendjes së sigurisë në shtet. Në këtë kontekst, Al-Rodhan identifikon 11 sfida për sigurinë kombëtare në botën dinamike dhe të ndërvarur (Al-Rodhan 2008):

1. Ndryshimi i strukturave globale të fuqisë, rënia e shteteve dhe konfliktet rajonale.
2. Implikime të sigurisë së rritjes së popullatës, nga migrimi dhe nga krizat me refugjatë.
3. Revolucioni i teknologjisë së informacionit dhe siguria kombëtare.
4. Interaksione transcivilizuese.
5. Ndarja ekonomike në rritje dhe siguria energjetike.
6. Krimi i organizuar transnacional.
7. Aktorët jo-shtetërorë, terrorizimi dhe luftërat asimetrike.
8. Proliferacioni.
9. Privatizimi i sigurisë.
10. Shëndeti, sëmundjet dhe bio-siguria.
11. Siguria e mjedisit jetësor

Sipas një burimi tjetër, në listën e kërcënimeve të sigurisë dhe sfidave të sigurisë marrin pjesë: sulmet kibernetike, terrorizmi dhe krimi transnacional, proliferacioni i armëve për shkatërrim në masë, shëmbiet e inteligjencës, lufta për dominim të hapësirës¹⁷ (në të cilën gjenden instalime të ndryshme për navigacion, vëzhgime, shërbime inteligjente, realizim, metrologji, instalime të operatorëve të telekomunikacionit dhe ngjashëm), pasiguria dhe gara mes vendeve për posedimin dhe kontrollin e resurseve natyrore,

¹⁷ I cili është atraktiv për shkak se nga ai kanë përfitime shteti, subjektet civile, ushtria, shkencëtarët dhe ekonomia.

kërcënimet shëndetësore dhe të pandemisë dhe krimet në masë (Clapper 2013: 1-13). Sfidave dhe kërcënimeve të theksuara mund t'u shtohen: asimilimi dhe rreziku nga zhdukja e kombeve dhe popujve të caktuar, rreziku nga konflikti ndëretnik dhe nga forma të tjera të luftës civile, konflikti ndërreligjioz, dallimet sociale ndërmjet shteteve dhe ndërmjet tërësive të caktuara territoriale në kuadër të shtetit sa i përket zhvillimit ekonomik dhe shoqëror (sidomos në kuadër të rajoneve relativisht të lidhura gjeografike) e të tjera.

Sfidat e sigurisë përkufizohen varësisht nga interesat kombëtare dhe doktrina e sigurisë së shteteve. Edhe përkundër faktit se vendet, në kuadër të OKB-së pranojnë akte për përkufizimin dhe ballafaqimin me sfida të caktuara të sigurisë, megjithatë nuk ekziston një model universal për përkufizimin gjithëpërfshirës të sfidave dhe kërcënimeve kombëtare të sigurisë. Në bazë të përmbledhjes nga të gjitha sfidat e sigurisë, sfidat e Republikës së Maqedonisë mund të klasifikohen në tre grupe: *evropiane, rajonale dhe të brendshme*.

3.1 Sfidat evropiane

Sfidat evropiane janë të rëndësishme për kompletimin e imazhit për gjendjen e sigurisë të Republikës së Maqedonisë dhe për përcaktimin e orientimeve në politikën e sigurisë. Sfidat evropiane të Republikës së Maqedonisë e përcaktojnë korrelacionin e specifikave shtetërore të sigurisë me sfidat e përgjithshme evropiane të sigurisë. Specifikat rezultojnë nga rëndësia gjeopolitike e Maqedonisë në kuadër të sigurisë evropiane, nga pozita e saj gjeografike (si rrugë transitore e cila shpesh shfrytëzohet nga ana e rrjeteve të krimit transnacional, veçanërisht gjatë kontrabandës me drogë, trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit me klandestinë e të tjera), nga përcaktimet strategjike të shtetit që lidhen me proceset e integritit euroatlantik të tij (të cilët tani për tani, në gjysmën e dytë të dhjetorit 2013, janë formuluar nga obligimet e shtetit në kuadër të partneritetit me BE dhe me NATO) dhe nga mundësitë për bashkëpunim më intensiv të sigurisë të bazuar mbi marrëdhëniet që i ka Maqedonia me BE, me NATO, me OSBE dhe me Këshillin e Evropës, ndërkaq janë në kontekst të aspiratave euroatlantike dhe të pjesëmarrjes në kapacitetet ndërkombëtare civile dhe ushtarake.

Qasja ndaj sfidave të përgjithshme evropiane të sigurisë është analitike dhe deskriptive. Ato janë rezultat të ngjarjeve në një mjedis territorial shumë më të madh dhe me numër shumë më të madh të popullatës. Sfidat e përgjithshme evropiane të sigurisë shfaqen si pasojë e:

- dallimeve të zmadhuara në shkallën e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në BE dhe të pjesës tjetër të Evropës dhe ndërmjet Evropës dhe pjesës tjetër të botës;
- zhvillimit të terrorizmit ndërkombëtar në Evropë;
- trafikimit të paligjshëm me armë konvencionale dhe armë për shkatërrim në masë;
- migrameve masive ekonomike dhe politike dhe azil, të cilat u shfaqën si rezultat i konflikteve politike dhe ushtarake, të diskriminimeve racore dhe etnike dhe me rrezikimin e të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e regjimeve autokratike dhe jodemokratike në Evropë dhe në rajonin e saj; dhe
- rritjes së numrit të veprave të krimit (serioz dhe të organizuar) transnacional të cilat nxisin jostabilitet të përhershëm social dhe politik të shteteve.

Sfidat evropiane të sigurisë në masë të madhe përputhen me sfidat globale të sigurisë për shkak të rolit të rëndësishëm të disa vendeve evropiane në politikën ndërkombëtare (para së gjithash në Këshillin e Sigurisë të OKB-së, në BE dhe në NATO), dispersionin e interesave të shteteve evropiane dhe BE-së nëpër botë dhe transformimi i BE-së, nga faktori fillestar ekonomik në një faktor kompleks (ekonomik, politik dhe të sigurisë). Në dy dekadat e fundit, pozicioni i BE-së dhe i disa shteteve më të fuqishme evropiane u jep të drejtën t'i krijojnë orientimet e skenës ndërkombëtare të sigurisë.


BE fillimisht filloi të krijojë politika për ballafaqimin me sfidat evropiane në territorin e vet, pastaj vazhdoi me fqinjët (në bazë të supozimit se shtetet fqinje janë burime të mundshme të kërcënimeve dhe se gjithashtu janë të rëndësishme për sigurimin e kufijve dhe sigurinë në përgjithësi të Bashkimit Evropian) dhe në fund zhvilloi instrumente për intervenim dhe promovim ndërkombëtar.

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (CFSP), e cila u inkorporua në Traktatin e Mastrohrit, fill para hyrjes së tij në fuqi, më 1.11.1993, u dedikua për rregullimin e marrëdhënieve të BE-së me vendet e tjera lidhur me bashkëpunimin politik ndërkombëtar dhe të drejtën ndërkombëtare (duke i përfshirë edhe të drejtat e njeriut) dhe sigurinë. Pasi *Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP)*, e cila hyri në fuqi në vitin 1999, ndërsa u bë pjesë përbërëse e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP). Politika prodhoi intensifikimin e bashkëpunimit policor për shkak të lidhshmërisë së madhe të sigurisë së brendshme dhe të jashtme dhe e mundësoi bashkëpunimin e Europolit me misionet e saj. Më vonë, në fund të vitit 2009, me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës politika u aplikua në *Politikën Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CDSP)*. Për dallim nga Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes, e cila ishte trashëgimtare e identitetit evropian të sigurisë dhe mbrojtjes në kuadër të NATO-s dhe ishte nën juridiksionin e BE-së (duke përfshirë vende të cilat nuk janë pjesë të NATO-s), Politika e Përbashkët ekzistuese e Sigurisë dhe Mbrojtjes, nga aspekti formal, është në kompetencë të Këshillit të BE-së, në kuadër të së cilit takohen shefat e vendeve-anëtare.

Sqarimit të spektrit dhe etiologjisë së sfidave evropiane të sigurisë i ndërlidhet multilateralizmi dhe qasja holistike e BE-së ndaj kërcënimeve të sigurisë, që bazohen në ballafaqimin e përbashkët me problemet lidhur me sigurinë në Evropë, fillimisht të përfshirë në Strategjinë Evropiane të Sigurisë (Solana 2003). Strategjia, e cila e operacionalizoi atë për të cilën ranë dakord subjektet politike në kuadër të politikave evropiane, parashikoi se përveç ballafaqimit me kërcënimet, ajo ka nevojë që të fokusohet edhe mbi zgjerimin e zonës së sigurisë në rajonin e Evropës dhe në përfundimin e rendit ndërkombëtar. Zhvillimi i Strategjisë Evropiane të Sigurisë (2003) rezultoi me miratimin e *Strategjisë për Sigurinë e Brendshme* të BE-së për periudhën kohore 2010-2014.

Strategjitë e BE-së, në parim janë afatmesme dhe janë kompatible me ndryshimet, me dinamikën dhe me diversitetin e kërcënimeve të sigurisë në Evropë. Nga aspekti komparativ, në Strategjinë fillestare Evropiane të Sigurisë si pesë kërcënime kryesore të sigurisë u theksuan: terrorizmi, shpërndarja e

armëve për shkatërrim në masë, konfliktet rajonale, rrezikimi i shtetformësisë dhe krimi i organizuar, në Strategjinë për Sigurinë e Brendshme propozohet ballafaqimi me pesë sfida të sigurisë: terrorizmi, krimi i organizuar, katastrofat natyrore dhe humanitare, krimi kibernetik dhe siguria e kufijve të BE-së. Strategjia në mënyrë përkatëse i përgjigjet perceptimit të qytetarëve të BE-së për burimet e mundshme të rrezikimit dhe ofron mundësi për shfrytëzimin më racional të resurseve kombëtare dhe evropiane të sigurisë (para së gjithash në kuadër të BE-së dhe NATO-s). Në drejtim të konstatimit të theksuar janë rezultatet që i përmban Eurobarometri (instrument për matjen e opinionit publik në BE, zbatuar mbi publikun e gjerë), në të cilin qytetarët e rëndomtë janë më pragmatik dhe më konkret në identifikimin e sfidave evropiane të sigurisë.



Grafiku 6: Perceptimi i sfidave më të rëndësishme të sigurisë në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së në bazë të të dhënave nga 27 vende-anëtare të BE-së (EC 2011: 10, 18)

Sipas hulumtimit, përafërsisht tre të katërta (74%) e të anketuarve besojnë se siguria e brendshme e BE-së ndërlidhet me ngjarjet dhe situatat e jashtme, prej të cilave një e katërta (26%) konsiderojnë se të dy faktorët janë shumë të ndërlidhur. Një nga tetë

të anketuarit (12%) janë të mendimit se ngjarjet e jashtme nuk kanë të bëjnë me sigurinë e brendshme të BE, ndërsa 14% përgjigjen se nuk e dinë (EC 2011: 78). Ndikimi i kërcënimeve globale sqarohet me reagimin e efekteve të globalizimit dhe ndryshimeve politike në botë të cilat, në ditët e sotme, shpejtë barten në Evropë. I këtuillë është rasti me terrorizmin (pas vitit 2001) dhe me ndikimin e krizës ekonomike botërore nga viti 2008 mbi të gjitha llojet e sigurisë (kombëtare, financiare, korporative, humane, ekonomike, juridike etj.).

Në rezultatet nga hulumtimi, të cilat i përmban Eurobarometri, dominojnë rreziqet bashkëkohore të sigurisë. perceptimi i terrorizmit, si një nga kërcënimet kryesore ndaj sigurisë së qytetarëve të BE-së bën me dije se ekziston një interaksion i fuqishëm në sigurinë ndërmjet Evropës dhe Amerikës Veriore. Terrorizmi u shndërrua në kërcënim strategjik ndaj sigurisë për shkak të rritjes së aftësive të tij logjistike, financiare dhe operative. Si formë e krimit, aktivitetet terroriste janë karakteristike për nga interaksioni i tyre me vepra të tjera penale (kontrabandë me armë, kontrabandë me drogë, pastrim parash dhe ngjashëm), e që në fakt paraqesin mënyrë për financimin e tij. Aktivitete terroriste në Evropë shpesh ndërlihen me kërcënime të përdorimit të *armëve për shkatërrim në masë* për shkak të efekteve të tyre dhe fuqisë të cilën e fitojnë grupet terroriste përmes posedimit të këtyre llojeve të armëve. Grupet terroriste shërbehen me kërcënime përmes përdorimit të armëve për shkatërrim në masë, ndërsa shpërbërja e BRSS dhe, kohëve të fundit, kolapsi i regjimeve të caktuara nëpër botë, të cilët kishin kontroll mbi teknologjinë dhe prodhimin e këtyre llojeve të armëve, u shkonte në favor. Në këtë mënyrë u tregua se sa e lëndueshme është Evropa ndaj këtyre kërcënimeve. Kur bëhet fjalë për ballafaqimin me terrorizmin, BE dhe Evropa nuk kanë zhvilluar instrumente të mjaftueshme për përballjen me terrorizmin kur aktivitetet terroriste financohen nga ana e shteteve dhe veçanërisht kur bëhet fjalë për vende-anëtare ose vende partnere të Bashkimit Evropian.

Katastrofat humanitare (nëse janë shkaktuar nga konfliktet e armatosura) dhe terrorizmi janë vepra politike të dhunës mbi komunitetin. Përcaktimi i qytetarëve për këtë lloj të kërcënimeve, si kërcënim serioz ndaj sigurisë kombëtare, mund të sqarohet me

atë që ky lloj i kërcënimeve, në masë të madhe, janë vepra të përfaqësuara të cilat karakterizohen me transnacionalizmin e krimit dhe vepra të cilat kanë potencial të shkaktojnë forma të krimit transnacional (krizë ekonomike dhe financiare, varfëri, luftëra civile dhe luftëra).

Katastrofave humanitare u bashkëngjiten migrimet politike të cilat janë rezultat i gjendjes së brendshme dhe të rajonit të Evropës me shtete dhe rajone jostabile. Sfida karakterizohet me rritjen e varfërisë tek njerëzit të cilët jetojnë në zona të prapambetura ekonomike të një shteti, reduktimin e të drejtave të njeriut, shfaqjen e ideologjive ekstremiste, shfaqjen e korrupsionit dhe të tensioneve etnike dhe religjioze. Në Evropë, këto karakteristika i pasqyrojnë vatrat potenciale të krizës, të cilat kanë kapacitet të shndërrohen në konflikt më të gjerë ndëretnik, ndërreligjioz ose ndërkulturor. Nga ana tjetër, këtë profil të lokacioneve në Evropë lehtësisht e detektojnë organizatat kriminale të cilat e shfrytëzojnë gjendjen jostabile të sigurisë për kryerje të veprimeve të krimit të organizuar ndërkufitar, ndërsa organizatat terroriste shohin një terren në të cilin ata në mënyrë më të sigurt mund t'i kryejnë aktivitetet e tyre. Në këtë kontekst, Evropa mund të rrezikohet edhe nga jashtë. Shtetet dhe rajonet jostabile të cilat përveç asaj që karakterizohen me konflikte të armatosura, me regjime autoritare dhe jodemokratike shkaktojnë migrime masive, destinacioni i fundit i të cilave janë shtetet e zhvilluara të Evropës. Këtij fenomeni i ndërldihen dallimet ekonomike dhe teknologjike të Evropës me rajonin e saj dhe me vendet prej të cilave kryesisht vijnë migrantët.

Krimi kibernetik paraqitet si rezultat i zhvillimit të zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit të cilat ofrojnë qarkullim të shpejtë të informacioneve, mundësi teknike dhe kapacitete për transmetim. Në kontekstin e zhvillimit shoqëror, zhvillimi teknologjik perceptohet si një atribut pozitiv i çdo shoqërie të zhvilluar e cila synon ta përmirësojë standardin jetësor të qytetarëve. Zgjidhjet e teknologjisë së informacionit mundësojnë qasje të lehtë dhe të shpejtë deri te informacionet, por njëherësh paraqesin instrument për informimin e qytetarëve lidhur me kërcënimet e sigurisë. Nga ana tjetër, mundësitë e teknologjisë së informacionit kontribuojnë në drejtim të përmirësimit të punës së shërbimeve të policisë, të

forenzikëve dhe të shërbimeve të inteligjencës gjatë ballafaqimit me krimin. Megjithatë, zhvillimi i shpejtë i kapaciteteve të zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit e rritën rrezikun e ekspozimit të qytetarëve në ndikimin e burimeve vendase dhe ndërkombëtare të kërcënimeve dhe rreziqeve, ndërsa përdorimi i tyre masiv nga ana e qytetarëve kontribuon që ato të përdoren si mjet kryesor për kryerjen e veprave penale që ndërlidhen me krimin kibernetik.

Instrumenti nuk i potencon pikat kontestuese të cilat kryesisht rezultojnë nga dallimet në zhvillimin ndërmjet anëtareve të vjetra dhe të reja të BE-së, përfshirë edhe dallimet ekonomike ndërmjet Evropës Veriore, nga njëra anë, dhe Evropës Jugore dhe Lindore, nga ana tjetër. Dallimet, të cilat u theksuan veçanërisht pas krizës ekonomike në vitin 2008 dhe krizës debotore në Greqi dhe në shtete të tjera të BE-së, ndikojnë në procesin e krijimit të strategjive të sigurisë së Bashkimit Evropian dhe në procesin e veprimit operativ dhe planifikimin e kapaciteteve të sigurisë.

Vendi	Dokumenti strategjik	Tema kryesore
Britania e Madhe	Siguria në botën e ndërvarur (2008) Britani e fuqishme në epokën e pasigurisë (2010)	Inkorporimi i hierarkisë në tre shkallë të kërcënimeve. Niveli më i lartë përfshin: - terrorizëm (duke i përfshirë edhe sulmet potenciale me armë kimike, biologjike, radiologjike dhe nukleare); - sulmet kibernetike; - krizat ndërkombëtare ushtarake; - fatkeqësi të mëdha ose fatkeqësi elementare.
Franca	Libri i Bardhë i Mbrojtjes dhe i Sigurisë Kombëtare (2008)	Autonomia sipas "prejardhjes" Zmbrapsje nukleare Mbrojtja Inovacione Parandalimi i krizave
Holanda	Strategjia Kombëtare e Sigurisë dhe Programi i Punës (2007-2008)	Ndryshimet klimatike Polarizimi dhe radikalizmi Furnizimi me energji Rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar

Tabela 3: Tema kryesore në strategjitë kombëtare të sigurisë (Ungerer 2011: 5)

Në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë të Lituanisë, nga viti 2002, në kapitullin dedikuar sfidave, kërcënimeve dhe rreziqeve mbi sigurinë kombëtare, janë cekur: terrorizmi, krimi i organizuar, kontrabanda me armë, kontrabanda me drogë, mirgimi jolegal dhe epidemitë, si dhe varësia e furnizimit me energji dhe resurse për Lituanië vetëm nga një vend. Gjendja ekonomike, përfshirë edhe mirëqenien e popullatës dhe evitimin e zhvillimit të pabarabartë social dhe ekonomik dhe pavarësia e shtetit, gjithashtu janë potencuar si kërcënime të mundshme për sigurinë kombëtare. Bullgaria, në Konceptin për Sigurinë Kombëtare, nga vitit 1998, potencon se nuk ka kërcënim të drejtpërdrejtë ushtarak për sigurinë kombëtare. Në vend të kësaj, fokusi është vënë mbi çështjet, si vijojnë: krimi i organizuar (transnacional dhe ndërkufitar), kontrabanda (me drogë, armë dhe njerëz), tregtia jolegale (më së shumti me armë, me ç'rast shkelen embargot e KB-së), terrorizmi dhe shkatërrimi i mjedisit jetësor (Albrecht & Barnes 2008: 3, ekstrakt). Nga aspekti komparativ, si pjesë përbërëse e bashkësisë transnacionale të sigurisë, administrata e SHBA-ve i identifikon armët biologjike, armët nukleare, sulmet kibernetike, ndryshimet klimatike dhe krimin transnacional, si pesë kërcënimet më të rrezikshme për sigurinë kombëtare dhe globale (Erwin, Magnuson, Parsons & Tadjeh 2012).

Nëse izolohen karakteristikat lokale dhe rajone të shteteve evropiane, të cilat nuk janë pjesë të BE-së dhe integrimi jo i plotë i sigurisë në Evropë, imazhi për sigurinë në BE, në masë të madhe duhet ta pasqyrojë gjendjen e sigurisë në pjesën tjetër të Evropës.

3.2 Sfidat rajonale (ballkanike)

Në Ballkan, edhe më tutje historia dhe ambiciet për shtete të mëdha e problematizojnë ardhmërinë e qetë dhe nuk lejojnë shfrytëzimin maksimal të potencialit për bashkëpunimin rajonal.

Njëkohësisht, në garën për përfitimin e interesave të aktorëve të rëndësishëm strategjikë, në kuadër të sigurisë ndërkombëtare (BE, NATO, vendet të cilat janë pjesë të Këshillit të Sigurisë të OKB-së dhe vendet-lider në kuadër të BE dhe të NATO-s), secili nga vendet ballkanike dëshiron të paraqitet si më i rëndësishëm në aspekt

gjeostrategjik, me këtë rast, pa i perceptuar realisht mundësitë dhe kapacitetet kombëtare. Me rivalitetin historik ndërkombëtar dhe me mbështetjen ndërkombëtare, të cilën e kanë/e kanë pasur ndër vite shtete të caktuara ballkanike, të mbështetura me ambicie politike të liderëve politikë, shpjegohen shkaqet dominuese për nxitjen e konflikteve ndërshtetërore dhe të brendshme në hapësirat e Ballkanit, ndërkaq konfliktet ndërshtetërore shpeshherë ndërlidhen me shkaktimin e konflikteve të brendshme – si reagim i realizimit të interesave të ndryshme të grupeve të caktuara etnike dhe për shkak të urrejtjes midis grupeve të ndryshme etnike, të cilat jetojnë në kuadër të një tërësie të njëjtë territoriale.

Megjithatë, mund të thuhet se rajoni, pas një sërë ngjarjeve “fatkeqe”, shënon progres në menaxhimin me sfidat rajonale të sigurisë. Pas vitit 2000 (me rënien e regjimit të Slobodan Millosheviqit), të gjitha shtetet e EJT kanë qeveri të zgjedhura demokratike dhe shumica e shteteve kanë orientim të qartë euroatlantik. Tek shtetet ekziston transparencë, vullnet për bashkëpunim dhe në vazhdimësi investohet në avancimin e marrëdhënieve bilaterale dhe multilaterale, si dhe në drejtim të bashkëpunimit rajonal. Së këtejmi, shkalla e zhvillimit të bashkëpunimit rajonal është baza kryesore për ballafaqimin me sfidat rajonale. Prandaj, në periudhën poskonfliktuale, me ndihmën e faktorit ndërkombëtar (BE, SHBA dhe vende të treta, interes i të cilave është siguria e Ballkanit), shteteve të rajonit iu dha mundësia t’i perceptojnë predispozitat e bashkëpunimit rajonal të konceptuara mbi bazë reale, siç janë: e kaluara e përbashkët, ngjashmëria në mentalitet, ngjashmëritë ndërmjet shumicës së gjuhëve të cilat fliten në rajon, ndarja e vlerave të përbashkëta kulturore vendase dhe shoqërore, traditat dhe karakteristikat e sigurisë nga koha më e re. Gjithashtu, autoriteteve shtetërore iu ofrua koncept sipas të cilit duhej të kuptohej se asnjë shtet i rajonit nuk mund t’i përkufizojë interesat e tij të sigurisë pa i vendosur në një korrelacion me sfidat e sigurisë dhe me interesat e vendeve të rajonit. Ky është një mësim të cilin vendet e rajonit e kuptojnë deklarativisht, por kanë nevojë që ta përsërisin më së paku në çdo 50 vjet kur do t’i kuptojnë pasojat e luftërave ose nëse iu imponohet nga fuqitë e mëdha. Sikurse edhe gjatë Luftës së Ftohtë konfliktet e fundit në Ballkan dëshmuar se

përkrah asaj se fuqitë e mëdha i japin mbështetje njëres nga palët, ata drejtpërdrejtë nuk konfrontohen dhe zhvillojnë të ashtuquajtur “politikë praktike”.

Megjithatë, krahas mësimëve nga e kaluara dhe krahas marrëdhënieve të vendeve, sa i përket anëtarësimit të tyre në institucionet euroatlantike, ekzistojnë disa sfida rajonale të cilat kanë potencial të ndikojnë mbi imazhin e sigurisë të situatave në Ballkan.

Në EJT sfidë më e rëndësishme edhe më tej mbetet **neutralizimi i potencialit për krijimin e konfliktit ndëretnik**. Konfliktet etnike në botën bashkëkohore mund të shpjegohen përmes shqyrtimit të identitetit etnik dhe fetar, të cilët kanë rrënjë të thella sociale, historike dhe gjenetike (Gurr 1993). Grupet etnike paraqesin grupe të qytetarëve të cilët e perceptojnë vetveten, ose të tjerët i perceptojnë ata, si grupe të cilat ndajnë identitet të veçantë dhe identitet kolektiv afatgjatë, i mbështetur mbi besimin në origjinën, historinë, fatin, përvojat dhe bindjet specifike kulturore të përbashkëta (Odendaal 1998). Konfliktet ndëretnike shpeshherë ndërliken me qëllimin material dhe politik të grupit dhe përfshirjen e identitetit kulturor për arritjen e qëllimeve të caktuara (Në raste të caktuara ato mbështeten edhe mbi orientimin radikal të disa grupeve të caktuara etnike). Në rajon më i pranishëm është mobilizimi etno-politik i grupeve si mënyrë me të cilën ata mobilizohen kundër shtetit të tyre, meqë janë të mendimit se janë të privuar nga disa të drejta të caktuara dhe paraqiten në formë të pakënaqësisë gjatë realizimit të interesave të tyre. Si rezultat i mobilizimit etno-politik, në Ballkan dominojnë partitë politike të formuara në bazë etnike dhe identiteteve etnike u jepet përparësi para atyre qytetare. Nga ana tjetër, mobilizimi etno-politik mund të shqyrtohet si reagim i grupeve etnike ndaj represionit nga ana e pushtetit, me të cilin ai dëshiron ta fitojë lojalitetin e tyre, me supozim (i cili njëherësh mund të jetë edhe stereotip) se grupe të caktuara etnike janë jolojale ndaj shtetit dhe paraqesin burim të vazhdueshëm të kërcënimeve ndaj sigurisë. Prandaj, në bazë të përvojave nga e kaluara, si instrumente për nxitjen dhe përballjen me problemet ndëretnike, rajoni e ka të njohur: nacionalizmin ekstremist, retorikën e luftës dhe ideologjinë anakronike ushtarake - politike.

Shfaqja e konflikteve dëshmoi se popujt në shumicën e shteteve ballkanike lehtë u nënshtrohen manipulimeve nga ana e politikanëve, kështu që fajin për destabilizimin e paqes, marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe ndëretnike, besimit dhe tolerancës, nuk duhet ta kërkojmë vetëm tek autoritetet politike. Motivet për shfaqjen e konflikteve etnike shpjegohen me karakteristikat e shteteve – demokraci relativisht të reja të cilat vështirë ballafaqohen me procesin e tranzicionit shoqëror, zhvillimin historik të shoqërive dhe papjekurinë politike të bartësve të pushtetit. Mungesa e të qenit shtetformues, në pjesën më të madhe të historisë së vendeve të rajonit, kontribuoi të prolongohet procesi i krijimit të kombeve/ shteteve dhe realizimi i nevojave për përkatësinë kombëtare. Qasja jopërkatëse në zgjidhjen e problemeve ndëretnike, në kuadër të shteteve dhe ndërmjet shteteve, rezultoi me një periudhë të gjatë të rehabilitimit postkonfliktual të shoqërive dhe me prezencën afatgjatë të pasojave ekonomike, sociale dhe psikologjike.

Në të ardhmen qasja ndaj sfidave rajonale duhet të jetë një kombinim i mësimëve të nxjerra dhe ambicieve aktuale të shteteve lidhur me aspiratat e tyre euroatlantike dhe zhvillimin ekonomik. Në këtë kontekst, është e pritshme që shteteve të caktuara (përfshirë edhe Maqedoninë) në një të ardhme relativisht të afërt t'u imponohet nevoja për ballafaqimin me potencialin e konfliktit ndëretnik të nxitur nga vizionet për krijimin e shteteve të mëdha njënacionale. Dimensioni relativ kohor i sfidës së theksuar rajonale, para së gjithash, varet nga zhvillimi ekonomik i shteteve dhe nga realizimi i interesave strategjike shtetërore lidhur me anëtarësimin në BE dhe NATO.

Megjithatë, çështja e hapur për shfaqjen e konflikteve ndëretnike mbetet stigmë mbi identitetin e Ballkanit, madje edhe në situatë kur progresi i përgjithshëm i shteteve është i pandalshëm.

Marrja e barrës së sigurisë rajonale mbi vete, përkatësisht si pjesë e identitetit rajonal, është njëra nga sfidat e EJK e cila ka mundësi reale të realizohet. Krahas investimeve të mëdha dhe mbështetjes së BE-së, NATO-s dhe partnerëve të tretë të përfshirë në integrimin rajonal të sigurisë, politik dhe ekonomik, prezenca tepër e gjatë e forcave ndërkombëtare të sigurisë (OKB, NATO dhe BE) në rajon, vështirë se do mund ta largojë Ballkanin nga karta botërore e krizës.

Ndërtimit të identitetit të vet të sigurisë, të bazuar mbi bashkëpunimin e përforcuar rajonal të sigurisë i shkon në favor komunikimi i përforcuar ndërmjet shteteve të rajonit, që është parakusht vendet e rajonit të mund të imponojnë zgjidhje në të cilat janë inkorporuar kontekstet lokale të gjendjeve të sigurisë. Kjo qasje i tejkaloi kornizat e modelit shabllon të rehabilitimit postkonfliktual (vendosja e sistemit të shtetit juridik me formimin/reformën e strukturës së sistemit të sigurisë, zbatimin e ligjeve dhe ndihmë gjatë funksionimit të jurisprudencës) e që në disa raste në Ballkan u tregua si iracional dhe jopërkatës.

Ajo për të cilën më së shumti apelohej gjatë komunikimit të rajonit me institucionet, siç janë: BE, NATO, OSBE dhe KiE është **ballafaqimi me korrupsionin dhe me krimin e organizuar**. Në periudhën e shpërbërjes së RSFJ, pas luftërave dhe pas një sërë reformash në shtetet, rajoni e dëshmoi se është vulnerabil ndaj formave tradicionale dhe bashkëkohore të krimit (trafikim me njerëz, kontrabandë me armë dhe drogë, trafikim me organe të njeriut, trafikim të klandestinëve, shfaqja e grupeve terroriste etj.). Shoqatat transnacionale kriminale, të cilat zakonisht nga aspekti kadrovik dhe teknik janë më mirë të pajisura nga shërbimet ekzistuese shtetërore të sigurisë, u treguan më të shkathëta në shfrytëzimin e dobësive të legjisllacionit, koordinimit të dobët operativ ndërmjet shërbimeve kombëtare të sigurisë dhe shkallës së ulët të veprimit represiv të institucioneve të jurisprudencës dhe të sigurisë. Për tejkalimin e kësaj sfide, në rajon u shtruan disa nisma rajonale të cilat rezultuan me formimin e organeve koordinuese të cilët funksionojnë sipas parimeve të bashkëpunimit ndërkombëtar policor.¹⁸ Ballafaqimi me krimin transnacional kërkon përparim në përfshirjen e instrumenteve dhe formave të bashkëpunimit operativ të sigurisë – diçka që është nevojë e domosdoshme e shërbimeve të sigurisë, ndërsa njëkohësisht është vështirë e pranueshme për politikanët meqë me bashkëpunimin e theksuar operativ të sigurisë aktualizohet çështja e rrezikimit të sovranitetit dhe besimit gjatë shkëmbimit të të dhënave. Me këtë sfida përballet edhe BE, kështu

¹⁸ Iniciativat mbështesin dhe implementojnë bashkëpunim siç praktikohet në kuadër të Interpolit, bashkëpunim bilateral policor (qendra të përbashkëta për bashkëpunim policor dhe doganor, patrulla kufitare binacionale dhe ngjashëm), nënshkrim të marrëveshjeve operative dhe strategjike me agjencitë e BE-së që kanë të bëjnë me drejtësinë dhe punët e brendshme, etj.

që edhe krahas asaj që ekzistojnë angazhime të caktuara dhe baza ligjore, nuk është reale të pritet ndonjë përparim më i madh në rajon në një të ardhme të afërt.

Po ashtu, duhet të theksohet fakti se vendet të cilat përmes integritimit në BE dhe NATO shënuan progres, edhe pas pranimit në këto organizata autoritetet e tyre nuk e ndryshuan raportin për çështjet lidhur me ballafaqimin me krimin e organizuar dhe korrupsionin – faktorë të cilët janë indikatorë të fuqishëm për progresin e shoqërisë në procesin e përmbushjes së standardeve evropiane.

Kontestet bilaterale ndërmjet vendeve-anëtare dhe vendeve-kandidate për anëtarësim në BE dhe NATO, përveç që paraqesin problem në integritet euroatlantike, kanë implikime të sigurisë edhe mbi stabilitetin rajonal. Kontestet nuk kontribuojnë në drejtim të përforsimit të bashkëpunimit në ballafaqimin me krimin transnacional dhe ndërkufitar. Kontestet bilaterale bazohen në marrëdhëniet e së kaluarës historike, të mbështetura mbi një doktrinë konkrete (Batkovski 2013; Mirčev 2012), kanë një propagandë të theksuar të fuqishme nacionaliste dhe për shkak të raportit pasiv të komunitetit ndërkombëtar ose të shteteve më të fuqishme në kuadër të politikës ndërkombëtare një ose disa nga palë fitojnë mbështetjen ndërkombëtare.

Terrorizmi në kornizat rajonale akoma nuk është e qartë se a është shfaqur si trashëgimi nga veprimet e armatosura në Ballkan, si përpjekje e bashkësisë ndërkombëtare që në mënyrë eksperimentale ta hulumtojë fenomenologjinë e tij në kuadër të një hapësire të kontrolluar ndërkombëtarisht ose si kombinim nga të dyja presupozimet. Terrorizmi në Ballkan ndërlidhet me veprimet e grupeve të caktuara kulturore (për shembull, Vahabistët), ndërsa caku i aktiviteteve të tyre janë qytetarët, sistemi i sigurisë i shteteve dhe subjektet e huaja të pranishme në rajon. Si në kuadrin global ashtu edhe në atë rajonal terrorizmi nuk mund të izolohet nga format e tjera kriminale (krimi i organizuar, korrupsioni, kontrabanda me drogë, armë, trafikimi me njerëz dhe organe njerëzore, pastrim dhe falsifikim parash dhe trafikimi me klandestinë).

Në procesin e eurointegritimeve, me fitimin e liberalizimit të vizave të shteteve, rajoni përballlet me presion që ta zgjidh **problemin e numrit të rritur të personave nga rajoni të cilët kërkojnë**

azil në pjesën më të zhvilluar të BE-së (të ashtuquajtur “azilantë të rrejshëm”) dhe problemin me migrantët ilegal ekonomik të cilët tranzitojnë nëpër vendet e rajonit. Kjo në masë të madhe i ngarkoi policitë kufitare, të cilët janë filtri i fundit për hyrjen e këtyre dy kategorive të migrantëve në BE. Vendet, në përputhje me standardet e BE-së dhe të zonës së Shengenit, gjatë ballafaqimit me këtë lloj të sfidave e implementojnë sistemin e menaxhimit të integruar të kufijve. Sistemi, i cili është në fazë të avancuar të implementimit, paraqet përgjigje më përkatëse ndaj sfidave lidhur me migracionin ilegal dhe sfidat shoqëruese, siç janë: trafikimi me njerëz, trafikimi me klandestinë dhe kontrabanda me drogë.

3.3 Sfidat dhe kërcënimet e brendshme

Sfidat e brendshme në detaje e pasqyrojnë gjendjen e sigurisë në shtet. Në këtë kontekst, përmes korrelacionit të gjendjes së sigurisë dhe sfidave të brendshme përcaktohen nevojat e sistemit të sigurisë dhe specifikohen orientimet zhvillimore të politikës së sigurisë. Si të përkufizuara në strategjinë e vet të sigurisë kombëtare, Maqedonia i numëron këto kërcënime kryesore ndaj sigurisë së saj lidhur me rreziqet e brendshme: degradimi ekologjik, krimi i organizuar, terrorizmi ndërkombëtar, konflikte ndëretnike dhe religjioze dhe jostabiliteti i vazhdueshëm nga Kosova (IFPA 2002:104). Meqë kërcënimet e theksuara në vazhdimësi ndikojnë mbi sigurinë e shtetit është më adekuate që të njëjtat të analizohen nga aspekti kohor – si sfida të sigurisë të cilat e shënuan dekadën e parë dhe të dytë të pavarësimit të Republikës së Maqedonisë.

Sfidat e brendshme të sigurisë të cilat ishin pjesë e **dekadës së parë** të ekzistimit të Republikës së Maqedonisë me sfida pjesërisht ekskluzive, por në pjesën më të madhe përkojnë me sfidat rajonale dhe sfidat globale të sigurisë.

Në fillimin e viteve të njëzeta të shekullit të kaluar, Maqedonia ballafaqohej me pesë probleme kryesore afatgjata, me ç’rast secili duhej të zgjidhej me sukses në mënyrë që vendi të siguronte ardhmëri si anëtare me të drejta të plota në bashkësinë euroatlantike. Problemet kryesore ishin si vijojnë: nevoja e ndërtimit të paraqitjes

më unike të elitave politike dhe intelektuale në Maqedoni, tensionet në marrëdhëniet ndëretnike, ritmi i ngadaltë i transformimeve demokratike, situata gjithnjë e më e keqe shoqërore-ekonomike dhe marrëdhëniet jo aq miqësore bilaterale ndërmjet Maqedonisë dhe shteteve fqinje (Sokalski 2005: 100). Maqedonia në shikim të parë mirë e kupton se është shembull kritik për jostabilitetin e Ballkanit. Në kundërshtim me identitetet politike, padrejtësisë ekonomike dhe konfliktet rajonale, që moti parashikohet fundosje e kombit-shtetit të vogël (Liotta & Jebb 2002). Pranimi i emrit me kompromis (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) në kuadër të OKB-së ishte kusht për njohjen ndërkombëtare të shtetit dhe për fitimin e subjektivitetit juridik i cili i mundësoi anëtarësim më FMN dhe fitimin e statusit vëzhgues në KSBE. Emri ishte shkak për embargon greke,¹⁹ ndërsa raporti i autoriteteve greke, sa i përket këtij problemi të imponuar, ka tendencë të zgjasë për një kohë të gjatë dhe është larg zbatimit adekuat të parimeve në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikës ndërkombëtare. Republika e Maqedonisë pranoi emër për përdorim të përkohshëm, e ndryshoi flamurin dhe Kushtetutën - e gjitha kjo e iniciuar nga ana e Greqisë, por prapë se prapë shteti mbeti i ngujuar në proceset eurointegruese. Kjo e justifikon supozimin se çdo reterim i mëtutjeshëm me dhe pa garancinë e fuqive të mëdha nuk do të jetë në favor të realizimit të interesave strategjikë të Republikës së Maqedonisë – integrimi në BE dhe NATO.

Në periudhën e theksuar karakteristike është raporti i bashkësisë ndërkombëtare ndaj RF të Jugosllavisë (nga shpërbërja e RSFJ deri në rënien e regjimit të Millosheviqit) në të cilin në disa raste Maqedonia ishte viktimë kolaterale për shkak të bllokadës së OKB-së ndaj Serbisë (e cila në atë kohë ishte partneri kryesor tregtar i Maqedonisë). Nga viti 1994, bllokada anti-Jugosllave i kushtoi Maqedonisë 3 miliardë dollarë amerikan. Duke i llogaritur presionet nga kriza e Kosovës, të vitit 1999, disa përllogaritje tregojnë se Maqedonia nga koha e pavarësisë së saj ka humbur më shumë se tetë miliardë dollarë amerikan (Liotta & Jebb 2002).

Si sfidë e fundit dhe më serioze e sigurisë, me të cilën u ballafaqua Maqedonia në fund të kësaj periudhe, ishte shfaqja e konfliktit të armatosur në vitin 2001, i cili përfundoi me nënshkrimin

¹⁹ Gjashtë javët nën bllokadën greke, ekonomikisht Maqedonisë i kushtuan 80 milionë dollarë në muaj, përkatësisht 85% nga fitimi i saj i eksportit (Liotta & Jebb 2002).

e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.²⁰ E nënshkruar më 13 gusht të vitit 2001, Marrëveshja Kornizë e Ohrit paraqet një pakt, ndërmjet shumicës maqedonase dhe minoritetit më të madh etnik – shqiptarët, e bazuar në marrëveshje për ndarjen e pushtetit. Qëllimi ishte që në Maqedoni të zbatohet një model më i lartë i “shtetit civil” që të shmangen konsekuencat e Dejtonit ku baza e zgjidhjes konsistonte në përkatësinë etnike të palëve të involvuara (MKG 2001: 8, ekstrakt). Nënshkrimi i Marrëveshjes Kornizë zhvillohej nën presion të fuqishëm ndërkombëtar, nën presionin e publikut dhe në kushte kur në mënyrë më të shprehur ndjeheshin pasojat nga konflikti. Dy subjektet më të mëdha politike nuk kishin mundësi të kërkonin zgjidhje alternative dhe të justifikohen para publikut. Me pretekst ose me shpjegime se me Marrëveshjen Kornizë arrihet një shkallë më e lartë e shoqërisë civile, kombi maqedonas u riformulua në bashkësi etnike maqedonase në shtetin e tij. Ky është një interpretim shumë i gabueshëm i modelit të shoqërisë civile meqë me modelin mund të riformulohet rregullimi shoqëror, por jo edhe identiteti i një kombi.

Sfidat e brendshme, të cilat e shënuan **dekadën e dytë** pas pavarësisimit të shtetit kanë të bëjnë me implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, me depolitizimin e sistemit të sigurisë, me angazhimet intensive për integrimin tonë në BE dhe NATO, me ndërtimin e institucioneve të shtetit, sipas standardeve evropiane dhe me fitimin e pjekurisë politike.

Sipas njërit nga dokumentet strategjik (paragrafi 24 nga Nacionalna koncepcija za bezbednost i odbrana 2003) në rreziqe dhe kërcënime ndaj sigurisë së Republikës së Maqedonisë bëjnë pjesë:

- manifestimet e mundshme të nacionalizmit ekstrem të mostolerancës racore dhe fetare;
- format dhe aktivitetet e ndërlidhura me terrorizmin ndërkombëtar, krimin e organizuar, migrimin jolegal, kontrabandën me drogë, armë dhe njerëz, me materiale strategjike për përdorim të dyfishtë, si dhe me pasojat nga përdorimi i mjeteve për shkatërrim në masë;

²⁰ Marrëveshja Kornizë përbëhet nga: 1) Parime themelore; 2) Ndërprerja e armiqësisë; 3) Zhvillimi i pushtetit të decentralizuar; 4) Mosdiskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë; 5) Procedura të veçanta parlamentare; 6) Arsimi dhe përdorimi i gjuhëve; 7) Shprehja e identitetit; 8) Implementimi; 9) Aneks: a. Amandamente kushtetuese, b. Ndryshime të legjisllacionit, c. Implementimi dhe masa për ndërtimin e besimit, dhe 10) Dispozita përfundimtare.

- posedimi i sasive të mëdha të armëve ilegale;
- problemet e tranzicionit siç janë: korrupsioni, terrorizmi urban, krimi i rëndë, përfshirë edhe shantazhe, gjobëvënie, vrasje dhe sulme mbi pronën e qytetarëve, krimi ekonomik, evazioni tatimor, mosngritja në nivelin e duhur të institucioneve të sistemit demokratik, problemet në funksionimin e gjyqësorit, problemet sociale dhe papunësia;
- aktivitetet e shërbimeve speciale të huaja të orientuara kah përkeqësimi i gjendjes së sigurisë dhe me këtë edhe ngadalësimi i proceseve demokratike dhe integruese, veçanërisht ato drejt NATO-s dhe BE-së;
- pasojat nga konflikti i interesave për shfrytëzimin e burimeve dhe rrugëve të energjensave strategjike, si dhe pengimi dhe bllokimi i importit të tyre në Republikën e Maqedonisë;
- fatkeqësitë elementare dhe fatkeqësi të tjera, katastrofat teknike-teknologjike, sëmundjet infektive të njerëzve dhe kafshëve të shkaktuara nga faktorë të brendshëm dhe/ose të jashtëm;
- krimi kibernetik, pirateria dhe abuzimi i teknologjisë së informacionit, veçanërisht në pjesën e të dhënave personale të qytetarëve, në pjesën e sekretit afarist, zyrtar dhe shtetëror;
- degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit jetësor.

Duke e perceptuar nga perspektiva kohore (në fund të vitit 2012) mund të konkludohet se një pjesë e problemeve të sigurisë së shtetit janë rezultat i procesit tepër të gjatë të tranzicionit të shoqërisë, një pjesë daton nga koha e pavarësimit të shtetit nga ish- RSFJ, ndërsa pjesa tjetër është pasojë e ndarjes së shoqërisë në baza etnike dhe politike. Marrë në përgjithësi, qasja për përballjen me sfidat e brendshme të cilën e kishte shteti në vitet e kaluara (lëshime pe për emrin gjatë pranimit në OKB, ndryshimi i Kushtetutës në vitin 1992 dhe më vonë ndryshimi i flamurit, pranimi i mbi 250'000 refugjatëve (FAO 1999) dhe mundësimi i forcave të NATO-s të kalojnë përmes territorit të tij gjatë kohës së krizës në Kosovë në vitin 1999, ndryshimi i Kushtetutës nën presionin ndërkombëtar në vitin 2001 dhe ndërprerja e konfliktit të armatosur të brendshëm, kontributi me numër të konsiderueshëm të pjesëtarëve të forcave të sigurisë në misionet ndërkombëtare të BE-së dhe NATO-s dhe

të trupave të tjerë ndërkombëtare, puna e të cilëve ka të bëjë me sigurinë ndërkombëtare), nuk është mirëfilli i identifikuar nga ana e bashkësisë ndërkombëtare dhe më së paku nga BE dhe nga NATO të cilët bën shumë pak që t'i zbusin pasojat e ballafaqimit me sfidat e brendshme të shtetit.

Në përgjithësi, në bazë të përvojave që kanë të bëjnë me sigurinë e ekzistimit dydekadësh të Republikës së Maqedonisë dhe me potencialin e kërcënimeve të brendshme, pasqyra e përgjithshme e sfidave të brendshme të sigurisë karakterizohet me një diversitet të madh. Në të janë përfshirë kërcënimet politike, ekonomike, demografike, etnike dhe ushtarake ose kombinimi i disa prej tyre. Përgjithësisht, si sfida më specifike të brendshme të sigurisë mund të veçohen:

- Zbatimi i regjistrimit të popullsisë;²¹
- Ruajtja e marrëdhënieve ndëretnike deri në shkallë e cila e garanton sigurinë dhe stabilitetin e shtetit;
- Ekstremizmi nacionalist i cili buron nga animozitetet anakronike politike dhe shoqërore që kanë të bëjnë me realizimin e interesave të vogla partiake;
- Mungesa e konsensusit politik për çështje me interes kombëtar;
- Shkalla e mbrojtjes së kufijve shtetërorë;
- Posedimi ilegal i armëve dhe municionit;
- Akuzat për mosrespektimin dhe mospërbushjen e obligimeve nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Disa politikanë shkojnë aq larg sa që kërkojnë anulimin dhe lidhjen e marrëveshjes së re, e cila shpie në drejtim të federalizmit të shtetit;
- Vullneti i pamjaftueshëm politik për kthimin e personave të

²¹ Të dhënat nga regjistrimi i vitit 1994 të cilat politikanët e bllokut të partive shqiptare në Maqedoni i konsideronin se janë joreale ishin njëri nga shkaqet që Kushtetutën ta quajnë "gjenerator të krizës" (deklaratë e Muhamed Halilit (PPD), e përditshmja Fakti, Shkup, viti 2.4.2001). Motivet e kësaj deklarate kanë të bëjnë me atë që një numër i madh i popullatës shqiptare, para së gjithash politikanët nga blloku i partive të shqiptarëve në Maqedoni, konsideronin se të dhënat e regjistrimit të vitit 1994 nuk janë të vërteta meqë numri i bashkësisë shqiptare në Maqedoni është më i madh se 40% nga popullsia e përgjithshme, kundrejt 22,9%, të dhëna të fituara nga regjistrimi në muajin qershor të vitit 1994. Argumenti i dytë për kritika ndaj Kushtetutës ishte statusi i shqiptarëve në Maqedoni të cilët në Preambulën e Kushtetutës janë përkufizuar si minoritet. Bashkësia shqiptare, sipas disa burimeve Jozyrtare, nuk është më shumë se 17%. Në bazë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, kusht për t'i gëzuar të gjitha privilegjet në pushtetin qendror dhe lokal është të ketë më së paku 20% përfaqësim të bashkësisë etnike, në kuadër të shtetit ose të njësisë territoriale.

zhvendosur në zonat e krizës nga viti 2001;

- Çështja e minoritetit maqedonas në fqinjësi, si pjesë e pandashme e kauzës maqedonase dhe të interesave mbinacionale maqedonase;²²
- Pasojat nga formimi i ngathët i organeve përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe bashkëpunimi i dobët integruar;
- Fuqia teknologjike e shumicës së kapaciteteve ekonomike;
- Efektet e transformimit të gjatë nga prodhimi ekonomik në ekonomi të tregut, që kanë të bëjnë me numrin e vogël të investimeve të huaja dhe vendase që e mundësoi zhvillimin e ekonomisë gri dhe të tregut informal;
- Shkalla e lartë e papunësisë e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon mbi shkallën e varfërisë, krijimin e shtresave shoqërore, shfaqjen e dukurive socio-patologjike dhe zhvillimin e formave të tjera të pasigurisë shoqërore dhe juridike;
- Emigrimi ekonomik i intelektualëve;
- Migrimi ilegal, trafikimi me njerëz dhe trafikimi i klandestinëve;²³ dhe
- Sfidat ekologjike lidhur me moszbatimin e ligjeve nga kjo fushë dhe me mungesë të vetëdijes tek qytetarët.

Zgjidhja e një numri të madh të sfidave të brendshme, në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërlidhet me përmbushjen e kërkesave të BE-së në procesin e negociatave për anëtarësim. Në këtë mënyrë, me zgjidhjen e sfidave të brendshme kontribuohet për një jetë më të qetë, më të sigurt, më të mirë dhe më kualitative të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe për funksionimin papengesa të institucioneve të shtetit.

²² Për fat të keq, Maqedonia nuk u përkushton vëmendje të mjaftueshme maqedonase në vendet fqinje, meqë qëndrimi i painteresuar dhe neutral i autoriteteve maqedonase shpesh justifikohet me mosndërrhyrje në punët e brendshme të fqinjëve. Minoriteti maqedonas në shtetet fqinje duhet të paraqes urë bashkëpunimi ndërkuftar meqë në përputhje me konceptin e BE-së dhe të zonës së Shengenit është gjithnjë e më e sigurt se kufijtë do të paraqesin vetëm vijat formale të cilat ndajnë dy ose më shumë shtete të integruara në kuadër të strukturës së BE-së.

²³ Raportet e fundit ndërkombëtare për Maqedoninë në këtë fushë flasin për një progres të madh në luftën kundër trafikimit me njerëz. Sipas KiE Maqedonia shënon progres në këtë fushë (SEP 2013).

3.3.1 Kërcënimet politike dhe etnike


Kërcënimet politike burojnë nga gjendja e brendshme politike dhe nga marrëdhëniet e jashtme të shtetit. Si parametra më të rëndësishëm për përcaktimin e kërcënimeve politike mund të theksohen: marrëdhëniet ndërmjet pushtetit dhe opozitës, kontesti me emrin, marrëdhëniet me fqinjët, implementimi i Marrëveshje Kornizë të Ohrit, përkufizimi i paqartë i interesave dhe prioriteteve kombëtare, formimi i partive politike mbi bazë etnike, skandale në sistemin e sigurisë lidhur me shfrytëzimin e tij për qëllime politike dhe ngjashëm. Kërcënimet etnike perceptohen përmes mundësive të tyre për iniciimin e konflikteve të dhunshme të motivuara në aspektin nacionalist dhe etnik. Së këtejmi, në përputhje me gjendjet të cilat sundojnë në shoqërinë maqedonase, rezulton se ekziston një interaksion i fuqishëm midis kërcënimeve politike dhe etnike. Rëndësia që i jepet interaksionit të kërcënimeve politike dhe etnike ka të bëjë me supozimin se kërcënimet etnike, të motivuara për realizimin e qëllimeve politike, janë faktori më serioz për destabilizimin e brendshëm të shtetit. Kësaj i ndërlidhet edhe fakti se më së shpeshti tensionet ndëretnike janë të motivuara politikisht, ndërkaq për qetësimin dhe tejkalimin e problemeve ndëretnike është i domosdoshëm vullneti politik.

Për t'i kuptuar kërcënimet etnike mund të shërbejë përkufizimi i bashkësisë shoqërore në kontekstin e sistemit të vlerave të cilat ekzistojnë në kuadër të grupeve të caktuara etnike. Bashkësia shoqërore, në kuadër të territorit shtetëror, paraqet një sistem të përgjithshëm të vlerave në të cilin ekzistojnë nënsisteme të vlerave të më shumë grupeve etnike. Së këtejmi, çështje thelbësore në lidhje me stabilitetin, sigurinë dhe paqen në shtet, janë si vijon (Spaseski 2005: 221):

- Së pari, nëse, sa, dhe mbi cilën bazë sistemet e vlerave të grupeve të ndryshme etnike janë koherente dhe koekzistente mes vete;
- Së dyti, cila është marrëdhënia ndërmjet sistemit të përgjithshëm të vlerave të bashkësisë dhe nënsistemet e vlerave të minoriteteve etnike, më saktësisht vlerat e përgjithshme


shoqërore të bashkësisë a respektohen nga grupet minoritare dhe nga ana tjetër sistemi i përgjithshëm i vlerave a u mundëson minoriteteve emancipimin e identitetit të tyre kulturor dhe participimin në marrëdhëniet e përgjithshme shoqërore.

Në kuadër të hulumtimit nga viti 2009 dhe 2013, publiku i gjerë u pyet që t'i identifikojë burimet e kërcënimeve etnike – si faktorë të cilët ndikojnë mbi krijimin e tensioneve dhe konflikteve ndër-etnike.



Grafiku 7: Ndikimi i ndarjes etnike të shoqërisë mbi gjendjen e sigurisë

Sipas frekuencës së përgjigjeve afirmative dhe negative, mbi 70% e të anketuarve maqedonas dhe shqiptarë në vitin 2009 dhe 2013 pajtohen se **ndarja etnike ndikon dukshëm mbi gjendjen e sigurisë**. Kjo ndarje ndihet në të gjitha fushat e shoqërisë por shqetëson fakti se politika, si instrument i partive politike, në kontinuitet gjeneron ndarje etnike madje edhe në qelizat më të vogla të shoqërisë. Maqedonasit, përmes zbatimit të konceptit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat në administratën e shtetit, si pjesë e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, gjithnjë e më shumë janë më të dëshpëruar për shkak të kumulimit të problemeve ekzistenciale-sociale mbi të cilat pjesërisht ndikon edhe zbatimi i diskriminimit pozitiv ndaj të gjitha grupeve etnike të cilat nuk janë shumicë në shtet, për shkak të kualitetit të kuadrove që pranohen në administratë dhe për shkak të mosrespektimit të kriterëve të zakonshme të konkurseve.



Grafiku 8: Ndikimi i marrëdhënieve të çrregulluara ndëretnike mbi gjendjen e sigurisë

Qëndrimi i mbi 80% të të anketuarve e vërteton shkallën e lartë të pajtimit të të gjitha grupeve etnike në Maqedoni për atë se **marrëdhëniet e çrregulluara ndëretnike** ndikojnë mbi gjendjen e sigurisë. Qëndrimi, kryesisht është produkt i manipulimeve politike dhe interesave të ndryshme të liderëve të grupeve etnike (të cilët njëkohësisht janë liderë edhe të grupeve politike), si gjeneratorë kryesorë të tensioneve ndëretnike. Ndarja etnike në shoqëri ndihet përmes mungesës së identifikimit të përkatësisë kombëtare (shtetërore) tek pjesëtarët e të gjitha grupeve etnike në Maqedoni, e cila veçanërisht është e shprehur me miratimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Kjo nuk e bën të qartë imazhin për atë se si qytetarët e përfytyrojnë Republikën e Maqedonisë.


Gjendja e çrregullimit permanent të marrëdhënieve ndëretnike në vitin 2001 u shërbeu liderëve politikë si terren i përshtatshëm për realizimin e ambicieve të tyre politike, me ç'rast pa mbajtur llogari për sigurinë e qytetarëve dhe të bashkësisë. Në Maqedoni, nxitja e tensioneve përmes parullave nacionaliste, nga ana e liderëve politikë si përfaqësues të bashkësisë së caktuar etnike, është pjesë përbërëse e periudhës elektorale. Nacionalizmi e ka kontinuitetin e vet kur bëhet fjalë për t'u dëshmuar një opsion i caktuar politik për relevancën dhe vullnetin për realizimin e objektivave të specifikuara në programin politik. Në vend të formimit të nacionalizmit i cili shkon në favor të ndërtimit të ndjenjave, përkatësisë dhe identitetit të kombit, me këtë rast pa i rrezikuar

kombet dhe popujt e tjerë me të cilin përforcohet shpirti i kombit (i njohur si patriotizëm) dhe i cili mundëson që më lehtë të tejkalohen të gjitha kërcënimet në shoqëri, liderët në Maqedoni synojnë kah krijimi i ndjenjave nacionaliste të çdo grupi etnik veç e veç. Në këtë mënyrë preken vetëm interesat e grupit dhe krijohet pseudo-patriotizëm i cili as për së afërmi nuk kontribuon për ruajtjen e stabilitetit dhe paqes në shtet.²⁴

Kërcënimet politike që ndërlihen me kërcënimet etnike e kompletojnë imazhin e kompleksitetit të gjendjes së sigurisë në Republikën e Maqedonisë. Në shoqërinë e ndarë në baza etnike, partitë e maqedonasve fokusohen mbi marrjen dhe ruajtjen e pushtetit, ndërsa partitë e shqiptarëve në Maqedoni më shumë fokusohen mbi çështjet etnike sesa mbi çështjet e tjera vitale të shtetit. Në këtë mënyrë dy subjektet e bëjnë gjendjen komplekse pa e dhënë kontributin e tyre për paqe të përhershme dhe për shuarjen e pasioneve nacionaliste. Në kushte të shkallës së lartë të politizimit të shoqërisë, nga modeli i shoqërisë multietnike përfitojnë vetëm elita të caktuara politike dhe një pjesë e vogël e qytetarëve të cilët janë ithtarë të tyre. Skandalet politike, si për shembull, aferat me përgjimet ("Duvllo" (Strofulla) – 1992 dhe "Golemoto Uvo" (Veshi i Madh) - 2001), lanë gjurmë të mëdha mbi jetën politike dhe mbi sigurinë e qytetarëve të shtetit.


Roli i faktorëve politikë është ngushtë i lidhur me marrëdhëniet me fqinjët, me gjetjen e zgjidhjes politike për kontestin me emrin dhe me problemet të cilat i kanë maqedonasit me fqinjët në lidhje me mosnjohjen e tyre dhe mohimin e të drejtës së organizimit politik dhe kulturor.

²⁴ Për atë se sa është kontradiktor qëndrimi se çështja e ngjashmërive etnike është parakusht për formimin e kombit tregojnë një sërë shembujsh në botë. Pakistani pas shkëputjes së tij nga India ose formimi i shtetit të Izraelit, dëshmon se shteti mund të formohet në bazë fetare si njësi matëse për identitetin. Në Zvicër ekzistojnë dallime gjuhësore ndërmjet grupeve, por megjithatë të gjithë janë përfaqësues të kombit zvicëran. Ekzistojnë edhe shembuj të tjerë me ç'rast shteti formohet në bazë të territorit dhe grupeve të pranishme etnike të cilat gjenden ose e kanë populluar atë territor, por megjithatë kanë shkallë të lartë të lojalitetit ndaj shtetit.




Grafiku 9: Ekzistimi i konsensusit politik ndërmjet partive politike në Maqedoni për negociatat me Greqinë në kontestin me emrin kushtetues të Republikës së Maqedonisë

Sipas rezultateve të fituara nga viti 2009, 62,1% e të anketuarve – maqedonas dhe 51,8% e të anketuarve – shqiptarë, pajtohen se nuk ekziston konsensus politik tek subjektet politike në Maqedoni për çështjen e negociatave me Greqinë në kontestin me emrin, ndërsa gjendja në vitin 2013 dëshmon se 79,3% e të anketuarve – maqedonas dhe 69,7% e të anketuarve – shqiptarë e kanë përsëritur përgjigjen e njëjtë. Kjo ka të bëjë me garat e shpeshta të partive politike për ta dëshmuar patriotizmin dhe për mënyrën sa i përket se kush i përfaqëson më së miri interesat e bashkësisë etnike dhe opsionit politik të cilit i takojnë. Në vend të konsensusit të domosdoshëm për ndërtimin e qëndrimit të përbashkët dhe strategjisë për negociata për emrin, partitë politike e devalvuan pozitën ndërkombëtare të Maqedonisë.




Grafiku 10: Ekzistimi i konsensusit politik ndërmjet partive politike në Republikën e Maqedonisë për inkuadrimin në BE dhe NATO si përcaktim strategjik

Shpërndarja e përgjigjeve në këtë pyetje është në lidhje të ngushtë me atë paraprake, meqë BE dhe NATO janë kategorik në qëndrimin se **mbyllja e çështjes së emrit është çelësi për anëtarësimin në dy organizatat**. Shumica e qytetarëve (61,9%) në vitin 2009 u prononcuan se ekziston konsensus tek partitë politike për anëtarësimin në BE dhe NATO, thuaja se në mënyrë identike si në vitin 2013, kur qëndrimin e njëjtë e kanë përsëritur 59,6% e të anketuarve. Kjo i referohet faktit se anëtarësimi në BE dhe NATO është pjesë e programeve politike të të gjitha partive në Maqedoni, ndërsa kjo korrespondon me përqindjen e lartë të pëlqimit të qytetarëve për anëtarësim, si një proces i domosdoshëm për ardhmërinë e Maqedonisë. Pyetja kryesore është: *“Si të mbyllet çështja me emrin në kushte kur ekziston pëlqim tek qytetarët dhe tek subjektet politike për atë se anëtarësimi në BE dhe NATO është çështje thelbësore për Republikën e Maqedonisë?”*. Kjo çështje e problematizoi marrëdhënien e partneritetit të Maqedonisë me BE dhe NATO meqë partneriteti nuk ka bazë nëse nga partnerët kërkohet përmbushja e kriterëve plotësuese për anëtarësim, të ndryshme prej atyre që kërkohen nga vendet e tjera aspirante.




Grafiku 11: Ndikimi nga mosintegrimi në NATO mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë

Rezultatet tregojnë se edhe pas zhgënjimit në Samitin e NATO-s në Bukuresht në vitin 2008, prapë se prapë **qytetarët e Maqedonisë në vitin 2009 dhe në vitin 2013 (në numër konsiderueshëm më të vogël) e konsiderojnë NATO-n si garanci themelore për paqen dhe stabilitetin në Maqedoni**.



Grafiku 12: Ndikimi i mungesës së ftesës për negociata për anëtarësim në BE mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë


Ndarja e qëndrimeve tek maqedonasit tregon se përafërsisht gjysma e të anketuarve – maqedonas janë të bindur se edhe **pa pranimin në BE do të mund të ruhet gjendje stabile e sigurisë**, ndërsa diç më pak konsiderojnë se pranimi në BE do të sjell një gjendje sigurie më stabile. Tek të anketuarit – shqiptarë, 2/3 konsiderojnë se fillimi i negociatave me BE në Maqedoni do të rezultojë me gjendje më të mirë të sigurisë. Qëndrimet afirmative bazohen mbi implikimet ekonomike nga anëtarësimi, si faktor kyç për tejkalimin e tensioneve ndëretnike përmes detektimit të interesave ekonomike të qytetarëve.



Grafiku 13: Ndikimi ndaj kontestit për emrin kushtetues të Maqedonisë

Rezultatet e pyetjes lidhur me **kontestin me emrin** nuk e tregojnë vetëm rolin e Greqisë si faktor kryesor për bllokimin e integritimeve, por tregojnë se vendi fqinj ka fuqi dhe ndikim në BE dhe


NATO. Përmes qëndrimit të qytetarëve shihet qartë fuqia e Greqisë në marrëdhënien ndërkombëtare dhe pafuqia e Maqedonisë për tejkalimin e “padhembshëm” të problemeve të procesit të integrimi euroatlantike. Pikërisht për këto shkaqe qëndrimi i qytetarëve është afirmativ edhe tek maqedonasit edhe tek shqiptarët, të cilët e perceptojnë Greqinë si “frenuese” kryesore të proceseve integruese të Maqedonisë. Mungesa e gjetjes së zgjidhjes për kontestin tanimë shndërrohet në kërcënim serioz politik dhe të sigurisë e që ka implikime të fuqishme mbi marrëdhëniet ndëretnike në shtet. Krahas asaj që alibi kryesor i Greqisë është sjellja e autoriteteve politike të Republikës së Maqedonisë, veçanërisht politika e shtetit pas vitit 2006 dhe se Greqia nuk e bllokoi Maqedoninë të bëhet vend-kandidat në vitin 2005 dhe ta nënshkruaj Marrëveshjen e Asocim Stabilizimit në vitin 2001, megjithatë autoritetet e Greqisë në vazhdimësi zhvillojnë politikë nacionaliste ndaj Maqedonisë. Për ta zvogëluar presionin e vendeve të tjera ajo gjatë bllokimit të eurointegrimi të Maqedonisë e përfshiu edhe Bullgarinë, e cila gjatë aktualizimit të kontestit bilateral lidhur me marrëdhëniet e ndërsjella iu qas realizimit të qëllimeve të doktrinës kombëtare që ka të bëjë me Maqedoninë.



Grafiku 14: Ndikimi i marrëdhënieve fqinjësore në Republikën e Maqedonisë

Rezultatet e qëndrimit afirmativ për **ndikimin e marrëdhënieve fqinjësore mbi gjendjen e sigurisë** vënë në pah deklaratat gjithnjë e më të shpeshta të autoriteteve zyrtare të shteteve fqinje dhe efektet e propagandës së vazhdueshme të huaj mbi situatat e shtetit. Këto aktivitete shkojnë në drejtim të

destabilizimit të vendit dhe nxitjes së tensioneve ndëretnike. Nga ana tjetër, Maqedonia me njohjen e Kosovës i përkeqësoi marrëdhëniet me Serbinë, ndërkaq pas kërkesave të shpeshtuara të minoritetit maqedonas në Greqi dhe Bullgari për organizim politik dhe për realizimin e të drejtave minoritare, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, Bullgaria dhe Greqia bashkërisht e bllokuan fillimin e negociatave të Maqedonisë me Këshillin e BE-së (në fund të vitit 2012 dhe në vitin 2013). Kësaj i bashkëngjiten rezultatet e hulumtimit të vitit 2013 për mosekzistimin e konsensusit ndërmjet partive politike për tejkalimin e problemit lidhur me marrëdhëniet e mira fqinjësore me Bullgarinë. Sipas të anketuarve, 27% e tyre konsiderojnë se ekziston konsensus për këtë çështje, ndërsa 73% konsiderojnë se nuk ekziston.



Grafiku 15: Ekzistimi i konsensusit politik ndërmjet partive politike në Republikën e Maqedonisë për prioritetet e politikës së jashtme (marrëdhënie të mira fqinjësore, pozita e Maqedonisë në fqinjësi, marrëdhëniet me Kosovën dhe ngjashëm)

Për shkak të ekzistimit të identitetit kolektiv etnik, **qytetarët prioritetet e politikës së jashtme i përkufizojnë varësisht nga përkatësia etnike**. Kjo pyetje i përmban prioritetet si tërësi, por nuk jep një pasqyrë të qartë për secilin prej tyre veç e veç. Në përqindje, maqedonasit dhe shqiptarët përgjigjen me përafërsisht përgjigje të njëjta. Përgjithësisht, janë më të shumta përgjigjet të cilat shkojnë në drejtim se nuk ekziston konsensus tek partitë politike për prioritetet e politikës së jashtme. Deklaratat e subjekteve politike manifestojnë unitet në lidhje me kontestin me emrin, mirëpo

marrëdhëniet me Kosovën akoma nuk janë miratuar nga pjesëtarët e të gjitha bashkësive etnike. Paraqitja e diplomacisë partiake në vend të asaj shtetërore konfirmon se ekzistojnë divergjenca tek faktorët politikë, sa u përket çështjeve të rëndësishme.

Gjithashtu, mungon edhe përkufizimi afatgjatë i prioriteteve të politikës së jashtme lidhur me zgjidhjen e përhershme të çështjeve të sigurisë. Në praktikë mungon angazhimi më i madh i praktikuesve nga fusha e sigurisë në kuadër të diplomacisë. Kjo do të ndihmonte në ndërtimin e qasjes profesionale të diplomacisë sa u përket çështjeve të sigurisë së shtetit.


	Përkatësia kombëtare									Gjithsej
	Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Vlleh	Romë	Serbë	Boshnjakë	Kroatë	Slllovenë	
Ekziston	157	26	10	0	6	8	6	1	0	214
	40,8%	31,3%	55,6%	0%	46,2%	80,0%	50,0%	33,3%	0%	40,5%
Nuk ekziston	208	51	8	3	7	2	5	2	1	287
	54,0%	61,4%	44,4%	100,0%	53,8%	20,0%	41,7%	66,7%	100,0%	54,4%
Nuk janë përgjigjur	20	6	0	0	0	0	1	0	0	27
	5,2%	7,2%	0%	0%	0%	0%	8,3%	0%	0%	5,1%
Gjithsej	385	83	18	3	13	10	12	3	1	528
	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%

Tabela 4: Ekzistimi i konsensusit politik ndërmjet partive politike në Republikën e Maqedonisë për kërkesat e bashkësive etnike (2009)

	Përkatësia kombëtare								Gjithsej
	Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Serbë	Vlleh	Romë	Boshnjakë	Të tjerë	
Ekziston	111	9	2	2	1	2	1	2	130
	41,1%	27,3%	100,0%	33,3%	100,0%	66,7%	100,0%	33,3%	40,4%
Nuk ekziston	159	24	0	4	0	1	0	4	192
	58,9%	72,7%	0%	66,7%	0%	33,3%	0%	66,7%	59,6%
Gjithsej	270	33	2	6	1	3	1	6	322
	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%

Tabela 5: Ekzistimi i konsensusit politik ndërmjet partive politike në Republikën e Maqedonisë për kërkesat e bashkësive etnike (2013)

Edhe pse sipas të anketuarve **nuk ekziston konsensus tek partitë politike për kërkesat e bashkësive etnike**, megjithatë shpërndarja e përgjigjeve ndërlidhet me përkufizimin e Republikës së Maqedonisë si shoqëri multietnike, kështu që qëndrimet janë shprehje e pakënaqësisë nga përmbushja e kërkesave të grupeve etnike. Një grup etnik e përfaqëson një ose më shumë parti politike në pushtet, por çdoherë ekziston rivalitet ndërmjet atyre të opozitës dhe të pushtetit, kështu që përmbushja e kërkesave të grupeve etnike paraqet kategori relative.




Grafiku 16: Ndikimi i përmbushjes së detyrimeve që rezultojnë nga Marrëveshja Kornizë

Është indikative që në vitin 2009 dhe në vitin 2013 shumica e të anketuarve maqedonas dhe shqiptarë (mbi 70%) pajtohen se **përmbushja e Marrëveshjes Kornizë ndikon mbi sigurinë dhe stabilitetin e Maqedonisë**. Rezultatet e hulumtimit të zbatuar në vitin 2006 (Tashevski Remenski 2007: 241) tregojnë se 82% e të anketuarve shqiptarë janë prononcuar se Marrëveshja Kornizë është zgjidhja e vetme për vendosjen e besimit dhe barazisë ndërmjet qytetarëve, ndërsa 82,7% e të anketuarve maqedonas pyetjes së njëjtë i janë përgjigjur negativisht. Në hulumtimin e njëjtë, vetëm 28,9% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, besojnë se paqja dhe stabiliteti duhet të rezultojnë nga implementimi i Marrëveshjes Kornizë. Në bazë të përkatësisë etnike të të anketuarve, 79,4% e shqiptarëve besojnë në paqe dhe stabilitet pas implementimit të Marrëveshjes Kornizë, përkundrajt 92,8% të maqedonasve dhe 5% të të anketuarve të bashkësive të tjera etnike të cilët u prononcuan për të kundërtën. Së këtejmi, potenciali për konflikt të ardhshëm rezulton nga qëndrimi se Marrëveshja është jolegjitime dhe e paqëndrueshme për maqedonasit të cilët janë popullatë shumicë në Maqedoni.

Bashkësitë e tjera etnike, të ndryshme nga bashkësia maqedonase dhe shqiptare, nuk pajtohen plotësisht me zgjidhjet e sanksionuara në Marrëveshje, meqë fitimi i një pjese të të drejtave të tyre bazohet mbi kriterin e përqindjes (prej 20%).

Në kontekst të sqarimit të rezultateve të pyetjeve, lidhur me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, duhet të theksohet se janë të shpeshta deklaratat e përfaqësuesve të partive të caktuara politike të cilat e devalvojnë kredibilitetin e Marrëveshjes dhe të njëjtën e konsiderojnë të pavlershme. Shqiptarët insistojnë në implementimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë, edhe pse me të janë përfshirë edhe çështje të cilat nuk ishin pjesë të saj, ndërkaq ishin në favor të bashkësive joshumicë. Shqiptarët akoma e kuptojnë Marrëveshjen si instrument me të cilin ata fitojnë një spektër të gjerë të të drejtave, me ç'rast Marrëveshjen nuk e perceptojnë si modifikim të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë me të cilën përveç të drejtave përcaktohen edhe detyrime për të gjithë qytetarët, pa dallim të statusit të tyre shoqëror dhe përfaqësimit në përqindje. Perceptimi i Marrëveshjes Kornizë vetëm si garanci për të drejta, por jo edhe për detyrime, mund të çojë në dezintegrimin e shoqërisë maqedonase, duke e përfshirë edhe shtetin. Respektimi i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë nuk është obligim vetëm i maqedonasve por edhe i shqiptarëve. Nga ana tjetër, maqedonasit duke dashur t'i shmangen federalizmit angazhohen që t'i kufizojnë kërkesat e shqiptarëve, të cilat në bazë janë joreale, tejet tendencioze dhe ekskluzive, në krahasim me pozitën e bashkësive të tjera etnike joshumicë në pjesët e tjera të Evropës.



Grafiku 17: Ndikimi i diskriminimit etnik mbi gjendjen e sigurisë


Rezultatet e kësaj pyetjeje tregojnë se 8 dhe 12 vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë dhe 7 përkatësisht 11 vjet pas ndryshimeve kushtetuese (sipas hulumtimeve të vitit 2009 dhe 2013), maqedonasit dhe shqiptarët (me mbi 78%) ndihen të diskriminuar. Qëndrimi i maqedonasve ka të bëjë me revoltin e zbatimit të të ashtuquajturit “diskriminim pozitiv” për shqiptarët gjatë punësimit në organet shtetërore dhe statusi i maqedonasve në shoqëri i bazuar mbi implementimin e Marrëveshjes Kornizë. Shqiptarët qëndrimin e tyre e mbështesin mbi joazhurnitetin dhe jokonsekencën e autoriteteve maqedonase lidhur me implementimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë.

	Национална припадност									Gjithsej
	Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Vlleh	Romë	Serbë	Boshnjakë	Kroatë	Slllovenë	
Ndikon	253	45	8	3	9	8	9	2	1	338
	65,7%	54,2%	44,4%	100,0%	69,2%	80,0%	75,0%	66,7%	100,0%	64,0%
Nuk ndikon	109	30	8	0	4	2	2	1	0	156
	28,3%	36,1%	44,4%	0%	30,8%	20,0%	16,7%	33,3%	0%	29,5%
Nuk janë përgjigjur	23	8	2	0	0	0	1	0	0	34
	6,0%	9,6%	11,1%	0%	0%	0%	8,3%	0%	0%	6,4%
Gjithsej	385	83	18	3	13	10	12	3	1	528
	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%

Tabela 6: Ndikimi i solidaritetit shqiptar në rajon (2009)

Nga aspekti etiologjik, shkaqet e krijimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit mund të kërkohen në **ndikimin e solidaritetit shqiptar në rajon**, si faktor për ndikimin ndaj gjendjes së sigurisë në Republikën e Maqedonisë. Solidariteti shqiptar në rajon gjithnjë e më shumë e nxitë ëndrrën për turbulenca të reja etnike në Ballkan dhe në raste të caktuara ai mbështetet me deklarata të përfaqësuesve të autoriteteve politike në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni (Srbinovski 2013; Ristevski 2013; Kurir 2012). Megjithatë, qëndrimi pozitiv i të anketuarve - maqedonas (65,7%) tregon se maqedonasit seriozisht janë të shqetësuar për shkak të

solidaritetit të madh shqiptar në Ballkan, i cili disa herë tregohet kyç për zhvillimin e ngjarjeve në Kosovë, në Serbinë Jugore dhe në Maqedoni. Solidariteti, në këtë rast, nënkupton vënien në funksion të të gjitha mjeteve në dispozicion për realizimin e projektit të ashtuquajtur “Shqipëria e Madhe”. Kohëve të fundit projekti në mënyrë precize është përkufizuar në dy platforma – “Platforma për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare” e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nga viti 1998 dhe “Platforma e Shqipërisë natyrore” nga Koço Danaj, botuar në Tiranë në vitin 2009 (Mirčev 2012; Batkovski 2012). Emërtimi i platformës së dytë paraqet një zbutje të terminologjisë së përdorur në titullin e platformës së parë për shkak të presionit ndërkombëtar mbi autoritetet në Shqipëri. Shqetësimi i maqedonasve është i bazuar për shkak të faktit se “Platforma për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare” parashikon që Republika e Maqedonisë të jetë shtet binacional i shqiptarëve dhe i maqedonasve me sovranitet të ndarë etnik ose me rajone autonome të shqiptarëve dhe maqedonasve, ndërkaq faza e tretë e “Platformës së Shqipërisë natyrore” parashikon federalizmin e Republikës së Maqedonisë.



Grafiku 18: Ndikimi i mosrespektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë

Mosrespektimi i **të drejtave të njeriut dhe tolerancës fetare** janë edhe dy faktorë të cilët ndikojnë mbi imazhin e gjendjes së sigurisë në Maqedoni. Mosrespektimi i të drejtave të njeriut veçanërisht është aktuale në punën e policisë. Edhe pse, sipas raporteve të Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT 2013) dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, respektimi i të drejtave të njeriut paraqet diçka

me të cilën Maqedonia nuk mund të lavdërohet. Nga ana tjetër, diçka që vjen më shumë në shprehje në periudhën postkonfliktuale konsiston me atë se shpesh veprimeve antikriminale të policisë iu përshkruhet konteksti anti-etnik ndaj njërit ose më shumë grupeve etnike dhe me këtë pamundësohet perceptimi objektiv i subjekteve të cilët janë burim i kërcënimeve të sigurisë. Toleranca fetare aspak nuk ndryshon nga toleranca ndëretnike, meqë pjesa më e madhe e pjesëtarëve të grupeve etnike në Maqedoni kryesisht i takojnë konfesionit të njëjtë.

	Përkatësia kombëtare									Gjithsej
	Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Vlleh	Romë	Serbë	Boshnjakë	Kroatë	Slllovenë	
Ndikon	322	67	14	2	11	9	9	2	1	437
	83,6%	80,7%	77,8%	66,7%	84,6%	90,0%	75,0%	66,7%	100,0%	82,8%
Nuk ndikon	48	10	3	1	2	1	2	1	0	68
	12,5%	12,0%	16,7%	33,3%	15,4%	10,0%	16,7%	33,3%	0%	12,9%
Nuk janë përgjigjur	15	6	1	0	0	0	1	0	0	23
	3,9%	7,2%	5,6%	0%	0%	0%	8,3%	0%	0%	4,4%
Gjithsej	385	83	18	3	13	10	12	3	1	528
	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%

Tabela 7: Ndikimi i korrupsionit mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë (2009)

Elementi më destruktiv i tranzicionit është korrupsioni dhe veçanërisht korrupsioni politik. Për shkak të përqindjes së lartë të të anketuarve (82,8%) të cilët kanë dhënë përgjigje pohuese se korrupsioni ndikon mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë, mund të themi se **korrupsioni paraqet kërcënim serioz ndaj sigurisë në Maqedoni**. Në hulumtimin e vitit 2013, 90,4% e të anketuarve u prononcuan se krimin e organizuar dhe korrupsionin i konsiderojnë si faktorë kryesorë për përkufizimin e gjendjes së sigurisë. Shkaqet për këto qëndrime kanë një natyrë më të thellë kohore. Në Maqedoni deri në vitin 1996 (me miratimin e Kodit Penal) kishte problem që krimi i organizuar të integrohet

në legjislacionin kombëtar.²⁵ Ballafaqimi i vështirë me krimin e organizuar dhe korrupsionin e pamundëson zhvillimin e shoqërisë dhe i zvogëlon mjetet e domosdoshme për ruajtjen dhe modernizimin e sistemit të sigurisë.

3.3.2 Kërcënimet ekonomike

Kërcënimet ekonomike rezultojnë nga shkalla e lartë e varfërisë në shtet, nga papunësia e madhe,²⁶ nga numri i investimeve kapitale në ekonomi, nga vlera e BPV për kokë banori²⁷ dhe nga ndikimi i zhvillimit të infrastrukturës në vend. Kushtet ekonomike i diktojnë standardet e jetës dhe fuqinë blerëse të popullatës dhe janë në korrelacion me zgjidhjen e përhershme të problemeve ekzistenciale, me paraqitjen e oligarkisë, me interesat personale të politikanëve të caktuar dhe me zhvillimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.


Ndikimin e kërcënimeve ekonomike mbi sigurinë, Maqedonia e ndjeu që në vitet e para të pavarësisë. Privatizimi i dyshimtë e devalvoi ekonominë vendase e cila i humbi kapacitetet më të rëndësishme ekonomike dhe tregjet tradicionale nga koha e RSFJ. Nga kjo periudhë është edhe embargoja greke ndaj Maqedonisë, fluksi i investimeve greke dhe bllokadat ndaj RF të Jugosllavisë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Kërcënimet ekonomike kontribuuan që Maqedonia të destabilizohet nga brenda dhe nga jashtë dhe në këtë mënyrë u dobësuan (në atë periudhë) kapacitetet modeste të sistemit të sigurisë.

Me hulumtimet nga viti 2009 dhe 2013 janë përfshirë disa pyetje të cilat i mbulojnë indikatorët e raportit ndërmjet ndikimit ekonomik dhe kërcënimeve mbi sigurinë.

²⁵ Kjo veçanërisht është e rëndësishme nëse dihet se procesi i privatizimit të pjesës më të madhe të kapitalit shoqëror zgjati nga viti 1992 deri në vitin 1999.


²⁶ Papunësia ishte rreth 30% në periudhën kohore 2005-2012 dhe ka tendencë të reduktimit (Novkovska 2011; DZS 2013: 254).

²⁷ Krahasj asaj që në vitin 2011 BPV për kokë banori ishte 3630 euro, në vitin 2010 ishte 3434 euro dhe ekziston një tendencë e dukshme e rritjes së BPV në vazhdimësi, përveç në vitin 2001 (DZS 2013a: 24, Novkovska 2011), megjithatë kjo nuk mjafton që të zbutet gjendja e varfërisë dhe papunësisë në vend.



Grafiku 19: Ndikimi i shkallës së lartë të papunësisë mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë

Dominimi i përgjigjeve afirmative (rreth 80% nga numri i përgjithshëm) në pyetjet që kanë të bëjnë me korrupsionin (si kërcënim politik) dhe me **papunësinë i pasqyron ndjenjat e qytetarëve për ndikimin e standardit jetësor mbi gjendjen e sigurisë në shtet**. Edhe pse shkalla e papunësisë shënon rënie të butë në vitet e fundit, megjithatë ajo akoma është në nivelin e rreth 30% (DZS 2013). Përmbushja e nevojave elementare i zvogëlon mundësitë për konflikt, pavarësisht se a bëhet fjalë për konflikt social, etnik, politik ose për ndonjë konflikt tjetër.



Grafiku 20: Ndikimi i zhvillimit të ngadaltë ekonomik mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë (2009)

Përqindja e lartë e përgjigjeve afirmative në këtë pyetje, 74,2% në vitin 2009 dhe 79,8% në vitin 2013, tregon se sipas qytetarëve **zhvillimi i ngadaltë ekonomik është më meritori për ndjenjën e pasigurisë tek qytetarët**. Zhvillimi ekonomik është kushte për prosperitetin e bashkësisë. Ai ndikon mbi shkallën

e varfërisë në shtet dhe i bën të dukshëm edhe problemet e tjera në shoqëri, siç janë: marrëdhëniet ndëretnike, tensionet sociale dhe migrimet ekonomike. Në Maqedoni në numër shumë më të madh është emigrimi sesa migrimi. Migrimi nënkupton një fenomen kompleks i cili përfshinë aktorë vendas, persona juridikë dhe fizikë, të cilët më së shpeshti tranzitohen nëpër Maqedoni dhe caku i tyre i fundit janë metropolet e zhvilluara evropiane, ndërkaq udhëhiqen nga motive ekzistenciale. Emigrimet kanë të bëjnë me popullatën e Republikës së Maqedonisë e cila përgjithmonë ose për një periudhë më të gjatë kohore emigron nga vendi dhe shkakton ndryshime ekonomike dhe demografike në shtet, si dhe gjeneron rreziqe sigurie.

3.3.3 Kërcënimet demografike

Ndikimi i *faktorit demografik* pasqyrohet përmes relacioneve të popullit maqedonas me grupet e ndryshme etnike të cilat jetojnë në Maqedoni. Populli maqedonas plakët për tre shkaqe: nataliteti i ulët, shkalla e lartë e mortalitetit dhe numri i madh i personave të cilët emigrojnë nga shteti. Kategorinë e fundit e përbëjnë persona me arsim të lartë të cilët vendosin që përgjithmonë të largohen nga Maqedonia. Këtë e argumentojnë edhe të dhënat zyrtare statistikore (Novkovska 2011; DZS 2012). Problemi me kërcënimet demografike vite me radhë është latent (Batkovski 1995), ndërsa veçanërisht vjen në shprehje pas "revolucionit industrial" në Maqedoni (në vitet e gjashtëdhjeta dhe të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar) kur kemi migrime të brendshme dhe pas konfliktit në vitin 2001 kur u intensifikuan migrimet e brendshme dhe të jashtme.

Të dhënat demografike për numrin e bashkësisë etnike shqiptare në Maqedoni kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi ndërtimin e marrëdhënieve ndëretnike, veçanërisht për shkak të kriterit të përqindjes të inkuorporuar në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit dhe në ligjet të cilat rezultojnë nga ajo, e që kanë të bëjnë me kushtin e ekzistimit të 20% të një bashkësie të caktuar etnike në Maqedoni, përqindje kjo e cila e mundëson realizimin e të drejtave plotësuese në pushtetin lokal dhe në struktura të tjera të pushtetit. Regjistrimi

i pasuksesshëm i vitit 2012 e problematizoi situatën e pasqyrës demografike në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht e stimuloi ekzistimin e më shumë tezave për mospasuesin e regjistrimit, siç janë: reduktimi i numrit të maqedonasve dhe shqiptarëve të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë, ruajtja e situatës status kuo për shkak të zbutjes së tensioneve ndëretnike dhe politike dhe presioni i faktorit ndërkombëtar për ruajtjen e paqes në vend.

3.3.4 Kërcënimet ushtarake

Kërcënimet ushtarake ndërlidhen me përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit në kushte të rrezikimit të sovranitetit, integritetit territorial dhe pavarësisë së vendit. Në kërcënime ushtarake bëjnë pjesë edhe propagandat militariste të fqinjëve. Bashkësitë më të mëdha, ajo maqedonase dhe shqiptare, në historinë e tyre nuk kanë pasur momente të konflikteve të drejtpërdrejta ushtarake. Vet rajoni, ideja e Shqipërisë së Madhe dhe heshtjet e mosfunksionimit të sovranitetit në pjesë të caktuara të vendit krijuan një klimë për zhvillimin e nacionalizmit militarist, i cili rezultoi me konflikt në vitin 2001.

Indikatorë real për kërcënime ushtarake është posedimi i sasisë së madhe të armëve tek qytetarët e Republikës së Maqedonisë edhe përkrah asaj se, në disa raste nga ana e faktorit ndërkombëtar dhe autoriteteve vendase, u organizuan aksione për dorëzimin vullnetar të armëve dhe u bënë ndryshime serioze në pjesën e legjislacionit që ka të bëjë me posedimin dhe përdorimin e armëve. Megjithatë, policia maqedonase shpesh zbaton aksione për zbulimin dhe sekuestrimin e armëve jolegale. Gjithashtu, objekt i sekuestrimit janë armët dhe municioni i ndryshëm nga pushka e zakonshme automatike.

Në mungesë të forcës, e cila realisht mund ta garantojë sigurinë e Republikës së Maqedonisë, publiku vendas anëtarësimin tonë në NATO e sheh si zgjidhje për tejkalimin e kërcënimeve ushtarake dhe veçanërisht kërcënimeve nga agresioni.

4 POLITIKA E SIGURISË

4.1 Nocioni

Shteti paraqet çdo “njësi” e cila është e organizuar nga popullata ekzistuese në një territor të kufizuar, të cilin ajo popullatë, përmes sistemit të organizuar politik, e kontrollon në mënyrë sovrane (Staic 2004: 10). “Shteti paraqet territor të përcaktuar i banuar përgjithmonë, i përfshirë me rregulla dhe zakone të përbashkëta të ndërlidhura në një trup në të cilin realizohen politikisht, përmes pushtetit të organizuar, sovranitetit autonom dhe kontrollit mbi të gjithë njerëzit dhe mbi të gjitha çështjet në kuadër të kufijve të vet, i aftë për luftë dhe paqe dhe për t’u inkuadruar në marrëdhëniet ndërkombëtare me bashkësitë e tjera në botë (Black 1991: 1407). Shteti, përmes vendosjes së sistemit kombëtar të sigurisë dhe sistemit politik (në të cilin janë përkufizuar qëllimet e pushtetit), paraqet kreatorin kryesor dhe bartësin e aktiviteteve gjatë zbatimit të politikës së sigurisë. Politika e sigurisë e afirmon rolin e shtetit dhe aparatin e tij në identifikimin dhe në ballafaqimin me burimet e kërcënimeve ndaj sigurisë, në absorbimin e tensioneve etnike dhe në sigurimin e kontrollit mbi vatrat potenciale të konflikteve me mjete demokratike.

Siguria paraqet lirinë e zgjedhjes së vlerave të cilat do të mbrohen në shoqëri. Siguria mund të matet si “mungesë e kërcënimit ndaj vlerave të fituara” (Wolfers 1952: 485). Së këtejmi, siguria perceptohet si mbrojtje e vlerave përgjithësisht të pranuar në shoqëri të përkufizuara me të drejtën pozitive ose me normat morale. Në këtë kontekst, përkufizimi i sigurisë ndihmon që të përcaktohen vlerat shoqërore si objekt kryesor i mbrojtjes në kuadër të politikës së sigurisë. Rëndësia e sigurisë ka lëvizur varësisht nga rrethanat shoqërore dhe nga zhvillimi i shoqërisë. Qasjen ndaj sigurisë, e cila daton nga fundi i Luftës së Ftohtë, disa studiues e quajnë “koncept thelbësor garues” përkatësisht koncept me vlerë aq të madhe saqë asnjë sasi e argumenteve ose provave nuk do të mund ta vinin në pikëpyetje rëndësinë e tij të vërtetë (Baldwin 1997: 3-26). Përveç qasjes politike ndaj sigurisë,

me kalimin e kohës teoriticienët e kanë zhvilluar edhe qasjen e fragmentuar dhe mikro-qasjen. Kështu, sot mund të identifikohen klasifikime të rëndësishme të sigurisë, siç janë: siguria lokale, rajonale dhe globale, përkatësisht *humane (njerëzore), familjare, shoqërore, ekonomike, ekologjike, energjetike, financiare, juridike dhe lloje të tjera të sigurisë*.

Me nocionin **politikë** nënkuptohet: shkenca dhe shkathtësia për menaxhim me shtetin; shkenca për qëllimet e shtetit dhe mjetet më të mira për mënyrën e realizimit të atyre qëllimeve; dhe fig. metoda e punës së një shteti të caktuar, partie, institucioni ose individi, urtësia dhe shkathtësia për komunikim me njerëzit dhe përballja me jetën, arsyeja e shëndoshë, zgjuarsia, dinakëri dhe të qenit i kujdesshëm (Vujaklija 1980: 724-725). Në rrethana bashkëkohore, politika përkufizohet si shkathtësi (aftësi) për matjen e raportit ndërmjet mjeteve dhe qëllimeve në një hapësirë të caktuar dhe në kohë të caktuar, për zgjidhjen e ndonjë problemi politik ose të çështjeve të tjera nga fusha e veprimit të organeve shtetërore, partive politike, shoqatave ose qytetarëve (Spaseski 2005:68). Politika shtetërore formalisht përkufizohet si spektër i gjerë i orientimeve dhe deklaratave të miratuara nga pushteti në nivel kombëtar e që janë në favor të qëllimeve kombëtare (US Department of Defense 2013: 182). Politika i përcakton orientimet e veprimit të shtetit në të gjitha nivelet e pushtetit, para së gjithash të pushtetit ekzekutiv në përbërjen e së cilit është edhe sistemi i sigurisë. Në këtë mënyrë politika e shtetit kontribuon në drejtim të sigurimit të orientimeve dhe vendosjen e kufizimeve të dedikuara që të ndikojnë mbi vendimet dhe të iniciojnë aksione për zbatimin e qëllimeve të politikës shtetërore.

Kusht për zbatimin e politikës së sigurisë është ekzistimi i shtetit politik stabil. Disa kritere e përcaktojnë stabilitetin politik të shtetit (Lazarevski 2001: 54):

- Rregullimi të jetë legjitim dhe i pranuar nga pjesa më e madhe e qytetarëve, por edhe nga grupacionet kryesore sipas përkatësisë etnike, profesionale, sociale ose përkatësisë tjetër në vend (ato të kenë sjellje pozitive ndaj tij);
- Korniza normative-institucionale, ashtu siç është vendosur, mundëson shprehjen e lirë, artikullimin, agregimin dhe prezantimin

e interesave të qytetarëve dhe zgjidhjen institucionale (tejkalimin) të konflikteve të natyrës etnike, sociale ose të natyrës tjetër;

- Rregullimi të korrespondojë me modelin dominant të kulturës politike në vend dhe rrjedhimisht me këtë "rregullat e lojës" të respektohen edhe nga qytetarët edhe nga titullarët e funksioneve politike;

- Udhëheqësia politike në vend të konstituohet, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Kushtetutë, dhe të jetë e pranueshme si legjitime nga ana e qytetarëve të vendit dhe nga bashkësia ndërkombëtare; dhe

- Udhëheqësia politike të jetë e aftë t'i mobilizojë resurset njerëzore dhe materiale të vendit dhe të sigurojë nivel të mirëqenies në vend që do t'i kënaq parashikimet dhe pritjet të një numri më të madh të qytetarëve sa i përket kualitetit të jetës.

Kritereve, me të cilët rregullohet kushtetutshmëria dhe ligjshmëria në punën e sistemit të sigurisë, për zbatimin papengesë të politikës së sigurisë, në kushte të stabilitetit politik në shtet, është e domosdoshme t'u shtohet depolitizimi, kontrolli demokratik i sektorit të sigurisë dhe inkorporimi i sistemit të vlerave gjatë seleksionimit dhe mobilitetit në shërbim të kuadrit të punësuar në sistemin e sigurisë.

Lidhjen ndërmjet ruajtjes së sigurisë dhe funksionimit të shtetit e përbën sistemi i sigurisë. **Sistemi i sigurisë** është pasqyrë e karakteristikave të shtetit dhe shërben për përmbushjen e qëllimeve politike, por duhet të synohet të jetë: funksional, profesional, i vendosur mbi baza të fuqishme ligjore dhe të jetë pasqyrë e veçorive të sigurisë së shtetit në aspektin e historisë, kulturës, ekonomisë dhe shtetformimit të tij (si specifike politike), pozitë gjeostrategjike, vendi dhe roli i shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare të sigurisë dhe në marrëdhëniet politike. Përmes sistemit të sigurisë manifestohet shkalla e interaksionit ndërmjet sigurisë së brendshme dhe planifikimit të procesit për promovimin e Maqedonisë në kuadër të sigurisë ndërkombëtare. Në dokumentet strategjike vendase, sistemi i sigurisë është përkufizuar si "shumë e masave komplekse dhe të ndërvarura, aktivitete, plane dhe programe, të cilat i ndërmarrin institucionet relevante në Republikën e Maqedonisë me qëllim të mbrojtjes, ruajtjes dhe avancimit të


sigurisë kombëtare” (Strategjia za nacionalna bezbednost na Republika Makedonija, 2008). Procesi i miratimit të vendimeve është jashtëzakonisht i rëndësishëm për politikën e sigurisë, kështu që në kuadër të procesit mund të veçohen disa role të sistemit të sigurisë kombëtare (Bearne, Oliker, O’Brien, & Rathme 2005: 2-4, ekstrakt). *Vlerësimi i përbashkët* paraqet bazë për politikën e sigurisë dhe procesin e vendimmarrjes. Këshilli Kombëtar i Sigurisë i bashkon kapacitetet për shkëmbimin e informacioneve dhe kapacitetet e zbulimit dhe administron me procesin e përcaktimit të prioriteteve kombëtare të sigurisë. *Ridedikimi i mjeteve* është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme gjatë ballafaqimit me kërcënimet në shtetet në zhvillim kapacitetet e sigurisë të cilave, përkatësisht shpenzimet për nevojat e sistemit të sigurisë janë të kufizuara për shkak të mundësive të tyre të limituara ekonomike. Shtetet e zhvilluara kanë një qasje shumë më të ndryshme gjatë zgjidhjes së kësaj sfide, meqë ata më shumë fokusohen mbi zhvillimin e zgjidhjeve ekzistuese dhe investimin në zgjidhje të reja dhe teknologji të kushtueshme. *Mbikëqyrja* është një mekanizëm i domosdoshëm për çdo shoqëri të zhvilluar demokratike dhe për të gjitha demokracitë në zhvillim. Funkcionet mbikëqyrëse duhet ta sigurojnë atë se resurset janë shpërndarë në mënyrë efikase, të kryejnë mbikëqyrje mbi planin ose trupin, të sigurojnë se organet e ndryshme janë të afta të propozojnë që të punojnë gjatë kohës së rasteve emergjente dhe të bëjnë mbikëqyrje mbi shpenzimet, administratën dhe politikën e agjencive të sigurisë. Ashtu sikurse tek shpërndarja e mjeteve, fokusi i kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi sistemin e sigurisë ndryshon tek vendet e zhvilluara dhe tek vendet në zhvillim. Vendet e zhvilluara investojnë në përgjegjshmëri, në sigurimin e kontrollit politik dhe në ndërtimin e besimit, ndërsa tek vendet në zhvillim dhe vendet të cilat janë në fazë post-konfliktuale kontrolli është fokusuar mbi sigurimin e rregullimit shtetëror dhe kthimin e besimit në sistemin e sigurisë. *Prioritetet e sigurisë* variojnë varësisht nga nevojat e sistemit të sigurisë dhe të shoqërisë. Aspektet vendase shkojnë në drejtim të integritetit të kapaciteteve të zbulimit, menaxhimit me kriza dhe me rrezikimin e shëndetit publik dhe transportit. Aspektet e jashtme kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në operacione paqësore dhe në diplomacinë e sigurisë. *Koordinimi gjatë ballafaqimit me kërcënimet* është

i rëndësishëm për bashkëpunimin ndër-agjencial në kuadër të sistemit të sigurisë. Ai varion dhe nënkupton formimin e organeve të specializuara për ballafaqim me një formë të caktuar të kërcënimit. Për shembull, nëse në Kanada prioriteti i është dhënë kërcënimit të sindromës së rëndë akute respiratore (CAPC), në Britani të Madhe është terrorizmi, në Etiopi është mungesa e ushqimit, ndërsa në Republikën e Maqedonisë kjo do të duhej jenë marrëdhëniet ndëretnike. *Reforma e sistemit të sigurisë*, përkatësisht orientimet dhe vëllimi i ndryshimeve të parashikuara rezultojnë nga politika e sigurisë së vendit. Po ashtu, qasja dhe modeli i reformës varion nga vendi në vend, kështu që ndodh që edhe krijimi i politikës së sigurisë të jetë pjesë e reformës.

Konceptimi i sistemit të sigurisë kërkon integrimin e elementëve të caktuar të cilët do ta kënaqin kompatibilitetin dhe qëndrueshmërinë e tij.

Në *elementët e përhershëm* (karakteristika) të sistemit të sigurisë, bëjnë pjesë (Spaseski 2005: 279):

- Autonomia në marrëdhëniet me sisteme dhe institucione të tjera në shtet;
- Organizimi sipas Kushtetutës së vendit;
- Profesionalizmi i realizuesve të tij;
- Siguria materiale e pjesëtarëve të sistemit; dhe
- Pajisja teknike bashkëkohore.



Skema 1: Përcaktimi nevojave të jashtme dhe të brendshme (Luethold në Albrecht & Barnes 2008: 3)

Analiza e mjedisit të sigurisë duhet të jap përgjigje për llojin e konceptit të sigurisë kombëtare (a fokusohet ai në mbrojtjen e shtetit ose të qytetarëve), për mjetet që do t'i shfrytëzojë sistemi i sigurisë në realizimin e qëllimeve të politikës së sigurisë, për mënyrën se si sistemi do të ballafaqohet me ndryshimet e krijuara të reja të sigurisë dhe për mënyrën se si sistemi do t'i loçojnë burimet e kërcënimeve të sigurisë. Kjo tregon se sa është i rëndësishëm është konsensusi kombëtar gjatë perceptimit të kërcënimeve dhe objektiviteti lidhur me atë se sa sistemi i sigurisë realisht është i përgatitur të ballafaqohet me kërcënimet aktuale ndaj sigurisë kombëtare.

Për shkak të përsosjes dhe inkorporimit të dinamikës si përgjigje ndaj kërcënimeve të ndryshueshme, në sistemin e sigurisë duhet të përcaktohen disa elementë të ndryshueshëm të cilët çdoherë do të determinohen në varësi të nevojave aktuale të sigurisë, përkundrajt kërcënimeve ndaj stabilitetit të shtetit. Si *elemente të ndryshueshme* të sistemit të sigurisë mund të numërohen (Spaseski 2005: 279):

- Përmirësimi i përsosjes së metodologjisë së punës;
- Avancimi dhe përsosja e veprimtarisë parandaluese;
- Përmirësimi i pozitës shoqërore të institucioneve të sigurisë të sistemit dhe të pjesëtarëve të tij;
- Harmonizimi i tij me sistemet bashkëkohore të sigurisë me të cilët bashkëpunon në luftimin e krimit ndërkombëtar bashkëkohor; dhe
- Edukimi permanent i kadrove dhe aftësimi i tyre që të funksionojnë me sukses në sistemet komplekse të sigurisë dhe ngjashëm.

Në pyetjen e parashtruar: “Sa organizata aktuale e sistemit të sigurisë bashkëvepron me politikën e sigurisë së Republikës së Maqedonisë?”, profesor Batkovski (intervistë me Prof. Dr. Tome Batkovski, 18.12.2013) deklaroi se politika e sigurisë të Republikës së Maqedonisë, gjithsesi që duhet të perceptohet përmes prizmit të përcaktimit strategjik të shtetit, e shprehur përmes “Konceptit Kombëtar për Siguri dhe Mbrojtje”, të miratuar në vitin 2003 për realizimin e anëtarësimit me të drejta të plota në BE dhe NATO. Në këtë aspekt, ai konsideron se Republika e Maqedonisë duhet të ndërtojë një sistem më konsistent të sigurisë dhe zbulimit, diçka

për të cilën opinionin e vet e ka prezantuar që në vitin 1994 në kuadër të komunitetit më të gjerë akademik dhe të ekspertëve. Ai konsideron se në Republikën e Maqedonisë duhet të miratohet Ligj për siguri kombëtare, i cili do t'i rregullojë aspektet themelore të sistemit të sigurisë dhe zbulimit në aspekt të strukturës, funksionit dhe marrëdhënieve të ndërsjella të faktorëve (subjekteve), në kuadër të tij. Nga njëra anë, në mënyrë më të qartë duhet të shprehet komponenti i hierarkisë së sistemit, ndërkaq nga ana tjetër të sigurohet hapësirë më e gjerë për realizimin e aktiviteteve të çdo subjekti veç e veç të sigurisë-zbulimit. Kështu, në mënyrë të qartë do të trasohet rruga për realizimin e parimeve të racionalitetit, efikasitetit, koordinimit dhe sinkronizimit në punën e çdo subjekti të sigurisë-zbulimit. Njëherësh, me miratimin e Ligjit për siguri kombëtare do të kemi një pozicionim më preciz dhe më racional (në përputhje me standardet e BE-së dhe NATO-s) të subjekteve të sigurisë-zbulimit në fushën civile dhe ushtarake, që do të ishte në funksion të realizimit efikas të politikës së sigurisë së shtetit në planin e brendshëm dhe të jashtëm.

Sistemi i sigurisë duhet të udhëhiqet nga parimet e legalitetit dhe të perceptimit real të nevojave gjatë formimit të kapaciteteve të tij njerëzore dhe teknike, ndërsa e gjithë kjo duhet të shkojë në drejtim të avancimit të marrëdhënieve në shoqëri. Në këtë mënyrë jepet një garanci e qartë për atë se shteti e mbron qytetarin, pronën e tij, të mirat dhe vlerat e fituara me zhvillimin e shoqërisë demokratike. Nga ana tjetër, qytetari duhet të ndërtojë marrëdhënie aktive me sistemin e sigurisë përmes kontributit të tij në ruajtjen e sigurisë në bashkësi, në përforcimin e stabilitetit dhe sigurisë.

Në shoqëritë post-socialiste dhe pos-komuniste, krahas reformës në sektorin e sigurisë, duhet të tejkalohen stereotipat ekzistuese ose pengesat reale me të cilat subjektet e sistemit të sigurisë përjetohej si instrumente të pushtetit. Kjo paraqet pengesë serioze për bashkëpunimin dhe besimin e ndërsjellë. Perceptimi i qytetarëve ndaj institucioneve dhe pjesëtarëve të sistemit të sigurisë duhet të orientohet në drejtim të afirmimit të funksionit të tij mbrojtës. Qytetari, sistemin e sigurisë nuk duhet ta përjetojë si të huaj ose si forcë e cila u kundërshtohet interesave të tij pa kurrfarë baze. Së këtejmi, sistemi i sigurisë duhet të imponohet me vlera, siç janë: vetëdija personale për identitetin i cili shpie drejt patriotizmit konstruktiv, lojaliteti, morali dhe vlerat kulturore.

Politika e sigurisë buron nga nevojat e sistemit të sigurisë. Politikën e sigurisë mund ta përkufizojmë si pjesë të politikës së përgjithshme e cila në bazë të fakteve reale, të fituara përmes vlerësimeve të sigurisë për shkallën e rrezikshmërisë së vlerave, i përcakton mjetet dhe masat me të cilat mund të arrihen qëllime të caktuara të sigurisë në vend dhe jashtë vendit (Spaseski 2005: 69). Politika e sigurisë, në nivel kombëtar e vendos perceptimin e pushtetit lidhur me kërcënimet ndaj sigurisë së shteti dhe të popullatës së vet dhe përgjigjet e tij për këto kërcënimë. Politika është e ndryshme nga rregullat ose ligjet. Ligji, për shembull, do të imponojë ose ndalojë një sjellje të caktuar, ndërsa politika vetëm i zhvillon aksionet për të cilat ka besueshmëri të madhe që ta arrijë rezultatin e dëshiruar. Kjo do të thotë se politika paraqet një plan të qëllimshëm për aksion sipas së cilit do të udhëhiqet pushteti ekzekutiv gjatë marrjes së vendimeve (Albrecht & Barnes 2008: 1). Nga këndvështrimi i gjerë mund ta përkufizojmë si veprimtari për përgatitjen dhe sigurimin e burimeve të rrezikimit të ardhshëm të natyrës, shoqërisë dhe ndërmjet shoqërive. Nga aspekti më i ngushtë, politikën e sigurisë mund ta përkufizojmë si shumë të masave të përgjithshme, veprimtarive dhe procedurave të dedikuara për veprim, si sistem bashkëkohor të sigurisë kombëtare (Kotovčevski 2012: 23). Politika kombëtare ballafaqohet me një sërë formash interaktive²⁸ dhe kumulative, të cilat përfshijnë një spektër i cili nënkupton direktiva zyrtare të sigurisë kombëtare dhe deklarata gjatë fjalimeve të kryetarit dhe në nivel të kabinetit të përgjigjet në pyetjen e gazetarëve dhe në paraqitjet në emisionet televizive për ngjarje rrjedhëse të përfaqësuesve në nivel të kabinetit (Boone Bartholomees, Jr. 2010: 398).

Koncepti është sinonimi më adekuat për politikën e sigurisë kombëtare, përkatësisht politikën e sigurisë. Doktrina, gjithashtu, është e ngjashme nga aspekti terminologjik dhe esencial me politikën e sigurisë, por kohëve të fundit braktiset si nocion për shkak të prapavijës ideologjike të shfrytëzimit të saj gjatë kohës së Luftës së Ftohtë. Politika dhe strategjia kanë domethënie të ndryshme në mjedise të ndryshme profesionale. Po ashtu, gjithnjë e më të shpeshta janë domethëniet kolokfiale (Elkus 2012: 26).

²⁸ Forma frekuentive, përkatësisht të përsëritshme, të cilat karakterizohen ose përfshijnë përsëritje.


Politikë do të thotë “çka të bëhet për diçka”, e jo si të bëhet ajo. Zbatimi i strategjisë parashikon “si të bëhet ajo” (Stolberg 2010: 29). Autoritetet politike në SHBA politikën e sigurisë kombëtare e bazojnë mbi vendimet e mëdha strategjike, në drejtim të realizimit të interesave kombëtare. Politika është pikënisje për formulimin e strategjisë në nivel kombëtar (Boone Bartholomees, Jr. 2010: 398, ekstrakt). Strategjia e siguron orientimin, qëllimi i saj është kontrolli dhe ajo në mënyrë fundamentale merret me zbatimin e forcës. Supozimi kryesor, nga këndvështrimi kombëtar, është se shteti dhe persona të tjerë konkurrent kanë interesa të cilat ata do t’i realizojnë në mënyrën më të mirë të mundshme, në përputhje me aftësitë e tyre. Strategjia e përfshin realizimin, mbrojtjen ose avancimin e këtyre interesave përmes aplikimit të instrumenteve të fuqisë. Strategji është e gjithë ajo që do të thotë (mënyrë ose koncept) se si udhëheqësia do ta shfrytëzojë fuqinë (mjetet ose resurset) që i ka në dispozicion shteti që të ushtrojë kontroll mbi shumën e rrethanave dhe lokacioneve gjeografike që të arrihen qëllimet që shkojnë në favor të interesave shtetërorë (Lykke Jr. 1989: 3-8). Strategjia është dedikuar për luftimin e pasigurisë, kompleksitetit dhe dinamikës. Ajo nuk është plan ose dokument. Në politikën bashkëkohore ajo shërben që të sigurohet se pushteti në përgjithësi e identifikon dhe vepron në mënyrë efikase në mbrojtje të interesit kombëtar (UK Parliament 2010). Strategjia ka karakter aplikativ, përkatësisht i përmban qëllimet dhe orientimet operative për implementimin e aktiviteteve lidhur me politikën e sigurisë, organizimin dhe planifikimin e shpërndarjes dhe sistemimin e resurseve fizike dhe njerëzore. Ekzistimi i strategjisë nuk është e ndërlidhur me ekzistimin e politikës. Nëse strategjia u dedikohet situatave kur nuk janë të njohura të gjitha të dhënat për gjendjen (dhe njëkohësisht krijuesit e saj nuk mund të përcaktojnë zgjidhje alternative për ballafaqim me situatën), politika më shumë është e ndërlidhur me vendimmarrjen dhe ajo i parashikon procedurat se kur mund të ketë vetëm disa dukuri të paparashikuara. Kjo e bën më kompleks dhe më të vështirë procesin e miratimit të vendimeve strategjike sa u përket vendimeve politike. Për realizimin e aktiviteteve të strategjisë angazhohet niveli i mesëm në sistemin e sigurisë, ndërsa për realizimin e vendimeve politike angazhohen qarqet më të larta të institucioneve të cilat e përbëjnë sistemin e

sigurisë. Politika e sigurisë merret me analizën e asaj se çka është bërë dhe i jep orientimet për atë se çka duhet të bëhet, ndërsa strategjia paraqet qasje metodologjike në përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në politikën e sigurisë. Prandaj, për zbatimin e një aktiviteti të caktuar ose për shfrytëzimin e ndonjë mjeti të parashikuar me strategjinë e sigurisë doemos duhet të ketë vendim i cili është përfshirë në kuadër të politikës së sigurisë.

Gjithashtu, që punët të jenë më të qarta duhet të bëhet një distinkcion ndërmjet politikës së sigurisë dhe krimit. Politikën e sigurisë e hasim edhe në të drejtën penale materiale edhe në të drejtën penale-procesuale. Po ashtu, identifikimi i shpeshtë i saj me politikën kriminale është krejtësisht e gabueshme meqë politika kriminale përfshin vetëm një pjesë të masave të cilat ndërmerren në kuadër të politikës së sigurisë. Politika e sigurisë është e pranishme edhe në fushën sociale, si politikë për luftën kundër dukurive socio-patologjike të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë e rrezikojnë sigurinë e qytetarëve dhe të shoqërisë në tërësi.

Koncepti kombëtar, politikën e sigurisë e përkufizon si “shumë të masave, aktiviteteve, planeve dhe programeve komplekse dhe të ndërvarura, të cilat i ndërmerr Republika e Maqedonisë për shkak të mbrojtjes, ruajtjes dhe avancimit të sigurisë të Republikës së Maqedonisë dhe qytetarëve të saj, në përputhje me resurset në dispozicion dhe me bashkëpunimin aktiv me bashkësinë ndërkombëtare. Nga aspekti sistemor në vetvete e përmban politikën, ekonominë, mbrojtjen, sigurinë e brendshme, fushën sociale, ekologjike dhe fusha të tjera” (paragrafi 25 nga Nacionalna koncepcija za bezbednost i odbrana: 2003). Në formulimin e politikës së sigurisë më me rëndësi është se si do të përkufizohet siguria (si bazë e saj), përkatësisht forma e varësisë funksionale e sigurisë me nevojat, interesat dhe vlerat të cilat sundojnë në shtet në lidhje me qëndrueshmërinë e saj, zhvillimin dhe stabilitetin e qëndrueshëm. Së këtejmi, politika e sigurisë paraqet veprimtari multifunksionale dhe multidisiplinore të një shteti, me të cilën ajo zhvillon instrumente në më shumë fusha të jetës së njeriut (politika e brendshme dhe e jashtme, ekonomia, kultura dhe marrëdhëniet shoqërore) me qëllim të arritjes së stabilitetit të qytetarëve të vet, përforcimit të gjendjes së sigurisë së brendshme përmes garantimit të vlerave kushtetuese dhe realizimit të pozitës më të mirë në përmasa ndërkombëtare, e

cila do t'i mundësojë fuqi, dominim dhe dispersion të interesave të saj jashtë kufijve të shtetit. Politika e sigurisë mund të sqarohet si një dokument integral sipas së cilit udhëhiqen subjektet politike në procesin e miratimit të vendimeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e sigurisë dhe gjatë miratimit të aksioneve në pjesën ekzekutive të sistemit të sigurisë. Procesi politik, i dedikuar për zgjidhjen e problemeve të sigurisë, përfshin zgjidhje alternative dhe skenar të bazuar mbi programe dhe prioritete të përcaktuara në bazë të rëndësisë së tyre sa u përket interesave të shtetit. Prandaj, mund të hasen formulime të ndryshme lidhur me politikën e sigurisë.



Skema 2: Modeli për formulimin e strategjisë së SHBA (Boone Bartholomees, Jr. 2010: 397)

Sa i përket asaj se si është përkufizuar politika e sigurisë, çdo shtet ndërton qasje të ndryshme në aspektin e rregullimit të dokumenteve strategjik nga fusha e sigurisë dhe sa i përket rolit të përfaqësuesve të pushtetit në proces. Ndonjëherë politikës kombëtare të sigurisë i jepet mandat me ligj të veçantë, për shembull, SHBA kërkojnë që Presidenti për çdo vit, të paraqes pranë Kongresit strategji për politikë kombëtare, krahas asaj që në praktikë kjo gjë nuk ndodhë çdoherë në nivel vjetor. Në Letoni, Parlamenti duhet ta aprovojë politikën e sigurisë të cilën e harton kabineti dhe e aprovon për çdo vit Këshilli Kombëtar i Sigurisë. Në raste të tjera, pushteti ekzekutiv vet ndërmerr hapa për hartimin e Strategjisë për Siguri Kombëtare. Në Federatën ruse, për shembull, Këshilli Kombëtar i Sigurisë i harton strategjitë e sigurisë të cilat i aprovon pushteti ekzekutiv. Në Austri, në vitin 2001 Parlamenti e formoi Këshillin e Sigurisë Kombëtare i cili e ka mandatin ta udhëheqë politikën e sigurisë kombëtare, por nuk është e domosdoshme të hartojë dokument të integruar për politikën kombëtare të sigurisë²⁹ (Hagmann & Stocker 2007: 2). Gjatë krijimit të politikës kombëtare të sigurisë dhe në përkufizimin e udhëzimeve për zbatimin e saj (përkatësisht strategjisë) më e rëndësishme është që subjekti i cili i miraton vendimet përfundimtare, pavarësisht nëse bëhet fjalë për Këshillin Kombëtar të Sigurisë, për kabinetin e Presidentit të Shtetit ose për Kryetarin e Parlamentit, ata duhet të pranojnë dokument të integruar strategjik në të cilin në mënyrë të qartë janë specifikuar kompetencat e sistemit të sigurisë, në kuadër të bashkëpunimit më të gjerë ndërmjet agjencive, të identifikohen dobësitë dhe përparësitë e kapaciteteve të sistemeve të sigurisë, të ekzistojë sistemi i rregulluar në mënyrë racionale për vendimmarrje dhe për planifikim dhe të ekzistojë sistem i përgjegjësishë - politike dhe në kuadër të institucioneve të cilët e përbëjnë pjesën ekzekutive të sistemit të sigurisë.

Për shkak të përcaktimit të çështjeve më të rëndësishme strategjike që kanë të bëjnë me politikën e sigurisë të Republikës së Maqedonisë, duhet të bëhet një koncept i qartë të përcaktimeve për të cilat angazhohet shteti në lidhje me çështjet dhe aspiratat e sigurisë. Procesi e nënkupton përcaktimin e orientimeve të shtetit

²⁹ Edhe përkrah asaj se një gjë e tillë bëhet.

në lidhje me marrëdhëniet me NATO dhe BE (si perspektiva të vetme për zgjidhjen e çështjeve të sigurisë), me anëtarësimin dhe bashkëpunimin me aleancat politike – ekonomike dhe qëndrimet kombëtare për ballafaqimin me kërcënimet e sigurisë në kuadër të nivelit kombëtar dhe në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare.

4.2 Qëllimet

Ekzistojnë pesë shkaqe kryesore pse shtetet duhet të kenë politikë kombëtare të sigurisë të integruar dhe të detajizuar (Hagmann & Stocker 2007: 1-2):

- që qeveritë ta sigurojnë shqyrtimin e të gjitha kërcënimeve në një mënyrë gjithëpërfshirëse;
- që të rritet efektiviteti i sektorit të sigurisë përmes optimalizimit të kontributit të të gjithë aktorëve të sigurisë;
- që të orientohet zbatimi i politikës;
- që të ndërtohet konsensus vendor;
- që të avancohet besimi dhe bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar.

Formulimi i politikës së sigurisë, në masë të madhe, varet nga vlerësimet e sigurisë të cilat janë produkt i analizave të sigurisë nga ngjarjet aktuale, shoqërore dhe të sigurisë në vend, në rajon dhe më gjerë. Me kornizën ligjore të politikës së sigurisë në mënyrë më precize rregullohen të drejtat dhe obligimet e sistemit të sigurisë dhe i të gjithë subjekteve të tjera në shoqëri, në përputhje me legjislacionin ndaj të cilit shteti synon të bëhet pjesë e tij.³⁰ Korniza, përveç se e rregullon organizimin dhe funksionimin e sistemit të sigurisë, ajo i rregullon edhe marrëdhëniet në fushën politike, kulturore, sociale dhe ekonomike, të cilat ndërliohen me rrezikimin e rregullimit shtetëror, me sigurinë e përgjithshme dhe individuale.

Efektiviteti, në masë të madhe, varet nga shkalla e koordinimit ndërmjet subjekteve të përfshira në implementimin e politikës së sigurisë. Kështu, si subjekte mund të paraqiten: institucionet e pushtetit ekzekutiv, organet e jurisprudencës (të cilat janë veçanërisht të rëndësishme për represionin) dhe qytetarët.

³⁰ Në rastin e Republikës së Maqedonisë, ky është legjislacioni europian.

Përfshirja e qytetarëve është rezultat i dinamikës së zhvillimit të shoqërisë civile e cila kontribuon në progresin gjatë realizimit të qëllimeve të politikës së sigurisë dhe përfundimit të institucioneve të shtetit. Përcaktimi i subjekteve të ngarkuara për zbatimin e politikës së sigurisë paraqet një proces të vazhdueshëm dhe dinamik i cili krahas të tria kategorive të theksuara përfshin edhe përfaqësues nga komuniteti afarist (duke e pasur parasysh se numri më i madh i objekteve, të cilat janë përcaktuar si infrastrukturë kritike, janë në pronë private) dhe aktorë të tjerë të cilët mund të kontribuojnë në drejtim të krijimit të konceptit të përbashkët për kuptimin e sigurisë.

Vet emërtimi "politikë e sigurisë" flet se bëhet fjalë për dhënien e konotacionit politik të sigurisë. Duke u nisur nga ajo se bëhet fjalë për nivel të lartë hierarkik në të cilin trajtohet çështja e sigurisë, politika e sigurisë ka për qëllim t'i harmonizojë vendimet operative me qëllimet afatshkurtra dhe afatgjata të politikës shtetërore. Është fakt se bëhet fjalë për qasje të centralizuara në menaxhimin me siguri, por nga ana tjetër ky pozicion mundëson që në mënyrë racionale dhe optimale të shfrytëzohen resurset, të shmangen kundërthëniet (veçanërisht në kuadër të procesit të planifikimit dhe vendimmarrjes) dhe të ndërtohet një qasje gjithëpërfshirëse në përcaktimin e drejtimeve për zbatimin e politikave.

Politika e sigurisë është konceptuar në atë mënyrë që të ketë dimension mbipartiak dhe mbientik. Me përfshirjen e subjekteve të ndryshme (ekspertë, përfaqësues të pushtetit dhe të partive politike) ndërtohet mekanizëm me të cilin politika e sigurisë nuk do të perceptohet si instrument në pronësi të pushtetit. Kjo qasje mundëson që në mënyrë më të lehtë të vendoset dialog në situata kur nevojitet konsensus për vlerat dhe interesat kryesore kombëtare dhe për mënyrën se si shteti duhet të ballafaqohet me faktorët të cilët i rrezikojnë të njëjtit.

Transparenca e politikës së sigurisë është zgjidhje e cila e mundëson fuqizimin e bashkëpunimit bilateral dhe ndërkombëtar me partnerët dhe organizatat ndërkombëtare në fushën e sigurisë.

Qëllimet e çdo politike të sigurisë janë përcaktuar në dokument që të integrojnë më së paku tri tema themelore: rolin e shtetit në sistemin ndërkombëtar, sfidat dhe mundësitë e perceptuara vendore dhe ndërkombëtare dhe përgjegjësia e aktorëve të cilët i

zbatojnë me qëllim që t'i zgjidhin këto sfida dhe mundësi (Hagmann & Stocker 2007: 2). Me përcaktimin e qëllimeve strategjike të politikës së sigurisë përcaktimi i shtetit bëhet më i qartë në lidhje me çështjet dhe aspiratat e sigurisë, njëkohësisht përcaktohen drejtimit e shtetit në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare. Qëllimet e politikës së sigurisë përkufizohen qysh në procesin e krijimit të saj. Modeli i formulimit të politikës, i zhvilluar në periudhën kohore ndërmjet vitit 2004 dhe 2009 nga ana e Kolexhit Ushtarak të Armatës së SHBA-ve, identifikon një sërë të variablave ose hapave të cilët kanë të bëjnë me procesin (Stolberg 2010: 30):

- Përcaktimi i problemeve politike;
- Konteksti strategjik: i jashtëm dhe i brendshëm;
- Identifikimi dhe rekomandimi i interesave prioritar kombëtar dhe opinionet politike vendore;
- Fakte / Supozime / Faktorë të cilët e përcaktojnë kornizën e zhvillimit të politikës;
- Përcaktimi i rezultateve / qëllimeve të dëshiruara për shtetin nga zbatimi i politikës;
- Përcaktimi i qëllimeve dhe masave të cilat e mbështesin politikën;
- Identifikimi i opsioneve të politikës;
- Analiza dhe pranimi i çdo opsioni të ofruar me politikën;
- Analiza e rrezikut për çdo opsion;
- Krahasimi i opsioneve politike dhe dhënia e rekomandimeve;
- Shqyrtimi dhe vendimmarrja nga ana e udhëheqësisë;
- Monitorimi mbi zbatimin; dhe
- Pranimi i informatave kthyesë për suksesin ose mosesuksesin e politikës, implementimit dhe vlerësimit të saj.

Qëllimet e politikës së sigurisë janë në kontekst të dhënies së konotacionit politik të sigurisë, meqë përmbushja e qëllimeve të politikës së sigurisë, para së gjithash kushtëzohet nga vullneti politik. Politika e sigurisë e mundëson afirmimin e rëndësisë së sigurisë në politikë dhe kontribuon në drejtim të konceptimit më të lehtë të strategjive shtetërore nga fusha e sigurisë. Të kuptuarit e politikës së sigurisë ka të bëjë me ekzistimin e kapacitetit tek faktorët politikë. Këto kapacitete më së shpeshti e kanë formën e ekspertëve të cilët u përkasin partive politike të cilët e njohin problematikën e sigurisë, të cilët kanë një pasqyrë për efektet e

kërcënimeve dhe sfidave të sigurisë dhe që i dinë nevojat e sistemit të sigurisë.

Konteksti strategjik është i rëndësishëm gjatë përcaktimit të orientimeve të jashtme dhe të brendshme për implementimin e politikës. Në këtë kuadër përcaktohen interesat dhe prioritetet kombëtare.

Në "rivalitetin" ndërmjet politikanëve dhe praktikuesve gjatë përcaktimit të qëllimeve të politikës së sigurisë, mënyrë më përkatëse paraqet zgjedhja e qasjes demokratike ndaj çështjeve lidhur me realizimin e qëllimeve të politikës së sigurisë. Së këtejmi, koncepti i zbatimit të politikës së sigurisë duhet të paraqes kompromis ndërmjet zgjidhjeve të cilat i ofrojnë politikanët dhe praktikuesit nga fusha e sigurisë, në të cilën praktikuesit do të ofrojnë zgjidhje të bazuara në ekspertizë, ndërsa subjektet politike në procesin e miratimit të vendimeve të kërkojnë pëlqim nga publiku. Gjithashtu, parakusht i rëndësishëm për ushtrimin kualitativ të rolit të politikanëve, të cilët marrin vendime për çështjet e sigurisë, është edukimi i tyre paraprak nga fusha e sigurisë.

Në projektimin e qëllimeve të politikës së sigurisë doemos duhet të merren në konsideratë faktorët ekonomikë, demografikë dhe faktorët e tjerë të cikët janë rezultat i rrethanave shoqërore. Disa prej këtyre faktorëve mund të shërbejnë si burim optimal për përcaktimin dhe tejkalimin e konflikteve potenciale. Për shembull, varfëria e stimulon kriminalitetin, përkatësia e ndryshme etnike, fetare, kulturore dhe racore nxitë tensione ndëretnike, ndërsa rrethanat gjeografike vendin e vënë në një pozitë të caktuar të varësisë në kuadër të ngjarjeve rajonale.

Implementimi i qëllimeve të politikës së sigurisë, përveç rregullimit ligjor, në pjesë të madhe varet edhe nga përmbushja e supozimeve si vijojnë:

- Ekzistimi dhe zhvillimi i përhershëm i institucioneve të sistemit të sigurisë në përputhje me dinamikën e kërcënimeve të sigurisë dhe të rreziqeve lidhur me vlerat dhe interesat themelor të Republikës së Maqedonisë;
- Pjesëmarrje aktive në krijimin e sigurisë rajonale dhe globale në nivel operativ, taktik dhe strategjik; dhe
- Përkushtimi i shtetit ndaj zhvillimit të potencialit ekonomik

nga i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë varet sigurimi i mjeteve për ballafaqim efikas të qëllimeve të politikës së sigurisë.

Sipas dokumenteve strategjike vendas (paragrafi 26 nga Nacionalna koncepcija za bezbednost i odbrana 2003), qëllimi themelor dhe afatgjatë i politikës së sigurisë kombëtare është ta mbrojë, ruaj dhe avancojë gjendjen e sigurisë së shtetit, duke krijuar ambient për realizimin e interesave kombëtare të Republikës së Maqedonisë. Për realizimin e këtij qëllimi doemos duhet të ndërmerren dhe vazhdimisht të ruhen dhe avancohen masat dhe aktivitetet si vijojnë:

- ruajtja dhe avancimi i efikasitetit dhe objektivitetit të mjeteve dhe metodave për grumbullimin e të dhënave dhe informacioneve të rëndësishme për sigurinë;

- analizë kualitative dhe e vazhdueshme nga ana e ekspertëve lidhur me rajonin e sigurisë, me qëllim të pjesëmarrjes aktive në krijimin e tij dhe parandalimin e rreziqeve dhe kërcënimeve;

- ruajtja dhe avancimi i kapaciteteve adekuate të sigurisë dhe aftësive për parandalim, minimizim dhe eliminim të rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë, si edhe për zgjidhjen e konflikteve dhe situatave të krizës;

- ruajtja dhe avancimi në nivel të gatishmërisë së organeve të pushtetit shtetëror dhe harmonizim të akteve normative, rregullave dhe procedurave për koordinim me kohë, menaxhment, si dhe me qëllim të përgjigjes efikase me kohë dhe përkatëse ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë;

- zhvillimi i shërbimit kufitar, i cili në mënyrë efikase do ta kontrollojë kufirin dhe zonën kufitare jashtë pikave legale të kalimeve kufitare, do t'i pengojë të gjitha llojet e tregtisë jolegale, do të ndërtojë kapacitete dhe procedura unike për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë me fqinjët, rajonin dhe bashkësinë ndërkombëtare. Shërbimi kufitar duhet të sigurojë edhe avancim të përhershëm të marrëdhënieve të besimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë me popullatën lokale, si dhe të mbaj llogari për përfaqësimin e bashkësive etnike në përbërjen e vet;

- orientimi i sistemit të sigurisë kah arritja e inter-operabilitetit me sisteme të tjerë të ngjashëm në shtetet demokratike të Evropës.

Në vazhdim të dokumentit të njëjtë strategjik janë përfshirë orientimet sipas të cilave duhet të bazohet dhe të zhvillohet politika e sigurisë kombëtare (paragrafi 27 nga Nacionalna koncepcija za bezbednost i odbrana në vitin 2003). Nga distanca kohore, një dekadë pas miratimit të Konceptit Kombëtar, në bazë të orientimeve Republika e Maqedonisë iu bashkëngjiti koalicionëve globale për kthimin dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë botërore, e ngritur në shkallën e kompatibilitetit të sigurisë kombëtare në përputhje me zgjidhjet kushtetuese dhe ligjore, me standardet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, ligjërisht është demonopolizuar siguria duke e përfshirë sektorin civil, është formuar koncepti për kontroll demokratik ndaj sektorit të sigurisë, është mbyllur kuadri i konceptit të sigurisë kombëtare (i vendosur mbi katër shtylla), është vendosur model për bashkëpunim më të mirë integruar etj. Megjithatë, një pjesë të orientimeve u mungon implementimi (edhe përkrah asaj se janë rregulluar me ligj), nuk u vendos model për përgjegjësi politike dhe profesionale, ndërkaq një pjesë e orientimeve janë tepriçë meqë ato tanimë janë specifikuar në Kushtetutë dhe në dokumentet që kanë të bëjnë me orientimet e shtetit në kuadër të proceseve integruar euroatlantike.

Me realizimin e qëllimeve, të cilat duhet të arrihen përmes aktiviteteve për zbatimin formal dhe joformal të masave të politikës së sigurisë, duhet të fitohen efektet si vijojnë:

- mbrojtja dhe kontrolli i territorit të Maqedonisë;
- mbrojtja e infrastrukturës kritike;
- reduktimi i krimit të dhunshëm dhe mposhtja e rrjeteve të krimit të organizuar;
- përforcimi i sistemit juridik dhe respektimi i “sundimit të së drejtës”;
- fuqizimi i integritetit të institucioneve lidhur me sundimin e proceseve demokratike;
- mbrojtja nga kërcënimet në lidhje me veprat e terrorizmit;
- rritja e kontributit të Maqedonisë për sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare;
- sigurimi i mjedisit stabil për zhvillimin e ekonomisë; dhe
- mbrojtja e lëndëve të para natyrore të Maqedonisë dhe reduktimi i rreziqeve nga fatkeqësitë.

Krijimi i **kulturës së sigurisë** paraqet një nga qëllimet e politikës së sigurisë e cila është në funksion të sigurisë së qytetarëve, të bashkësisë dhe shoqërisë në tërësi. Kultura e sigurisë do të ketë potencial më demokratik nëse vendoset mbi baza të fuqishme. Më së shpeshti, siguria dhe kultura e sigurisë përfshin masa proaktive, por në këtë rast nuk e përjashtojnë mundësinë për shfrytëzimin e represionit. Ajo do të shfrytëzohej në situata kur janë rrezikuar vlerat individuale dhe kolektive por edhe interesat e shoqërisë, përkatësisht të shtetit (Rajkovčevski 2008: 398). Me kulturë të sigurisë mund të nënkuptohet aktivitetet e sigurisë i cili shpreh gatishmëri të aktiviteteve dhe të sjelljes në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e fituara, si dhe në përputhje me qëndrimet e vlerave të pranuar. Ajo pasqyrohet në identifikimin e rreziqeve, në reagimin ndaj tyre përmes shmangies së rrezikut, në parandalimin e rrezikut ose në thirrjen e subjekteve të cilët do të përgjigjen në mënyrë profesionale dhe do t'i ruajnë vlerat e rrezikuara (Stanarevic, Ejduš, Matović, Unijat, Popović, Millošević, Dimtrićević, Gjorgjević, i Gjelic 2009: 16). Kultura e sigurisë ka dy dimensione. Njëri nga dimensionet është i brendshëm dhe nënkupton krijimin e konceptit të sigurisë, ndërsa dimensionet e dytë është i jashtëm dhe nënkupton zbatimin e të njëjtit përmes ndërtimit të qëndrimit dhe zbatimit të masave për ruajtjen e sigurisë, identifikimin e kërcënimeve dhe mënyrën e reagimit e cila rezulton me rrezikimin e sigurisë.

Sa u përket relacioneve të kulturës së sigurisë me kulturën strategjike, politike dhe me kulturën organizative, për shkak të nivelit në të cilin krijohet dhe të cilit i jepen orientime për implementimin e saj, kultura e sigurisë dhe strategjike paraqet pjesë të kulturës politike të një komuniteti të organizuar politik. Kultura e sigurisë paraqet nënkulturë (subkulturë) të brendshme të pjesëtarëve të sistemit të sigurisë, por edhe të qytetarëve tek të cilët ekziston interesimi që të participojnë në ruajtjen e sigurisë brenda bashkësisë. Prandaj, mund të themi se kultura e sigurisë mbi orientime konkrete politike ka fuqi të përfshijë një numër më të madh të pjesëmarrësve aktivë në identifikimin dhe ballafaqimin me kërcënimet e sigurisë.

Sistemi i sigurisë përmes kulturës së sigurisë ndikon mbi sjelljen e qytetarëve, sjelljen e bashkësisë dhe mbi elementet e sistemit të sigurisë. Sjellja është në funksion të ruajtjes së sigurisë

dhe parandalimit të kërcënimeve dhe të rreziqeve. Nëse ekzistojnë instrumente për kontroll demokratik mbi sistemin e sigurisë ka gjasa reale që kultura e sigurisë të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve në lidhje me rëndësinë dhe mundësinë e kërcënimeve të sigurisë. Zakonisht kjo rezulton me një sjellje proaktive të qytetarëve dhe të bashkësisë në drejtim të identifikimit dhe zbulimit të kërcënimeve të sigurisë.

Nga ana tjetër, fuqia e kulturës së sigurisë ndikon mbi njerëzit, mbi opinionin e tyre, mbi paragjykimet, ndjenjat, mënyrën e sjelljes dhe përcaktimeve politike, lë hapësirë për keqpërdorime të mundshme ndaj kulturës së sigurisë. Shembull klasik janë autorizimet e zgjeruara të shërbimeve të sigurisë (në kurriz të reduktimit të kontrollit demokratik mbi punën e tyre) e zvogëluan besimin e qytetarëve ndaj shërbimeve të sigurisë dhe me këtë u zvogëlua efikasiteti gjatë punës së policisë.³¹ Prandaj, përmbushja e qëllimeve të kulturës së sigurisë dhe politikës së sigurisë varet nga efikasiteti i mekanizmave për monitorim mbi sistemin e sigurisë. Arritja e qëllimeve duhet ta ndjek respektimin e parimeve humaniste dhe të kontribuojë në drejtim të proceseve të përgjithshme pozitive në shoqëri, ndërkaq implementimi i gabueshëm i qëllimeve të politikës së sigurisë mund të çojë në rrënimin e rregullimit shtetëror dhe të vlerave themelore të shoqërisë.

Qëllimet e politikës së sigurisë, përveç me gjendjen e brendshme të sigurisë, janë në korrelacion me ngjarjet rajonale

³¹ Si shtojcë e kësaj vërejtje janë përvojat e SHBA-ve dhe e Britanisë së Madhe ku autorizimet e gjera të shërbimeve të sigurisë në ballafaqimin me kërcënimet terroriste sollën deri te keqpërdorimi i qëllimeve të politikës së sigurisë. paraqitja e "terrorit shtetëror" paraqet reagim ndaj zgjidhjeve të mundësuar me Aktin Patriotik të SHBA-ve të miratuar gjashtë javë pas sulmeve terroriste në vitin 2001. Në vitin 2002, SHBA-të e miratuan Aktin për Siguri Shtetërore, me të cilin në mënyrë shtesë u formua Departamenti i Sigurisë Shtetërore si trup për koordinimin e më shumë agjencive të sigurisë në SHBA. Pas sulmeve terroriste në Londër në vitin 2005, menjëherë në vitin 2006 Britania e Madhe miratoi Akt Terrorist, ndërkaq u inkorporuan autorizimet e rritura policore edhe gjatë kohës së Lojërave Olimpikë në Londër në vitin 2012 kur seriozisht u ngrit shkalla e sigurisë për shkak të kërcënimeve me sulme terroriste. Autorizimet e gjera të shërbimeve të sigurisë në SHBA rezultuan me skandalin i cili u shfaq në vitin 2013, ndërkaq i njëjti ndërlidhet me përgjimet e politikanëve të njohur nga Evropa dhe nga Amerika Jugore nga ana e Agjencisë Kombëtare të Sigurisë (NSA) të SHBA-ve. Periudhën ndërmjet skandalit me Agjencinë Kombëtare të Sigurisë e shënuan edhe afera të tjera të sigurisë, të cilat u shfaqën me zbardhjen e informatave të klasifikuara të sigurisë. Botuesi, gazetari dhe aktivisti australian Xhulian Asanzh publikoi informata të klasifikuara nga burime anonime, ndërkaq specialisti amerikan i kompjuterëve Eduard Snouden, i cili është ish i punësuar në CIA dhe i cili ka qenë i angazhuar në Agjencinë Kombëtare të Sigurisë gjithashtu publikoi në media mbi 200 000 informata të klasifikuara.

dhe evropiane të sigurisë. Kjo ka të bëjë me faktin se asnjë shtet (as shtetet më të zhvilluara dhe më demokratike) absolutisht nuk mundet vet ta garantojnë paqen, sigurinë dhe prosperitetin e qytetarëve të vet. Kjo veçanërisht ka të bëjë me kërcënimet globale asimetrike.³² Së këtejmi, zbatimi i qëllimeve të politikës së sigurisë, në një pjesë të caktuar, bazohet mbi zgjidhjet dhe mundësitë të cilat rezultojnë nga bashkëpunimi rajonal dhe global i sigurisë. Tendenca ekzistuese, të cilën e ndjekin shtetet gjatë konceptimit të politikës së sigurisë, angazhohet për miratimin e politikës prudente të sigurisë e orientuar në drejtim të bashkëpunimit intensiv rajonal, në drejtim të mbrojtjes së shoqërisë dhe në drejtim të avancimit të vlerave të përbashkëta, të miratuara në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare.

Shikuar në aspektin e kuadrit kombëtar, qëllimi kryesor i politikës së sigurisë të Republikës së Maqedonisë është të ofrojë siguri dhe t'i mbrojë qytetarët e vet, duke u mbështetur mbi ligjet vendore dhe institucionet vendore dhe mbi zgjidhjet që i ofrojnë institucionet globale dhe rajonale të sigurisë përmes anëtarësimit të Maqedonisë në sistemet kolektive të sigurisë dhe përmes bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare në luftën e koordinuar kundër krimit dhe kërcënimeve ndaj sigurisë. Për përmbushjen e qëllimeve kryesore është e domosdoshme që politika e sigurisë të jetë gjithëpërfshirëse dhe të përmbajë veçori politike, ekonomike, ekologjike, sociale dhe kulturore. Karakteristikat përkojnë me zbatimin e politikës së sigurisë me qëllim të parandalimit meqë ajo përfshin veprim politik dhe diplomatik në fushat e politikës ekonomike dhe zhvillimore, por njëkohësisht edhe përdorimin e masave kushtetuese, sociale dhe humanitare. Përdorimi i mjeteve ushtarake ka të bëjë vetëm me situata të domosdoshme të përcaktuara me Kushtetutë të cilat rezultojnë nga dispozitat në lidhje me shtetformimin, lirinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe me ruajtjen e vlerave të

³² Kërcënimet asimetrike janë kërcënime dhe rreziqe të cilat për bazë e kanë modelin e zhvillimit të luftës jokonvencionale. Ato paraqesin një spektër të shumëllojshëm dhe të paparashikuar të operacioneve ushtarë, paramilitare dhe të informacionit, të udhëhequra nga kombe, nga organizata, nga grupe, nga individë ose nga forca vendase të cilat gjenden nën ndikimin e propagandës dhe kontrollit të huaj. Çak i kërcënimeve janë dobësitë dhe mangësitë e vendit i cili është objekt i kërcënimeve dhe të sistemit të tij të sigurisë (Primmerman 2006, ekstrakt). Karakteristikat e kërcënimeve asimetrike kanë të bëjnë me atë që gjatë realizimit të aktiviteteve përdoren teknikat e befasisë dhe armët të cilat nuk i takojnë mënyrës konvencionale të luftimit, ndërkaj për realizimin e aksioneve nuk është i domosdoshëm kontakti fizik ndërmjet ekzekutuesit dhe cakut.

përgjithshme. Marrë në përgjithësi, qëllimet e politikës së sigurisë të Republikës së Maqedonisë kryesisht fokusohen mbi:

- parandalimin e konflikteve ndëretnike dhe krizave politike; dhe
- shfrytëzimin e plotë të mundësive nga anëtarësimi në organizatat që kanë të bëjnë me sigurinë euroatlantike, evropiane dhe rajonale.

4.3 Parimet e politikës së sigurisë

Parimet e politikës shtetërore të sigurisë paraqesin bazë për organizimin dhe për veprimin e sistemit të sigurisë. Në to janë inkorporuar vlerat e Kushtetutës dhe orientimet e përcaktuara në marrëdhëniet e brendshme dhe të jashtme të shtetit. Ekzistojnë më shumë qasje në përcaktimin e parimeve të politikës së sigurisë. Ato, në një pjesë të madhe, korrespondojnë me parimet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e shtetit (Jenkins 2007; Parliament of Estonia 2010: 4). Kështu, në bazë të përcaktimit, kuptimit dhe nevojave të sigurisë, politika e sigurisë bazohet mbi **parimin e rregullimit juridik, parimin e sigurisë së pandashme, parimin e gjithëpërfshirjes, veçorinë dhe mbrojtjen e vlerave vitale, parimin e paqes dhe partneritetit, parimin e transparencës dhe parimin e transparencës për ndryshime.**

➤ **Parimi i rregullimit juridik** përfshin norma kushtuese dhe ligjore, norma të përcaktuara me të drejtën ndërkombëtare dhe norma të cilat shteti në mënyrë të pjesshme ose të plotë i ka pranuar dhe ratifikuar në dhomën kombëtare ligjvënëse (Parlament). Korniza ligjore e politikës së sigurisë duhet të jetë pasqyrë e nevojave reale, rrethanave politike të sigurisë dhe duhet ta lehtësojë realizimin e qëllimeve të vendosura, të cilat janë përcaktuar me politikën shtetërore të sigurisë. Korniza ligjore nuk duhet të adaptohet sipas interesave individuale politike dhe të interesave të caktuara etnike, religjioze, kulturore dhe entiteteve të tjera të shoqërisë. Ajo duhet të korrespondojë me qëllimet për ruajtjen e interesave kombëtare dhe të mundojë zhvillim papengësë të shoqërisë demokratike me të gjitha vlerat dhe përfitimet e saj. Në rastin e Republikës së Maqedonisë, rregullimi ligjor i politikës së sigurisë duhet të jetë në harmoni me

proceset integruese euroatlantike, me perspektivat e sigurisë dhe me ato ekonomike të shtetit. Në situatë kur shteti ka hyrë thellë në proceset integruese euroatlantike, është shumë e besueshme se ekziston sinkronizim midis katër burimeve të kornizës ligjore.

➤ **Parimi i sigurisë së pandashme** e shpjegon interaksionin e sigurisë kombëtare me sigurinë rajonale dhe globale. Interaksioni i këtyre tre llojeve të sigurisë është i matshëm përmes shkallës së sigurisë së një shteti dhe përmes formës me të cilën shteti i vendos marrëdhëniet e veta të jashtme. Përfaqësimi i këtij parimi në politikën kombëtare të sigurisë i tregon nevojat e shteteve për pjesëmarrje në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë (NATO, Interpol, agjencitë e BE – Evropol dhe Fronteks, iniciativa rajonale të sigurisë etj.). Respektimi i parimit të sigurisë së pandashme i obligon shtetet që përmes vendosjes së partneritetit të ndërmarrin obligime dhe përgjegjësi me qëllim të ruajtjes së sigurisë ndërkombëtare, në kuadër të mundësive dhe kapaciteteve të veta.

➤ **Parimi i qasjes gjithëpërfshirëse** (nënkupton shkallë më të lartë të identifikimit të kërcënimeve ndaj sigurisë dhe mënyrave për ballafaqimin me to), specificitetit (në përputhje me nevojat e sistemit të sigurisë dhe me karakteristikat e shtetit) dhe **mbrojtjes së vlerave vitale** është rezultat i kompleksitetit të kërcënimeve dhe i rreziqeve dhe ndërvarësisë së tyre. Politika e sigurisë duhet të përcaktojë mekanizma përkatës me të cilët sistemi i sigurisë do të ketë kapacitet të mundësojë mbrojtje aktive dhe gjithëpërfshirëse të interesave dhe vlerave shoqërore të përcaktuara me Kushtetutë. Parimi i qasjes gjithëpërfshirëse duhet të parashikojë instrumente për parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme të politikës së sigurisë, përkatësisht sistem të masave për koordinim dhe mbikëqyrje të institucioneve të sistemit të sigurisë.

SHBA, si vend-lider në politikën ndërkombëtare dhe në bashkësinë ndërkombëtare të sigurisë, qasjen gjithëpërfshirëse e përkufizon si kombinim të të gjitha elementeve të fuqisë së shtetit (të cilat njëherësh janë pjesë përbërëse të sistemit të sigurisë dhe pushtetit), në formën e njohur si "3D (3D's)"³³, që përdoren bashkë me të gjitha veglat e tjera relevante të rëndësishme për interesat kombëtare të SHBA-ve dhe të cilat mbulojnë një spektër

³³ Diplomacia, zhvillimi dhe mbrojtja (angl. diplomacy, development and defense).

të aktiviteteve, nga zbatimi i ligjeve deri në presionin ekonomik, por edhe mbështetje nga partnerët ndërkombëtarë dhe joqeveritarë (US Department of Defense 2010; Hadley & Perry 2010: 31-32).

➤ **Parimi paqedashës dhe i partneritetit** shpjegohet me botëkuptimin konvencional të vlerave përgjithësisht të pranuar në kuadër të shoqërive demokratike dhe të organizatave ndërkombëtare, në kontekst të ruajtjes së sigurisë. Kjo nënkupton mundësi për zgjidhje paqësore të të gjitha çështjeve me mjete politike, juridike dhe dialog. Maqedonia, me konsekuencë e respekton këtë parim, me atë se nuk ka pretendime territoriale ndaj fqinjëve dhe vendeve të tjera, ndërkaq njëherësh asnjërin nga fqinjët nuk e përjeton si armik (Paragrafi 1 nga Amendamenti I i Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë). Nga ana tjetër, koncepti paqedashës për udhëheqjen e politikës së sigurisë, hap mundësi për kërcënime ndaj integritetit territorial dhe ndaj sovranitetit, por megjithatë paraqet zgjidhje më racionale për ruajtjen e stabilitetit. Ky parim ndërlihet me respektimin e parimeve demokratike, me të drejtën ndërkombëtare, me parimin e barazisë dhe të bashkëpunimit ndërmjet shteteve.


➤ **Parimi i transparencës (publicitetit)**, si pjesë e risive të inkuorporuara me demokratizimin dhe reformën e sistemit shtetëror të sigurisë, ka për qëllim tejkalimin e dallimeve të cilat rezultojnë nga stereotipat e sistemit (tradicionalizmi, mbyllja dhe konservatorizmi). Koncepti civil i sistemit të sigurisë kërkon që ai të jetë më i hapur dhe më i arritshëm për publikun. Krahasuar me politikën kombëtare të sigurisë së Austrisë, Zvicrës, Kanadasë dhe Afrikës Jugore, në mënyra të ndryshme përkufizohet rëndësia e transparencës së politikës së sigurisë (Born 2001: slide 4). Publiku shërben për konsolidimin e politikës rrjedhëse (në Afrikën Jugore dhe në Zvicër), për menaxhimin me sigurinë humane (tek të gjithë), për t'i pastruar punët me të kaluarën (në Afrikën Jugore dhe në Kanada), paraqet përgjigje për sfidat e reja të sigurisë (në Kanada) dhe është përgjigje gjatë ndërtimit të besimit në aktivitetet që kanë të bëjnë me informacionet (në Afrikën Jugore).

Transparenca, si pjesë e demokratizimit të sistemit të sigurisë nënkupton inkuorporimin e instrumenteve për kontroll demokratik të sistemit të sigurisë. Me kontroll (ndërkaq veçanërisht me kontrollin nga ana e sektorit qytetar) sigurohet transparenca e aktiviteteve të institucioneve kompetente të shtetit për krijimin dhe zbatimin e aktiviteteve të politikës së sigurisë, në përputhje me

standardet të cilët aplikohen në demokracitë e zhvilluara. Përveç funksionit qytetar, bartës kryesor të funksionit mbikëqyrës janë: Parlamenti, Qeveria dhe organet e tjera të formuara.

➤ **Parimi i transparencës për ndryshime** bashkëvepron në mënyrë terminologjike me parimin e dinamikës dhe fleksibilitetit. Fleksibiliteti ka të bëjë me aplikimin e politikës së sigurisë në mënyrë me cilën ajo duhet t’u përshtatet ndryshimeve dhe sfidave globale të sigurisë. Fleksibiliteti nuk do të thotë se politika duhet të ndryshojë shpesh, por kjo më shumë ka të bëjë me përshtatjen e saj ndaj problemeve të cilët shfaqen gjatë aplikimit dhe qëllimeve të saj të cilat synojnë shmangien e konfliktit dhe tejkalimin e dallimeve.

4.4 Procesi i krijimit dhe rregullimit ligjor të politikës së sigurisë në Republikën e Maqedonisë



Skema 3: Pyetje të cilat duhet të parashtrohen gjatë zhvillimit të politikave të sigurisë (Luethold në Albrecht & Barnes 2008: 2)

Krijimi i politikës së sigurisë kërkon përbushjen e disa parakushteve (Albrecht & Barnes 2008: 2, ekstrakt):

- zbatimin e analizës strategjike, përcaktimin e vizionit në lidhje me menaxhimin e sigurisë, konsultimin e opinionit të gjerë me qëllim të identifikimit të kërcënimeve ndaj sigurisë dhe përfshirjen e opinionit ekspert dhe shkencor me qëllim të fitimit të rekomandimeve dhe orientimeve në krijimin e konceptit;
- rangimin e kërcënimeve dhe rreziqeve aktuale;
- përcaktimin e kapaciteteve të sigurisë dhe kornizës financiare për mirëmbajtjen dhe modernizimin e tyre në drejtim të shfrytëzimit më efikas dhe më racional të mjeteve në dispozicion për ballafaqimin me kërcënimet aktuale;
- në bazë të parakushtit të dytë dhe të tretë duhet të bëhet analizë për riorganizimin dhe pajisjen shtesë të sistemit të sigurisë me resurse njerëzore dhe materiale, të cilat do të mundësojnë ballafaqim me kërcënimet prioritare ndaj sigurisë; dhe
- përcaktimin e prioriteteve të ardhshme dhe buxhetit për ballafaqimin me kërcënimet ndaj sigurisë, të cilat do të shfaqeshin në afat të mesëm dhe të gjatë.

Përpjekjet, për krijimin e modelit të politikës së sigurisë në Republikën e Maqedonisë, datojnë nga periudha e pavarësisë së shtetit. Procesi i pavarësisë në vitin 1991 me vete sollti një sërë reformash me të cilat projektohet ardhmëria e vendit. Njëra prej tyre ishte reforma e sektorit të sigurisë, e cila fitoi intensitet pas njohjes ndërkombëtare të shtetit dhe obligime të cilat rezultuan nga anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare. Sfidat, me të cilat u përball procesi i krijimit të politikave të sigurisë, në përputhje me nevojat e sistemit të sigurisë në ballafaqimin me kërcënimet ndaj sigurisë në kontekst të ndryshimeve që ndodhën në nivel lokal, rajonal dhe ndryshimeve botërore, kryesisht rezultonin nga mospasja e përvojës për krijimin e politikës së sigurisë, përcaktimit të kërcënimeve dhe ballafaqimit me ekspansionin e mbrojtjes dhe ushtarak. Në kohën kur prioritetet e sigurisë u orientuan drejt formimit të sistemit mbrojtës dhe ushtrisë, si pjesë e domosdoshme e shtetformimit dhe krijimit të kombit dhe kur vendi u përball me propagandë të fuqishme nga fqinjët, e cila nuk shkonte në favor të njohjes ndërkombëtare, të pavarësisë dhe të sovranitetit të shtetit, nuk kishte kohë për leksione për krijimin e politikës së sigurisë.

Titulli i dokumentit strategjik	Dokument publik	I miratuar/i publikuar në "Gaz. Zyrtare të R. të Maqedonisë"	Ndryshimet
Libri i Bardhë i Mbrojtjes	po	1998	2005 dhe 2012
Strategjia e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë	po	11.9.1998	1.3.2010
Marrëveshja Kornizë e Ohrit	po	13.8.2001	Jo
Koncepti Kombëtar i Sigurisë dhe Mbrojtjes	po	11.6.2003	Jo
Pasqyra Strategjike e Mbrojtjes	jo	22.10.2003	Jo
Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufijve	po	12.2003	Jo
Strategjia për Reforma të Policisë	jo	2003	2004
Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Maqedonisë	jo	1.2008	Jo
Plani Afatgjatë për Zhvillimin e Mbrojtjes 2011-2020	po	1.2011	

Tabela 8: Pasqyra e miratimit të dokumenteve strategjike nga fusha e sigurisë në periudhën kohore 1998-2013

Historia e procesit të miratimit të dokumenteve strategjike e tregon shkallën e demokracisë dhe transparencës dhe kontinuitetit të miratimit të legjisllacionit për avancimin e politikës shtetërore të sigurisë.³⁴ Baza, nga e cila udhëhiqen të gjitha dokumentet strategjike në fushën e sigurisë është Kushtetuta e shtetit. Qëllimet e politikës së sigurisë janë të orientuara kah mbrojtja e interesave

³⁴ Duke e ndjekur kronologjinë sipas së cilës janë miratuar ligjet dhe dokumentet strategjike të cilat e rregullojnë sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë, mund ta përcaktojmë radhën, si vijon: Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (viti 1991, me amendamentet e Kushtetutës nga viti 1992, 1998, 2001, 2003, 2005 dhe 2009, Ligji për punë të brendshme (viti 1995), Ligji për Agjencinë e Zbulimit (viti 1995), Strategjia e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë (viti 1998), Ligji për mbrojtje (viti 2001), Koncepti Nacional i Sigurisë dhe Mbrojtjes (viti 2003), Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (viti 2003), Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe prurjeve të tjera nga vepra penale (2004), Ligji për Drejtorinë e Doganave (2004), Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale (2005), Ligji për menaxhimin me kriza (2005), Plani i Veprimit për Menaxhim të Integruar të Kufirit (2005), Ligji për punë të jashtme (2006), Ligji për ndjekjen e komunikimeve (viti 2006), Ligji për policinë (2006, hyri në fuqi më 11.11.2007) dhe ligje të tjera relevante të miratuara gjatë periudhës kohore 2008-2013.

dhe vlerave (themelore), të përcaktuara në nenin 8 të **Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë** nga viti 1991 dhe ndryshimi i amendamenteve në vitin 2001, në përputhje me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Njëherësh, Kushtetuta i përcakton vlerat themelore të cilat janë objekt i mbrojtjes së sistemit të sigurisë. Në këtë kontekst, zhvillimi i parimeve demokratike të shtetit duhet të nënkuptojë monitorimin e vlerave tradicionale, të lidhura ngushtë dhe të varura në mënyrë të ndërsjellë përmes përforcimit të: sistemit politik parlamentar, sundimit të së drejtës, rikuperimit të shpejtë ekonomik dhe zhvillimit ekonomik, përmirësimit të standardit jetësor, zhvillimit dhe përsosjes së sistemit për mbrojtje shëndetësore dhe sociale të popullatës, mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore të vendit – si elemente me rëndësi esenciale për stabilitetin e përhershëm të sigurisë të Republikës së Maqedonisë. Ndryshimet në Kushtetutë, nga vitit 2002, të cilat janë në përputhje me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, parashikuan integrimin e dy mekanizmave kyç për ballafaqimin me konfliktet ndëretnike, siç janë: *Teoria e demokracisë konsociale ose kontraktuese dhe Modeli për reduktimin e konfliktit etnik të Donald Horovic*.

Politika e sigurisë mund të prezantohet si “Libri i Bardhë”, e që në të vërtetë është emër joformal për dokument parlamentar i cili e artikulon politikën qeveritare. Ai është dokument i lëshuar nga qeveria dhe përcakton politikën dhe/ose propozon aktivitet nga fusha e shqetësimit aktual. Edhe pse nuk është i obliguar me ligj, Libri i Bardhë ndonjëherë mund të konsiderohet si pjesë e një procesi të hapur të konsultimeve. Megjithatë, Libri i Bardhë nuk ka tendencë ta përcaktojë qëllimin e qartë të qeverisë për të miratuar legjislacion të ri. “Libri i Gjelbër” zakonisht është më transparent dhe mundet vetëm të propozojë strategji ose të formulohet si diskutim ose dokument konsultativ (Albrecht & Barnes 2008: 4). **Libri i Bardhë i Mbrojtjes** në Republikën e Maqedonisë filloi të aplikohet që në vitin 1998, por ai u iniciua për ta kapërcyer hendekun i cili u shfaq si rezultat i mungesës së strategjisë kombëtare në këtë fushë. Libri i Bardhë shfrytëzon pjesë nga dokumentet strategjike nga fusha e sigurisë dhe me të bëhen përpjekje në mënyrë më sistematike të tregohen çështje të caktuara nga fusha e sigurisë që i përmbajnë dokumentet publike dhe dokumentet interne, por pa qasje thelbësore.

Nevoja për politikë të sigurisë për herë të parë përmendet në paragrafin 9 të **Konceptit Kombëtar të Sigurisë dhe Mbrojtjes**³⁵ nga viti 2003, në paragrafin 25 përcaktohet politika e sigurisë kombëtare, ndërsa në paragrafët 26 dhe 27 përcaktohen qëllimet e politikës së sigurisë. Miratimi i Konceptit u parashikua me nenin 17, paragrafin 1, pikën 8 të Ligjit për mbrojtje ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 42/2001 dhe 5/2003) dhe në përputhje me pikën 1 ai paraqet dokument bazë të Republikës së Maqedonisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Konceptit Kombëtar i Sigurisë dhe Mbrojtjes bazohet në vlerësimin e kreatorëve vendas të politikave në fushën e sigurisë për mjedisin ndërkombëtarë dhe për pozitën e Republikës së Maqedonisë, për rrezikimin e sigurisë së saj dhe bazohet në qëllime dhe orientime të harmonizuara për udhëheqjen e politikës kombëtare të sigurisë. Koncepti Kombëtar i Sigurisë dhe Mbrojtjes paraqet dokument të sistematizuar me të cilin përcaktohen interesat e Maqedonisë, rajoni i sigurisë, rreziqet, kërcënimet, qëllimet dhe orientimet e udhëheqjes së politikës së sigurisë, fushat dhe instrumentet e zbatimit të saj. Për realizimin e interesave të veta kombëtare, Republika e Maqedonisë duhet të udhëheqë politikë të sigurisë me të cilën përsoset sistemi i sigurisë në mënyrë që të jetë e aftë, efikase dhe kredibile për t'iu përgjigjur sfidave bashkëkohore të sigurisë, t'i zgjidh krizat në vend, por edhe të ndihmojë në zgjidhjen e krizave në rajon dhe më gjerë.

Në Konceptin janë përkufizuar pesë elemente të politikës së sigurisë, siç janë: politika e jashtme, ekonomike, e mbrojtjes, politika e sigurisë së brendshme dhe e mbrojtjes së mjedisit jetësor (pika 28, paragrafi 1 nga Nacionalna koncepcija za bezbednost i odbrana 2003). Nga pesë elementet e politikës së sigurisë, politika e jashtme, politika e brendshme dhe politika e mbrojtjes dhe sigurisë veçohen si elemente më me ndikim mbi sigurinë e shtetit dhe si elemente në mesin e të cilave mund të identifikohen disa relacione të ndërvarura. Tre elementet e theksuara të politikës së sigurisë kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi krijimin e politikave për veprimin

³⁵ Miratimi i Konceptit Kombëtar të Sigurisë dhe Mbrojtjes është vepër e grupit ndërsektorial i përbërë nga përfaqësues të ministrisë së Punëve të Jashtme, të Punëve të Brendshme, të Mbrojtjes në konsultime me kabinetin Presidentit. Konceptin Kombëtar të Sigurisë dhe Mbrojtjes e ka hartuar Qeveria, ndërsa e ka miratuar Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

e sistemit të sigurisë në funksion të ruajtjes së paqes, sigurisë dhe stabilitetit të shtetit. Objekt i mbrojtjes janë vlerat e fituara me ndryshimet demokratike, të cilat pasuan pas pavarësismit të shtetit dhe me miratimin e konceptit të multi-etnicitetit të përfshirë në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Këtyre vlerave u ndërlidhen atributet e shoqërisë maqedonase të cilat janë pjesë e historisë së shtetit dhe e ngjarjeve bashkëkohore të sigurisë, siç janë: e kaluara antifashiste, anëtarësimi në koalicionin e shteteve për luftë kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, mbështetja politike dhe operative e aktiviteteve për parandalimin e krimit të organizuar dhe serioz transnacional dhe aktivitete të tjera të cilat i ndërmerr shteti në fushat që kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes ndërkombëtare.

Përveç elementeve të politikës së sigurisë, Koncepti Kombëtar përkufizon edhe çështje të tjera. Globalizimi dhe rritja e ndërvarësisë së shteteve, rezultoi me ndryshime në materien dhe formën e interesave shtetërore. Si pasojë e proceseve integruese, sovraniteti politik dhe ekonomik i shtetit fitoi një dimension të ri përmes lidhjes së shtetit me interesat kolektive. Në këtë kontekst, interesat e përcaktuara në Koncept janë klasifikuar në: *të përhershëm, vital, dhe të rëndësishëm*³⁶ (paragrafi 7 nga Nacionalna koncepcija za bezbednost i odbrana, 2003). Interes i përhershëm i Republikës së Maqedonisë është ruajtja dhe avancimi i identitetit të saj shtetëror me shprehjen e lirë të identitetit etnik të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, si dhe mbrojtja e pavarësisë dhe integritetit territorial. Sipas Konceptit, me interesat vital avancohet gjendja e sigurisë dhe krijohen kushte për jetë më të mirë të qytetarëve dhe për funksionimin e shoqërisë. Në interesat vital bëjnë pjesë:

- mbrojtja dhe avancimi i paqes dhe sigurisë, jetës, shëndetit, pronës dhe sigurisë personale të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë;
- zhvillimi i shoqërisë multi-etnike, i bazuar mbi besimin e ndërsjellë, angazhimet dhe synimet e përbashkëta të të gjitha bashkësive etnike për stabilitet dhe përparim të gjithanshëm të shtetit;

³⁶ Precizimi plotësues i interesave mund të gjendet edhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare nga viti 2008, në Strategjinë e Mbrojtjes nga viti 2010 dhe në Librin e Bardhë të Mbrojtjes nga viti 2012.

- zhvillimi ekonomik i bazuar mbi parimet e ekonomisë së tregut, pronës private, si dhe mbi mbrojtjen e infrastrukturës vitale dhe resurseve të Republikës së Maqedonisë;

- mbrojtja dhe avancimi i bazave demokratike të shtetit ligjor – pluralizmi politik, demokracia parlamentare, ndarja e pushtetit dhe zgjedhjet e ndershme dhe demokratike, sundimi i së drejtës, respektimi konsekuent i të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe të drejtat dhe liritë e qytetarëve të cilët u përkasin të gjitha bashkësive dhe ruajtja dhe avancimi i vazhdueshëm i sigurisë së përgjithshme të brendshme të shoqërisë dhe shtetit;

- integrimi politik-mbrojtës në NATO, integrimi politik, ekonomik dhe i sigurisë në BE, si dhe në sisteme të tjerë për siguri kolektive.

- Koncepti, interesat e rëndësishëm i percepton si parakushte për krijimin dhe realizimin e interesave të përhershëm dhe vital të Republikës së Maqedonisë. Në to bëjnë pjesë:

- ndërtimi dhe zhvillimi i të gjitha formave të bashkëpunimit me fqinjët, ndërkaq në interes së paqes, sigurisë dhe zhvillimit të Republikës së Maqedonisë dhe fqinjëve të saj;

- kontributi i vet për ruajtjen dhe avancimin e paqes dhe stabilitetit në EJT me qëllim të përforcimit të segmentit të demokracisë, sigurisë dhe prosperitetit të të gjitha vendeve të rajonit;

- pjesëmarrja në ndërtimin e paqes dhe stabilitetit në rajon, Evropë dhe botë, si dhe parandalimi dhe ndërtimi i instrumenteve për paralajmërimin e hershëm të tensioneve dhe krizave, me qëllim të zgjidhjes me kohë dhe efikase përmes rrugës paqësore;

- ruajtja dhe avancimi i rregullimit ndërkombëtar bazuar mbi drejtësinë, respektimin e ndërsjellë të rregullimit ndërkombëtar i bazuar në të drejtën ndërkombëtare, si dhe barazia politike dhe ekonomike e shteteve;

- sigurimi i kushteve dhe avancimi i stabilitetit të brendshëm politik dhe mundësi për të drejta të barabarta për pjesëmarrje e cila në vetvete duhet të përmbajë edhe konsensusin përgjithësisht të pranuar në lidhje me çështjet e interesit të përhershëm, vital dhe të rëndësishëm të vendit;

- krijimi i kushteve për avancimin e kulturës së sigurisë;

- ndërtimi i shtetit të së drejtës, shtetit social, me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallim të përkatësisë së tyre gjinore, racore, fetare, politike, sociale, kulturore dhe përkatësisë tjetër;
- krijimi i kushteve për ndërtimin e shoqërisë me komunikime dhe marrëdhënie me të cilat do të zhvillohen vlerat e përbashkëta dhe kultura e të jetuarit, sidomos tek gjenerata e re, në frymën e tolerancës, kultivimit të vlerave demokratike dhe respektimit të integritetit personal, të bazuara në traditën demokratike evropiane, pavarësisht përkatësisë etnike, fetare dhe përkatësisë tjetër;
- ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit jetësor në shtet në bashkëpunim me rajonin më të gjerë.

Nëse analizohet përmbajtja e Konceptit nga aspekti kohor, lidhur me objektivat e përcaktuara në Koncept që kanë të bëjnë me integrimet euroatlantike, të njëjtat akoma nuk janë realizuar. Së këtejmi, shtrohet pyetja: “Mjetet, forcat ose metodat e politikës së sigurisë a kanë qenë të gabuara, tepër ambicioze ose të planifikuara keq?”. Kjo flet se pranimi i modelit universal jo gjithmonë korrespondon me rrethanat reale të vendit dhe me sistemin e sigurisë për të cilin është dedikuar, siç është: perceptimi real i kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj paqes dhe stabilitetit, përcaktimi i qartë i prioriteteve të sigurisë, bërja e dallimit ndërmjet interesave kombëtare (shtetërore) dhe interesave etnike, si dhe përcaktimi i dedikimit të vlerësimeve ndaj sigurisë.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Maqedonisë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nga viti 2008, paraqet realizim të qëllimit për miratimin e saj, të parashikuar me Konceptin Kombëtar të Sigurisë dhe Mbrojtjes, nga viti 2003. Strategjia është strukturuar në gjashtë kapituj, si vijojnë: Përkufizimi dhe parimet e sigurisë kombëtare, 2. Interesat dhe qëllimet e sigurisë, 3. Rajoni i sigurisë, 4. Sfidat, kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë, 5. Implementimi i interesave kombëtare të sigurisë ose i konceptit strategjik, dhe 5. Sistemi i sigurisë kombëtare.

Krijimi i **Strategjisë së re të Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë** u realizua në fillim të vitit 2010. Ministri i Mbrojtjes, Zoran Konjanovski, ia dorëzoi Presidentit dhe Komandantit Suprem

të Forcave të Armatosura, Gjorge Ivanov "Strategjinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë" të dytën me radhë. Sipas Ministrit Konjanovski, Strategjia është një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm i cili duhet të ndryshohet dhe plotësohet çdo pesë vjet, ndërsa me zgjedhjen e presidentit të ri dhe komandantit suprem e njëjta të plotësohet. "Baza mbi të cilën u hartua Strategjia para së gjithash është Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe roli i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës të Republikës së Maqedonisë, lidhur me mbrojtjen e sovranitetit territorial dhe integritetit të vendit, neni 5 i Marrëveshjes së Uashingtonit, si dhe me misionet jashtë Maqedonisë" – deklaroi Konjanovski. Sipas burimeve zyrtare, në hartimin e Strategjisë, gjatë vitit 2008 dhe 2009, janë përfshirë persona profesionistë nga Ministria e Mbrojtjes, SHP i ARM-së, profesorë nga Universiteti "Shën Cirili e Metodi" bashkë me institucione të tjera dhe në bashkëpunim me NATO – ekipi këshillëdhënës në shtet dhe përfaqësues të "Buz Alen Hamilton" nga Amerika (Ministerstvo za odbrana 2010). Strategjia e Mbrojtjes është harmonizuar me obligimet dhe përgjegjësitë të cilat do të rezultojnë nga anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë në NATO dhe BE. Përmes pjesëmarrjes aktive në Partneritet për Paqe (PpP), Procesin e Planifikimit dhe Kontrollit të Forcave (PARP), Planin e Veprimit për Anëtarësim në NATO (MAP) dhe Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes e atëhershme (PESM), Republika e Maqedonisë vendosi një bashkëpunim të gjerë të mbrojtjes me vendet e NATO-s dhe BE-së (Hyrje në Strategjia za odbrana na Republika Makedonija 2012). Strategjia si rreziqe dhe kërcënime të mundshme mbi sigurinë kombëtare i identifikon: terrorizmin, krimin e organizuar transnacional, proliferimin e armëve për shkatërrim në masë, konfliktet dhe krizat rajonale, nacionalizmin dhe ekstremizmin radikal, mostolerancën etnike dhe fetare, prezencën e sasive të mëdha të armëve jolegale dhe armëve të lehta dhe municionit, krimin kibernetik dhe kërcënime dhe rreziqe të tjera jokonvencionale (Ministerstvo za odbrana 2011: 5). Strategjia është një dokument i rëndësishëm i cili në bazë të vlerësimit të kërcënimeve, rreziqeve dhe sfidave të ardhshme ndaj sigurisë kombëtare i përkufizon misionet dhe udhëzimet strategjike të mbrojtjes për përmbushjen e tyre, ofron vizion për zhvillimin e aftësive të Ministrisë dhe Armatës, i identifikon resurset e nevojshme për ruajtjen dhe zhvillimin e

sistemit të mbrojtjes dhe siguron udhëzime për integrimin politik dhe ushtarak në NATO, si dhe për pjesëmarrje në Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes të BE-së.

Pas miratimit të Strategjisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë në mars të vitit 2010, në fillim të vitit 2011 u miratua *Plani Afatgjatë për Zhvillimin e Mbrojtjes për periudhën kohore 2011-2020*, si akt i parë për implementimin e strategjisë. Plani i përcakton proceset dhe aktivitetet kryesore për përfundimin e kapaciteteve institucionale të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për zhvillimin e aftësive ushtarake të Armatës së Republikës së Maqedonisë. Plani siguron unitet të angazhimeve të Ministrisë dhe të Armatës për zhvillimin sistematik të mbrojtjes dhe harmonizimin e resurseve të limituara me prioritetet kryesore zhvillimore (Ministerstvo za odbrana 2011: 2-3).

Dokumentet strategjike nga fusha e sigurisë ndihmuan në përcaktimin e interesave kryesore dhe të prioritetëve të sigurisë së shtetit. Si interesa kryesore për shtetin mund të identifikohen:

- ruajtja e sovranitetit, integritetit territorial dhe rendit kushtetues, si dhe implementimi i demokracisë, pluralizmi politik, sundimi i së drejtës, liria e sipërmarësisë, të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale;
- ruajtja e stabilitetit të shtetit dhe zhvillimi i tij ekonomik, shoqëror dhe kulturor;
- monitorimi i ngjarjeve të ndërlydhura me mundësitë e tij, zhvillimi gjithëpërfshirës dhe i shpejtë i resurseve ekonomike, teknologjike dhe njerëzore;
- kontributi aktiv i përafritit të tij në nivelin e shteteve të zhvilluara industriale dhe mundësimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme;
- promovimi i sigurisë dhe prosperitetit të qytetarëve të saj dhe zhvillimi i mjedisit të sigurt, përmes krijimit të kulturës së sigurisë dhe përsosja e masave për përmirësimin e sigurisë njerëzore;
- ruajtja e paqes dhe sigurisë, parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve ndërshtetërore, rajonale dhe të brendshme, në përputhje me Kartën e KB-së dhe normave e standardeve të së drejtës ndërkombëtare;
- monitorimi dhe pranimi i dispozitave që kanë të bëjnë me

politikat evropiane të sigurisë, në përputhje me statusin kandidat për anëtarësim në BE, ndërsa deri në momentin e anëtarësimit me të drejta të plota kjo nënkupton harmonizim të interesave kombëtare me politikat e BE-së;

- zbatimi i aktiviteteve të koordinuara me NATO-n dhe ruajtja e kontinuitetit të marrëdhënieve të mira me SHBA-të, si partner kryesor të Maqedonisë për anëtarësim në Aleancë;

- mbizotërimi i përgjithshëm i vlerave demokratike, përfshirë edhe ato të cilat duhet të jenë pjesë e përgjigjeve të pyetjeve me fillimin e negociatave para-aderuese për BE dhe vlerat të cilat vlejnë në NATO, pas aderimit në Aleancë;

- realizimi i aktiviteteve për stabilitet afatgjatë në EJL, veçanërisht në koordinim me vendet fqinje, në bazë të një sërë vlerash demokratike dhe implementimit në përmasa më të gjera të të drejtave të maqedonasve të cilët jetojnë në vendet fqinje;

- stabiliteti afatgjatë përmes kontributit aktiv për zgjidhjen e plotë të konflikteve në rajon dhe luftimin e kërcënimeve që kanë të bëjnë me sigurinë rajonale, veçanërisht të atyre që kanë të bëjnë me terrorizmin, proliferacionin me armë për shkatërrim në masë, kontrabandën me drogë dhe krimin e organizuar;

- bashkëpunimi konstruktiv me të gjithë aktorët ndërkombëtar – shtete, organizata, OJQ-të (vendase dhe ndërkombëtare) dhe zhvillimi i bashkëpunimit ekonomik bilateral, rajonal dhe multirateral.

Prioritetet e sigurisë janë të rëndësishme për planifikimin e resurseve të sistemit të sigurisë në ballafaqimin me kërcënimet dhe sfidat ndaj sigurisë. Në krijimin dhe zbatimin e politikës së sigurisë, prioritet duhet të kenë:

- interesat e shtetit;
- rajoni i tij i sigurisë me rreziqet dhe kërcënimet;
- politika e sigurisë kombëtare; dhe
- orientimet e zhvillimit të mbrojtjes.

4.4.1 Analiza e procesit dhe e qasjes gjatë miratimit të dokumenteve strategjike nga fusha e sigurisë

Në periudhën, e cila zgjatë tanimë dy dekada, Republika e Maqedonisë miratoi një sërë ligje vendore dhe ratifikoi një numër të

madh të konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare dhe kështu shteti, në mënyrë afatgjatë e harmonizoi, legjislationin kombëtar dhe inkorporoi standarde të cilat aplikohen në vendet-anëtare të OKB-së, në Këshillin e Evropës, në BE, në NATO dhe në organizata të tjera të rëndësishme ndërkombëtare. Përshtatja e standardeve mundësoi që shteti të arrijë shkallë të lartë të kompaibilitetit me vendet-anëtare të organizatave të cekura, me qëllim të ballafaqimit më efikas, më ekonomik dhe më racional të rreziqeve ndaj sigurisë të karakterit të brendshëm dhe të jashtëm.

Procesi i krijimit të politikës së sigurisë e ka gjenezën e saj e cila rezulton nga karakteristikat dhe nga zhvillimi i shoqërisë maqedonase. Atë e karakterizon një sërë anomalish dhe jokonsekuenca në mënyrën, kronologjinë dhe formën e dokumenteve të miratuara strategjike. Prandaj, në këtë periudhë duhej të kuptohej se rregullimi ligjor i sigurisë – si kriter politik, është minimumi që mund ta ofrojnë autoritetet politike si zgjidhje për problemet e sigurisë dhe për tejkalimin e sfidave të shtetit.

Në vet procesin mund të veçohen disa momente dhe qasje kyç të cilat i japin orientimet në krijimin e dokumenteve strategjike në fushën e sigurisë.

Fillimet e procesit të miratimit të dokumenteve strategjike të "sigurisë" janë shënuar nga ndërhyrja e tepërt i interesave (partiake) personale gjatë udhëheqjes së politikës shtetërore, mospërvoja, mospasja e iniciativës për ndërmarrjen e masave për ruajtjen e shtetësisë dhe stabilitetit, qasjes së padefinuar të shfrytëzuesve të fundit të politikave të sigurisë, prezencës së madhe të interesave të fqinjëve për dominim dhe krijim të jostabilitetit në Maqedoni me qëllim të hapjes së mundësive për zbatimin e qëllimeve të tyre përmes qytetarëve të zakonshëm, politikanëve dhe një varg arsyesish tjera, janë shkaqe se pse Maqedonia shumë vite pas pavarësisë nuk ndërtoi politikë të sigurisë (Vankovska 2002: 234-235, ekstrakt). Qasja në procesin e miratimit të dokumenteve strategjike nga fusha e sigurisë nuk dallon fare nga mënyra e udhëheqjes së politikës shtetërore (Mirčev 2012: 14-16).

Në formulimin fillestar të dispozitave të dokumenteve strategjike mungon apostrofimi i karakterit multietnik i shoqërisë maqedonase dhe orientimet për amortizimin e ndikimeve permanente të fqinjëve mbi mbijetesën dhe progresin e shtetit. Kjo

flet për pranimin me lehtësi të zgjidhjeve të ofruara universale për konceptimin e sigurisë kombëtare, diçka që as për së afërmi nuk korrespondon me realitetin në Republikën e Maqedonisë. Megjithatë, ky nuk është justifikim për letargjinë e elitës politike dhe të sigurisë maqedonase kur janë në pyetje prioritetet shtetërore, interesat dhe mbijetesa e shtetit.

Në vend që të merren me krijimin e politikës së sigurisë, një kohë të gjatë, qeveritë maqedonase e praktikojnë sekjuritizimin.³⁷ Përkatësisht, siguria ishte vetëm një "akt i fjalës"³⁸ dhe elita politike ishte agjenti më i mirë sekjuritit, përkatësisht i vetmi që e përcaktonte sigurinë, kërcënimet ndaj sigurisë dhe ballafaqimin me to. Me fjalë të tjera, elita bënte flirt me vlerësimet e sigurisë konform kërkesave rrjedhëse vendase dhe ndërkombëtare (Vankovska 2002: 234-235). Shpërfillja e vlerësimeve të sigurisë dhe fakti që vlerësimet e bëra, të cilat nuk merreshin parasysh, rezultuan me konflikt të armatosur në vitin 2001. Armata, edhe pse atëherë akoma kishte kompetencë për ta ruajtur dhe mbikëqyrur kufirin shtetëror, udhëheqja e saj dhe elementet e zbulimit patën vlerësime krejtësisht të gabuara për sigurinë dhe rrjedhimisht me këtë – ndërmarrje të aktivitete të gabuara. Kjo vë në pah se ushtria dhe disa subjekte tjera të sistemit të zbulimit iknin nga realiteti (Intervistë me Prof. Dr. Tome Batkovski, 18.12.2013). Gjithashtu, meqë konstatimi ka të bëjë me periudhën e pavarësisht të shtetit (viti 1991) deri në fillimin e konfliktit të armatosur (viti 2001), është fakt se në kushte kur janë të limituara resurset njerëzore, të angazhuara për çështjet e sigurisë, autoritetet

³⁷ Edhe pse është një shprehje e cila përdoret shpesh në terminologjinë financiare, sekjuritizimi është nocion i cili fillon të zë vend të rëndësishëm në terminologjinë e sigurisë. Duke u nisur nga ajo se çka do të thotë të jesh i sigurt, çka na bën të sigurt, kush ose çka është e sigurt, siguri prej se, siguria përfshin diçka që garanton siguri ose mbrojtje. Ndoshta siguria ekziston si një spektër, nga një shkallë e kënaqshme nominale deri në ndonjë shkallë e lartë alarmante. Ndoshta ajo është proces ose ka ndonjë vlerë nominale. Kur siguria nënkuptohet si proces i cili është objekt për evaluimin moral, shoqëror dhe individual, ajo është ideja ose koncepti që quhet sekjuritizëm. Si koncept është inkorporuar nga Ole Uiver (Wæver 1995: 46-86), profesor danez, përfaqësues i perspektivës konstruktiviste në shkencat shoqërore. Ai e përfaqëson tezën se disa punë në të vërtetë nuk ekzistojnë si realitet i fuqishëm material, por ekzistojnë vetëm si krijim shoqëror në kokat e njerëzve sepse njerëzit heshturazi pajtohen të veprojnë nëse konstatohet se ekziston gjendje kritike.

³⁸ Sipas këndvështrimit të Uiver sa i përket sigurisë si "akt i fjalës" ("problemi është problem i sigurisë nëse ai është përcaktuar nga bartësit e fuqisë") nënkuptohet identifikimi i diçkaje si problem sigurie, me ç'rast bartësit e sigurisë kërkojnë të drejta të veçanta (Wæver 1995:46-86).

politike dhe përfaqësuesit e klasifikuar lartë të sistemit të sigurisë në Maqedoni nuk ishin të gatshëm ta konsultonin opinionin ekspert për çështje të cilat kanë të bëjnë me politikën e jashtme, të mbrojtjes dhe me politikën e brendshme të sigurisë. Kjo flet për mungesën e qasjes gjithëpërfshirëse, inovative dhe qasjes fleksibile në lidhje me angazhimin e sektorit civil dhe të kastës akademike në krijimin e zgjidhjeve nga fusha e sigurisë, si dhe paraqet një nga arsytet më të rëndësishme për shkak të të cilave shoqëria maqedonase u ekspozua ndaj ndikimeve politike në këtë fushë. Përveç nevojës për përfshirjen e opinionit ekspert, në periudhën e kaluar, shteti nuk ndërtoi parime për përfshirjen e publikut të gjerë, përkatësisht për ta bindur në arsyeshmërinë e miratimit të masave në politikat dhe strategjitë e sigurisë, në rastet kur ka nevojë të stimulohet një ndryshim i caktuar në politikën e sigurisë në shtet. Resurset e limituara njerëzore në krijimin e konceptit të sigurisë kombëtare, politizimi i vendimeve të miratuara dhe mungesa e komunikimit ndërmjet autoriteteve politike, publikut të gjerë dhe atij ekspert rezultuan me transformimin e shpejtë të shtetit, nga “Oaza e Paqes” deri para vitit 2001 në “Fuçi Baruti” pas konfliktit të vitit 2001.

Autoritetet shtetërore, në masë të pamjaftueshme, e shfrytëzuan prezencën ndërkombëtare të sigurisë në territorin e vet (në kuadër të diplomacisë parandaluese të OKB-së, të misionëve të BE-së dhe NATO-s në procesin e kthimit të paqes dhe stabilitetit pas konfliktit në vitin 2001 dhe në kuadër të reformës së sektorit të sigurisë) si ndihmë e drejtpërdrejtë për krijimin e politikës së sigurisë. Modelet, për strukturimin e sistemit të sigurisë, të përfshira me reformën e sektorit të sigurisë, në një pjesë të madhe u ofruan nga faktori ndërkombëtar dhe nga vendet partnere, të angazhuara për zbatimin e reformës. Në kushte të këtilla vështirë mund të pritet se një shtet i ri, i cili një kohë të gjatë ka probleme në drejtim të identifikimit të nevojave, interesave dhe karakteristikave të sistemit të sigurisë, në fillimet e veta dhe veçanërisht pas konfliktit të vitit 2001, mundet në mënyrë të pavarur të krijojë politikë të sigurisë, e cila do të jetë një zgjidhje autentike vendase, në përputhje me problemet e sigurisë. Reforma ofroi zgjidhje të cilat rezultojnë nga zbatimi i modelit të unifikuar në kushte vendase. Edhe pse kjo qasje është zgjidhja më e shpeshtë në botën e integruar, për të cilën nevojiten reforma paraprake në mënyrë që zgjidhja e propozuar të mundet tërësisht të integrohet në konceptet ekzistuese, të cilat tanimë zbatohen

në bashkësinë ndërkombëtare, megjithatë zgjidhjet e sugjeruara në kuadër të reformës rezultuan që ndërtimi i politikës së sigurisë në Republikën e Maqedonisë të jetë i gjatë dhe një proces i paharmonizuar i kushtëzuar nga një sërë faktorësh. Shkaqet e prolongimit të procesit kryesisht mbështeten mbi faktin se disa kapacitete të caktuara të sigurisë ishin të imponuara, vinin nga jashtë dhe kishin motive politike. Gjithashtu, në periudhën postkonfliktuale zbatimi i konceptit të shoqërisë multietnike me mentorim ndërkombëtar, në kushte të demokracisë në tranzicion, i reduktoi kapacitetet vendase për ballafaqim racional me kushtet e krijuara të reja të sigurisë. Kjo, dukshëm e ngadalësoi procesin e krijimit të politikës së sigurisë vendase (pa primesa të huaja), por nga ana tjetër prezenca e faktorit ndërkombëtar mundësoi qasje në përvojat e huaja nga fusha e politikës së sigurisë, reformës së sektorit të sigurisë, punës së policisë në shoqëritë multietnike dhe në parandalimin e konflikteve. Marrë në përgjithësi, autoritetet, në vend që ta shfrytëzojnë faktorin ndërkombëtar dhe ndihmën e huaj, sa i përket reformës së sektorit të sigurisë dhe procesit të rehabilitimit të shoqërisë post-konfliktuale, ata tepër gjatë e ruajtën statusin e protektoratit të forcave të mëdha për prestigjin e tyre në rajon dhe për realizimin e eksperimenteve për funksionimin e shoqërisë multietnike konfliktuale dhe shoqërisë multietnike post-konfliktuale.

Në kontekst të analizës së procesit të miratimit të dokumenteve strategjike të Republikës së Maqedonisë nga fusha e sigurisë, në periudhën kohore 1991-2005 (Filipov, 2005; Nacev 2003), Filipov i bëri vërejtjet, si vijojnë: (2005:40-41, ekstrakt):

- Është argumentuar konstatimi se Strategjia e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë duhej të miratohej që në vitin 1992, menjëherë pas hyrjes në fuqi të Ligjit të parë për mbrojtje nga viti 1992. Strategjia e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, u miratua nga Presidenti i atëhershëm i shtetit Kiro Gligorov madje më 11.9.1998 gjashtë vjet pas miratimit të Ligjit për mbrojtje. Filipov, vonesën e këtillë e llogarit si gabim dhe dështim të pafalshëm.
- Shkaqet e zvarritjes dhe mosmiratimi i Strategjisë së Integruar të Sigurisë Kombëtare të Republikës së Maqedonisë sqarohen përmes dy varianteve të mundshme: e para, Qeveria është dashur ta miratojë Strategjinë e planifikuar të Integruar të Sigurisë Kombëtare, si rrjedhojë normale të ngjarjeve gjatë

miratimit të dokumenteve strategjike të sigurisë dhe e dyta, se kjo fare nuk është dashur të parashikohet si detyrë strategjike në konceptin kombëtar të sigurisë dhe mbrojtjes, nëse Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ka konsideruar se mjafton vetëm Koncepti Kombëtar i Sigurisë dhe Mbrojtjes. Vakumi, i krijuar nga mungesa e dokumenteve kyç strategjike nga fusha e sigurisë, që u krijua nga periudha e pavarësisë (1991) deri në momentin e miratimit të Strategjisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë (3.9.1998) dhe situata e "status kuos" deri në miratimin e Konceptit Kombëtar të Sigurisë dhe Mbrojtjes (11.6.2003) krijoi përshtypje për një vizion të paqartë për elitën politike dhe profesionale lidhur me prioritetet dhe aspiratat e sigurisë së shtetit.

- Pika 29, paragrafi 2 nga Koncepti Kombëtar i Sigurisë dhe Mbrojtjes, përveç miratimit të Strategjisë së Integruar të Sigurisë Kombëtare të Republikës së Maqedonisë e parashikon edhe miratimin e Strategjisë së re të Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë. Strategjia e re e Mbrojtjes u miratua në vitin 2010, dy vjet pas miratimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë të Republikës së Maqedonisë (2008), ndërkaq shtatë vjet pas Konceptit Kombëtar nga viti 2003.

Vërejtjet, për procesin e miratimit të politikës së sigurisë të Republikës së Maqedonisë, kanë të bëjnë me disa konstatime, siç janë: procesi i miratimit të dokumenteve strategjike zgjatë tejmase, nuk ekziston orientim i qartë në lidhje me radhitjen e miratimit të dokumenteve strategjike nga fusha e sigurisë, nuk janë përkufizuar në mënyrë të qartë prioritetet kombëtare, nuk ekziston dallimi ndërmjet interesit etnik dhe kombëtar dhe në raste të caktuara ka mbivendosje të kompetencave ndërmjet dy ose më shumë institucioneve të cilët janë pjesë të sistemit të sigurisë.

4.4.2 Analiza e përmbajtjes dhe kualitetit të dokumenteve të miratuara strategjike

Ndryshimi i karakterit të strukturave të sigurisë, në kuadër të reformës së përgjithshme të shoqërisë maqedonase, është një

proces i pandashëm i cili është ngushtë i lidhur me ndryshimin e marrëdhënieve dhe rolin ndërmjet shtetit dhe shoqërisë në ambientin e ri demokratik, i krijuar pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë. Në këtë kontekst, nevoja për miratimin e dokumenteve strategjike nga fusha e sigurisë, ndonjëherë edhe me afate kohore të imponuara, në asnjë çast nuk duhet të ndikojë mbi përmbajtjen dhe kualitetin e dokumenteve të miratuara.

Për shembull, supozimet gjatë përgatitjes së *Librit të Bardhë për Mbrojtje*, nga muaji gusht i vitit 1998, si dhe i dokumenteve të tjerë të ngjashëm për planifikimin e mbrojtjes, të cilët i paraprinë Librit të Bardhë, tregojnë se kërcënimet do të vinë nga jashtë. Konflikti i vitit 2001 i ndryshoi këto supozime dhe i ndërpreu planet reformiste të sigurisë, meqë vendi ishte përballur jo me kërcënime nga jashtë por me kërcënime të brendshme.

Prolongimi i miratimit të Strategjisë së Integruar të Sigurisë Kombëtare, i cili zgjati deri në vitin 2008, ndikoi negativisht mbi kualitetin e një sërë ligjesh nga fusha e sigurisë (2005:40-41, ekstrakt). Ata mund të miratoheshin edhe pa Strategjinë si dokument fillestar, mirëpo do të kishin vlerë më të madhe nëse ajo shfrytëzohej si bazë e tyre.

Mosmiratimi i dokumenteve strategjike të sigurisë ose miratimi i dokumenteve të cilët përmbajnë mjaft zgjidhje të pakuptueshme, të ngatërruara dhe kontradiktore është një nga karakteristikat e vendeve në tranzicion gjatë përcaktimit të çështjeve të sigurisë. Autoritetet politike në vendet e tranzicionit dhe në shumicën e vendeve të zhvilluara nuk janë të interesuar çdoherë t'i miratojnë vendimet e tyre politike, veçanërisht jo ato që janë nga fusha e sigurisë. Kjo, në njëfarë mënyre, do të thotë publiku të mbahet në gjendje pasigurie sa u përket temave të sigurisë. Publiku nuk ka qasje në dokumentet strategjike në të cilët është përkufizuar se cilët janë potencialet e rrezikimit ndaj sigurisë, çka është e lejuar, çka është e pritshme dhe çka është e ndaluar të bëhet në shoqëri.

Një karakteristikë tjetër e kualitetit të dokumenteve strategjike të Republikës së Maqedonisë nga fusha e sigurisë konsiston me atë që gjatë krijimit të tyre, i cili zgjatë një kohë më të gjatë, si pjesë e reformës së sektorit të sigurisë, nuk janë respektuar disa kritere të caktuara të cilët mundësojnë kontinuitet

gjatë monitorimit të gjendjes së sigurisë, si dhe nuk parashikohen implikime për mënyrën se si do të vepronte shteti në rastet kur rrezikohen forcat e tij të sigurisë, veçanërisht ato të cilat marrin pjesë në operacione ndërkombëtare paqeruajtëse. Dokumentet nuk e marrin në konsideratë opinionin publik për pjesëmarrjen e forcave maqedonase të sigurisë në situatë kur vendi jep kontribut të konsiderueshëm për sigurinë ndërkombëtare, ndërsa nuk është pjesë e organizatave ndërkombëtare të cilat janë inicuese të misionit (BE dhe NATO).

Çështja e miratimit të dokumenteve strategjike të sigurisë të Republikës së Maqedonisë akoma nuk është mbyllur. Kjo mbetet sfidë për shkencëtarët dhe ekspertët nga fusha e sigurisë. Miratimi i dokumenteve strategjike të sigurisë ndërldhet me reformën e sektorit të sigurisë dhe me dinamikën e ngjarjeve të sigurisë dhe ngjarjeve të tjera shoqërore që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare.

5 PARANDALIMI I KONFLIKTEVE

Parandalimi i konflikteve paraqet proces me të cilin përfshihen faktorët, pjesëmarrësit dhe kushtet të cilat ndikojnë mbi një konflikt të caktuar. Procesi nënkupton krijimin e analizave të sigurisë, përcaktimin e indikatorëve dhe zhvillimin e skenarëve të mundshëm. Parandalimi i konflikteve paraqet një nga komponentët kyç të politikës së sigurisë kombëtare. Ajo bazohet mbi përkufizimet për *konfliktin* dhe për *teorinë e konfliktit*. Konflikti paraqet formë të interaksionit ndërmjet individëve dhe grupeve të ndryshme, në të cilët qëllimi është, të shkatërrohet, të imponohet ose të merret kontrolli mbi individët ose grupet në shoqëri. Në konflikt çdonjëra nga palët është e vetëdijshme për diversitetin e grupit tjetër. Konflikti shfaqet në kushte kur individëve ose grupeve u kufizohen resurse të caktuara, të drejtat, përfitimet etj. Konflikti midis grupeve, në masë të madhe, e rrit kohezionin e brendshëm në kuadër të grupit, ndërkohë që i ashpërsos ndjenjat (paragjykimet) armiqësore ndaj grupit me të cilin është në konflikt (Tashevski Remenski 2007: 49). Monitorimi i konflikteve, si fenomen shoqëror, mund të bëhet nga aspekti sociologjik, psikologjik, filozofik, juridik, të sigurisë, politikë dhe aspekte të tjera. Konflikti "*perse*" (për secilin) paraqet shprehje të natyrshme të dallimeve shoqërore dhe të luftës së përvetshme të njerëzimit për drejtësi dhe vetëvendosje. Konflikti, për nga natyra, nuk është destruktiv dhe paraqet dukuri normale në çdo bashkësi dinamike. Nëse konflikti menaxhohet në mënyrë të padhunshme dhe në mënyrë të hapur, ai mund të jetë pozitiv, konstruktiv dhe progresiv.

Përveç formave të lartpërmendura të konfliktit, korrelacion më thelbësor është korrelacioni i politikës së sigurisë me konfliktet, qëllimi i të cilave është destabilizimi dhe çrregullimi i marrëdhënieve në shoqëri, përkatësisht me konfliktet të cilat shkaktojnë pasoja të shkurtra ose të përhershme mbi shoqërinë. Shembull më radikal i këtij lloji konflikti janë konfliktet e armatosura dhe luftërat. Për shkak të efekteve të konflikteve të armatosura dhe luftërave është e domosdoshme të ndërtohet qasje e posaçme metodologjike në të cilën analizohen shkaqet, gjendjet dhe potenciali i konfliktit të armatosur ndëretnik, si pjesë e politikës së sigurisë të Republikës

së Maqedonisë, e cila i merr parasysh perceptimet e ndryshme dhe e cila duhet të jep informacione për zbatimin e aktiviteteve për parandalimin e konflikteve. Qasja fillon nga supozimi paraprakisht i përcaktuar, i cili bazohet në atë se:

- Proceset, për arritjen e zgjidhjes së konfliktit duhet t'i përfshijë të gjitha palët e prekura. Aktivitetet për zgjidhjen e konfliktit duhet të zhvillohen me pëlqimin e të gjitha palëve, nëse një gjë e tillë është e mundshme. Nëse përfshihet pala e tretë, ajo duhet të jetë objektive në raport me palët kundërshtarë.
- Rolet, në zgjidhjen e konflikteve dhe mbështetjes juridike të saj, duhet të jenë të matura dhe është e pëlqyeshme të mos udhëhiqen nga organe të njëjta në situata kur është evidente se nuk mund të arrihet zgjidhje.
- Supozimet sipërfaqësore dhe të njëanshme çojnë në intervenime kundërproduktive, kështu që gjatë përcaktimit të roleve dhe gjatë ndërtimit të qasjes duhet të merren parasysh argumente të caktuara.

Çdo perspektivë teorike, si për shembull: marksizmi ose feminizmi, e cila e njofton shoqërinë se në të mbisundon konflikti i interesave, ndërmjet atyre të cilët kanë qasje në pasuri, pushtet status etj., mund të quhet teori e konfliktit (Bruce & Yearley 2006: 46-47). Në rastet kur bëhet fjalë për konflikte ndëretnike, përfaqësuesit e bashkësive etnike e shfrytëzojnë teorinë e konfliktit për tejkalimin e mosmarrëveshjeve politike dhe etnike në situata kur ekziston konflikt interesash i ndërlidhur me subjektet politike, etnike dhe me subjekte të tjera të shtetit.

Në kontekstin e cekur, parandalimi i konflikteve paraqet proces dinamik, i cili ndryshon varësisht nga rrethanat. Në kushte bashkëkohore, parandalimi ka rëndësi gjithnjë e më të madhe për sigurinë dhe kapacitetin e saj për ta ruajtur paqen, për t'i tejkaluar situatat e krizës, për të ndihmuar në krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe për të krijuar mekanizma për zgjidhje të padhunshme të konflikteve. Qëllimi i parandalimit të konflikteve është të krijojë situatë në të cilën diversitetet dhe konfliktet do të zgjidhen në mënyrë të padhunshme dhe konstruktive. Sa u përket karakteristikave, parandalimi i konflikteve në Republikën e Maqedonisë dhe në rajon ka *dimension etnik (dhe religjioz) dhe dimension politik*.

Përkatësia etnike dhe/ose fetare ishin vendimtare për shfaqjen e konflikteve në Republikën e Maqedonisë dhe në rajon. Religjioni shpeshherë paraqet vijën e ndarjes (kroatë/serbë, tre grupet boshnjake, shqiptarë kosovarë/serbë kosovarë, maqedonas/shqiptarë), por zakonisht religjioni nuk është shkak për shfaqjen vetvetiu të konfliktit, mirëpo religjioni shërben si shenjë më përkatëse e identitetit përmes përcaktimit të identitetit kombëtar ose etnik (Buzan & Waever 2003: 384). Parakusht për konfliktet ndëretnike është ekzistimi i mostolerancës etnike dhe religjioze ndërmjet grupeve të ndryshme etnike bazuar në urrejtje dhe paragjykime. Ndarjet dhe mostoleranca intensifikohen akoma më shumë për shkak të theksimit të tepërt të simboleve etnike, besimeve tradicionale dhe për shkak të mungesës së kapacitetit për tejkalimin e stereotipave në kuadër të grupeve.

Dimensioni politik i parandalimit të konflikteve sqarohet me atë që konfliktet më së shpeshti iniciohen nga liderët etnikë, të cilët njëherësh janë edhe liderë politikë në mjedisin politik, në të cilin dominojnë parti politike mono-etnike. Dimensionit politik i ndërlidhet vullneti politik për zbatimin e parandalimit të konflikteve dhe kapaciteti i liderëve politikë për eliminimin e dukurisë së diskriminimit politik mbi bazë etnike. Sa i përket lidhjes ndërmjet diskriminimit nga ana e shtetit me diskriminimin etnik, në botë, gjatë viteve të tetëdhjeta të shekullit të kaluar, janë identifikuar 233 grupe të politizuara etnike (Gurr & Harff 1994: 5-7, ekstrakt). Sipas të dhënave, 63% prej tyre kanë përjetuar diskriminim historik ose diskriminim të vazhdueshëm ekonomik, ndërsa 72% kanë përjetuar vetëm diskriminim politik. Në më shumë raste diskriminimi ndërlidhet me rrezikimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Megjithatë, bën përshtypje fakti se më shumë se 85% e këtyre grupeve politike organizohen për shkak të dhunës dhe diskriminimit etnik nga ana e shtetit, me qëllim që t'i promovojnë dhe t'i mbrojnë nga pushteti dhe nga grupet e tjera interesat e tyre kolektive. Edhe pse grupet etnike janë të politizuara, ata revoltin e tyre zakonisht e manifestojnë në mënyrë të qetë, por megjithatë i njëjti më vonë përshkallëzohet në dhunë (në 21% të rasteve).

Të dy dimensionet janë drejtpërdrejtë të lidhura me sqarimin e konfliktit etnik – si konflikt i cili ka potencial më të madh

përbrenda ta rrezikojë sigurinë e Republikës së Maqedonisë. Nga ana tjetër, implikimet e sigurisë nga integrimet e bllokuara euroatlantike dhe problemet me të cilat ballafaqohet Republika e Maqedonisë në këtë proces tepër të gjatë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon mbi potencialin për shkaktimin e konfliktit të brendshëm i cili përveç mbi marrëdhëniet ndëretnike ka ndikim edhe në fusha të tjera (kryesisht ekonomike) të jetës shoqërore, siç janë: shkalla e papunësisë, ardhmëria e pasigurt e të rinjve, mungesa e investimeve për shkak të statusit të sigurisë së vendit, zhvillimi i infrastrukturës etj. Strategjitë kombëtare për parandalimin e konflikteve, përveç ndaj marrëdhënieve të brendshme ndëretnike kanë të bëjnë edhe me zgjidhjen e problemeve me fqinjët. Maqedonia mbështetet mbi faktorin ndërkombëtar gjatë ndërmjetësimit të kontesteve me fqinjët (emri, kisha dhe identiteti). E gjithë kjo zhvillohet në një atmosferë jo aq miqësore në të cilën mungon vullneti politik i palëve dhe rezulton me ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit. Në këtë drejtim, funksioni parandalues i elementeve të politikës së sigurisë ka të bëjë me masat që i krijon shteti për avancimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe për përparim në kuadër të integritimeve euroatlantike, si interes me rëndësi thelbësore kombëtare të Republikës së Maqedonisë.

Për shkak të rëndësisë së konflikteve ndëretnike, në kontekst të sqarimit të konceptit për parandalimin e konflikteve në Republikën e Maqedonisë, doemos duhet të sqarohet interaksioni ndërmjet *konflikteve etnike, përkatësisë etnike* (si fenomen shoqëruar) dhe *ndikimi i tyre mbi sigurinë e shtetit*.

Konflikti etnik është burimi kryesor dhe primar i dhunës dhe jostabilitetit në botë. Ndërmjet viteve 1900 dhe 1987, 170 milionë njerëz u vranë nga pushtetet e tyre nëpër botë (Rummel 1972, në Tshuy 1997: ix, xv). Këto shifra në masë të madhe i tejkalojnë shifrat e viktimitave të konflikteve ndërshtetërore. Sipas të dhënave të Ernest Reger, deri në vitin 1993 përafërsisht dy të tretat e konflikteve politike në botë kanë qenë konflikte etnike (Lederach 1997: 7, cit.). Në periudhën kohore kah fundi i Luftës së Ftohtë (në vitin 1989) deri në fillim të shekullit 21 ka pasur 116 konflikte ushtarake në 78 lokacione anembanë botës, prej të cilave shtatë janë luftëra ndërmjet shteteve të ndryshme, ndërsa 20 janë luftëra

të brendshme të përcjella me intervenime ushtarake nga jashtë (Eriksson & Wallensteen 2004: 626). Në Republikën e Maqedonisë dhe në rajon, përkatësia etnike, si fenomen më dominues shoqëror, perceptohet si burim kryesor për shfaqjen e konflikteve etnike. Qytetarët, shumë më shpesh, prononcohen në bazë të përkatësisë etnike, sesa sipas formave të tjera shoqërore (klasa shoqërore, denominacioni religjioz dhe ngjashëm). Qytetarët vetveten e shohin si pjesë përbërëse të sistemit të vlerave, karakteristikë për një grup të caktuar etnik. Njëkohësisht, pikërisht përkatësia etnike më së shumti u nënshtrohet ndikimeve, ndryshimeve, asimilimit dhe manipulimit. Rajoni tanimë është i njohur për mohimin e përkatësisë etnike të grupeve etnike minoritare dhe për “mitin për shtet të pastër etnik”.

I gjithë koncepti i “luftës etnike” është mashtrues, sepse e imponon luftën e Hobsit, “të gjithë kundër të gjithëve”, me ç’rast konfliktet e ashtuquajtura etnike udhëhiqen nga grupe të vogla ushtarake, grupe të cilat deklarojnë se luftojnë dhe se vrasin në emër të ndonjë etniteti më të madh (Mueller 2000: 42). Miler konfirmon se minoriteti i cili ia mësyn dhunës e shkatërron hapësirën për një mjedis të qëndrueshëm dhe nga kaosi i shkaktuar lindin elemente patologjike dhe kriminale. Kaufman e nënvizon rolin e politikës së simboleve. Hazarderët politikë dhe grupet ekstremiste e shfrytëzojnë fuqinë emocionale që t’i ndryshojnë privilegjet e grupit më të madh. Dilema klasike e sigurisë paraqitet midis pjesëmarrësve racional, atëherë kur mungesën e besimit dhe paaftësisë që të intensifikohen negociata, nën kushte anarkiste, shkakton erupsion të konflikteve serioze. Sipas tij, shumë konflikte etnike kanë përjetuar erupsion, meqë njëra ose që të dyja palët i kanë dhënë përparësi konfliktit e jo bashkëpunimit (Kaufman 2001: 220, ekstrakt). Krijimi dhe intensiteti i konfliktit etnik, në masë të madhe varet nga subjektet të cilët kanë interes nga shkaktimi i konfliktit. Nëse pozita e tyre është e lidhur me liderizmin, me fuqi në kuadër të grupit etnik/politik, me përdorimin e dhunës dhe me realizimin e ambicieve politike dhe me profit nga konflikti, atëherë shanset për zbatimin e parandalimit janë shumë të vogla. Në kushte të këtilla, vështirë është të orientohet mosbesimi dhe mllefi i armikut në drejtim i cili do të mundësonte zgjidhjen e konfliktit, ndërkaq palët e pranojnë

se dhuna është opsioni i vetëm dhe më adekuat për zgjidhjen e konfliktit.

Strategjia për parandalimin e konflikteve, si një qasje gjithëpërfshirëse për operacionalizimin e aktiviteteve për zgjidhjen e konflikteve, ka për qëllim arritjen e stabilitetit me efekte të cilat janë shpejtë të dukshme. Përcaktimi i mënyrës së zbatimit të parandalimit të konflikteve është kushtëzuar nga faza në të cilën gjendet konflikti. Momenti më kritik për ndërmarrjen e aksionit paraqet kalimi nga paqja stabile në jostabile ose drejtpërdrejtë nga paqja stabile në krizë, përkatësisht në luftë. Gjithashtu, nuk ekziston një qasje absolute identike gjatë zgjidhjes së konflikteve meqë nuk ekzistojnë konflikte identike, edhe pse është e mundur të përcaktohen ngjashmëri ndërmjet dy ose më shumë konflikteve. Kjo ndihmon që më shpejtë të ndërtohet qasja për zgjidhjen e konfliktit. Strategjia e parandalimit të konflikteve paraqet një kombinim të instrumenteve të vjetër dhe të rinj, afatgjatë dhe afatshkurtër, civil dhe ushtarak, represiv dhe preventiv. Instrumentet shërbejnë për ndryshime strukturore ose për ofrimin e ndihmës në situata të jashtëzakonshme, në rastet kur duhet të parandalohet fillimi i konfliktit ose të mundësohet kthimi i paqes. Në këtë kontekst, aktivitetet për parandalimin e konflikteve nënkuptojnë teknika në të cilat anëtarët e grupeve të ndryshme etnike, të përballur me interesa të kundërta, ballafaqohen me kërcënime pa krijuar dhunë apo humbje të besimit. Dhuna midis grupeve nuk shfaqet rastësisht, mirëpo ky është rezultat i agresionit dhe antagonizmit të akumuluar ndërmjet tyre.

Ekziston një numër i madh kornizash dhe metodash për zhvillimin e strategjive për parandalimin e konflikteve, por kryesisht ato përkohë me katër faza kryesore (Anderlini & Stanski 2004: 4):

1. Një analizë e situatës, e cila përfshin:
 - ⇒ Objekte (indikatorë) që mbështesin dhe e vënë në lëvizje konfliktin dhe
 - ⇒ Qëllime ose kushte të cilat ndikojnë ndaj reduktimit të konfliktit, të cilat mund të jenë bazë për arritjen e paqes;
2. Identifikimin ose "hartat" e pjesëmarrësve dhe bartësve kryesorë duke i përfshirë edhe ata të cilët e nxisin dhe e stimulojnë konfliktin dhe ata të cilët e zbusin konfliktin dhe e promovojnë paqen;

3. Zhvillimin e skenarëve për situatat e mundshme nga rastet më të këqija deri te rastet më të mira;
4. Planifikimin e përgjigjeve efektive përmes identifikimit të aksioneve dhe hapave që duhet të ndërmerren për uljen e tensioneve dhe për promovimin e zgjidhjes pa dhunë të konfliktit.

Në kuadër të diplomacisë bashkëkohore, janë zhvilluar një numër i madh metodash të aksionit diplomatik, qëllimi i të cilit është të gjendet zgjidhje paqësore për kontestin, përkatësisht të parandalohet konflikti. Në këto metoda bëjnë pjesë: negociatat, analizat, ndërmjetësimi, pajtimi, arbitrazhi, ujdia gjyqësore dhe "shërbimet e mira" (Sokalski 2005: 27-28). Përdorimi i diplomacisë bashkëkohore, në zgjidhjen e kontesteve bilaterale ndërmjet shteteve ose gjatë zgjidhjes së problemeve të brendshme të dy ose më shumë grupeve të ndryshme etnike ose politike, u tregua si më pragmatik nga zgjidhja e drejtpërdrejtë e kontestit ndërmjet palëve të prekura. Kjo nuk do të thotë se diplomacia bilaterale është më pak e vlefshme. Dimensioni multilateral shfrytëzohet në rastet kur të gjitha mundësitë për zgjidhje bilaterale të konfliktit janë absolutuar ose në rastet kur nuk ekziston vullnet dhe interes i mjaftueshëm te njëra palë për zgjidhjen e të njëjtit. Sokalski, gjatë argumentimit të tezave të tij, u referohet përvojave ndërkombëtare të OKB-së në zgjidhjen e konflikteve. Duke u nisur nga presupozimi se aksioni parandalues duhet të shfrytëzohet për qëllime pozitive dhe në mungesë të pëlqimit rreth përkufizimit të saj final, Sokalski i bën një vështrim të veçantë parandalimit të *drejtpërdrejtë, të tërthortë dhe parandalimit të detyrueshëm* (Sokalski 2005: 49). *Parandalimi i drejtpërdrejtë*, i specifikuar në nenin 33 të Kartës së OKB-së, është një instrument ndërkombëtar për promovimin e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe për avancimin e marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve. Rëndësia e tij ndërlihet me masat të cilat ndërmerren me parandalimin ekzistues para konfliktual. Sipas Sokalskit *parandalimi i tërthortë* mund të zbatohet në situata parakonfliktuale dhe postkonfliktuale, në kohë krizash ndërmjet shteteve të caktuara ose në kuadër të një shteti. Implementimi i këtij lloji të parandalimit duhet ta ngërthejë: sundimin e së drejtës, mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe

mekanizma të tjerë ndërkombëtarë për avancimin e shoqërisë civile dhe vlerave demokratike. Parandalimi i tërthortë për eliminimin e shkaqeve të konfliktit në Maqedoni mund të arrihet përmes aplikimit të masave në kontekst rajonal. Respektimi i tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë ka të bëjë me shkaqet fundamentale shoqërore të shfaqjes së konflikteve, siç janë: përjashtimi, dendësia e madhe e popullsisë, papunësia, shpërndarja e pabarabartë e resurseve dhe degradimi i mjedisit jetësor. *Parandalimi i detyrueshëm* zbatohet kur për arritjen e qëllimit (vendosjen e paqes dhe stabilitetit përmes përfundimit të konfliktit ose përmes ballafaqimit me një krizë të caktuar) bashkësia ndërkombëtare ose ndonjë subjekt i pavarur më së shpeshti është i interesuar për ndërprerjen e konfliktit dhe është i gatshëm të ndërtojë përmes presionit ose detyrimit për zbatimin e parandalimit. Sokalski, në arsyetimin e tij lidhur me parandalimin e detyrueshëm, sqaron se aksioni i hershëm parandalues, edhe pse ekzistojnë disa përjashtime, konsiderohet si parandalim jo i detyrueshëm. Ekziston edhe aksion ndëshkues i cili i përmban masat ushtarake, përkatësisht intervenim me forcë ushtarake, por kjo zbatohet vetëm si mjet i fundit, i parashikuar me Kapitullin VII të Kartës së KB-ve. Parandalimi i detyrueshëm duhet të jetë mjeti i fundit i cili shfrytëzohet në rastet kur janë absolvuar të gjitha veprimet (negociata, ndërmjetësimi, pajtimi dhe shfrytëzimi i "shërbimeve të mira"), ndërkaq u dedikohet politikanëve, subjekteve lokale dhe rajonale.

Zbatimi i parandalimit të konflikteve në Republikën e Maqedonisë në mënyrë të drejtpërdrejtë varet nga **struktura organizative e kornizës kombëtare për parandalimin e konflikteve** (e cila është pjesë integrale e politikës së sigurisë) dhe nga **përvojat e shtetit në këtë fushë**.

5.1 Karakteristikat e kornizës kombëtare për zbatimin e parandalimit të konflikteve

Korniza kombëtare për parandalimin e konflikteve detyrimisht bazohet mbi respektimin e së drejtës, si parim themelor për funksionimin e shtetit. Çdo shkelje dhe keqpërdorim i përfitimeve

nga shoqëria demokratike dhe shtetit juridik, e detyron shtetin që përmes institucioneve të veta të aplikojë forcën legjitime, të njohur si forcë shtetërore, si pjesë e masave represive për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe vlerave shoqërore.

Korniza kombëtare për parandalimin e konflikteve në Republikën e Maqedonisë përkon me përpjekjet e shtetit për harmonizimin e standardeve vendase me ato evropiane në këtë fushë. Në përputhje me kornizën kombëtare, subjektet vendase për zbatimin e parandalimit të konflikteve (sistemi i sigurisë, autoritetet politike dhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë si përfaqësues të bashkësive etnike), përveç zbatimit të parandalimit, kanë për detyrë të participojnë në krijimin dhe implementimin e politikës kombëtare të sigurisë, t'i identifikojnë kërcënimet, shkallën e konfliktit dhe ndikimin e tyre mbi rrezikimin e rendit, të integriteteve euroatlantike dhe të marrëdhënieve ndëretnike. Edhe pse sistemi i sigurisë është faktor kyç i kornizës për zbatimin e parandalimit të konflikteve në frymën e demokracisë (para së gjithash për shkak të gjithëpërfshirjes dhe për shkak të profesionalizmit), në procesin e krijimit, ndryshimit dhe plotësimit të kornizës kombëtare për parandalimin e konflikteve duhet të përshihen edhe subjekte të tjera të rëndësishme të shoqërisë (institucionet shtetërore, sektori civil, përfaqësuesit e jetës politike në shtet, mediat, ekspertë të fushës së sigurisë e të tjerë). Po ashtu, në drejtim të ngritjes së shkallës së kulturës së sigurisë, është i domosdoshëm edukimi i popullatës për identifikimin e burimeve të kërcënimeve ndaj sigurisë.

Kornizës së përgjithshme për parandalimin e konflikteve, si pjesë përbërëse e politikës së sigurisë, i ndërlidhet gjendja e sigurisë, përvojat dhe marrëdhëniet të cilat i ka shteti me vendet dhe organizatat partnere në fushën e sigurisë (me NATO, me BE, me SHBA dhe me Turqinë).

5.2 Përvojat e Republikës së Maqedonisë në parandalimin e konflikteve

Sa u përket përvojave të Republikës së Maqedonisë në parandalimin e konflikteve, për fat të keq, dominojnë përvojat të cilat i ka Republika e Maqedonisë me prezencën e forcave ndërkombëtare

të sigurisë në territorin e saj, për shkak të parandalimit të agresionit, konflikteve dhe për ndërtimin e shoqërisë postkonfliktuale. Subjektet ndërkombëtare marrin pjesë në realizimin e aktiviteteve tradicionale paqeruajtëse, të shoqëruara me programe për zhvillim shoqëror me qëllim të zbrapsjes së konflikteve ndëretnike dhe agresionit.

Prezenca e misionëve të OKB-së, në fazat e hershme nga pavarësimi i shtetit, ishin pjesë të zbatimit të konceptit të diplomacisë preventive, aktivitetet e OSBE-së ndërlidheshin me inkorporimin e modeleve të punës së policisë në shoqëritë multietnike dhe reformat në polici, ndërsa prezenca e NATO-s dhe e BE-së ishin pjesë e rehabilitimit postkonfliktual të vitit 2001.

Kryesisht, faktori ndërkombëtarë, në momente të caktuara u tregua si kyç për zbatimin e konceptit të parandalimit të konflikteve, ndërkaq prezenca e bashkësisë ndërkombëtare në Maqedoni u imponua si garanci për paqen dhe si bartës kryesor i detyrave të sigurisë në politikën e sigurisë vendase dhe të jashtme të shtetit. Përvojat në zbatimin e parandalimit të konflikteve në Republikën e Maqedonisë, krahas kapacitetit dhe gjendje së sistemit të sigurisë, treguan se ajo, në masë të madhe, varet nga vullneti i autoriteteve politike, dëshira e grupeve etnike për të bashkëpunuar dhe nga mbështetja e bashkësisë ndërkombëtare (BE, OSBE dhe NATO). Perceptimet e qytetarëve për prezencën e sigurisë ndërkombëtare ngelën të ndara dhe skajshëm të ndryshme, nga nevoja e madhe për ruajtjen e sigurisë deri tek imazhi për protektorat të bashkësisë ndërkombëtare në të cilin shteti është i paaftë që vet ta ruajë sigurinë dhe ta garantojë rendin kushtetues.

Relacionet e Republikës së Maqedonisë me OKB datojnë që nga periudha pas pavarësimit të saj, kur OKB-ja për herë të parë vendosi konceptin e quajtur diplomacia parandaluese, koncept nga i cili mësonin të dyja palët. Në vitin 1992, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Butros Butros-Gali, thirri për më shumë diplomaci parandaluese, e që sipas tij nënkuptonte jo vetëm aktivitetin e tij personal diplomatik, por edhe shpërndarje parandaluese të misionëve paqësore në kuadër të shtetit dhe ndërmjet shteteve – kjo e fundit pa detyrim, me pajtimin e të gjitha palëve (Berridge & James 2001: 193-194). Diplomacia parandaluese i përfshin ato aksione ose institucione të cilat shfrytëzohen me qëllim të

parandalimit të kontesteve politike, të cilat shfaqen midis shteteve dhe përmes tyre mund të përshkallëzohen në konflikt të armatosur (Lund 1995). Diplomacia parandaluese është aksion i koordinuar, qëllimi i së cilës është të zgjidhen, të parandalohen ose të kufizohen kontestet para se të bëhen të dhunshme (Stedman 1995). Diç më vonë, diplomacia parandaluese u përkufizua si "përdorim i teknikave diplomatike, qëllimi i së cilës është ta parandalojë shfaqjen e kontesteve, të pengojë që kontestet të shndërrohen në konflikt të armatosur, ndërkaq nëse megjithëkëtë shfaqen dhe nëse kjo me këtë nuk arrihet sukses, të parandalohet përhapja e konfliktit të armatosur" (Boutros-Ghali 1996:18) dhe si "aksion i ndërmarrë në vende të ndjeshme dhe në kohë të ndjeshme me qëllim të shmangies së kërcënimit ose përdorimit të forcës së armatosur dhe formave të ngjashme të detyrimit nga ana e shteteve ose grupeve, me qëllim të zgjidhjes së kontesteve politike të cilat mund të shfaqen për shkak të efektit të destabilizimit nga ndryshimet ekonomike, shoqërore, politike dhe nga ndryshimet ndërkombëtare" (Lund 1996:37). Sipas Lund, parandalimi dallon tri faza: fazën fillestare, kur diplomacia parandaluese orientohet kah zgjidhja e burimeve kryesore të kontestit; vijon faza, e cila synon të pengojë që kontesti të shndërrohet në dhunë; dhe shumë më vonë është faza kur bëhen përpjekje të kufizohet përhapja e dhunës, e cila është përshkallëzuar tashmë (Lund 1996: 34). Përfshirja e OKB-së me qëllim të parandalimit të konfliktit të brendshëm dhe agresionit, u tregua si formulë e suksesshme e OKB-së e zbatuar në Maqedoni. Për herë të parë në botë, në kuadër të OKB-së u zbatua misioni³⁹ i diplomacisë

³⁹ Duke u bërë vështrim masave të parandalimit të konflikteve, të aplikuara në Maqedoni, tanimë misionet e vogla të stacionuara të OSBE-së dhe BE-së gjatë vitit 1992 ishin të plotësuara me stacionimin e forcave paqeruajtëse të OKB-së në Maqedoni – pjesë iniciuese e UNPROFORIT (UN Protection Force), të shpërndara çdo kund në territorin e ish Jugosllavisë. Këto forca më vonë u riemëruan në UNPREDEP (UNPREDEP - UN Preventive Deployment) dhe përfshinin 800 ushtarë, pastaj u plotësuan me 360 paqeruajtës nga SHBA-të nën komandën e OKB-së. (Rosas & Lahelma 1997: 184). Funkzioni kryesor i tyre ishte zbrapsja e intervenimit të Serbisë në Maqedoni, mirëpo vëmendje më e madhe iu kushtua skenës së brendshme, ku ekzistonin tensione ndërmjet shumicës maqedonase dhe minoritetit shqiptar. Si degë e misionit paqeruajtës të KB-së në pjesët e tjera të ish Jugosllavisë, UNPREDEP-i kishte strukturë dhe funksione të specializuara me të cilat u reduktua jostabiliteti më i madh i jashtëm dhe i brendshëm i vendit, pasi Maqedonia shpalli pavarësinë. Misioni zgjati nga viti 1995 deri në viti 1999.

parandaluese⁴⁰, i cili përmes involvimit të bashkësisë ndërkombëtare në situata të konfliktit i tejkaloi parimet e organizatës (pëlqimi i palëve, paanshmëria dhe mospërdorimi i forcës, përveç në rastet e vetëmbrojtjes dhe mbrojtjes së detyrave të parashtruara). Në bazë të përvojave në Maqedoni, koncepti i diplomacisë parandaluese me kalimin e kohës u zhvillua dhe u mbindërtua.

Misioni i OKB-së në Maqedoni përfshiu tri shtylla të aktiviteteve. Shtylla e parë i përmbante aktivitetet tradicionale të misioneve paqësore, përkatësisht ushtrinë dhe vëzhguesit ushtarak përgjatë kufirit maqedonas, si ndihmë e forcave të sigurisë në vëzhgimin e kufirit dhe në ruajtjen e integritetit territorial nga ndërhyrjet e strukturave militante të huaja, në periudhë të kërcënimeve publike nga autoritetet politike të vendeve fqinje. Shtylla e dytë, e përmbante mbështetjen politike në negociata dhe në ndërmjetësimin e situatave, kur ekzistojnë moskuptime dhe tensione. Këto detyra i kryenin diplomatët, duke i shfrytëzuar shkathtësitë dhe autoritetin e tyre në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare. Njëkohësisht, në kuadër të shtyllës së dytë funksiononte policia civile e KB-së, e cila kishte rolin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të minoriteteve kombëtare në territorin e Maqedonisë. Shtyllën e tretë të aktiviteteve, Sokalski e emërton "dimension njerëzor" (Sokalski 2005: 53). Kjo shtyllë, përfshiu aktivitete të cilat e ndihmuan zhvillimin e shoqërisë civile, përmes zhvillimit, reformimit dhe përsheptimit të proceseve për harmonizimin e institucioneve dhe organeve shtetërore me parimet e shoqërisë demokratike në procesin e tranzicionit. Praktikisht, edhe pse Maqedonia, në atë periudhë, nuk kishte konflikt të armatosur, me implementimin e dy shtyllave të para të aktiviteteve u realizuan të gjitha masat e nevojshme për funksionimin normal të shtetit.

⁴⁰ Konsiderohet se inkorporimi i parë i "Diplomacisë Parandaluese" buron nga mendimet inovative të Sekretarit të dytë të Përgjithshëm të OKB-së – Dag Hamarsheld (Dag Hammarskjöld) gjatë kohës së udhëheqjes së tij me OKB-në, në periudhën kohore 1953-1960. Sipas Komisionit Carnigie (Carnegie Commission 1997) bëhet dallimi midis parandalimit operativ, i cili përmban strategji për përballjen me kriza dhe parandalimit strukturor i cili përfshin strategji për zgjidhjen e shkaqeve kryesore të konfliktit vdekjeprurës. Parandalimi strukturor (ose parandalimi i shkaqeve rrënjësore) ka të bëjë me shkaqet rrënjësore, siç janë: varfëria, represioni politik dhe pamundësia e shpërndarjes së resurseve, të cilat nëse neglizhohen mund të shndërrohen në dhunë. Sipas autorëve të këtij raporti, Diplomacia Parandaluese është formë e parandalimit operativ. Parandalimi afatgjatë përfshinë përpjekje për reduktimin e varfërisë dhe arritjen e bazës për zhvillim ekonomik. Strategjitë parandaluese, gjithashtu, i promovojnë të drejtat e njeriut, mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe i institucionalizojnë veprat politike me të cilat përfaqësohen të gjitha grupet.

Shtylla e tretë, e orientuar kah demokratizimi i shoqërisë, në fakt paraqiste hyrje në reformën e përgjithshme të shtetit.

Aktiviteti i dytë i OKB-së në Maqedoni u zhvillua pas konfliktit të vitit 2001. Kuvendi e formoi Agjencinë për Implementimin e Programit për Çarmatimin e Popullatës, ndërsa Qeveria me ndihmën e shoqërisë civile e zbatoi fushatën sa i përket Programit për ngritjen e vetëdijes publike në kuadër të mbarë shtetit. Liderët lokalë dhe shtetërorë të qeverisë, këtë e perceptuan si interes për fitimin e pikëve, ndërsa UNDP-ja u dhuroi tiketa për lotari secilit pjesëmarrës për të fituar automobil, TV aparat, aparate për amvisëri, libra dhe shkollim. Rreth 6000 copë armë u grumbulluan për më shumë se 45 ditë (Risser 2003). Me aktivitetin e këtillë, OKB-ja përsëri e justifikoi prezencën në vend si subjekt aktiv për kthimin e paqes dhe stabilitetit në shtet.

Përvojat e Maqedonisë me OKB treguan se këshillat dhe aktivitetet e bashkësisë ndërkombëtare mund të jenë mjaft konstruktive dhe të kontribuojnë që më shpejtë dhe në mënyrë më efikase të përballen me kërcënimet e jashtme dhe të brendshme të sigurisë.

Roli i **NATO**-s dhe **BE**-së në sigurinë e Evropës kryqëzohet në shumë fusha të veprimit të tyre, ndërkaq përputhja e aktiviteteve të tyre veçanërisht theksohet nga fillimi i shekullit 21. Kjo i referohet ripërkufizimit të mandatit të BE-së me dimensionin e ri të sigurisë, me të cilin u inkorporua shkallë e lart e përputhjes së prioritetëve, të interesave dhe të objektivave të të dyja organizatave. Gjatë kohës së konflikteve në Ballkan, NATO për herë të parë veproi në Evropë, ndërsa, gjithashtu, BE në Maqedoni për herë të parë dërgoi komponentë të sigurisë për të marrë pjesë në kthimin dhe ruajtjen e paqes.

Prezencës së BE-së dhe NATO-s në Maqedoni u parapriu krijimi i politikës evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes (1999), si bazë për formimin e forcave evropiane të sigurisë. Formimi i forcave evropiane të sigurisë u motivua nga qëllimi i shmangies së dominimit të SHBA-ve në NATO dhe krijimi i doktrinës së re të BE-së, me të cilën braktiset qasja paraprake e cila bazohej në zgjidhjen e konflikteve vetëm me metoda ekonomike, politike dhe humanitare. Për shkak të shfrytëzimit racional të kapaciteteve të sigurisë, BE dhe

NATO ranë dakord për angazhimet “Berlin Plus”⁴¹ të cilët më vonë u verifikuan në Samitin e Kopenhagës në muajin dhjetor të vitit 2002. Në këtë mënyrë, BE i fokusoi orientimet e veta politike dhe strategjike në drejtim të ndërmarrjes së operacioneve konkrete me qasje deri te kapacitetet për planifikim, logjistikë dhe informacione të Aleancës dhe anasjelltas. Në përgjithësi, periudhën e cila filloi që në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar e shënuan tretribute të njohura si: thellimi, zgjerimi dhe përforcimi i politikave të jashtme dhe të brendshme të sigurisë të BE-së, me të cilat arrihet efekt më i madh në kohezionin e brendshëm të procesit integruar të BE-së dhe politikës së saj të jashtme (Bono 2006: 155). Thellimi ka të bëjë me arritjen e marrëveshjes ndërmjet vendeve-liderë në kuadër të politikave të jashtme evropiane të sigurisë për çështje kyç me interes të përbashkët (për inkorporimin e euros, për formimin e Zonës Shengen, për politikën ndaj Iranit, për operacionin “ad hok” me karakter ushtarak etj.). Zgjerimi nënkupton spektrin e aktiviteteve të politikës së jashtme, përkatësisht angazhimin e BE-së në Ballkan, në Afrikë dhe në Azi dhe në zgjerimin dhe zhvillimin e politikës evropiane fqinjësore. Përforcimi është në kontekst të integritetit të aktiviteteve të sigurisë së brendshme dhe të jashtme të ndërlidhura me ballafaqimin me terrorizmin dhe me rritjen e prezencës ushtarake jashtë kufijve të BE-së. Tendencat e përforcimit të rolit të BE-së përmes politikës evropiane të sigurisë vërehen në Kushtetutën e dështuar nga vitit 2004, në 10 operacionet gjatë periudhës kohore 2003-2005 në përputhje me Detyrat e Petersburgut⁴² dhe në Traktatin e Lisbonës nga viti

⁴¹ Kryesisht, aranzhmanet “Berlin Plus” fokusohen mbi pikat si vijojnë:

- a. NATO-BE marrëveshje për siguri;
- b. Qasje e lejuar në kapacitetet e NATO-s për planifikimin e operacioneve për menaxhimin me kriza të udhëhequra nga BE;
- c. Akses i mjetet dhe mundësitë e NATO-s për operacionet e menaxhimit me kriza të udhëhequra nga BE;
- ç. Procedurat për cedimin, monitorimin, kthimin dhe thirrjen të mjeteve dhe mundësive të NATO-s;
- d. Obligime kontraktuese për Zëvendësin e Komandës Supreme të Aleancës të NATO-s për Evropë (DSACEUR) dhe opsioni i Komandës Evropiane për NATO; dh. Konsultimet BE-NATO për aranzhmanet në kontekst të operacioneve për menaxhimin me kriza, të udhëhequra nga BE me qëllim të shfrytëzimit të mjeteve dhe aftësive të NATO-s;
- e. Angazhime për përforcimin koherent dhe të ndërsjellë të mundësive dhe nevojave.

⁴² Nga të cilët katër ishin për ruajtjen e paqes në Ballkan dhe në Afrikë (Konkordia, Altea, Artemis dhe Amis).

2009, për ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit të vendeve aktuale të ardhshme (vende-kandidat) të BE-së dhe të partnerëve të saj. Tendencat përmbajnë një sërë masash me të cilat parashikohet: ndihma e ndërsjellë në rast të agresionit ushtarak kundër njërit nga vendet-kandidate, zgjerimi i Detyrave nga Petersburgu (për veprim në operacione paqeruajtëse) dhe solidariteti midis anëtareve në rast të sulmit terrorist ose fatkeqësive të mëdha. Strategjia Evropiane e Sigurisë nga viti 2003, evaluimi i saj (EU 2008) nga viti 2008, dokumenti i titulluar: “Strategjia e Brendshme e Sigurisë e BE-së në aksion: Pesë hapa drejt Evropës së sigurt” (EC 2010), i cili i tregon rezultatet dhe orientimet e aksionit të saj i miratuar në vitin 2010 dhe një sërë ngjarjesh me të cilat në vitin 2013 shënohet një dekadë nga miratimi i Strategjisë Evropiane të Sigurisë vë në pah transformimin evident të rolit të BE-së në lidhje me çështjet e sigurisë – nga përdorimi i fuqisë së “butë” në përdorimin e “fuqisë së fortë”.

Përvoja e Republikës së Maqedonisë me BE dhe NATO, në aspekt të parandalimit të konflikteve bazohet mbi lidhshmërinë e aktiviteteve të tyre gjatë dhe pas konfliktit të vitit 2001. Lidhja e NATO-s dhe BE-së në Maqedoni, tregoi integrimin e SHBA-ve dhe BE-së në mënyrë specifike të kontribuojnë në krijimin dhe zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Republika e vogël dhe e re, e cila nënkuptonte model për shoqëri multietnike, përjetoi përplasje serioze ndërmjet grupeve radikale të minoritetit shqiptar dhe të forcave shtetërore të sigurisë, në pranverën e vitit 2001. NATO edhe një herë ndjeu obligimin për intervenim, meqë gjendja ishte rezultat i drejtpërdrejtë i situatës në Kosovës, kështu që bashkësia ndërkombëtare sadopak kishte pjesë të përgjegjësive të tërthortë, por gjithashtu edhe për shkak se konfliktet e kësaj natyre do të mund të kishin efekt të destabilizimit reciprok mbi situatën në Kosovë (Theiler 2008: 21). Në muajin shkurt të vitit 2001, nën presionin e imponuar me konfliktin ndëretnik, ndërmjet forcave maqedonase të sigurisë dhe shqiptarëve të rebeluar të armatosur, NATO dhe BE i koordinuan negociatat ndërmjet dy palëve gjë që rezultoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në muajin gusht të vitit 2001. Në fund të muajit, pasi NATO e pranoi kërkesën e Presidentit të atëhershëm

Trajkovski, filloi misioni "*Korrja e domosdoshme*",⁴³ i cili zgjati gjatë periudhës nga data 27.8.-26.9.2001 dhe kishte për qëllim ta zbatojë operacionin për çarmatimin e shqiptarëve etnikë dhe të organizojë shkatërrimin e armëve të tyre. Pastaj, pasoi operacioni "*Dhelpra e kuqremtë*".⁴⁴ Misioni zyrtarisht filloi më 27.9.2001 me mandat fillestar tremujor, i cili u vazhdua në mënyrë plotësuese deri më 15.12.2002, me detyrë për t'i mbrojtur 280 vëzhguesit ndërkombëtar të BE-së dhe OSBE-së, të cilët e monitoronin implementimin politik të Marrëveshjes paqësore në Maqedoni. Operacioni numëronte 1000 pjesëtarë të vendeve evropiane- anëtare të NATO-s. Në mënyrë që ta zvogëlojë mundësinë e përsëritjes së konfliktit, NATO ra dakord ta vazhdojë mbështetjen me operacionin *Harmonia Aleate*,⁴⁵ e

⁴³ Në vitin 2001 NATO – në bashkëpunim të ngushtë me BE dhe me OSBE – me intervenimin në kohë, zbulues dhe të koordinuar ndihmoi në vënien fund të luftës civile në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Me kërkesë të Qeverisë së Shkupit, Sekretari i Përgjithshëm i atëhershëm i NATO-s, Lordi Robertson, dërgoi ekip për ballafaqimin me kriza, i cili duhet të negocionte për ndërprerjen e zjarrit me të a.q. Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), grup i armatosur i rebelëve – shqiptarë etnik, të cilët morën territore në pjesën perëndimore të vendit. Në atë kohë, mbijetesa e Maqedonisë ishte vënë në pikëpyetje. Duke i aplikuar mësimet dhe përvojat e KFOR-it dhe të SFOR-it, NATO realizoi bashkëpunim të ngushtë me BE dhe OSBE – duke filluar nga niveli politik dhe deri te niveli më i ulët në terren, ndërsa tri organizatat, të dyja palëve në konflikt, u prezantuan qëndrimin e unifikuar ndërkombëtarë. Ekipi i NATO-s arriti të ndihmojë dhe ta bind UÇK që të bie dakord për ndërprerjen e zjarrit dhe t'i mbështes negociatat të cilat ishin në rrjedhë, ndërkohë që kulminuan me 13 gusht, me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Në këtë periudhë, NATO i shpërndau 4000 ushtarët e vet të cilët morën pjesë në operacionin "*Korrja e domosdoshme*" dhe duhej ta mbikëqyrnin çarmatimin e UÇK-së. Gjatë 30 ditëve të ardhshme, në disa lokacione të caktuara u grumbulluan përafërsisht 4000 copë armë. Detyra u krye deri në fillim të muajit tetor, ndërsa UÇK-ja pushoi së ekzistuari si organizatë e strukturuar ushtarake. Pas përfundimit të "*Korrjes së domosdoshme*", ndërkaq me kërkesë të Qeverisë në Shkup, disa qindra ushtarë të NATO-s ngelën në vend, si mbrojtje e vëzhguesve civil, të cilët kishin detyrë ta monitoronin kthimin e forcave shtetërore të sigurisë në ish rajonet e krizave. Në muajin prill të vitit 2003, NATO përgjegjësinë për këtë operacion ia dorëzoi BE (NATO 2003b).

⁴⁴ Me aprovimin e Planit të Veprimit më 26.09.2001, Këshilli i Atlantikut të Veriut u pajtua për realizimin e urdhrin ekzekutiv duke e autorizuar Komandantin e Lartë të Aleancës për Evropë, Gjeneralin Xhozef Ralston (Joseph Ralston) ta kumtojë urdhrin për aktivizimin e operacionit "*Dhelpra e Kuqërremtë*" (NATO 2003).

⁴⁵ Prezenca e NATO-s pas datës 15.12.2002 kishte dy qëllime: elementet e tij operativë siguronin mbështetje për vëzhguesit ndërkombëtar dhe elementet e tij këshillëdhënëse u ndihmonin autoriteteve për ta kthyer sigurinë në mbarë territorin. Më 17.3.2003, Këshilli i Atlantikut të Veriut vendosi ta përfundojë operacionin *Harmonia Aleate*, kështu që BE i filloi procedurat për ndërmarrjen e misionit. Ndërmarrja u bë me marrëveshje të plotë të autoriteteve në Shkup dhe paraqiste progres të rëndësishëm për kthimin e stabilitetit, të arritur gjatë kohës së misionit dhe operacionit paraprak "*Dhelpra e Kuqërremtë*" (NATO 2003a). Duke filluar nga viti 2002, BE-ja zhvilloi plane për ndërmarrjen e misionit ushtarak të NATO-s në Maqedoni nën patronazhin e PESM. Çështjet e pazgjidhura për parimet të përgjithshëm të bashkëpunimit të sigurisë ndërmjet NATO dhe BE i frenuan planet e BE-së për disa muaj. Në fund të vitit 2002 dhe në fillim të vitit 2003, NATO dhe BE i formalizuan parimet për vendosjen e lidhjeve institucionale, përfshirë edhe mbështetjen dhe qasjen e BE-së në strukturat materiale dhe teknike të NATO-s, të kontraktuara me aranzhmanet "*Berlin Plus*". Pasoi ftesa nga autoritetet maqedonase që BE ta marrë përgjegjësinë për ndërmarrjen e operacionit *Harmonia Aleate* nga NATO (Kim 2005: 11).

cila numëronte 700 pjesëtarë dhe e përfshiu periudhën kohore 16.12.2002-31.3.2003, kur u zëvendësua liderizmi me misionin, përkatësisht me misionin filloi të udhëheq BE-ja. Kështu, në fund të muajit mars të vitit 2003, BE e filloi misionin e parë paqësor. Në përvojën e parë të zbatimit të detyrave, të cilat rezultojnë nga aranzhmani "Berlin Plus", udhëheqësit e NATO-s në Shkup, përfshirë edhe Përfaqësuesin e Lartë Ushtarak, mundësoi ndihmë për autoritetet maqedonase për zbatimin e reformës në sektorin e sigurisë dhe në harmonizimin e standardeve të NATO-s. Misioni, me të cilin menaxhonte BE-ja, i quajtur *Konkordia*⁴⁶ dhe zgjati nga 31.3. deri më 15.12.2003, pas çka vijoi misioni policor civil i BE-së – operacioni *Proksima*,⁴⁷ i cili vazhdoi deri në muajin dhjetor të vitit 2005. Në misionin Konkordia (i cili kishte numër të vogël të pjesëtarëve, më pak se numri i pjesëtarëve të NATO-s, të cilët në atë periudhë punonin në reformën e Armatës së Republikës së Maqedonisë në kuadër të Partneritetit për Paqe dhe përgatitjet për anëtarësim në NATO) përfaqësuesit policorë të BE-së, në kuadër të Proksima-s bashkëpunonin me policinë maqedonase dhe ndihmonin në zbatimin e reformës së MPB-së dhe në tranzicionin operativ të Policisë kufitare, si pjesë e angazhimeve gjithëpërfshirëse të BE-së për promovimin e menaxhimit të integruar të kufijve.

⁴⁶ BE-ja misionin Konkordia e përshkruan si një komponentë të premtimit të saj më të madh dhe të shumanshëm për Maqedoninë, që përfshinë ndihmë ekonomike dhe favore nga pranimi në BE. Përveç për Maqedoninë, misioni pionier Konkordia shërbeu si test edhe në operacione të tjera të EUFOR-it (EUFOR operations). Vërehet se BE i nënkuptonte obligimet ushtarake paqeruajtëse të ndërmarra nga NATO në BeH në muajin dhjetor të vitit 2004. Ashtu siç BE-ja i ndërtonte kapacitetet e veta ushtarake dhe nënkuptonte për të ardhmen misione plotësuese jashtë kufijve të saj, kjo të mbetet e shënuar në fillimet e përvojave të saj në Maqedoni (Kim 2005: 11-12). Në Samitin në Selanik, në muajin qershor 2003, Javier Solana (Javier Solana) propozoi angazhim për përcaktimin e qëllimeve strategjike të BE-së në tri pika, të cilat u pranuan dhe u shtuan në qëllimet e operacionit Konkordia:

- Kontribut për stabilitet në fqinjësinë e BE;
- Vendosja e rendit ndërkombëtar të bazuar mbi multilateralizmin;
- Ballafaqimi me kërcënimet, qoftë kur bëhet fjalë për kërcënime të vjetra ose të reja.

⁴⁷ Në vazhdim të operacionit Konkordia, nga data 15.12.2003, BE dhe autoritetet maqedonase u morën vesh për opsionet për prezencën e re të BE-së. Ata ranë dakord që të vendosin mision policor të BE-së (EUPOL) të quajtur Proksima, i cili në Maqedoni kishte 200 nëpunës policorë civilë dhe ishte i ngjashëm me misionin e BE-së në Bosnje. Misioni i ri u fokusua në trajnimin e policisë, me qëllim të përforcimit të punës policore, shërbimit kufitar dhe shërbimet e tjera të cilat posedojnë autorizime. Ekspertët e BE-së e "monitoronin, mentoronin dhe këshillonin" policinë maqedonase dhe e mbështesnin zhvillimin e saj si shërbim policor efikas, i trajnuar mirë, profesional dhe shërbim policor multietnik (Kim 2005: 12-13). Misioni ishte me mandat prej në viti, por me kërkesë të autoriteteve maqedonase ai u vazhdua edhe për një vit dhe zgjati deri në muajin dhjetor të vitit 2005. Ai u fokusua në tre programe: rendi publik, krimi i organizuar dhe policia kufitare.

Përveç simbolikës së marrëdhënieve ndërmjet BE-NATO-Maqedoni, përmes misioneve të zbatuara pas konfliktit të vitit 2001, domethënia e tyre konsiston në atë se me misionet u arrit më larg sesa aranzhmanet "Berlin Plus, ndërsa kontinuiteti i misioneve ishte specifik në më shumë aspekte. Së pari, NATO vepronte me kërkesë të autoriteteve të shtetit sovran, i cili nuk ishte anëtar i saj. Operacioni *Korrja e domosdoshme* në të vërtetë ishte operacioni i parë i llojit të "*Kasave Blu*" të OKB-së dhe bazohej në marrëveshjet kontraktuese të të dyja palëve në konflikt. Operacioni *Dhelpra e Kuqërremtë*, krahas qëllimeve planore, kishte edhe qëllime shtesë, përkatësisht ta sigurojë stabilitetin e shtetit, ta tregoj interesimin e NATO-s për integritetin territorial të shtetit dhe ta theksojë kontributin e SHBA-ve. Misionet arritën shkallën më të lartë të koordinimit të institucioneve partnere dhe me komitetet e BE-së dhe të OSBE-së në historinë e deriatëhershme të NATO-s. Gjithashtu, kjo ishte hera e parë që NATO të udhëheq me operacion në kuadër të misionit të parë të pavarur ushtarak të BE-së, me përforcimin e mbështetjes evropiane të Aleancës përmes dhënies së formës së re të vlerës së bashkëpunimit transatlantik dhe me ndarjen e detyrave (Solana 2004). Nga ana tjetër, jostabiliteti i vendit dhe pasiguria në implementimin fillestar të misionit *Konkordia* u pasqyrua në qasjen e centralizuar gjatë udhëheqjes së misionit nga Komanda operative e NATO-s (Supreme Headquarters Allied Powers Europe - SHAPE) në Mons (Belgjikë) dhe me rezervat operative të NATO-s, të cilat tanimë ishin vendosur në Maqedoni.

Nga aspekti i dobisë të cilën Maqedonia e fitoi nga BE-ja në parandalimin e konflikteve, kjo duhet të analizohet përmes më shumë parametrave, në mesin e të cilëve më të rëndësishëm janë: mënyra e aplikimit të parimeve në kuadër të parandalimit, angazhimi institucional dhe vëllimi i ndihmës.

Sfidat e sigurisë në Maqedoni e arsyetuan veprimin e BE-së dhe NATO-s, por në masë të madhe kontribuan në europeizimin e vendit. Meqë misionet zhvilloheshin thuaja se paralelisht me reformën e sektorit të sigurisë, ato ndihmuan në zbatimin e reformës të sektorit të sigurisë përmes zhvillimit të kapaciteteve të vet shtetit për ballafaqimin me konflikte dhe bashkëpunimin operativ të drejtpërdrejtë të sigurisë dhe i mundësoi Maqedonisë promovimin

e kapaciteteve të veta të sigurisë – që drejtpërsëdrejti ndikoi mbi reputacionin e vendit, në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe mbi qasjen në ndërtimin e politikës më racionale të brendshme dhe të jashtme të sigurisë.

Në të ardhmen, përpjekjet e BE-së dhe NATO-s për zgjidhjen e konflikteve në Maqedoni duhet të orientohen kah ndihma më e madhe ekonomike, angazhimin e tyre në drejtim të perspektivës përkatëse evropiane (në proceset integruese euroatlantike, përkatësisht pjesëmarrjen aktive të BE-së në procesin e tejkalimit të kontestit me emrin) dhe aplikimin konsekuent të parimeve të së drejtës ndërkombëtare.

Aspektet e parandalimit të konflikteve në kuadër të prezencës së **OSBE**-së në Maqedoni datojnë që nga viti 1992 dhe ishin të orientuara në vëzhgimin e kufirit me Serbinë dhe me vendet e tjera fqinje për shkak të mundësisë së përhapjes së konfliktit në Maqedoni. Aktivitetet e para të OSBE-së ishin në drejtim të bashkëpunimit me Misionin Vëzhgues të Bashkësisë Evropiane (European Community Monitor Mission) dhe me misionin parandalues të OKB-së. Në këtë bashkëpunim lindën, siç thoshin përfaqësuesit e huaj zyrtarë, deri atëherë masa dhe aktivitete të panjohura civile, të stimuluar nga OSBE-ja, të cilat përfshinin: dialog ndëretnik, promovim të tolerancës përmes radio programeve dhe programeve televizive dhe demokratizimin e mediave (Clement 1997). Qëllimi kryesor i OSBE-së, sa u përket aktiviteteve të parandalimit të konflikteve, konsistonte në identifikimin dhe ofrimin e përgjigjeve përkatëse të potencialit të konfliktit të mundshëm dhe veprimin parandalues mbi mundësinë e konfliktit eventual të fillojë dhuna. Në këtë kontekst, OSBE-ja në Maqedoni ishte aktive pas incidenteve të dhunshme në vitin 1997 në Gostivar dhe Tetovë, pas thirrjeve për krijimin e "Shqipërisë së Madhe" nga ana e liderëve të Kosovës në vitin 1998 dhe gjatë fluksit të refugjatëve kosovarë në periudhën e krizës së Kosovës në vitin 1999.

Gjatë kohës dhe pas përfundimit të konfliktit, në vitin 2001, OSBE-ja kontribuoi për inkorporimin e një numri të konsiderueshëm të iniciativave në punën policore, për përmirësimin

e bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe bashkësisë⁴⁸ dhe për reforma gjatë implementimit të proceseve demokratike. Sot, edhe pse në numër simbolik, prezenca e OSBE-së angazhohet për përgatitjen institucionale të vendit për eurointegrimet. Nga aspekti i kapaciteteve të OSBE-së që ndërlidhen me sigurinë, në Maqedoni akoma është aktiv Departamenti për mbështetjen e policisë i vendosur në Qendrën për Trajnime të MPB-së.


Marrë në përgjithësi, nga përvojat e Maqedonisë, sa i përket rolit të faktorit ndërkombëtar në parandalimin e konflikteve, duhet të nxirret mësim për kreatorët e politikës së sigurisë. Formulimi i kuadrit në parandalimin e konflikteve, nuk duhet të kuptohet si importim i një modeli shabllon për zbatimin e parandalimit, por ai duhet t'i ketë parasysh kontekstet lokale të sigurisë dhe të shoqërisë në përgjithësi. Në këtë kontekst, bashkësia ndërkombëtare, aktorëve lokal mund t'u ofrojë opsione të cilët korrespondojnë me rrethanat në shtet dhe të jetë iniciator kryesor i aktiviteteve që kanë të bëjnë me reformën e sektorit të sigurisë, e që nënkupton edhe trajnim për krijimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë.

⁴⁸ Përmes formimit të grupeve këshillëdhënëse qytetare, trajnimit të trenerëve për zbatimin e konceptit "Policia në Bashkësi", trajnimin e koordinatorëve për marrëdhënie në bashkësi, organizimit të fushatave mediatike, dërgimit të nëpunësve policorë të ngarkuar për zbatimin e konceptit "Policia në bashkësi" në shkolla dhe organizim i përbashkët i ditëve të hapura të policisë.

6 ZBATIMI I POLITIKËS SË SIGURISË

6.1 Struktura dhe funksionet e sistemit të sigurisë kombëtare

Për zbatimin e politikës së sigurisë është i ngarkuar sistemi i sigurisë kombëtare i Republikës së Maqedonisë. Në kuadër të strukturës organizative të sistemit të sigurisë kombëtare të Republikës së Maqedonisë identifikohen subjektet themelore të përfshira në realizimin e funksioneve të tyre (Kotovčevski 2012: 23, ekstrakt). Subjektet bashkëveprojnë në ndarjen e pushtetit në shoqëri. Për kryerjen e aktiviteteve operative janë ngarkuar institucionet të cilat burojnë nga pushteti ekzekutiv.



Skema 4: Skema e sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë (Bela kniga na odbranata 2012: 23)

Presidenti i shtetit është kompetent për Këshillin e Sigurisë dhe për Agjencinë e Zbulimit. Presidenti i Republikës së Maqedonisë është Komandant Suprem i Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe Kryetar i Këshillit të Sigurisë së Shtetit. Presidenti (paragrafi 12 i Bela kniga na odbranata 2012):

- o miraton Strategjinë dhe Planin e Mbrojtjes së Republikës;

- o përcakton masa të gatishmërisë dhe urdhëron zbatimin e tyre;
- o përcakton organizimin, formacionin dhe komandimin e Armatës;
- o miraton dokumente për përdorimin e Armatës dhe urdhëron përdorimin e saj;
- o u jep pëlqim dokumenteve për zhvillimin e Armatës;
- o përcakton masat për ngritjen e gatishmërisë luftarake të Armatës dhe urdhëron zbatimin e tyre;
- o urdhëron mobilizimin e Armatës;
- o miraton akte normative lidhur me gatishmërinë luftarake, luftën e armatosur dhe mobilizimin e Armatës;
- o cakton eprorë në pozita të formacioneve gjeneralë, si dhe avancon dhe shkarkon gjeneralë;
- o cakton dhe revokon përfaqësues ushtarakë të Republikës jashtë vendit.

Këshillin e Sigurisë e përbëjnë: Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Qeverisë, ministrat që udhëheqin me organet e administratës shtetërore në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe punëve të jashtme, si dhe tre anëtarë të cilët i emëron Presidenti i Republikës. Gjatë emërimit të tre personave, Presidenti mban llogari që përbërja e Këshillit në mënyrë përkatëse ta pasqyrojë përbërjen e popullatës të vendit. Këshilli i shqyrton çështjet lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës dhe paraqet propozime pranë Kuvendit dhe Qeverisë (paragrafi 12 nga Bela kniga na odbranata 2012).

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë përfaqësohet nga tre komisionet e Kuvendit, si vijojnë: Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri, Komisioni për Mbikëqyrjen e Punës së Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim (pranë MPB) dhe Agjencia e Zbulimit dhe Komisioni për Mbikëqyrje dhe Monitorimin e Komunikimeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

Nga **sistemi gjyqësor** në sistemin e sigurisë kombëtare bëjnë pjesë: Gjykata Kushtetuese, hetuesia, prokuroritë dhe gjykatat.

Për **kontroll shoqëror** janë të ngarkuara organizatat joqeveritare civile dhe mjetet i informimit publikë.

Qeveria e përfaqëson pjesën dominuese të sistemit të sigurisë kombëtare. Qeveria përfaqësohet nga më shumë

komisione qeveritare, ministri, drejtori dhe organe të tjera të saj. Mikrostrukturën e pjesëmarrjes së Qeverisë në sistemin e sigurisë kombëtare e përbëjnë subjektet si vijojnë:

- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Mbrojtjes
- Ministria e Punëve të Jashtme
- Ministria e Financave (Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Drejtoria e Doganave, Byroja për Prokurime Publike dhe Drejtoria për Zbulim Financiar)
- Ministri të tjera
- Njësitë e vetëqeverisjes lokale (rajone, komuna dhe objekte)
- Komisioni për Luftë kundër Prodhimit të Palejuar, Kontrabandës me Drogë dhe Keqpërdorimit të Drogës
- Komisioni Kombëtar për Luftë kundër Trafikimit me Njerëz dhe Migracionit Jolegal në Republikën e Maqedonisë
- Komisioni Kombëtar për Menaxhimin e Integruar Kufitar
- Qendra Kombëtare Koordinuese për Menaxhimin e Integruar Kufitar
- Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara
- Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Qendra për Menaxhim me Kriza
- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (Komiteti Drejtues dhe Grupi për Vlerësime)

Zbatimi i politikës së sigurisë, përveç që bazohet mbi modelin e bashkëpunimit kompleks ndër-agjencial, megjithatë paraqet sfida më të madhe sigurie për autoritetet politike në Republikën e Maqedonisë dhe për sistemin e sigurisë në tërësi. Në bazë të qendrave të caktuara të fuqisë, në kuadër të rregullimit shoqëror të Republikës së Maqedonisë, zbatimi i politikës së sigurisë në masë të madhe edhe më tej do të varet nga aftësitë e menaxhimit me çështjet e sigurisë të disa subjekteve kryesore të sistemit të sigurisë, siç janë: Presidenti i shtetit (i cili njëkohësisht është në krye të Këshillit të Sigurisë), Kryetari i Qeverisë dhe strukturat udhëheqëse të subjekteve të sistemit të sigurisë të Republikës së Maqedonisë që kanë të bëjnë me krijimin dhe menaxhimin e udhëzimeve strategjike për udhëheqjen e politikës së sigurisë, veçanërisht sa u përket çështjeve në lidhje me sigurinë e brendshme, mbrojtjen dhe punët e

jashtme. Institucionet, funksioni kryesor i të cilave është mbrojtja e sigurisë shtetërore, përveç që kanë mandat që t'i zbatojnë aktivitetet e parashikuara me ligje (të cilat në pjesën më të madhe kanë të bëjnë me ballafaqimin me krimin, me menaxhimin me mbrojtjen e sovranitetit shtetëror dhe me garantimin e rendit kushtetues), ato njëkohësisht ndihmojnë edhe në drejtim të përcaktimit të interesave shtetërore të sigurisë.

Funksionimi i sistemit të sigurisë, në masë të madhe, varet nga kuantiteti dhe kualiteti i të dhënave të grumbulluara në terren (të ashtuquajtura të dhëna operative) dhe nga pjesëmarrja aktive e qytetarëve të bashkësisë lokale në identifikimin e kërcënimeve ndaj sigurisë. Të dhënat operative, të cilat janë produkt i punës së institucioneve të pushtetit ekzekutiv, të cilat janë pjesë të sistemit të sigurisë janë të dobishme për procesin e përgatitjes dhe miratimit të vendimeve qeveritare dhe për inkorporimin e zgjidhjeve alternative. Të dhënat përfshijnë një spektër informatash në lidhje me burimet e brendshme, rajonale dhe globale të kërcënimeve. Bashkëpunimi i institucioneve të sistemit të sigurisë me *qytetarët* mbështetet mbi kontaktin e drejtpërdrejtë ndërmjet pjesëtarëve të sistemit të sigurisë dhe qytetarëve. Në këtë pjesë vërehet puna e nëpunësve policorë zonal (mbështetur mbi konceptin "Policia në bashkësi", "Bashkësi të sigurta" dhe zbatimi i parandalimit) dhe zbatimi i *aktiviteteve zbuluese*.

Kontributi i qytetarëve në realizimin e politikës së sigurisë fillimisht duhet të nxitet nga motivimi i tyre që të marrin një pjesë të obligimeve dhe të përgjegjësive për identifikimin e rreziqeve të sigurisë dhe për komunikimin me institucionet e sistemit të sigurisë. Kjo do të thotë se ata duhet ta identifikojnë rrezikun dhe të jenë të informuar për pasojat nga konfliktet eventuale të armatosura ndëretnike, terrorizmi apo ndonjë rrezik tjetër i sigurisë. Për shembull, nëse shtrohet pyetja "*Çka mund të bëjnë qytetarët në aspekt të zhvillimit dhe përshkallëzimit të konfliktit potencial?*", atëherë involvimi i tyre në parandalimin e proceseve konfliktuale nënkupton:

- krijimin e rrjetit formal dhe joformal për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për pasojat nga konfliktet e ardhshme, monitorimin e tendencave konfliktuale në bashkësi dhe ndikimet të cilat zakonisht ndikojnë mbi qytetarët, si dhe përkufizimi i rolit të tyre në tejkalimin e kundërthënies dhe dhunës;

- punë për përcaktimin e pjesëmarrësve përmes identifikimit të shtrirjes së indikatorëve dhe zhvillimi i strategjisë së përbashkët për shkaqet e konfliktit;
- punë me institucione fetare dhe ekonomike me qëllim të mobilizimit të kapaciteteve të tyre dhe përdorimi i ekspertizës gjatë promovimit të dëmit nga dhuna përmes organizimit të dialogut në një pjesë ose në tërë bashkësinë;
- identifikimin e mekanizmave tradicional për zgjidhjen e konflikteve, zhvillimin e mënyrave për përdorimin e tyre tanimë në situata të përshkallëzuara dhe prezenca e ekipeve konsulente dhe e eksperte të qytetarëve në zonat e konflikteve për shkak të përcaktimit të kërkesave të popullatës lokale me qëllim të shmangies dhe ndërprerjes së dhunës;
- angazhimin e trajnuesve të cilët do të punojnë në parandalimin e konflikteve në shkolla; dhe
- zhvillimin dhe trajnimin e agjencive lokale mediatike dhe të agjencive ndërkombëtare për informim dhe për publikimin e storjeve të suksesshme që kanë të bëjnë me mungesën e përdorimit të dhunës.

Në zhvillimin e partneritetit, ndërmjet pushtetit dhe shoqërisë, konceptet civile i japin përparësi inkorporimit të koncepteve për sigurinë e njeriut dhe mostolerancës absolute të dhunës, kaosit, pasigurisë, korrupsionit dhe krimit. Kapacitetet e nevojshme për koordinimin e edukimit publik dhe vetëdijes, përfshijnë një sërë masash të zhvilluara në formë të programeve të cilat shërbejnë për:

- ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për rëndësinë e sistemit gjyqësor dhe rezultatet e proceseve gjyqësore që kanë të bëjnë me sigurinë;
- edukimin dhe konsultimin e publikut për çështjet dhe prioritetet në kuadër të sigurisë shtetërore dhe të njerëzve;
- mbështetjen shoqërore të parandalimit të konflikteve ndëretnike, terrorizmit dhe manipulimeve politike;
- ndërtimin e besimit dhe respektit publik ndaj autoritetit kushtetues;
- mbështetjen e zhvillimit të mekanizmave për mbrojtje të infrastrukturës kritike dhe resurseve natyrore të rëndësishme për sigurinë e shtetit; dhe


- masa dhe metoda sociale për ndërgjegjësim përmes dialogut për zgjidhje pa dhunë të konflikteve dhe krijimin e shoqërisë së sigurt.

Implementimi i politikës së sigurisë, në kuadër të formulimit bashkëkohor të sistemit të sigurisë, e nënkupton apostrofimin e *nevojës për zbulim efektiv* (i përforcuar me programe të koordinuara për ndërgjegjësimin e publikut, për arsim dhe për debat lidhur me çështjet e sigurisë). Në këtë drejtim, shteti duhet t'i modernizojë kapacitetet e zbulimit efektiv, analizës së të dhënave të fituara dhe në vazhdimësi të zhvillojë teknika për përdorimin e tyre në drejtim të përfundimit të kohezionit në vend. Në këtë mënyrë, vendosja e bazave të kornizës ligjore të veprimtarive të zbulimit dhe veprimit operativ (në terren) të sistemit të sigurisë nënkuptojnë përmbushjen e parakushteve për:

- grumbullimin efektiv, për analiza dhe përdorimin e zbulimit taktik për qëllimet e operacionit;
- zhvillimin e politikave dhe të orientimeve;
- zhvillimin e mekanizmave të cilët mundësojnë bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar me institucionet e autorizuara;
- zhvillimin e kapaciteteve për ndjekjen e kryerësve të veprave penale, personave rezidentë dhe personave të dyshuar me qëndrim jo të përhershëm dhe të mallrave;
- ndjekjen dhe monitorimin e personave për të cilët ekzistojnë informata se mund kryejnë vepra të terrorizmit;
- monitorimin e kufijve të shtetit për shkak të kontrollit të lëvizjes së njerëzve dhe materieve të rrezikshme potenciale;
- kontrollin e transferteve të dyshimta të parave; dhe
- monitorimin e personave të cilët kanë potencial për veprime destruktive kundër shtetit; dhe
- krijimin e mekanizmave të cilët mundësojnë qasje deri te institucionet të cilat nuk janë pjesë të sistemit të zbulimit.

Përvojat e Maqedonisë, që kanë të bëjnë me konfliktin e vitit 2001, treguan se për zbatimin e politikës së sigurisë nuk mjafton vetëm analiza e gjendjes së brendshme të sigurisë. Qasja gjithëpërfshirëse nënkupton që të merret parasysh dinamika e ndryshimeve rajonale të sigurisë, sfidave dhe kërcënimeve. Së

këtejmi, si mjaft të dobishme mund të konsiderohen të dhënat të cilat institucionet kanë mundësi t'i sigurojnë nga institucionet maqedonase dhe nga ekspertët të cilët gjenden jashtë vendit (për shembull, atashe policorë, ushtarakë dhe të punësuar të tjerë në përfaqësitë diplomatike-konsullore, oficerë për ndërlidhje, pjesëtarë të forcave të sigurisë të cilët marrin pjesë në operacione paqësore dhe ngjashëm).



Skema 5: Struktura organizative e sistemit të sigurisë kombëtare të Republikës së Maqedonisë (Kotovčevski 2012: 24)

Modeli i sigurisë kombëtare hyri në funksion pas miratimit të Strategjisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë në vitin 2010, si dokumenti i fundit strategjik në kuadër të politikës së sigurisë, me të cilën u precizua forma e sistemit të ri të sigurisë, i cili përbëhet nga tre nënsisteme – i mbrojtjes kombëtare, i sigurisë së brendshme dhe i mbrojtjes dhe shpëtimit, prej të cilëve secili funksionon si sistem i pavarur. Krahas politikës së sigurisë, strukturat e sigurisë dhe vetorganizimi i sigurisë i shoqërisë civile, struktura e re e sistemit të sigurisë kombëtare parashikon pjesëmarrje të forcave kombëtare të sigurisë në sistemet ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes. Kjo ka të bëjë me misionet e BE-së dhe NATO-s të cilët e përbëjnë shtyllën e katërt të sistemit. Me strukturën e theksuar të sistemit të

sigurisë kombëtare tejkalohet koncepti i modelit klasik të sigurisë kombëtare në të cilin në mënyrë strikte janë ndarë rolet e policisë, ushtrisë dhe elementet e zbulimit,⁴⁹ ndërkaq në mënyrë të qartë është theksuar bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e sigurisë.

Politika e sigurisë i jep udhëzimet dhe qëllimet e përdorimit të strukturave të sigurisë, me ç'rast e planifikon shfrytëzimin e kapaciteteve të përgjithshme të sigurisë për nevojat e shoqërisë civile dhe për pjesëmarrjen e shtetit në aktivitetet të cilat burojnë nga anëtarësia e saj ose nga partneriteti me organizatat ndërkombëtare, të cilat veprojnë në fushën e sigurisë. Zbatimi i politikës së sigurisë, njësoj sikurse edhe koncepti i saj, paraqet një model interdisiplinar i bazuar në zbatimin e elementeve të politikës së sigurisë. Vende dhe ekspertë të ndryshëm i përkufizojnë në mënyra të ndryshme elementet e politikës së sigurisë. Në elementet e cekur në Konceptin Kombëtar të Sigurisë dhe Mbrojtjes nga viti 2003, Kotovčevski (2012: 24, 26) shton edhe gjashtë elementë të cilët e rrumbullakojnë kornizën e politikës së sigurisë. Estonia, konceptin e politikës së sigurisë e ndan në disa elemente, siç janë: politika e jashtme, politika e mbrojtjes, politika e sigurisë së brendshme dhe pajtimit dhe kohezionit në shoqëri (Parliament of Estonia 2010). Në më shumë raste elementet e konceptit të sigurisë kombëtare korrespondojnë me nevojat e sistemit të sigurisë, përmbajnë ide inventive dhe janë në korrelacion me rrethanat shoqërore.

Politika e sigurisë së brendshme drejtpërsëdrejti është orientuar kah ruajtja e sigurisë së brendshme (publike) dhe sigurisë kushtetuese. Politika e sigurisë së brendshme është orientuar drejt mbrojtjes, ruajtjes dhe avancimit të interesave të Republikës së Maqedonisë, që kanë të bëjnë me zgjidhjen e rreziqeve dhe kërcënimeve lidhur me mbrojtjen e rendit demokratik të përcaktuar me Kushtetutë, me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe me norma dhe garanci të tjera kushtetuese-juridike të rëndësishme për sigurinë e Republikës së Maqedonisë (paragrafi 44 nga Koncepti Kombëtar i Sigurisë dhe Mbrojtjes 2003). Sipas Konceptit Kombëtar, Ministria e Punëve të Brendshme, elementet e kundërzbulimit dhe zbulimit të sistemit të sigurisë dhe subjektet e mbrojtjes civile paraqiten si aktorë kryesorë në zbatimin e politikës së sigurisë së brendshme.

⁴⁹ Sipas modelit klasik policia është e ngarkuar për sigurinë e brendshme, ushtria për rrezikimin nga jashtë dhe elementët e zbulimit në kuadër të sistemit të sigurisë janë të ngarkuara për sigurinë e brendshme dhe të jashtme.

Në të kaluarën e afërt, siguria e brendshme dallohej nga politika e jashtme në më së paku dy aspekte: qëllimet e sigurisë së brendshme më shumë kanë qenë të përqendruara dhe fokusuar mbi sigurinë dhe mbrojtjen dhe fillimisht ka bashkëvepruar me armiqtë aktualë dhe potencialë dhe me përdorimin e forcës së tyre, qoftë kur bëhet fjalë për forcë të dukshme ose të kamufluar (Sarkesian et al 2008:4). Në rrethana bashkëkohore, pjesa më e madhe e aktiviteteve të politikës së sigurisë së brendshme përkon me aktivitetet e politikës së jashtme (e cila udhëhiqet me kombinimin e masave diplomatike, politike, psikologjike dhe ekonomike) dhe me politikën e mbrojtjes (e cila buron nga doktrina ushtarake dhe nga përcaktimet strategjike të shtetit në fushën e mbrojtjes). Si shembull klasik për kompatibilitetin e qëllimeve të politikës së brendshme dhe të jashtme të sigurisë është bashkëpunimi të cilin e ka Maqedonia me agjencitë e BE – EUROPOL dhe FRONTEKS, bashkëpunimi në kuadër të trupave rajonale të bashkëpunimit të sigurisë dhe bashkëpunimi policor në misionet civile në BE, bashkëpunimi në OKB dhe OSBE. Menaxhmenti i krizës është një nga çështjet që bën pjesë në politikën e sigurisë së brendshme, por veçanërisht trajtohet në kuadër të dokumenteve strategjike nga fusha e sigurisë (Lazarevski, Gjorgon i Taleski 2010), me qëllim të bashkëpunimit të theksuar integruar dhe ndërkombëtar gjatë realizimit të aktiviteteve lidhur me ballafaqimin me fatkeqësitë dhe katastrofat.

Botëkuptimi tradicional i qëllimeve të politikës së brendshme të sigurisë shërben që të sigurojë një shkallë optimale të sigurisë së qytetarëve, të sigurojë funksionim papengesa të institucioneve të shtetit dhe të vihet në mbrojtje të interesave dhe vlerave të shtetit. Politika e brendshme e sigurisë është fokusuar mbi kërcënimet e brendshme dhe të jashtme ndaj Republikës së Maqedonisë dhe në të njëjtën theksohet se shteti nuk duhet të jetë burim i rrezikimit të sovranitetit dhe integriteti territorial të shteteve të tjera. Në drejtim të sqarimit është shembulli i Greqisë, e cila nga Republika e Maqedonisë, vite me radhë, përpiqet të krijojë burim të kërcënimeve

ndaj sigurisë së saj shtetërore.⁵⁰ Nga qëllimet e konceptuara në këtë mënyrë të politikës së brendshme të sigurisë të Republikës së Maqedonisë rezulton se politika duhet të orientohet në drejtim të ballafaqimit me të gjitha format e krimit (terrorizmin, krimin e organizuar, migrimin jolegal, kontrabandën me drogë, me armë, trafikimin me njerëz dhe forma të tjera), *ballafaqimit me të gjitha veprat që kanë të bëjnë me rrezikimin e rendit kushtetues dhe me vlerat e shoqërisë, zbutjen e implikimeve të sigurisë, me integrimet e bllokuara euroatlantike mbi sigurinë e brendshme, ballafaqimin me pasojat nga zhvillimi i dobët ekonomik (i cili veçanërisht ndikon mbi krijimin e dukurive socio-patologjike) dhe menaxhimin me gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike.*

Integrimet euroatlantike, si qëllim strategjik i shtetit, perceptohen si garanci e sigurisë së brendshme e cila kontribuon për zhvillimin ekonomik, imponon standarde gjatë koordinimit dhe veprimeve operative të sistemit të sigurisë dhe e ngrit shkallën e sigurisë së njeriut. Standardet kontribuojnë në drejtim të bashkëpunimit më efikas dhe bashkëpunimit kompatibil ndër-agjencial midis institucioneve ushtarake, policore dhe të zbulimit në nivel të brendshëm dhe për komunikimin e tyre më të mirë me institucionet simotra të shteteve të tjera dhe me organizatat ndërkombëtare të sigurisë. Inkorporimi i standardeve është veçanërisht i rëndësishëm gjatë shkëmbimit të informatave dhe implementimit të procedurave operative. Kjo ndihmon për identifikimin me kohë për zbulimin dhe shmangien e kërcënimeve terroriste, formave të krimit të organizuar, migrimeve ilegale dhe formave tjera të kërcënimeve ndaj sigurisë.

Zhvillimi ekonomik kontribuon në drejtim të tërheqjes së investimeve të huaja, zvogëlimin të tensioneve sociale dhe numrit të dukurive socio-patologjike dhe në drejtim të angazhimit më të madh të popullatës të aftë për punë. Imazhi i përmirësuar ekonomik i shtetit i ndryshon prioritetet e sigurisë dhe mundëson krijimin e politikës afatgjate të brendshme të sigurisë.

⁵⁰ Fillimet datojnë nga koha kur janë miratuar amendamentet e Kushtetutës (viti 1992). Shteti, përmes Kushtetutës, u përcaktua se nuk ka pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje, se nuk e ndryshon kufirin shtetëror (vetëm në përputhje me Kushtetutën, ndërsa mbi parimin vullnetar dhe në përputhje me normat përgjithësisht të pranuar ndërkombëtare) dhe nuk ndërhyr në të drejtat sovraane të shteteve të tjera dhe në punët e tyre të brendshme (Amendamenti I dhe II nga Ustav na Republika Makedonija 1992).

Një nga qëllimet më të rëndësishme të politikës së brendshme të sigurisë, rreth së cilët ndërlidhen të gjitha qëllimet e tjera të politikës së sigurisë, është zgjidhja e problemeve ndëretnike. Politika e brendshme e sigurisë duhet të shërbejë për uljen e ndikimit politik në zgjidhjen e problemeve ndëretnike në llogari të inkorporimit të profesionalizmit në sistemin e sigurisë dhe përdorimin e metodave qytetare në zgjidhjen e problemeve (transparencë për dialog, qasje e përbashkët ndaj zgjidhjes së një problemi konkret dhe ngjashëm). Zgjidhjet politike treguan se përmbushja e kërkesave të cilat i prekin vetëm interesat e partive të caktuara politike dhe të një pjese të vogël të popullatës, paraqesin zgjidhje të pjesshme ose të pasuksesshme dhe me to vetëm bajpasohen problemet e shtresuara. Konkretisht, politika e brendshme e sigurisë duhet të përmbajë instrumente të cilat synojnë drejt zgjidhjes së problemeve kryesore të dy bashkësive më të mëdha etnike në Republikën e Maqedonisë – maqedonase dhe shqiptare. Hipoteza kryesore e vendosur përpara pjesëtarëve të bashkësisë shqiptare në Republikën e Maqedonisë është: *"A dëshiron ajo të jetojë bashkë me popullin maqedonas në kushte të ekzistimit të një modeli qartë të përkufizuar të shoqërisë liberale civile dhe në rrethana kur u garantohen të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut, të sanksionuara me Kushtetutë dhe me ligje, apo shqiptarët në Maqedoni do të synojnë drejt realizimit të idesë për federalizmin e shtetit dhe në rastin e fundit – shkëputjen e pjesëve ku jetojnë shqiptarët?"*

Gjithashtu, në drejtim të realizimit të qëllimeve të politikës së brendshme është edhe inkorporimi i standardeve të larta profesionale në drejtim të zvogëlimit të ndikimit politik të brendshëm mbi sistemin e sigurisë. Nëse e dimë së politika e brendshme e sigurisë mbështetet mbi mundësitë e veprimtarisë së zbulimit, atëherë përvojat e ndërlidhura me skandalet e përgjimit (afëra "Duvlo", "Sina Ptica" dhe "Golemoto Uvo") tregojnë se shoqëria maqedonase nga aspekti politik akoma nuk është e pjekur, përkatësisht nuk ka kapacitete ta depolitizojë këtë fushë dhe të inkorporojë një kontroll demokratike "të pranueshme qytetare" mbi elementet e zbulimit.

Politika e jashtme e sigurisë i shfrytëzon teknikat e politikës së jashtme. Ajo edhe më tutje do të identifikohet me atë që kërkon gjetjen e kompromisit dhe negociatave, ndërkaq në raste të caktuara i përfshinë edhe teknikat e diplomacisë tradicionale. Së

këtejmi, politika e jashtme e sigurisë e Republikës së Maqedonisë është orientuar drejt mbrojtjes, ruajtjes dhe avancimit të interesave të Republikës së Maqedonisë në marrëdhëniet me shtetet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare. Duke u nisur nga prioritetet afatgjata të udhëheqjes së politikës së jashtme, Republika e Maqedonisë angazhohet për ndërtimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore me të gjitha shtetet fqinje të rajonit dhe më gjerë, merr pjesë aktive në iniciativat për bashkëpunim rajonal dhe në vazhdimësi angazhohet në drejtim të thellimit të marrëdhënieve dhe krijimit të sigurisë në kuadër të OKB-së, OSBE-së dhe organizatave e institucioneve të tjera ndërkombëtare (paragrafi 30 dhe 31 nga Nacionalna koncepcija za bezbednost i odbrana 2003).

Për përkufizimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të sigurisë është angazhuar niveli më i lartë politik dhe strategjik i sistemit të sigurisë dhe shtetit. Zbatimi i politikës së jashtme të sigurisë është pjesë përbërëse e aktiviteteve të diplomacisë së sigurisë, të cilën e përbëjnë forma të zakonshme dhe alternative të bashkëpunimit të sigurisë (pjesëmarrje në nisma rajonale të sigurisë, dërgimin e atashëve policorë dhe ushtarakë, oficerëve për ndërlidhje dhe hapjen e zyrave rajonale, formimin e qendrave të përbashkëta për trajnim, formimin e trupave koordinues dhe ngjashëm). Në esencë, zbatimi i politikës së jashtme të sigurisë të Republikës së Maqedonisë, në masë të madhe, varet nga zbatimi i qëllimeve strategjike të politikës së përgjithshme të jashtme dhe nga suksesi i politikës së brendshme të sigurisë që ka të bëjë me çështjet e sigurisë, me promovimin dhe realizimin e interesave të jashtme të sigurisë (të cilat në një pjesë më të madhe i përfshijnë integritet euroatlantike). Qëllimet më të rëndësishme në politikën e jashtme të sigurisë të Republikës së Maqedonisë janë realizimi i përfitimeve nga njohja e shtetit me emrin kushtetues⁵¹ për shkak të realizimit të interesave kombëtare të sigurisë. Nga ana tjetër, si sfida të tjera të sigurisë në marrëdhëniet e jashtme, janë: gjetja e zgjidhjes për vendosjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore⁵² dhe ridefinimi dhe përforcimi i marrëdhënieve me partnerët strategjikë

⁵¹ Për momentin më shumë se 2/3 e vendeve-anëtare të OKB-së e kanë njohur shtetin me emrin e tij kushtetues.

⁵² Përfshirë edhe kontestin për emrin (për shkak të rëndësisë së bashkëpunimit rajonal të sigurisë).

të shtetit me qëllim të përshpejtimit të proceseve eurointegruese (për shkak të implikimeve të sigurisë nga integrimet e bllokuara të Maqedonisë në BE dhe NATO). Çështja e marrëdhënieve të mira fqinjësore është aktuale meqë Maqedonia ka marrëdhënie më intensive dhe më të sigurt me disa vende të BE-së, të rajonit dhe me SHBA-të sesa me fqinjët. Për marrëdhëniet me fqinjët dëshmojnë deklaratat e përfaqësuesve zyrtarë (MKG 2013; Srbinovski; S.Z. 2012; Jovanovska 2012) të autoriteteve të vendeve fqinje (nga pavarësimi deri më sot) të cilat e dëmtojnë bashkëpunimin rajonal të sigurisë, nuk janë në favor të marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe paraqesin ndërhyrje në punët e brendshme të Republikës së Maqedonisë. Markante është sjellja iracionale e Greqisë dhe e Bullgarisë (pas bashkëngjijtes së saj ndaj Greqisë në bllokimin e eurointegrimi në vitin 2012 dhe mbajtjen e qëndrimit të njëjtë në mbledhjen e Këshillit të BE-së në fund të vitit 2013) për çështjen e respektimit të parimeve të politikës ndërkombëtare në kuadër të proceseve integruese të Maqedonisë për anëtarësim në NATO dhe BE. Të dy fqinjët e Maqedonisë, tanimë një kohë të gjatë, ia pamundësojnë realizimin e qëllimeve strategjike të politikës së jashtme të sigurisë.

Viteve të kaluara, Republika e Maqedonisë shënon progres të vazhdueshëm në drejtim të përgatitjes për qasje në kuadër të Kapitullit 31 për politikën e jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes. Angazhimet tona në mënyrë të rregullt i ka njohur KE (Ministerstvo za nadvorešni raboti 2013a).⁵³

Republika e Maqedonisë në politikën e përbashkët të jashtme të sigurisë të BE-së merr pjesë në më shumë nivele, siç janë: komunikimi formal (dialogu politik), bashkëngjitja ndaj deklaratave të përbashkëta, prononcimeve dhe pozitave të përbashkëta të BE-së, në fushën e kontrollit të armëve dhe joprofeliracionit, në fushën e marrëveshjeve për shkëmbimin e informatave të klasifikuara dhe në pjesën operative në lidhje me pjesëmarrjen në formacione ushtarake dhe participimin në operacione paqeruajtëse.⁵⁴

⁵³ Relevanca e vlerësimeve për progres bazohet mbi konkluzionet dhe rekomandimet që i përmbajnë Raportet e KE-së për progresin e Republikës së Maqedonisë për periudhën kohore 2009-2013.

⁵⁴ Pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse e pasqyron pjesën operative të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së (dhe NATO-s), kështu që ky aktivitet trajtohet si pjesë përbërëse e politikës mbrojtëse të sigurisë.

Dialogu politik që ka të bëjë me pjesëmarrjen e Maqedonisë në PPJS nënkupton mbajtje të takimeve formale në kuadër të Këshillit të Stabilizim Asocimit, me ç'rast në të njëjtat bisedohet për çështje nga domeni i PPJS dhe përcaktohen pozitat e përbashkëta sa u përket çështjeve aktuale të politikës ndërkombëtare. Dialogu politik zhvillohet edhe përmes pjesëmarrjes në takime joformale të ministrave të punëve të jashtme të BE-së; takimeve joformale të ministrave të mbrojtjes të BE-së, përkatësisht takimeve për dialog politik ndërmjet BE-së (Përfaqësuesit të Lartë të BE-së) dhe vendeve evropiane që janë anëtare të NATO-s, ndërsa nuk janë anëtare të BE-së, si dhe vendeve-kandidate për anëtarësim në BE; përmes konsultimeve ndërmjet BE-së dhe vendeve-kandidate sa u përket çështjeve multilaterale; si dhe përmes pjesëmarrjes në takime të rregullta të organizuara nga trupat e shërbimit evropian për punë të jashtme që janë përgjegjës për PPJS/PPSM (Ministerstvo za nadvorešni raboti 2013a).⁵⁵

Qëndrimi i autoriteteve zyrtare të Republikës së Maqedonisë konsiston me atë se konform marrëveshjeve të nënshkruara shteti do t'u bashkëngjitet deklaratave, prononcimeve dhe pozicioneve të përbashkëta të BE-së.⁵⁶ Qëndrimet kanë të bëjnë me çështjet aktuale ndërkombëtare dhe me zbatimin e masave konkrete restriktive dhe masave të tjera të cilat më së shpeshti kanë të bëjnë me vende të treta. Kjo pjesë e përfshin edhe qëndrimin e shtetit në lidhje me politikat e sigurisë të Bashkimit Evropian, ndërsa si institucione të

⁵⁵ Sa për ilustrim, Maqedonia gjatë periudhës së kaluar, me ftesë të Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Çështje të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë, Ketrin Eshton, mori pjesë në dialogun politik me anëtarët evropiane të NATO-së, të cilat nuk janë anëtare të BE-së, si dhe të vendeve kandidatë për anëtarësim në BE, si dhe në takime joformale të ministrave për punë të jashtme të vendeve-anëtare të BE-së. Në takime u diskutuan tema siç është progresi i formimit të Shërbimit Evropian për Punë të Jashtme, marrëdhëniet BE-NATO, zhvillimi i kapaciteteve ushtarake të BE-së, operacioni EUFOR Libya, misioni EUFOR Althea në BeH, Operacioni ATALANTA, mbajtja e stërvitjeve ushtarake të BE-së për menaxhim me kriza MILEX 11, zhvillimi i kapaciteteve për menaxhim me kriza, si dhe çështje me interes të përbashkët lidhur me ngjarjet në Afganistan, Pakistan dhe fqinjësinë jugore të BE-së.

⁵⁶ Këshilli i BE-së, në muajin tetor të vitit 2003, në bazë të konkluzioneve të Samitit në Selanik, miratoi dokument të posaçëm për implementimin e dispozitave të dialogut politik dhe bashkëpunimit midis vendeve të BE-së dhe vendeve nga procesi i stabilizim asocimit PSA në fushën e PPJS. Në bazë të këtij dokumenti BE i fton vendet anëtare të PSA t'u bashkëngjiten deklaratave/prononcimeve dhe pozicioneve të përbashkëta në lidhje me çështjet aktuale të marrëdhënieve ndërkombëtare. Krahas vendeve nga PSA, me ftesë të BE-së, deklaratave u bashkëngjiten edhe vendet e EFTA-s – Lihtenshtajni, Islanda dhe Norvegjia, anëtare të Zonës Ekonomike Evropiane, ndërsa në raste të caktuara edhe vende të tjera (Ministerstvo za nadvorešni raboti 2013a).

angazhuara për zbatimin e masave paraqitet pjesa më e madhe e institucioneve të cilat e përbëjnë sistemin e sigurisë kombëtare.⁵⁷

Në lidhje me fushën e informatave të klasifikuara, vazhdojnë aktivitetet për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me më shumë vende për shkëmbim dhe mbrojtje të ndërsjellë të informatave të klasifikuara. Në muajin shkurt të vitit 2012, Republika e Maqedonisë i aprovoi ndryshimet e Marrëveshjes në lidhje me procedurat e sigurisë për shkëmbimin e informatave të klasifikuara ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së, të cilat u inkorporuan si rezultat i hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës dhe formimit të institucioneve të reja të BE-së (Ministerstvo za nadvorešni raboti 2013a).

Roli i OKB-së, si platformë më numerike dhe gjithëpërfshirëse, e cila ofron zgjidhje obligative për harmonizimin e bazave ligjore dhe institucionale për ballafaqimin me sfidat dhe kërcënimet globale në botë, në relacionet me Republikën e Maqedonisë në fushën e politikës së sigurisë, nënkupton koordinim të politikës ndërkombëtare, aksion financiar dhe ligjor në parandalimin e aktiviteteve që rezultojnë nga terrorizmi botëror, nga krimi i organizuar, nga kontrabanda me drogë dhe nga të gjitha llojet e armëve. Në planin operativ, Republika e Maqedonisë merr pjesë në misionet ushtarake dhe civile në OKB, mirëpo pjesëmarrja është minimale dhe shumë larg asaj që mund të quhet "simbolike".

Relacionet e pjesëmarrjes së Maqedonisë në aktivitetet e OSBE-së janë të rëndësishme për politikën e jashtme të sigurisë meqë OSBE është institucioni i vetëm evropian i cili i mbulon të tre dimensionet e ndërlidhur të sigurisë: dimensionin ushtarak, ekonomik dhe human. Sinergjisë së tyre i ndërlidhet promovimi i paqes dhe stabilitetit përmes bashkëpunimit, implementimit të demokracisë dhe mbështetjes të të drejtave të njeriut. Në kuadër të marrëdhënieve dhe prezencës së OSBE-së në Maqedoni, shteti kishte mundësi që në kuadër të politikës së sigurisë të inkorporojë përvoja të diplomacisë parandaluese, të menaxhmentit të krizës, rehabilitimit të zonave post-konfliktuale dhe dimensionin politik të sigurisë për

⁵⁷ Në muajin tetor të vitit 2011 u formua Trupi Koordinues për Mbikëqyrjen e Implementimit të Masave Restriktive Ndërkombëtare, me të cilin kryeson Ministria e Punëve të Jashtme. Krahas kësaj, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme funksionojnë departamente për Politikë të Përbashkët të Jashtme të Sigurisë dhe për Kontrollin e Armëve, si komponentë të rëndësishëm organizativ të PPJS.

vendosjen e kontrollit mbi armët. Nga ana tjetër, marrëdhëniet me OSBE kanë perspektivë më esenciale, meqë përvojat të cilat vendi i mësoi, të cilat kanë të bëjnë me reformën dhe trajnimin e policisë, me menaxhimin e kufijve dhe me zbatimin e modelit për zhvillimin e shoqërisë multietnike, si model i suksesshëm për parandalimin e konfliktit ndëretnik në Maqedoni, paraqesin një bazë solide për bashkëpunimin e ardhshëm.

Bashkëpunimi bilateral strategjik i sigurisë dhe bashkëpunimi transatlantik rezultojnë nga marrëveshjet strategjike të bashkëpunimit të sigurisë të cilat Republika e Maqedonisë i ka nënshkruar me SHBA në muajin maj të vitit 2008 (si forcë prijëse në NATO dhe lider në luftën kundër terrorizmit) dhe me Turqinë më datë 11.11.2008, si partner strategjik në kuadër të bashkëpunimit ushtarak dhe policor. Marrëveshjet janë një lloj garancie për bashkëpunimin afatgjatë në fushën e sigurisë. Me marrëveshjet siguria bën pjesë në çështjet e partneritetit strategjik bilateral dhe të njëjtat paraqesin mbështetje formale të sigurisë deri në anëtarësimin e Maqedonisë me të drejta të plota në NATO. Bashkëpunimi me SHBA mbështetet mbi identifikimin e përbashkët të vlerave të demokracisë, sundimit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Vlerat e njëjta përmes pjesëmarrjes së Republikës së Maqedonisë në misionet e NATO-s dhe në koalicionin antiterrorist e vendosën shtetin në link-un transatlantik të sigurisë të Evropës dhe Amerikës Veriore.

Në përgjithësi, politika e jashtme e sigurisë duhet t'i shfrytëzojë mundësitë të cilat i ofrojnë organizatat ndërkombëtare të sigurisë në drejtim të ruajtjes së sigurisë së brendshme dhe përkufizimit të politikës së sigurisë. Njëherësh, anëtarësia aktuale dhe e ardhshme në organizatat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me sigurinë (NATO, BE, OKB, OSBE etj.) dhe marrëdhëniet e vendit me partnerët e saj (strategjikë) në fushën e sigurisë nënkupton zbatimin e obligimeve të kontraktuara dhe harmonizimin e politikës së sigurisë së shtetit me orientimet strategjike dhe me veprimin operativ të organizatave ndërkombëtare. Procesi i ndërtimit të politikës së sigurisë nënkupton harmonizim të qëllimeve kombëtare me qëllimet e organizatave ndërkombëtare, me ruajtjen (deri në një shkallë të caktuar) të veçorive kombëtare të sistemit të

sigurisë dhe veçori të tjera të cilat burojnë nga rrethanat e shtetit dhe rajonit. Në këtë drejtim, është e pritshme që të ekzistojnë dallime lidhur me vlerat dhe interesat e integruara në strategjitë e sigurisë të organizatave ndërkombëtare në të cilat shteti synon të anëtarësohet. Në këtë pjesë shteti duhet t'u përmbahet interesave të përbashkëta të organizatave, mirëpo sipas shembullit të shteteve të tjera kjo është mundësi për promovimin e prioriteteve shtetërore dhe interesave të mjedisit rajonal dhe global dhe mundëson ndërtim të qasjes solidare në ballafaqimin me kërcënimet ndaj sigurisë.

Politika e sigurisë dhe e mbrojtjes i përkufizon orientimet strategjike të segmentit të mbrojtjes të sistemit të sigurisë dhe është në korrelacion me politikën e jashtme (nga aspekti i integriteteve euroatlantike) dhe me politikën e brendshme të sigurisë (me qëllim të funksionit mbrojtës nga agresioni i jashtëm). Politika e mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë në tërësi i pranoi parimet, qëllimet dhe detyrat të cilat rezultojnë nga koncepti strategjik i NATO-s, nga Orientimet Gjithëpërfshirëse Politike të NATO-s, nga Samiti në Rigë në vitin 2006 dhe nga Strategjia Evropiane e Sigurisë nga viti 2003 (Hyrje në Strategjia za odbrana na Republika Makedonija 2010). Politika e mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë është orientuar drejt zhvillimit të vazhdueshëm të forcave dhe aftësive mbrojtëse dhe zhvillimit të sistemit të mbrojtjes me çka sigurohet roli i saj në mbrojtjen e interesave kombëtare në përputhje me standardet e NATO-s, dhe mundësohet kontributi i vendit në drejtim të mbrojtjes së sigurisë rajonale dhe globale përmes pjesëmarrjes së Republikës të Maqedonisë në operacionet ndërkombëtare për mbështetjen e paqes dhe sigurisë (paragrafi 83 nga Strategjia za nacionalna bezbednost na Republika Makedonija 2008). Për mbështetjen e sigurisë kombëtare, sistemi i mbrojtjes i Republikës së Maqedonisë është aftësuar për mbështetjen dhe përmbushjen e misioneve strategjike (paragrafi 8 nga Bela kniga na odbranata 2012), si vijojnë):

- mbrojtja dhe siguria e integritetit territorial dhe pavarësia e Republikës së Maqedonisë;
- pjesëmarrja në mbrojtjen kolektive të NATO-së;
- kontribut në operacione të misioneve të spektrit të gjerë të OKB-së, NATO-s dhe BE-së;
- mbrojtja e interesave më të gjerë të Republikës së Maqedonisë.

Së këtejmi, qëllimet e politikës së mbrojtjes dhe sigurisë ndërlidhen me *anëtarësimin në NATO, me pjesëmarrjen në misionet e BE-së dhe NATO-s dhe me eliminimin e mundësisë për agresion.*

Nëse në të kaluarën ekzistonte balanci i sigurisë ndërmjet shteteve, Maqedonia në kuadrin e ngjarjeve të reja të sigurisë, që nga pavarësia nuk ka dyshime sa i përket zgjedhjes ndërmjet anëtarësimit në *NATO* dhe neutralitetit.⁵⁸ Maqedonia u përball me dy dilema të ndërlidhura mes vete. E para, nevoja e integritimit në BE nënkupton aprovimin e politikës së sigurisë si përgjigje ndaj sfidave të sigurisë. E dyta, anëtarësimi në *NATO* ofron siguri maksimale me shpenzime minimale sa i përket sovranitetit formal, për dallim nga BE e cila ofron një spektër më të gjerë të sigurisë, pa sigurimin e garancisë “ushtarake” për sigurinë dhe stabilitetin e shtetit. BE ofron zhvillim ekonomik dhe aprovimin e politikës së përbashkët të sigurisë. Edhe pse ka përjashtime megjithatë një pjesë e madhe e vendeve fillimisht anëtarësohen në *NATO* dhe pastaj në BE. *NATO* e garanton sigurinë që të mundet BE-ja të ketë kushte për realizimin e zhvillimit ekonomik dhe demokratik. Shikuar nga aspekti strategjik, ndërkaq duke e lënë anësh kontestin iracional me fqinjën, Maqedonia për faktin se kufizohet me pesë vende, nga të cilat tre janë anëtare të *NATO-s*, dy të BE-së, ndërkaq njëri vend tanimë një kohë të gjatë është në zonën e Shengen-it, ka rëndësi gjeostrategjike dhe potencial të madh për realizimin e ambicieve euroatlantike.

Anëtarësimi në *NATO* paraqet një përgjigje të shtetit për mënyrën se si ai zgjedh që të fitojë garanci për sigurimin e sigurisë dhe mbrojtjes së brendshme dhe të kontribuojë për ruajtjen e sigurisë ndërkombëtare në formë të solidaritetit ndërmjet shteteve në mbrojtjen e paqes në botë. Procesi i anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në *NATO* e hapi çështjen: *“Kush kujt i duhet më shumë, neve NATO-s ose NATO-ja neve?”*. Anëtarësimi në *NATO* nuk do të thotë vetëm privilegje për vendet anëtare por edhe obligime dhe shpenzime.

⁵⁸ Republika e Maqedonisë përcaktimin e saj për integrim në strukturat euroatlantike e definoi qysh në vitin 1993, kur Kuvendi i Republikës së Maqedonisë njëzëri e miratoi Rezolutën për Anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në *NATO* dhe të njëjtën përsëri e konfirmoi në vitin 2007 (Ministerstvo za nadvorešni raboti 2013).

Maqedonia për anëtarësimin në NATO nga buxheti i vet do të duhet të ndajë për çdo vit një shumë përafërsisht prej 1,3 milionë euro në nivel vjetor, kështu thonë përlogaritjet e Ministrisë së Mbrojtjes, ndërkaq nëse këtyre u shtohen paratë që këtë vit ndahen për misionet paqësore - 3,2 milionë euro, arrihet deri në shumën prej 4,5 milionë euro.

Shuma më e madhe do të ndahet për participimin e Maqedonisë në buxhetin e NATO-s, e cila vështirë mund të përcaktohet saktësisht dhe tani për tani është e panjohur për analiza. Ajo përlogaritet për çdo vit në mënyrë të veçantë dhe ndryshe. Në të sublimohen të dhënat e Bankës Botërore, përkatësisht përlogaritet raporti ndërmjet BPV, shportës së konsumatorit dhe lartësisë së buxhetit të mbrojtjes në buxhetin kombëtar.

(Srbnovski 2012)

Shpenzimet e shtetit kanë të bëjnë edhe me përfaqësuesit e selisë politike dhe ushtarake të Aleancës në Bruksel dhe me shpenzimet e nevojshme për realizimin e misionëve paqeruajtëse. Në buxhetin e NATO-s participojnë dy ministri: MPJ në buxhetin civil dhe Ministria e Mbrojtjes në buxhetin ushtarak dhe në programin e NATO-s për investime në siguri (NSIP).⁵⁹

Krahas mendimit se anëtarësimi në sistemet kolektive të sigurisë rezulton me më shumë obligime sesa përfitime, megjithatë anëtarësimi i vendeve më të vogla kontribuon në drejtim të garantimit të vlerave themelore, por edhe në drejtim të garancive plotësuese për realizimin e beneficioneve ekonomike. Anëtarësimi ofron siguri për investime të huaja dhe është një faktor i rëndësishëm në kalkulimet strategjike të kompanive transnacionale. Anëtarësimi në NATO në masë të madhe i përmbush qëllimet e politikës së sigurisë dhe mbrojtjes dhe njëkohësisht paraqet çelës për zgjidhjen e tensioneve të brendshme ndëretnike dhe për pengimin e ndikimeve destabilizuese të jashtme.

⁵⁹ Kriteret më të rëndësishme në përcaktimin e lartësisë së kontributeve kombëtare në NATO-buxhetet janë fuqia ekonomike dhe numri i popullsisë së shteteve, ndërsa si bazë kryesore e të dhënave kanë shërbyer numrat e Bankës Botërore. Në pjesën civile të thesarit të Aleancës, shteti përmes MPJ do të merrte pjesë me përafërsisht 200.000 euro në vit, ndërsa për periudhën e njëjtë kohore në Sektorin Ushtarak, përmes Ministrisë së Mbrojtjes i janë ndarë përafërsisht 700.000 euro. Kësaj shume do t'i shtohen edhe financat të cilat do të varionin nga 100.000 deri më 300.000 euro, të cilat do të dedikoheshin për NATO-Programin për Investime në Siguri dhe resorët e tjerë të sigurisë (Srbnovski 2012).

Realizimi i politikës së sigurisë dhe mbrojtjes, në kuadër të pjesëmarrjes së forcave të sigurisë në operacionet paqeruajtëse përputhet me pjesën operative të politikës së jashtme të sigurisë. Pjesëmarrja e forcave maqedonase të sigurisë mbështetet në kornizën ligjore të vitit 1995 (e cila i rregullon marrëdhëniet ndërmjet Maqedonisë dhe NATO-s në kuadër të Partneritetit për Paqe) dhe në statusin e fituar të kandidatit në vitin 2005 (me të cilin rregullohen marrëdhëniet ndërmjet Maqedonisë dhe BE-së). Në bazë të anëtarësimit me të drejta të plota, Maqedonia (edhe pse tani për tani vetëm në mënyrë simbolike) merr pjesë në misionet ushtarake dhe civile të OKB-së dhe OSBE-së. Fillimet e veprimit operativ të forcave maqedonase të sigurisë jashtë vendit ndërlidhen me fillimet e pjesëmarrjes së forcave të armatosura maqedonase në misionin në Irak (2003), ndërsa në fund të vitit 2013 forcat maqedonase të sigurisë marrin pjesë në misionet e BE-së dhe NATO-s në Bosnjë dhe Hercegovinë, përkatësisht në Afganistan.

Në përputhje me dokumentet strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes, Maqedonia, për kontributin e saj në operacionet e udhëhequra nga NATO, BE dhe OKB, e ka deklaruar obligimin se do të zhvillojë dhe ruaj aftësi shpërndarëse në nivel prej 50% të strukturës së përgjithshme të forcave tokësore të ARM-së. Me kërkesë të NATO-s, si kontribut të vetin, ARM-ja do të shpërndajë forcë maksimale ushtarake në nivel të një grupi të batalionit të mesëm të këmbëtorisë dhe në nivel të elementit kombëtar për mbështetje. Sa i përket kontributit afatgjatë në operacionet ndërkombëtare, njëkohësisht do të marrim pjesë me njësite dhe personel ushtarak i cili gradualisht do të rritet me së paku 8% nga struktura e përgjithshme e forcave tokësore të ARM-së, në përputhje me dinamikën e zhvillimit të aftësive shpërndarëse (pika 5 nga Kapitulli III Misioni Strategjike të Sistemit të Mbrojtjes përfshirë në Strategjia za odbrana na Republika Makedonija 2010). Pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse nënkupton përfshirjen e njësiteve dhe aftësive të Armatës, si vijojnë (Ministerstvo za odbrana 2011: 16):

- Një batalion i mesëm i këmbëtorisë i cili do të zhvillohet në mënyrë progresive në grup batalioni të mesëm të këmbëtorisë;
- Një helikopter detashment;
- Një çetë e policisë ushtarake;

- Një çetë për vëzhgim të thellë;
- Një tog inxhinierie;
- Një tog inxhinierie për deminim;
- Një spital i lëvizshëm i nivelit 2; (MTF Role 2) dhe
- Dy skuadra për luftë kundër-terrorizmit.

Megjithatë, nga aspekti i gjendjeve aktuale të marrëdhënieve me NATO-n, pjesëmarrja në misione duhet të korrespondojë me interesat shtetërorë, duhet të ekzistojë balancë ndërmjet kontributit të Maqedonisë dhe nevojave të partnerëve strategjikë, qëllimet e misionit duhet të jenë të qëndrueshme dhe së paku nga aspekti kohor çdo mision duhet të përcaktohet dhe të ketë strukturë transparente me kompetenca paraprakisht të precizuara të forcave maqedonase të sigurisë në kuadër të misionit.

Republika e Maqedonisë për herë të parë paraqiti Rezolutë për Anëtarësim në BE në vitin 2004. Në vitin 2005, Maqedonia e fitoi statusin e kandidatit për anëtarësim në BE dhe obligimet që t'i harmonizojë qëllimet e politikës së sigurisë me politikën dhe strategjinë e sigurisë së BE-së. Shteti u bë pjesë e takimeve të Trojkës së BE-së në mbrojtje, në takimet joformale të ministrave të mbrojtjes ose në Këshillin për Punë të Përgjithshme dhe Marrëdhënie me Jashtë (GAERC) dhe në takimet e Komitetit Ushtarak të BE-së, ndërsa në kuadër të veprimit operativ, harmonizimi me politikën dhe strategjinë e sigurisë së BE-së nënkupton pjesëmarrje në misionet ushtarake dhe civile të BE-së. Me zhvillimin e marrëdhënieve me BE, Republika e Maqedonisë për të parën herë, në muajin maj të vitit 2006, e deklaroi kontributin e vet në drejtim të përforcimit të kapaciteteve ushtarake të BE-së (në përputhje me Qëllimin Kryesor 2010) dhe më vonë Armata e Republikës së Maqedonisë u bë pjesë e operacioneve ushtarake të BE-së për menaxhimin me kriza.⁶⁰ Republika e Maqedonisë, në tetor të vitit 2006, e përmbushi edhe obligimin për deklarimin e kontributit të vet në drejtim

⁶⁰ Më 29.10.2012 u nënshkrua Marrëveshja ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së për inkuorimin e kornizës për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë në operacionet e BE-së për menaxhim me kriza. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje kontribuoi për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve partnere në kuadër të Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë të BE-së, në të cilën Maqedonia kontribuon në mënyrë aktive përmes pjesëmarrjes në disa operacione paqeruajtëse të udhëhequra nga BE-ja, si dhe në zhvillimin e kapaciteteve të veta luftarake (Ministerstvo za nadvorešni raboti 2013a).

të përforcimit të kapaciteteve civile të BE-së (në përputhje me Qëllimin Kryesor).⁶¹ Përmes komunikimit formal në nivel strategjik të cilin e udhëheqin përfaqësuesit më të lartë të mbrojtjes dhe diplomacisë, vendi fitoi mundësi në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndikojë në realizimin e qëllimeve strategjike të specifikuara me politikën kombëtare të sigurisë. Marrë në përgjithësi, harmonizimi i qëllimeve të politikës së sigurisë është një proces në të cilin janë përfshirë institucionet e sigurisë së BE-së dhe kjo ofron mundësi për promovimin e kapaciteteve vendase në planin ndërkombëtar. Republika e Maqedonisë duhet t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë të cilat rezultojnë nga statusi i kandidatit dhe nga politikat e BE-së për bashkëpunim me vendet e treta.

Nga muaji korrik i vitit 2006, në bazë të vendimeve të Kuvendit, Maqedonia merr pjesë në operacionin ushtarak të BE-së në Bosnjë e Hercegovinë ALTEA (ALTHEA). Kjo pjesëmarrje vazhdoi edhe në vitin 2013, me 11 persona (10 persona në ekipin mjekësor dhe një person ndihmës këshilltar juridik në Zyrën Juridike të Komandës së EUFOR-it). Në bazë të përcaktimit të deklaruar për pjesëmarrje në grupe luftarake (GL) të BE-së, në gjysmën e dytë të vitit 2012, Republika e Maqedonisë merr pjesë në grupin luftarak BE LG II/2012, në të cilin merr pjesë Gjermania (vend lider), Austria, Çekia, Irlanda dhe Kroacia. Kontingjenti kombëtar numëron 150 persona personel ushtarak me këtë përbërje: një çetë e këmbësorisë, personel të shtabit në komandën e forcave, skuadër e përbashkët për MABK, ekip për zbulim, teknikë mjekësor në çetën mjekësore Niveli-1 dhe elementi kombëtar për mbështetje. Kontingjenti është në gatishmëri të plotë për shpërndarje gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012, nëse për një gjë të këtillë do të ketë nevojë, si dhe të miratohen vendime përkatëse në nivel të BE-së dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (Ministerstvo za nadvorešni raboti 2013a).

Në bazë të përvojave të Republikës së Maqedonisë në misionet ndërkombëtare, ekspertët e huaj dhe përfaqësuesit zyrtarë i kanë kualifikuar forcat maqedonase të sigurisë: si forca të armatosura me mbështetje dhe respekt të lartë nga publiku, bazohen në kontroll demokratik, të përbëra nga persona që i janë

⁶¹ Janë deklaruar gjithsej 51 persona në kuadër të pesë fushave: policia 15, sundimi i së drejtës 16, administrata publike 8, mbrojtja civile 8 dhe monitorimi 4.

besnik shtetit të vet dhe profesionit dhe janë trajnuar dhe motivuar në mënyrë përkatëse (Unkovska 2012; Vrencovska 2010; Televizija Sitel 2013). Këto lloje të evaluimit ndërkombëtar janë të dobishme për krijimin e orientimeve strategjike në zhvillimin dhe avancimin e forcave të sigurisë.

Si rezultat i përcaktimeve strategjike të shtetit dhe progresit të tij në integrimet euroatlantike, Maqedonia në fund të vitit 2013 është anëtare e Partneritetit për Paqe të Grupit të Adriatikut dhe në mënyrë aktive merr pjesë në misionet e NATO-s dhe BE-së. Nëse tejkalohet kontesti me emrin është fakt se implikimet nga anëtarësimi me të drejta të plota në NATO do të ishin më të rëndësishme për shtetin. Shteti, përveç mbrojtjes tradicionale në mesin e anëtareve të Aleancës dhe benefitit ekonomik, me anëtarësimin në NATO drejtpërdrejtë do të përfshihet në aktivitetet që kanë të bëjnë me menaxhmentin e krizës në Rajonin euroatlantik.

Politika ekonomike e sigurisë është e rëndësishme sa u përket çështjeve që kanë të bëjmë me sigurinë, me ç'rast stabiliteti i demokracisë maqedonase duhet të vendoset mbi baza të fuqishme ekonomike dhe civilizuese, të cilat sigurojnë mjete për politikë efektive të sigurisë dhe e përforcojnë reputacionin e shtetit përmes rritjes së stabilitetit dhe identitetit shtetëror. Qëllimet afatgjata të Maqedonisë duhet të jenë të afërta me shtetet e zhvilluara të BE-së në aspekt të mundësive ekonomike. Instrumentet e politikës së sigurisë, në këtë fushë, kanë për qëllim ta rrisin konkurrencën ekonomike të shtetit dhe të subjekteve të tij ekonomik, të kontribuojnë për stabilitetin financiar dhe të çmimeve dhe t'i bashkojnë kapacitetet e ekonomisë dhe shoqërisë. Rëndësia e politikës ekonomike të sigurisë pasqyrohet në efektet e saj gjatë ndërtimit të vizionit afatgjatë dhe strategjisë së përkufizuar për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve në bazë ekonomike. Ky është rezultat i marrëdhënieve të përditshme shoqërore dhe interaksionit të të dy grupeve më të mëdha etnike në fushën e ekonomisë.

Politika e sigurisë për mbrojtjen e mjedisit jetësor është çështje e cila bëhet gjithnjë e më aktuale për shkak të garës për profit dhe prestigj në ekonomi. Profiti, i cili është imperativ për subjektet ekonomike, paraqitet si shkak për ndotjen e mjedisit jetësor, ndërsa në mënyrë plotësuese ndikon edhe mbi ndryshimet

klimatike që kanë të bëjnë me mbijetesën e Planetit dhe e përcakton rëndësinë strategjike të resurseve natyrore (para së gjithash të ujit) në marrëdhëniet gjeopolitike. Në Maqedoni, krahas inkorporimit të legjislacionit evropian, çështja e krimit ekologjik akoma nuk e fiton rëndësinë e mirëfilltë.

Struktura organizative e tre nënsistemeve të përfshirë me **strukturat e sigurisë** në mënyrë më të qartë i përcakton kompetencat e tyre. Së këtejmi, pjesa e sigurisë është dedikuar për sigurimin e sigurisë kombëtare nga të gjitha format e jashtme të cilat ndikojnë mbi rrezikimin e sigurisë – luftëra ndërshtetërore, agresion i armatosur, intervenime ushtarake dhe humanitare dhe konflikte të armatosura ndërkufitare. Me këtë strukturat e sigurisë bëhen kyç për operacionalizimin e aktiviteteve të parashikuara me politikën e sigurisë. Policia është e ngarkuar për punët e brendshme dhe është promotor në bashkëpunimin ndër-agjencial midis institucioneve kombëtare të ngarkuara për zbatimin e ligjeve, ndërsa elementi i tretë është vendosur në një bazë relativisht të re dhe e përfaqëson pjesën në të cilën sistemi i sigurisë në të ardhmen do të duhet të investojë shumë.

Vetorganizimi i sigurisë së shoqërisë civile nënkupton organizim spontan por megjithatë të organizuar mirë dhe të orientuar si vetorganizim dhe veprim të sigurisë dhe mbrojtjes së individëve, por edhe të formave dhe shkallëve të ndryshme të vetorganizimit të sigurisë të grupeve shoqërore (grupe interesi, bashkësi lokale në nivel të vetëqeverisjes lokale), vetorganizim i sigurisë të individëve dhe grupeve shoqërore në çdo kohë, në çdo vend dhe në të gjitha nivelet e shoqërisë si digë për mbrojtje nga të gjitha format e rrezikut, fillimisht të sigurisë së tyre individuale (njerëzore) (Kotovčevski 2012: 33). Element kryesor për zbatimin e vetorganizimit të sigurisë të shoqërisë civile është krijimi i kulturës së sigurisë, si mënyrë për identifikimin e kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj sigurisë në shoqëri, si dhe për ndërgjegjësimin për ballafaqimin me rreziqet. Baza e vetorganizimit të sigurisë në kontributin aktiv të bashkësisë (i cili e nënkupton specifikimin e rolit të tij, obligimet dhe përgjegjësitë) në aktivitetet e orientuara për ruajtjen e sigurisë përmes ndërtimit të bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe bashkësisë lokale dhe sistemit të sigurisë në kuadër të Platformës së Sigurisë Kombëtare. Në punën e policisë, vetorganizimi i sigurisë

justifikohet me tezën për humanizëm dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve (Stojanovski 2006: 22). Esenca e tij, kur bëhet fjalë për parandalimin dhe ballafaqimin me krimin, bazohet mbi parimin e partneritetit në të cilin qytetarët kanë rol aktiv në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre bashkë me policinë. Koncepti e nënkupton ndërtimin e marrëdhënies së dyfishtë të varësisë ndërmjet të drejtave dhe obligimeve, përkatësisht përcaktimin e përbashkët të prioriteteve të sigurisë në bashkësinë lokale, pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në identifikimin e kërcënimeve ndaj sigurisë dhe aktivitete më të mëdha gjatë realizimit të gjendjes stabile të sigurisë. Teza e apostrofon policinë si lider gjatë realizimit të konceptit, përkatësisht prej saj pritët që me sjelljen e vet të jetë shembull, ta udhëheq dhe orientojë këtë marrëdhënie.

Pjesëmarrje e shtetit në organizata ndërkombëtare dhe të mbrojtjes paraqet një qasje relativisht të re në shfrytëzimin e kapaciteteve të sigurisë. Qasja është inkorporuar në politikën e mbrojtjes dhe në politikën e jashtme të sigurisë së Republikës së Maqedonisë. Pjesëmarrja në organizatat ndërkombëtare dhe në misionet strategjike të mbrojtjes, si pjesë të politikës së mbrojtjes, e përcaktuar në Strategjinë e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë (pika 3 nga Kapitulli IV. Zhvillimi i sistemit të mbrojtjes i përfshirë në Strategjia za odbrana na Republika Makedonija 2010), në përgjithësi parashikon:

- Zhvillimin e aftësive për mbrojtjen e vendit;
- Avancimin e mekanizmave të kontrollit demokratik dhe civil mbi ARM dhe përdorimin e saj në funksion të qëllimeve të politikës së jashtme;
- Zhvillimin e kapacitetit të MM për menaxhimin efikas me resurset dhe proceset e mbrojtjes;
- mbindërtimin, zhvillimin dhe ruajtjen e aftësive ushtarake të ARM-së;
- integrimin në strukturën politike, mbrojtëse dhe ushtarake të NATO-s;
- përfshirjen dhe kontributin në politikën evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes;
- kontributin e vazhdueshëm në operacionet ndërkombëtare për mbështetjen e paqes dhe sigurisë.

6.2 Ballafaqimi me sfidat e sigurisë

Çështje kyç në Republikën e Maqedonisë gjatë zbatimit të politikës vendase të sigurisë edhe më tutje do të mbetet: *“Si të ruhet identiteti dhe vlerat kushtetuese të shtetit (veçanërisht kërcënimet mbi integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë), ndërkaq të ndërpriten të gjitha lëvizjet separatiste dhe ekstremiste dhe ndikimi nga jashtë?”*. Këto janë probleme me të cilat ballafaqohen edhe shtete më të mëdha me përbërje etnike më komplekse, mirëpo në rastin e Republikës së Maqedonisë duhet të merren parasysh veçoritë të cilat rezultojnë nga gjendja e sigurisë dhe nga sfidat e sigurisë së shtetit. Qasja në zgjidhjen e çështjeve të sigurisë nënkupton ndërtim të mikorstrategjive për një ballafaqim të caktuar me çdo sfidë sigurie që do të jenë në korrelacion të ngushtë për shkak të shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore dhe materiale të sigurisë. Së këtejmi, është gabim të flitet për unifikimin e modelit (të qasjes dhe të masave) të politikës së sigurisë gjatë ballafaqimit me kërcënimet ndaj sigurisë, për shkak të etiologjisë dhe fenomenologjisë së tyre të ndryshme të kërcënimeve ndaj sigurisë në Republikën e Maqedonisë. Prandaj specifika e kërcënimeve ndaj sigurisë konsiston me atë që zbatimi i politikës së sigurisë të shqyrtohet nga aspekti i shfrytëzimit të mundësive të politikës së sigurisë për **ballafaqimin me potencialin e konfliktit ndëretnik** dhe për **ballafaqimin me rreziqet e tjera ndaj sigurisë**.

6.2.1 Ballafaqimi me potencialin e konfliktit të armatosur ndëretnik

Konflikti etnik për Republikën e Maqedonisë është specifik për shkak të gjendjeve të cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet e brendshme ndëretnike, të cilat karakterizohen si më të ndjeshme për sigurinë dhe stabilitetin e shtetit. Konflikti ndëretnik, si kërcënim më serioz ndaj sigurisë së shtetit, paraqet bazë mbi të cilën duhet të krijohet politika e sigurisë kombëtare. Prandaj, tejkalimit të tensioneve ndëretnike, si faktorë thelbësor për shkakimin e konfliktit, i përkushtohet më shumë vëmendje në drejtim të konceptimit të politikës së sigurisë.

Ballafaqimi me konfliktin ndëretnik është materie komplekse e cila bazohet mbi:

- identifikimin e më shumë indikatorëve me të cilët identifikohen treguesit dhe aktorët/palët kryesore
- përdorimin e mekanizmave për parandalimin e konflikteve.

Nëse politika e sigurisë është projektuar mbi bazë të dinamikës së konfliktit potencial, atëherë për konceptimin e saj domosdoshmërisht duhet të identifikohen grupet ose personat të cilët e përkeqësojnë gjendjen, të cilët kanë për qëllim ta qetësojnë konfliktin dhe ata të cilët bëjnë përpjekje ta promovojnë jo dhunën dhe paqen. Së këtijmi, me rëndësi të veçantë është të jepet përgjigje në pyetjet të cilat mund të ndihmojnë në drejtim të identifikimit dhe profilin të pjesëmarrësve në aspekt të pozicionit të tyre, interesit, fuqisë, sjelljeve dhe dobësive (Anderlini & Stanski 2004: 7-8):

- ⇒ Kush/Çka është pjesëmarrës ose bartës, përfshirë edhe burimin e tij të mbështetjes/legjitimitetit?
- ⇒ Në çfarë niveli ata janë më aktivë dhe më efikas (ndërkombëtar, shtetëror, rajonal ose lokal)?
- ⇒ A janë ata përfaqësues nga pjesë të ndryshme të bashkësisë (përfshirë edhe grupet e marginalizuara)?
- ⇒ Cilat janë kërkesat e tyre, nevojat e tyre dhe frika e tyre?
- ⇒ Çfarë fuqie/mjete/kapacitete posedojnë?
- ⇒ Me kë janë të lidhur ose kush ndikon mbi ta?
- ⇒ A kanë vizion për paqe? Çka përfshin vizioni i tyre (për shembull: autonomi, bashkëjetesë, reformë territoriale etj.)?

Element kyç në kuptimin e kontekstit dhe të rrethanave të konfliktit paraqet aftësia e leximit të shenjave dhe indikatorëve paralajmërues për tension ose dhunë të rritur. Në bazë të identifikimit të tyre mund të zbatohet programi për paralajmërimin e hershëm të konfliktit. Nga ana tjetër, indikatorët i tregojnë gjendjet në lidhje me sigurinë e njerëzve (fizike, ekonomike, politike dhe ngjashëm), me çështjet politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe me çështjet ushtarake (veçanërisht që kanë të bëjnë me mobilizimin e grupeve), me çështje rajonale dhe gjeopolitike, me çështje gjyqësore dhe ligjore.

Indikatorët mund të ndahen në katër kategori të ndërlidhura mes vete (Anderlini & Stanski 2004: 4-5, ekstrakt):

- *Indikatorë sistemorë*: gjendje më të theksuara fundamentale, strukturore dhe gjendje të rrënjosura thellë në shoqëri;⁶²
- *Indikatorë të drejtpërdrejtë*: ngjarje, situata dhe tendenca të shprehura afatmesme;⁶³
- *Kuptime të drejtpërdrejta ose trigger*:⁶⁴ ngjarje (raste) të vështira për t'i parashikuar por, në kombinim me indikatorë sistemor dhe të drejtpërdrejtë, mund ta aktivizojnë dhunën⁶⁵ dhe
- *Indikatorë paqësorë*: faktorë të cilët e promovojnë paqen dhe jo dhunën.⁶⁶

Analiza e indikatorëve mundëson që më mirë të kuptohet mjedisi dhe rajoni i konfliktit për shkak të përcaktimit të aksioneve korrektuese. Ato duhet të jenë të shpejta dhe operative nëse bëhet fjalë për parandalimin e drejtpërdrejtë (për shembull, gjatë shpërndarjes së paqeruajtësve) ose nëse konstatohet nevoja për aplikimin e parandalimit strukturor me qëllim të përcaktimit të shkaqeve kryesore të konfliktit për një periudhë kohore më të gjatë. Shpeshherë, zgjidhja paraqet kombinimin e të dyjave.

“Mungesa e kulturës”⁶⁷ së parandalimit u tregua si një nga indikatorët kryesorë para fillimit të konfliktit të armatosur në vitin

⁶² Në Amerikën Latine kishte dallim enorm midis pakicës së pasur, e cila posedonte pjesën më të madhe të vendit, dhe të varfërve. Dallimet ekonomike ishin burim kyç për pakënaqësi dhe konflikt. Shembuj të tjerë për indikatorë sistematik janë dominimi afatgjatë ose sundimi ushtarak ose dominimi shoqëror dhe ekonomik i një grupi etnik mbi tjetrin.

⁶³ Në Ruandë, dy vjet para gjenocidit, grupet ekstremiste Hutu e shfrytëzonin radion për përhapjen e propagandës dhe mesazheve me urrejtje kundër fisit Tutsi dhe pjesëtarëve të prudent të Hutu. Shembuj të tjerë si indikatorë të afërt janë: formimi i policive, rritja e pakënaqësisë publike, inflacioni i lartë, rritja e dhunës mbi një minoritet të caktuar etnik ose fetar dhe shkalla e lartë e papunësisë.

⁶⁴ Definim tjetër i triggerëve është se ata paraqesin ngjarje ose incidente të cilat vënë në pah se faktorët strukturorë ose dinamikë kanë krijuar gjendje e cila ka ardhur në fazë kur vetë triggeri e shfrenon krizën ose tanimë paraqet fazë të paralajmërimit të vonuar.

⁶⁵ Në Ruandë, rrëzimi i avionit të Presidentit ishte trigger për gjenocidin e vitit 1994. Shembujt e tjerë i përfshijnë mashtrimet zgjedhore, rritjen e menjëhershme të çmimeve të të mirave elementare, burgosjet politike dhe sulmet mbi demonstratat e qeta qytetare.

⁶⁶ Në Afrikën e Jugut, para përfundimit të Aparteidit, me çdo sulm të policisë mbi demonstruesit ose sulmeve guerile ndaj caqeve civile rriteshin tensionet. Në raste të këtilla, apeloni për qetësi dhe braktisjen e metodave të dhunshme.

⁶⁷ Përmendet në Raportet e Punës së OKB-së të përpiluara nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, të publikuara më 3.9.1997 dhe më 31.8.1999 (UN Docs. A/52/1 i A/54/1).

2001, i cili kishte të bënte me marrëdhëniet e çrregulluara ndëretnike. Për gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike, si burim potencial i konflikteve, paraprkasht alarmoi UNDP-ja dhe OSBE-ja në *Raportet për paralajmërim të hershëm*, mirëpo autoritetet politike nuk i përkushtuan rëndësi adekuate domethënies së raporteve. Kundrejt mundësisë që të merren parasysh këta indikatorë serioz, autoritetet politike si më adekuate e imponuan nevojën për fillimin e konfliktit, në formë të ideologjisë politike të bazuar mbi etnonacionalizmin.⁶⁸

Së këtëjmi, indikatorë kryesorë, gjatë zbatimit të pjesës së politikës kombëtare të sigurisë që ka të bëjë me avancimin e potencialit të konfliktit të armatosur ndëretnik, janë:

- *efektet e integritimeve të bllokuara euroatlantike mbi sigurinë e shtetit,*
- *ndikimet politike mbi gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike dhe*
- *jostabiliteti politik.*

Të tre indikatorët janë nën ndikim të fuqishëm të gjendjeve politike në vend. Sistemi i sigurisë, si bartës kryesor i aktiviteteve operative të politikës së sigurisë, i bazuar mbi strategji paraprkasht të përcaktuara të sigurisë, thjesht mund të ndikojë mbi procesin e vendimmarrjes për menaxhimin me rreziqet etnike, politike dhe ushtarake – si rreziqe të cilët në vete kryesisht i përmbajnë indikatorët politikë. Indikatorët vënë në dukje atë se autoritetet politike duhet ta bartin barrën më të madhe gjatë ballafaqimit me sfidat e sigurisë, ndërkaq kjo veçanërisht ka të bëjë me sfidën e përgjegjësisë lidhur me potencialin për shfaqjen e konfliktit të armatosur të brendshëm ndëretnik. Në përgjithësi, përgjegjësia e autoriteteve politike gjatë ballafaqimit me potencialin e konfliktit ndëretnik, si qëllim thelbësor të politikës kombëtare të sigurisë, nënkupton kontinuitet dhe gjithëpërfshirje gjatë projektimit të vlerësimeve të sigurisë dhe rekomandimeve lidhur me përmirësimin e kornizës ligjore të sigurisë dhe aftësive e kapaciteteve operative të sistemit të sigurisë. Në bazë të analizës së të tre indikatorëve, ata tregojnë se disa gjendje të caktuara në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë mbi jostabilitetin politik, siç janë:

- Manipulime dhe ndikime politike mbi sistemin e sigurisë (për

⁶⁸ Nacionalizmi i bazuar mbi ideologji politike paraqet proces destruktiv në formën e kërcënimit etno-politik.

shembull, aferat me përgjimin 1992-2001);

- Politizimi vs Profesionalizimi i sistemit të sigurisë;
- Shfrytëzimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit si burim i marrëveshjeve politike;
- Mungesë e përkufizimit afatgjatë të interesave dhe prioriteteve të popullit maqedonas në shtetin e vet;
- Lojëra destruktive politike me interesat e popullit maqedonas (për shembull, Ligji për ndarje territoriale - 2004)

Po ashtu, të tre indikatorët kanë të bëjnë me tezën se *"Shumica e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë janë të bindur se integrimi në strukturat euroatlantike do të thotë garanci dhe sigurim të stabilitetit dhe sigurisë në Republikën e Maqedonisë, ndërkaq me këtë do të ndikohet mbi përforcimin e bashkëjetesës ndëretnike ndërmjet qytetarëve, veçanërisht ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve."*

Indikatorët vënë në pah disa gjendje, të cilat kanë ndikim mbi marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni, siç janë:

- Nuk perceptohen seriozisht kërcënimet të cilat vënë në dukje ekzistimin e islamit radikal, grupeve terroriste ose kërcënimeve me federalizim/shkëputje të një pjese të Maqedonisë.
- Ekziston mungesë e represionit penal – juridik për vepra të cilat politikisht janë inskenuar dhe janë në funksion të çrregullimit të marrëdhënieve ndëretnike në shtet.
- Ekziston tolerancë e madhe për kryerësit e veprave penale kundër shtetit.
- Shpeshherë paraqitet nevoja e involvimit të palës së tretë për qetësimin e tensioneve ndëretnike.

Sokalski dallon tre grupe të **mekanizmave** për parandalim dhe zgjidhje të konflikteve si pjesë të instrumenteve të cilat i ofron OKB-ja (Sokalski 2005: 51, ekstrakt). *Grupi parë* buron nga institucionet brenda kuadrit të OKB-së (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Sigurisë, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, i determinojnë mekanizmat kryesorë global për parandalimin e konflikteve⁶⁹). Organet e gjykatës penale

⁶⁹ Më shumë detaje lidhur me rolin parandalues të organeve kryesore të KB-së ka në Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm Kofi Anan, Prevention of Armed Conflict, UN Doc. A/55/985-S/2001/574 nga 7.6.2001.

janë organe të reja në kuadër të OKB-së, ndërsa janë formuar si rezultat i konflikteve të cilat ndodhën në hapësirat e ish Jugosllavisë dhe në Ruandë. Krahas asaj se puna e tyre bazohet mbi parimin e drejtësisë, rezultatet e proceseve gjyqësore dëshmuar se sa ato janë nën ndikimin e fuqishëm të politikës ndërkombëtare. Presionet nga fuqitë e mëdha, në procedurën e marrjes së vendimeve përfundimtare, e zvogëluar kredibilitetin e gjykatës. *Grupi i parë* i mekanizmave për zgjidhjen dhe parandalimin e konflikteve linin përshtypje se ato janë më efikas në zgjidhjen e konfliktit ndërshtetëror sesa konfliktit të brendshëm. *Grupi i dytë* është pjesë e mekanizmave parandalues global dhe bazë e tij janë instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga anëtarët e OKB-së. Zbatimi i tyre është obligim për vendet dhe përmbajnë klauzolë për kontroll apo me instrumentet parashikohen organe të veçanta në përbërje të organizatës të cilat i shqyrtojnë dhe analizojnë raportet kombëtare dhe japin rekomandime deri te organet më të larta për ndërmarrjen e aksioneve të mundshme. Në këto instrumente bëjnë pjesë të dy paktet ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut dhe një numër i madh konventash dhe deklaratash të miratuara në kuadër të/ose me ndërmjetësimin e OKB-së. Struktura komplekse, interesat e përziera të shumanshme në organizatën botërore dhe mungesa e vullnetit tek një numër i caktuar i vendeve për ratifikimin dhe implementimin e instrumenteve, paraqesin frenim të funksionimit të tyre real. *Grupi i tretë* i mekanizmave janë rezultatet nga konferencat e shumta, punëtoritë, simpoziumet dhe kongreset e organizuara nga OKB. Ky grup i mekanizmave u jep rekomandime vendeve në formë të propozimeve për tejkalimin dhe parandalimin e konflikteve.

Në zhvillimin historik të Republikës së Maqedonisë mund të identifikohen mekanizma të caktuar për parandalimin e konflikteve në formë të zgjidhjeve dhe modifikimeve të tyre. Zgjidhjet vendase bazohen mbi:

- *formimin e koalicioneve ndëretnike,*
- *përdorimin e instrumenteve të Donald Harovic dhe Arent Lijphart,*
- *mbështetjen e dialogut dhe besimit, dhe*
- *mekanizmat politiko-juridikë për reduktimin dhe zgjidhjen e konflikteve etnike,*
- *mekanizma të tjerë për ballafaqimin me konflikte.*

Instrumentet e lartpërmendur kryesisht shërbejnë për parandalimin e konflikteve në shoqëritë e ndara në baza etnike.

Formimi i koalicioneve ndëretnike në shoqërinë maqedonase daton që nga fillimet e sistemit shumë-partiak në shtet, në vitin 1990, fill para pavarësimit të Republikës së Maqedonisë nga ish Jugosllavia. Koalicionet ndëretnike përballen me besim të kufizuar ndërmjet partnerëve të koalicionit e që rezultojnë me probleme periodike në nivel strategjik, politik dhe në nivel teknik. Në shoqëritë thellësisht të ndara etnike me elektorat të ndarë dhe me parti politike të fokusuara kryesisht mbi interesin etnik, koalicionet ndëretnike vështirë mund t'i arrijnë qëllimet e përbashkëta politike. Rezultatet që konsiderohen si të suksesshme për njërin nga partnerët, mund të jenë utopike për partnerin tjetër, për shkak të kërkesave dhe interesave divergjente të grupeve politike. Koalicionet ndëretnike karakterizohen me atë që në kontinuitet kanë tensione të brendshme – ndërmjet partnerëve të koalicionit për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e një identiteti të caktuar etnik.

Përvojat e Republikës së Maqedonisë me bashkësinë ndërkombëtare, në fushën e parandalimit të konflikteve, kryesisht mbështeten mbi zbatimin e konceptit të OKB-së për diplomaci parandaluese dhe mbi konceptet për parandalimin e konflikteve të ofruara pas konfliktit të vitit 2001 (të integruara në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit me prezencën ndërkombëtare të forcave të sigurisë, të BE dhe NATO) të cilat përmbajnë zgjidhje që rezultojnë në mekanizmat e Donald Horovic dhe Arent Lijphart për parandalim afatgjatë të konflikteve etnike në shoqëri multietnike (Taševska Remenski 2009: 232-238). Marrëveshja Kornizë e Ohrit bazohet mbi përvojat botërore të ndërlydhura me shumë shembuj për tentativa të suksesshme dhe më së shpeshti me tentativa të pasuksesshme për menaxhimin me shtete multietnike (Galtung 1996: 61 - 68; McGarry & O'Leary 1993: 4-38, Smooha & Hanf 1996: 326-332; Berghe 1987: 83-236.) të cilat janë të dobishme gjatë analizës së masave të politikës së sigurisë. Marrëveshja e ka formën e modelit kushtetues për ballafaqimin me konfliktet etnike.

Më shumë se një dekadë, pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, akoma është e hapur pyetja: "A fitoi Maqedonia një model të veçantë i cili përkon me rrethanat e shtetit?". Në drejtim të shpjegimit të strukturës dhe qëllimit të Marrëveshjes, janë përvojat

rajonale që kanë të bëjnë me ndikimin ndërkombëtar për arritjen e modelit të kontraktuar kushtetues. Kronologjikisht, arritjes së Marrëveshjes i parapriu Marrëveshja e Dejtonit (1995) e cila kishte të bënte me kornizën kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinën, ndërsa në vitin 2007 për zgjidhjen e statusit të Kosovës u propozua Plani i Marti Ahtisarit (Glas javnosti 2013), i cili paraqet pikënisje në negociatat ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Kryesisht, pranimi i modelit universal për zgjidhjen e konflikteve në Ballkan, që në fillim u konstatua se nuk është zgjidhje adekuate për problemet e vërteta në shtetet e prekura. Kështu, duke u nisur nga multietniciteti, si problem për funksionimin e shtetit dhe nga aspekti i manifestimit të tij mbi rrethanat rajonale të sigurisë, kjo konsiston me atë që Marrëveshja Kornizë e Ohrit bashkë me Marrëveshjen për Bosnjë e Hercegovinën dhe Kosovën të paraqesin modele specifike për zgjidhjen e konflikteve ndëretnike në Ballkan.

Gjendjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndëretnike dhe implementimin e Marrëveshje Kornizë të Ohrit, të cilat drejtpërdrejtë e karakterizuan periudhën postkonfliktuale paraqesin qasje specifike të bashkësisë ndërkombëtare në zgjidhjen e problemeve të brendshme të një shtetit të pavarur sovran. Frustrimi i bashkësisë ndërkombëtare ndaj maqedonasve sikur e verbëroi për problemet strukturore me Marrëveshjen e Ohrit: se ajo u siguron siguri shqiptarëve me çmim të drejtpërdrejtë ndaj ndjenjës së sigurisë të maqedonasve, duke vendosur sfidë unike para shumicës kombëtare të shtetit.⁷⁰ Me Marrëveshjen u arrit reduktimi proporcional i pushtetit administrativ maqedonas (duke ia lënë pushtetin qendror pushtetit lokal) dhe pushtetit ligjvënës (duke u dhuruar shqiptarëve pseudo-veto në zgjedhjen e gjyqtarëve, në nxjerrjen e ligjeve nga fusha e vetëqeverisjes lokale, kulturës, përdorimit të gjuhës, arsimit, dokumentacionit dhe përdorimit të simboleve). Fuqia e simboleve maqedonase zvogëlohet me lejimin e përdorimit të lirë të simboleve shqiptare (dhe të të tjerëve), siç është flamuri shqiptar. Edhe pse Ligji për flamuj është miratuar më vonë, aplikimi i tij u problematizua për shkak të respektimit jokonsekuent të ligjit nga ana e autoriteteve lokale në vendet ku në numër më të madh jeton

⁷⁰ Në muajin gusht, më se evident ishte rreziku se largimi i kontraktuar i forcave të NATO-s, pas vetëm një muaji qëndrimi, do të krijonte vakum të sigurisë në shtet (ICG 2001). Me rënien dakord të Shkupit që të vazhdojë me mandat të ri, Operacioni Dhelpira e Kuqërremtë, e parandaloi rrezikun e drejtpërdrejtë.

bashkësia shqiptare. Marrë në përgjithësi, Marrëveshja Kornizë kërkonte nga shumica maqedonase të bëjë diçka që deri më tani nuk ka qenë praktikë me asnjë shtet të Ballkanit. Nga ajo u kërkuar që të heq dorë nga karakteri pronësor i vet i shtetit, me këtë rast pa iu dhënë mundësi reciproke që ta ruaj identitetin e vet në mënyrë në të cilën popujt e tjerë të Ballkanit e bëjnë këtë, e as të mund të angazhohet për kauzën e minoriteteve të veta kombëtare⁷¹ (MKG 2001: 8). Marrëveshja gjeneroi humbje të identitetit maqedonas.⁷² Marrëveshja Kornizë propozonte që Maqedonia të shndërrohet në anomali: “shtet qytetar” në një rajon ku pozita e shtetit kuptohet dhe strukturohet në kushte të pakontestueshme etnike (Pettifer 2001: 9). Problemeve me identitetin maqedonas u ndërlidhen gjendjet me minoritetin maqedonas i cili jeton në vendet fqinje. Të gjitha këto sfida ndaj identitetit maqedonas të cilat reciprokisht përforcohen,⁷³ vënë në pah faktin se synimet e mëparshme ndaj territorit maqedonas dhe ndaj popullit maqedonas nuk janë shuar⁷⁴. Marrëveshja Kornizë e rrënoi ndjenjën maqedonase të sigurisë dhe të dominimit të brendshëm pa i kufizuar aspiratat e bashkësisë shqiptare në Maqedoni dhe të përfaqësuesve të tyre politikë. Miratimi i reformave kushtetuese rezultoi me atë që ndjenja e nënçmimit tek maqedonasit nga ana e bashkësisë ndërkombëtare të shndërrohet

⁷¹ Për shembull, as Kroacia e as Serbia nuk kanë miratuar masa formale ose simbolike me të cilat do t'u ofrohen të drejta të barabarta minoriteteve të tyre më të mëdha, siç u bë në Marrëveshjen Kornizë. Minoritetet e të dy etniteteve në Bosnjë, edhe pse ligjërisht ata nuk janë minoritete por popuj konstituiv, gëzojnë vetëm disa nga të drejtat që Marrëveshja e Ohrit ua jep shqiptarëve në Maqedoni. Madje as mbrojtjen, të cilën në një kohë e gëzonin serbet e Kosovës nuk është e barabartë me atë që e gëzojnë shqiptarët në Maqedoni.

⁷² Ndryshimi i Preambulës e përmend “popullin maqedonas” si dhe përmend “pjesë e popullatës shqiptare”, “turqit” dhe ngjashëm. Vërehet se ndryshim i vetëm tjetër në Marrëveshjen Kornizë ishte modifikimi i amendamentit për komunitetet religjioze. Ndryshimi i bërë (përfshirë fjalët “njësoj si dhe” pas përmendjes së Kishës Ortodokse Maqedonase) nga maqedonasit u kuptua si mbrojtje të këtij institucioni.

⁷³ Emërtimet “maqedonas slloven” ose “bullgarë”, që të dy të favorizuar nga Grekët e përforcuan qëndrimin bullgar se maqedonasit janë vetëm nëngrup i popujve më të mëdhenj slloven ose bullgar në rajon. Atë që serbët i emërtojnë maqedonasit me “serb të jugut” tanimë nuk ekziston, falë politikës federalistike të Tito-s. Pohimet kundër identitetit maqedonas jo vetëm se përforcohet njëri me tjetrin, por ndonjëherë bëjnë konspiracione aktive: “Me sa duket bullgarët janë bashkuar me grekët në mohimin e ekzistimit të popullit maqedonas”, siç është promovuar nga ana e jugosllavëve (Poulton 2000: 168-69).

⁷⁴ Sa u përket pretendimeve territoriale bashkëkohore ndaj Maqedonisë, besohet thellë se, në vitin 1992 dhe 1993, ministrat e punëve të jashtme të Jugosllavisë dhe Greqisë kanë diskutuar për ndarje të mundshme territoriale të Maqedonisë.

në ndjenjë të nevojës për mbështetje ndërkombëtare.⁷⁵

Procesi ndërkombëtar i ndërmjetësimit, i cili rezultoi me Marrëveshjen e Ohrit krijoi pakënaqësi të madhe. Gjithashtu, gjithnjë e më e pranishme është ndjenja se ngjarjet e datës 11.9.2001 dhe “lufta kundër terrorizmit” ua riorientoi vëmendjen fuqive të mëdha dhe i inkurajoi që ta ashpërojnë qëndrimin e tyre ndaj grupeve shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoni (MKG 2001: 6).

Reformat e Ohrit sollën punësimin e mijëra shqiptarëve në sektorin publik për shkak të përmbushjes së kuotave etnike, me këtë rast pa pasur kujdes në profesionalizmin dhe në kriteret reale gjatë seleksionimit të kuadrove.⁷⁶

Zbatimi i kornizës për parandalimin e konflikteve, si pjesë e politikës së sigurisë, përveç ndryshimeve kushtetuese, përfshinë miratimin dhe implementimin e zgjidhjeve të caktuara ligjore. Marrëveshja Kornizë e Ohrit drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të tërthortë ndërlidhet me procesin e miratimit dhe implementimit të:

- *Ligjit për amnisti* (2002) dhe interpretimin e nenit 1 të miratuar nga Parlamenti më 20 korrik 2011, në lidhje me zgjidhjen e rasteve të Hagës;
- *Ligjit për të drejtat e posaçme të pjesëtarëve të forcave të sigurisë të Republikës së Maqedonisë dhe anëtarëve të familjeve të tyre* (2002) dhe Propozim-Ligjin për të drejtat e posaçme të

⁷⁵ Siç deklaroi Presidenti Trajkovski në ditën e miratimit të reformave: Ne i plotësuam premtimet tona të përbashkëta. Tani ata (bashkësia ndërkombëtare) duhet ta plotësojnë pjesën e tyre”. Deklarata e Presidentit për miratimin e reformave kushtetuese, 16 nëntor 2006. Si borxhe kryesore ndërkombëtare, të cilat i përmend Trajkovski, janë konferenca donatore dhe njohja e emrit kushtetues të Maqedonisë. Atë që Trajkovski e mendon nuk mbetet vetëm në konferencën e detyrueshme donatore e cila duhet të mbahet më 20 dhjetor të vitit 2001 dhe njëfarë lloji të ndihmës ekonomike. Maqedonasit, mes tjerash, tani presin mbështetje të plotë ndërkombëtare për “zero tolerancë” në lidhje me çfarëdo qoftë obstrukcioni shqiptarë ose dhunë. “Ne presim mbështetje rezervë dhe përfshirje në bashkësinë ndërkombëtare në lidhje me kthimin e forcave të sigurisë në rajonet e krizës (përkatësisht zonat nën kontrollin e UÇK-së” - deklaroi Trajkovski). “Nuk shoh asnjë arsye se pse Maqedonia nuk do të integrohej plotësisht, duke filluar nga nesër.” – deklaroi Georgievski (Fjalim i Kryeministrit Georgievski për dhjetëvjetorin e miratimit të Kushtetutës së Maqedonisë, më 17.11.2001).

⁷⁶ Politizimi i administratës publike është vërejtja e përgjithshme, të cilën e vë në pah KE-ja në raportet e veta për progresin e Republikës së Maqedonisë (nga viti 2006 deri në vitin 2013), por veçanërisht shprehet gjatë punësimit të kuadrove me përkatësi të bashkësisë shqiptare, për shkak të arsimimit të tyre jopërkatës. Gjithashtu, pas vitit 2001 ekzistojnë më shumë raste kur për shkak të përmbushjes së parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, në përputhje me Marrëveshjen e Ohrit, për shkaqe të panjohura marrin të ardhura personale, me këtë rast pa u paraqitur në vendin e punës. Gjendjet e theksuara çojnë në segregacion etnik dhe politik midis të punësuarve në sektorin e sigurisë (Rajkovićevski 2011: 81-89).

- forcave të sigurisë dhe anëtarëve të familjeve të tyre (2012);⁷⁷
- *Ligjit për organizim territorial të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë (2004);*
- *Ligjit për përdorimin në gjuhës të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale (2008); dhe*
- Të tjerë.

Partitë shqiptare në Maqedoni konsiderojnë se hapja e katër rasteve kundër ish luftëtarëve nga radhët e shqiptarëve të Maqedonisë, në mars të vitit 2008, të cilat paraprakisht u kthyen nga Gjykata e Hagës, është në kundërshtim me Ligjin për amnisti (Petrovic 2008). Sipas Ligjit, amnistia aplikohet ndaj të gjithë kryerësve të veprave penale që kanë të bëjnë me konfliktin e vitit 2001, përfundimisht me datë 26 shtator 2001, përveç për personat të cilët kanë kryer vepra penale që kanë të bëjnë dhe kanë lidhje me konfliktin, ndërkaq kundër të cilave Tribunali Ndërkombëtar ka ngre procedurë. Në vitin 2008, Tribunali ndërkombëtar ua ktheu autoriteteve maqedonase katër nga pesë rastet⁷⁸ të cilat gjykata i pranoi në vitin 2002, me këtë rast pa ngritur procedurë për to. Së këtëjmi, me interpretimin, plotësisht u amnistuan anëtarët e UÇK-së për shkeljen e së drejtës humanitare ndërkombëtare. Ky ishte devalvim serioz i kontributit të mbrojtësve (brانيتellave) dhe u interpretua si precedent politik me të cilin politikanët ndikonin mbi vendimet e lëndëve gjyqësore në lidhje me të drejtën ndërkombëtare. Interpretimi shkaktoi ortek reagimesh nga familjet e viktimave dhe personave të zhdukur, nga mbrojtësit (brانيتellat) dhe nga organizatat ndërkombëtare

⁷⁷ Propozim-ligji krijoi tensione politike ndërmjet partive dhe brenda kuadrit të partnerëve të koalicionit. Tensionet veçanërisht erdhën në shprehje për shkak se BDI-ja kërkonte prolongimin e miratimit të këtij ligji dhe reciprocitet përmes integritit të të drejtave të pjesëtarëve të UÇK-së në ligj.

⁷⁸ Katër rastet kishin të bënin me vepra për të cilat dyshohen se janë kryer nga luftëtarët dhe udhëheqësit e UÇK-së (1. "Udhëheqësia e UÇK-së", që ka të bëjë me dhjetë të dyshuar, anëtarë të lartë të UÇK të akuzuar për "pjesëmarrje në krime serioze", 2. "Penda e Likovës", që ka të bëjë me ndërprerjen e furnizimit me ujë të zonës së Kumanovës, duke lënë thuaja se 100.000 banorë pa ujë për disa javë, 3. "Punëtorët ndërtimorë të Kompanisë Mavrovo", që ka të bëjë me grabitjen e pesë punëtorëve nga rruga në afërsi të fshatit Grupçin, dhe 4. "Neproshteni" (varrezë masive në fshatin Neproshten – Tetovë). Rasti i pestë kishte të bënte me përfaqësuesit e autoriteteve politike dhe komandueset të Republikës së Maqedonisë dhe për ta vendoste Gjykata. Ata ishin dyshuar për vrasje, për shkatërrim me dashje të qyteteve dhe fshatrave dhe për trajtim mizor (MKSJ 2013).

(Amnesty international 2011) për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ligji për gjuhët nuk i përmbush plotësisht kërkesat e shqiptarëve në Maqedoni, përkatësisht politikanët nga radhët e partive shqiptare në Maqedoni vënë në dukje se me të nuk është zgjidhur përdorimi i gjuhës shqipe në strukturat komanduese të ushtrisë dhe policisë. Këtë e tregojnë kërkesat e shpeshta të përfaqësuesve të partive shqiptare në Maqedoni.

Sipas gjendjes së marrëdhënieve ndëretnike, Marrëveshja, 13 vjet pas nënshkrimit të saj, u tregua si kundër-produktive dhe akoma nuk i jep rezultatet e pritshme në drejtim të qetësimi të tensioneve ndëretnike dhe të arritjes së qëllimeve të politikës së sigurisë. Në Marrëveshje nuk ekziston komponentë dinamike, kështu që mund të thuhet se ajo nuk është fleksibile, përkatësisht nuk ka kapacitetet t'u përshtatet ndryshimeve të sigurisë në shoqëri mbi bazë të angazhimit të liderëve politikë dhe shoqërorë për gjetjen e zgjidhjes për tejkalimin e tensioneve ndëretnike. Marrëveshja ka kapacitet të gjenerojë tensione politike për faktin se ajo bazohet në karakteristika demokratike (përfaqësim etnik dhe kuota etnike) të cilat i përcaktojnë të drejtat plotësuese të bashkësive etnike në Maqedonisë, jashtë nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet e Republikës së Maqedonisë. Në këtë mënyrë, rezultatet e çdo regjistrimi të zbatuar në Republikën e Maqedonisë në mënyrë esenciale mund të ndikojnë mbi të drejtat e bashkësive etnike, ndërsa humbja e këtyre të drejtave mund të jetë shkas i fuqishëm për tensione dhe konflikte ndëretnike.

Gjithashtu, problemet me zbatimin e Marrëveshjes Kornizë ndërliidhen me marrëdhëniet midis subjekteve politike vendase dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare. Kjo shpjegohet me faktin se liderët politikë ende kanë nevojë për mbështetje të bashkësisë ndërkombëtare në situata të marrëdhënieve të çrregulluara ndërpolitike kur vinë në shprehje interesat absolut partiak dhe kur për shkak të mosekzistimit të konsensusit politik rrezikohen interesat kombëtare. Prandaj, marrëdhëniet ndërmjet subjekteve politike vendase dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare mund të kualifikohen si indikatorë serioz për veçoritë dhe pozicionin e subjekteve politike sa i përket autoritetit të tyre në skenën politike vendase dhe ato flasin për ndikimin e

subjekteve politike në kuadër të bashkësive etnike/politike të cilat i përfaqësojnë në lidhje me procesin e ruajtjes së paqes.

Mbështetja e dialogut dhe besimit është bazë për zbatimin e metodës zvicerane në kuadër të rregullave të cilat i përdor bashkësia ndërkombëtare për parandalimin e konflikteve dhe për rehabilitimin e shoqërisë postkonfliktuale. Në shoqërinë postkonfliktuale aktorët ndërkombëtarë luajnë rolin kryesorë në inkurajimin e palëve, e që nënkupton përfshirjen e tyre në procesin e miratimit të vendimeve, në ndërtimin e dialogut dhe kthimin e besimit. Në Maqedoni, në vitin 2004, u përfshi Ministria e Punëve të Jashtme e Zvicrës përmes qasjes multidisiplinore, i fokusuar mbi ndërtimin e besimit përmes dialogut të nivelit më të lartë politik, i njohur si Proces i Mavrovës (PER 2005), përmes mbështetjes teknike të miratuesve të vendimeve dhe përmes dialogëve më të rëndësishëm (mbështetje e përgjithshme teknike dhe tema që kanë të bëjnë me mbështetjen teknike, si për shembull, caktimin e këshilltarëve të Zëvendës Kryeministrit/Nënkryetarit të Qeverisë) dhe masa të ndryshme për ndërtimin e besimit në nivele më të ulëta (zhvillim dhe udhëheqje të këshilltarëve për ndërtimin e paqes). Procesi i Mavrovës kishte për qëllim promovimin e dialogut dhe besimit në koalicionin qeveritar dhe tek të gjitha palët e përfaqësuara në Parlament. Qëllimi i dialogut të Mavrovës ishte t'u mundësojë takime palëve në ambient gjysmë-formal. Procesi parashikoi që pa presion mbi anëtarët, në procesin e miratimit të vendimeve ose gjatë arritjes së marrëveshjes, të iniciohet dialog i cili mund të jetë vendimtar dhe gradualisht të çojë deri në zgjidhjen e problemeve specifike. Ky mekanizëm, në mënyrë të drejtpërdrejtë, varet nga vullneti i palëve për bashkëpunim dhe vullneti për të lëshuar pe. Prandaj, Procesi i Mavrovës mund të trajtohet si masë sekondare për implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, e cila i prek strukturat e mesme dhe të ulëta të administratës. Përvojat, nga vitet 2004-2005, treguan se vendosja e dialogut dhe e besimit janë më shumë të përfaqësuar në nivel më të lartë shtetëror, sesa në kuadër të niveleve të mesme dhe të ulëta të administratës. Nga ana tjetër, potenciali dhe leksioni i nxjerrë nga Procesi i Mavrovës krijoi bazë për dialog dhe për ndërtimin e besimit në mënyrë shumë më të thjeshtë. Edhe krahas faktit se iniciatorë të procesit ishin aktorët ndërkombëtarë, megjithatë pati

nevojë për bindje më të madhe dhe aplikim të masave për fitimin e besimit për t'u ulur të gjitha palët në një tavolinë. Përveç kësaj, pritej që procesi të ishte më i qartë për palët e involvuara sesa për përfaqësuesit ndërkombëtar. Përfaqësuesit ndërkombëtarë duhet të kuptonin se sukcesi i procesit nuk mund të matet me evitimin e stagnimit në vendosjen e dialogut dhe ndërtimin e besimit, me kuantitetin e vendimeve të miratuara dhe me mungesën e presionit politik.

Kur bëhet fjalë për mekanizmat dhe për mënyrat e reduktimit ose zgjidhjes së konflikteve ndëretnike, reduktimi i tensioneve etnike mund të arrihet në më tepër nivele: joformal, lokal, politik, ekonomik, territorial, kombëtar, institucional etj. Me këtë rast, rëndësi më e madhe u kushtohet mekanizmave politiko-juridik për reduktimin dhe zgjidhjen e konflikteve etnike.

Në kontekst të mekanizmave të Lijphart-it dhe të Horovic-it duhet të përmenden mekanizmat për avancimet institucionale të demokracisë dhe për reduktimin e konflikteve ndëretnike në shoqëritë pluraliste (Bernard & Stockwell 2000). Ato ofrojnë propozim-mekanizma në bazë të shembujve të dëshmuar empirik për funksionim të suksesshëm të shoqërive pluraliste, siç janë:

- ngritja e barrierave institucionale midis bashkësive të ndryshme etnike përmes mekanizmave siç është federalizmi ose sistemi juridik dhe arsimor i decentralizuar (në bazë të autonomisë së njësive të vetë-qeverisjes lokale);
- implementimi i mekanizmave për ndarjen e pushtetit në nivel të elitave politike përmes institucionalizimit të ndarjes proporcionale të pushtetit dhe të drejtën e ndërsjellë për veto në bazë etnike;
- implementimi i institucioneve zgjedhore me të cilat përmes votimit do të zgjidhen kandidatët me përgjegjësi të konsiderueshme, përkatësisht formimi i partive me karakter multietnik; dhe
- zvogëlimi i rëndësisë së etnicitetit në politikë dhe mundësi shoqërore dhe ekonomike.

Në drejtim të analizës së zgjidhjeve për zgjidhjen e konflikteve ndëretnike ndërlihet propozimi i Akademisë së Shkencës dhe

Arteve të Maqedonisë (ASHAM⁷⁹) (MKG 2001: 3-4) dhe komentet e politikanëve maqedonas për zgjidhjen e problemeve ndëretnike përmes idesë së ndarjes së kufizuar territoriale sipas vijave etnike. Propozimi i ASHAM-it, i cili nuk është trup politik, i publikuar në fund të muajit maj të viti 2001, nxiti polemika të shumta dhe nuk ngeli i pavërejtur nga ana e politikanëve vendas dhe të publikut. Protesta publike kundër propozimit rezultoi me atë se të gjithë mbështetësit e tij iu shmangën komenteve të mëtutjeshme. Nga konflikti e këtej, ngjashëm si edhe me propozimin e ASHAM-it, në publik vazhdimisht ofrohen zgjidhje të cilat në masë dominante nuk janë në favor të popullit maqedonas.

Marrë në përgjithësi, tejkalimi i sfidave të brendshme të sigurisë që kanë të bëjnë me parandalimin e konfliktit ndëretnik, nënkupton gjetjen e zgjidhjes për:

- Zbatimin e rregullt të regjistrimit të popullsisë.
- Konsolidimin e shtetit juridik.
- Implementimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.
- Krijimin e politikës shtetërore për ballafaqimin me problemet ndëretnike.
- Profesionalizimin e administratës publike.

6.2.2 Ballafaqimi me sfidat e tjera të sigurisë

Politika e sigurisë duhet të tregojë se shteti ka kapacitet të përballet me konflikt ndëretnik dhe me të gjitha kërcënimet e tjera ndaj sigurisë. Duke i marrë parasysh karakteristikat e Republikës së Maqedonisë, më tepër kërcënime të sigurisë, në një moment të caktuar, dëshmuar se mund ta rrezikojnë seriozisht sigurinë dhe stabilitetin e shtetit. Prandaj, politika e

⁷⁹ Ata të cilët duan të mësojnë më shumë për ndarjen "paqësore" ose "me marrëveshje" duhet ta kenë parasysh se propozimi i ASHAM-it në të vërtetë nuk ishte propozim për ndarje (ndarjen e vendit ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve etnikë), por propozim akoma më i tmerrshëm dhe më joreal për shkëmbimin e njëanshëm të territorit dhe për shkëmbimin e popullatës, përfshirë Shqipërinë (zonën e Prespës së Vogël). Si i tillë, ka mangësi serioze në aspekt të qasjes: (a) se shqiptarët etnikë nga Maqedonia do të pajtoheshin që të absorbohen në Shqipëri; (b) se do të pajtoheshin ta humbasin Shkupin; dhe (c) se, pas superioritetit të dëshmuar të UÇK-së, do t'i linin maqedonasit t'i vendosnin kushtet e ndarjes. Në të vërtetë, me këtë plan, si dhe edhe me shumë të tjerë të tillë, arritja e marrëveshjes do të ishte po aq e vështirë, nëse jo edhe më e vështirë, sesa marrëveshja për jetë të përbashkët në shtet multietnik. Më tutje, një plan i tillë nuk mund të sigurojë garanci se më vonë nuk do të shfaqen pohime se, marrëveshja është "e padrejtë" ose "e imponuar".

sigurisë duhet të ndërtojë qasje individuale ndaj ballafaqimit me çdo lloj kërcënimi të brendshëm, rajonal ose kërcënimi global.

6.2.2.1 Ballafaqimi me sfidat e brendshme

Ballafaqimi me krimin e organizuar, me ekonominë jolegale dhe me korrupsionin nënkupton qasje të vetme e cila duhet të ketë koordinim të theksuar të fuqishëm në veprimin e organeve gjyqësore dhe ekzekutive. Eliminimi i profitit ekonomik i grupeve kriminale dhe mbrojtja e sistemit nga ndikimet materiale dhe financiare të kryerësve të veprave penale janë pjesë e detyrave për aksion të suksesshëm kundër krimit të organizuar. Reformat në Kodin Penal dhe në Ligjin për procedurë penale nënkuptojnë ndryshime dhe harmonizimin e legjislacionit maqedonas sipas standardeve evropiane, me qëllim të luftës më efikase kundër korrupsionit dhe kundër të gjitha formave të tjera të veprimeve të paligjshme.

Ngjarjet të cilat i paraprijnë hartimit të parë të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë (në vitin 1996) treguan se autoritetet shtetërore qëllimisht i bëjnë opstruksione kriminalizimit të veprave nga fusha e krimit të organizuar në mënyrë që e drejta penale të mos mund të ndikojë mbi procesin e privatizimit. Nga ana tjetër, reagimi i organeve të jurisprudencës për zbatimin me konsekuencë të Kodit Penal tregoi se shteti nuk ka orientime të qarta në zbatimin e reformës së legjislacionit penal. Në përgjithësi, në këtë pjesë, masat e politikës së sigurisë kanë të bëjnë me kontrollin tatimor dhe me përmirësimin e punës së institucioneve gjyqësore, të burgjeve dhe të institucioneve të tjera që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjeve të cilat kanë për qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe të koordinimit të ndërsjellë, rritjen e pajisjes teknike dhe inkorporimin e zgjidhjeve më pragmatike organizative në funksionimin inter-agjencial.

Ballafaqimi me krimin ka karakter mbinacional, kështu që përveç bashkëpunimit ndër-institucional, ai nënkupton bashkëpunim ndërkombëtar të sigurisë mbi bazë të modelit mirë të konceptuar vendas të sistemit të sigurisë. Ballafaqimi me korrupsionin përfshin elemente për ndalimin e ekonomisë ilegale: mbikëqyrjen e përhershme dhe efektive mbi rrjedhën e parave publike,

transparencën e sistemit juridik dhe të funksionimit të shtetit dhe procesit për zgjedhje të drejtë të nëpunësve publikë. Mjetet kryesore për luftë kundër ekonomisë ilegale përfshijnë reduktimin e shpenzimeve publike, zhvillimin rajonal të tatimeve, zbatimin e rregullave juridike dhe të doganave dhe sigurimin e zbatimit të tyre. Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet parandalimit të komunikimit midis grupeve/organizatave kriminale me përfaqësuesit politikë, me institucionet publike, me jurisprudencën, me forca të armatosura, me institucione të tjera që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe me mediat.

Ballafaqimi me kontrabandën me drogë, me kontrabandën me armë dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Baza e aktiviteteve të orientuara kundër shpërndarjes dhe furnizimit me droga, kontrabandës me armë dhe me njerëz, përfshinë ngritjen e efikasitetit për zbulim, për ndjekjen e tendencave teknologjike (me qëllim të avancimit të pajisjes teknike dhe të shkathtësive të personave përgjegjës), për shkëmbim të informatave dhe për bashkëpunim me partnerë ndërkombëtar.

Përveç drogave tradicionale, vëmendje të posaçme duhet t'i kushtohet përhapjes së drogave të reja sintetike. Edhe pse Maqedonia është treg i vogël, megjithatë shteti nga një vend përmes së cilit tranzitohen drogat të cilat hynë në vend, dalëngadalë bëhet destinacion i tyre i fundit. Arsimimi dhe ndërgjegjësimi luajnë rol kryesor në luftën kundër përhapjes së drogës.

Ballafaqimi me trafikimin me qenie njerëzore nënkupton bashkëpunimin e vendit në nivel rajona dhe global, si pjesë e iniciativave për bashkëpunim policor ndërkombëtar. Në kuadër të rregullimit ligjor dhe të zgjidhjeve institucionale (vendase, bilaterale dhe ato të cilat rezultojnë nga anëtarësimi në organizata ndërkombëtare) shteti duhet të gjejë mënyrë për t'i zbatuar strategjitë dhe t'i dënojë kryerësit e këtij lloji të veprave penale.

Ballafaqimi me kontrabandën me armë, si një nga veprimtaritë kriminale me përfitime të larta, nënkupton kontinuitet në hetimet dhe aktivitetet e forcave të sigurisë. Aktivitetet nuk janë drejtuar vetëm kah kryerësit, të cilët në mënyrë jolegale posedojnë dhe të cilët kontrabandojnë armë, por ato duhet të nënkuptojnë edhe mbikëqyrje dhe kontroll të shoqërive tregtare të regjistruara për shitje legale dhe për prodhim të armëve dhe municionit.

Menaxhimi kufitar dhe migracioni janë fusha për të cilat kohëve të fundit ekziston një kornizë evropiane për qasje të harmonizuara ndaj kësaj problematike. Në këtë kontekst, Maqedonia, në procesin e reformave në polici dhe institucionet e tjera në kuadër të administratës shtetërore, në bazë të statusit kandidat ka mundësi të mësojë nga përvojat e vendeve-anëtare të BE-së, nga anëtarët e Zonës Shengen dhe nga BE në përgjithësi. Kjo kërkon përshtatje të gjendjeve institucionale dhe ligjore ndaj standardeve të BE-së. Politika e sigurisë, në këtë pjesë, duhet të orientohet kah mundësimi i trajnimit përkatës të institucioneve dhe të personave të autorizuar për gjetjen e implikimeve të sigurisë nga proceset e migracionit, në kuadër të interesave ekonomike, të politikave të migracionit dhe të formave për sigurimin e kufijve shtetëror. Orientimet e ardhshme për ballafaqimin me krimin transnacional duhet të fokusohen në zhvillimin e zgjidhjeve organizative më efektive dhe në pajisjen plotësuese teknike të policisë kufitare dhe të sistemeve që kanë të bëjnë me çështjet e vizave dhe të migracionit.

Ekstremizmi politik dhe religjioz janë forma të cilat në mënyrë permanente kanë potencial të zhvillohen në kuadër të shoqërisë, por ato kanë veprim oscilues për shkak se faktorët politikë dhe liderët fetarë, jo aq shpesh dhe jo aq në mënyrë intensive, i shfrytëzojnë këto forma të ekstremizmit për të ndikuar mbi popullatën. Ballafaqimi me këto kërcënime kërkon sigurimin e organeve kompetente shtetërore për parandalimin e çdo lloji kërcënimi të të drejtave themelore të njeriut dhe për funksionimin e sistemit demokratik në vend, të cilët në masë të madhe mbështeten mbi mundësitë e elementeve të zbulimit, në kuadër të sistemit të sigurisë. Reduktimi i suksesshëm i ekstremizmit politik ose fetar, në afat të gjatë kohor, mund të arrihet përmes menaxhimit të suksesshëm të problemeve sociale, para së gjithash të problemit të varfërisë, i cili paraqet bazë për mbështetësit e ekstremizmit. Ballafaqimi me ekstremizmin fetar i ndërlikohet rreziku nga efektet e islamit radikal. Viteve të fundit u dëshmuar se Bashkësia Islame në Maqedoni (Kirilica 2010; Deneshen vesnik 2012; MKD 2012), me vështirësi ballafaqohet me këtë problem, kështu që islami radikal dalëngadalë dhe në mënyrë të kamufluar bëhet problem serioz për sigurinë e shoqërisë.

Ndryshimet demografike drejtpërdrejt janë të lidhura me

qëndrueshmërinë e shtetit social, si formë e cila nuk mund të ruhet në kohë të rritjes së dobët ekonomike. Ndryshimet demografike janë ngushtë të lidhura me ndryshimet kushtetuese të cilat rezultojnë nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Shkalla e ulët e natalitetit dhe tendenca e shpërnguljes masive e qytetarëve nga Republika e Maqedonisë, mund të tejkalohet me zhvillimin e vetë-kujdesit, rritjen e mundësive për punësim dhe vetëpunësim, me mundësimin e konkurrencës së ndershme gjatë punësimit, me ndihmë nga shteti dhe me masa për planifikimin e familjes dhe me strukturimin e vëmendshëm të politikës demografike dhe të migracionit, të bazuar përsëri me mbështetjen e familjes dhe të punësimit.

6.2.2.2 Ballafaqimi me sfidat rajonale dhe globale

BNdikimi i sfidave të vjetra dhe të reja të sigurisë, në kuadër të mjedisit ndërkombëtar të sigurisë kërkojnë përshtatje të vazhdueshme të shteteve, të organizatave ndërkombëtare dhe të sistemit ndërkombëtar të sigurisë. Maqedonia nuk është immune ndaj proceseve rajonale dhe globale në fushën e sigurisë, kështu që pjesëmarrja e saj aktive në organizatat dhe koalicionet ndërkombëtare të sigurisë dhe korrelacioni i sigurisë së brendshme me ngjarjet rajonale të sigurisë e imponojnë nevojën për ballafaqimin me sfidat rajonale dhe globale.

Ndikimi i *jostabilitetit të disa pjesëve të Ballkanit* mbi gjendjen e sigurisë në Maqedoni dhe në rajon edhe më tej do të jetë një nga sfidat më serioze rajonale. Ato rezultojnë nga:

- zgjidhja përfundimtare e çështjes së statusit të Kosovës dhe
- nga situata dhe nga mungesa e progresit të përgjithshëm në Bosnje e Hercegovinë.

Ballafaqimi me jostabilitetin e rajonit varet nga proceset integruese euroatlantike të shteteve të rajonit, përkatësisht nga koha kur të gjitha vendet do të bëhen anëtare të BE-së dhe/ose të NATO-s. Ndihma e siguruar nga bashkësia ndërkombëtare duhet t'u mundësojë zhvillim Maqedonisë dhe rajonit përmes mobilizimit të kapaciteteve të brendshme dhe të institucioneve demokratike, përforcimit të shtetësisë dhe rehabilitimit të ekonomisë.

Terrorizmi kryesisht paraqet sfidë rajonale dhe globale për shkak të aksionit transnacional të tij dhe për shkak të aksionit të koordinuar në ballafaqimin me të. Në këtë kontekst nuk mund të thuhet se Maqedonia ndërton qasje individuale në ballafaqimin me veprat e terrorizmit dhe se vetëm Maqedonia është e rrezikuar nga ky kërcënim i sigurisë në kuadër të rajonit. Prandaj, mbrojtja nga terrorizmi mund të jetë e suksesshme vetëm me bashkëpunim gjithëpërfshirës dhe me bashkëpunim të koordinuar ndërkombëtar të sigurisë. Lufta kundër terrorizmit përfshin përdorimin e parandalimit dhe të intervenimit, përfshirje në angazhimet ndërkombëtare për eliminimin e bazave materiale të terrorizmit dhe për mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Nga ana tjetër, qëndrimi i qartë i shtetit për pozitën dhe kontributin e vet në koalicionin anti-terroristik i mundëson realizimin e interesave të vet në kuadër të aktiviteteve për ruajtjen e paqes në botë.

Kontrabanda me armë konvencionale⁸⁰ dhe me armë për shkatërrim në masë në prapavijë qëndron profiti legal i shteteve, profiti ilegal i organizatave transnacionale kriminale dhe mundësia që armatimi të përdoret si kërcënim për rendin kushtetues, paqen dhe sigurinë.

Republika e Maqedonisë, si anëtare e sistemit ndërkombëtar për kontroll në mënyrë aktive kontribuon për përforcimin e zhvillimit të mjeteve ndërkombëtare juridike dhe të marrëveshjeve në fushën e mospërhapjes së armëve për shkatërrim në masë. Si subjekt i bashkëpunimit, përveç aktiviteteve diplomatike dhe administrative (kontroll dhe licencim), Maqedonia ka nevojë për zhvillim të aftësive për zbulim dhe mbrojtje nga këto armë. Mënyra me të cilën shteti ballafaqohet me kontrabandën me armë konvencionale dhe me

⁸⁰ Republika e Maqedonisë, në muajin nëntor të vitit 2004, në mënyrë unilaterale u bashkua ndaj parimeve dhe kriterëve të Kodeksit të BE-së për veprimet gjatë eksportit të armëve (më vonë edhe ndaj Pozicionit të Përbashkët të Këshillit 2008/944/CFSP nga data 8 dhjetor të vitit 2008 për rregullat për kontrollin e eksportit të pajisjes dhe teknologjisë ushtarake). Në bazë të këtij dokumenti, Republika e Maqedonisë rregullisht paraqet raporte vjetore pranë Këshillit të BE-së për eksportin e armëve dhe të teknologjisë ushtarake, të cilët më pas bëhen pjesë integrale të raporteve vjetore të BE-së, në kontekst të implementimit të Kodeksit dhe të Pozitës së Përbashkët të Këshillit (2008/944/CFSP). Në muajin maj të vitit 2005, Qeveria e Republikës së Maqedonisë iu bashkëngjiti Pozitës së Përbashkët për kontrollin e ndërmjetësimit në tregtinë me armë, ndërsa në muajin qershor të po atij viti edhe ndaj Programit të BE-së për Parandalim dhe Luftë Kundër Tregtisë Jolegale me armë konvencionale (Ministerstvo za nadvorešni raboti 2013a).

armë për shkatërrim në masë janë përvojat e vendeve të fituara në periudhën paskonfliktuale nga fusha e çarmatimit dhe të kontrollit të armëve. Në fushën e kontrollit të armëve dhe joproliferacionit, mund të veçohen disa karakteristika sipas së cilave Maqedonia arrin progres të konsiderueshëm në këtë fushë (Ministerstvo za nadvorešni raboti 2013a):

- Maqedonia ishte ndër 30 vendet e para të cilat e ratifikuan Konventën për Ndalimin e Municionit Kasetor (Oslo Convention - CCM), me çka kontribuoi që ajo më shpejtë të hyjë në fuqi. Maqedonia zuri vend proaktiv në zbatimin e obligimeve të cilat rezultojnë nga kjo Konventë, veçanërisht të nenit 6, i cili ka të bëjë me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe i ofroi kapacitetet e veta për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e lehtësimit të shkatërrimit të një pjese të municionit kasetor të magazinuar në rajon;

- Ministria e Punëve të Jashtme vazhdon me praktikën e përgatitjes së raporteve kombëtare në lidhje me Kodeksin e BE-së për sjelljen gjatë importit të armëve, si dhe për zbatimin e Planit të Veprimit të OKB-së për parandalim, çrënjosje dhe luftën kundër tregtimit ilegal me armë të vogla të lehta në të gjitha aspektet. Për planifikimin, monitorimin dhe për analizimin e gjendjes me kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta dhe për koordinimin e aktiviteteve të institucioneve kompetente, është formuar Komisioni Nacional për Armë të Vogla dhe të Lehta;

- Në lidhje me kontrollin e armëve konvencionale dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, filluan aktivitetet për anëtarësim në Aranzhmanin Uasenar. Më datë 1.12.2010 Maqedonia dërgoi shkresë me dedikim pranë Sekretariatit të Aranzhmanit Uasenar dhe kryesuesit të atëhershëm, për anëtarësim në Aranzhmanin, ndërsa më datë 25.2.2011 kërkoi përfshirje në programin e Grupit Shoqëruar të Aranzhmanit Uasenar (Wassenaar Arrangement Outreach programme), si ndër-etapë para anëtarësimit me të drejta të plota. Në kuadër të aktiviteteve të parapara për anëtarësim në aranzhman, Maqedonia mori pjesë në brifingun teknik i dedikuar për shtetet të cilat nuk janë anëtare të Aranzhmanit Uasenar, i cili u mbajt në selinë e Uasenarit në Vjenë më datë 15.6.2012. Paralelisht, në përputhje me dinamikën

e parashikuar, u zhvilluan edhe aktivitetet për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në Grupin Australian dhe në Grupin e Furnizuesve Bërthamor; dhe

- Maqedonia zyrtarisht e mbështeti iniciativën e KE-së për formimin e qendrave të ekselencës për materiale kimike, biologjike, radiologjike dhe për materiale bërthamore, dhe për impiante nga rajoni i Ballkanit e deri në Kaukaz, me shkrim nga ana e Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë, adresuar KE-së më datë 2.6.2011. Propozim projekte të Maqedonisë për Qendra të ekselencës për armë kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN) u paraqitën në fillim të muajit qershor të vitit 2011. Me ftesë të KE-së, përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe nga Ministria e Mbrojtjes morën pjesë në Konferencën për Formimin e Qendrës Rajonale për menaxhim me rreziqe dhe me kërcënime që kanë të bëjnë me materiale kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore dhe me impiante për rajonin nga Ballkani në Kaukaz, e cila u mbajt në Tbilisi (Gjeorgji) në muajin shkurt të vitit 2011. Këto aktivitete paraqitën hyrje për formimin e trupit nacional koordinues për ballafaqimin armë kimike, biologjike, radiologjike dhe me armë bërthamore (CBRN).

Përfshirja në operacionet që lidhen me menaxhimin rajonal dhe ndërkombëtar të konflikteve, në procesin e ndërtimit të shtetit (përmes vendosjes së paqes dhe ruajtjes së saj) dhe në dhënien e ndihmës humanitare janë modalitetet me të cilët shteti përballet me rreziqet ndërkombëtare të sigurisë në kuadër të rajonit euroatlantik. Inkorporomi i konceptit të ri, në lidhje me menaxhmentin e krizës në nivel kombëtar, kërkon harmonizim të vazhdueshëm të politikës së jashtme të sigurisë dhe të obligimeve të cilat e presin Maqedoninë në marrëdhëniet me NATO-n dhe BE, si partnerë në ballafaqimin me rreziqet ndërkombëtare të sigurisë. Maqedonia, në bazë të ndihmës së institucioneve vendase dhe të ekspertëve duhet të vazhdojë të kontribuojë në aksione ndërkombëtare politike, diplomatike, civile, policore dhe aksione humanitare.

Bashkëpunimi i bazuar në mbështetjen për zhvillim shoqëror dhe ekonomik është i dobishëm nga aspekti i ballafaqimit rajonal me rreziqet, meqë përmes bashkëpunimit hapen mundësi për zhvillim infrastrukturor dhe për zhvillim të bashkëpunimit ndërkufitar dhe

rajonal. Bashkëpunimi rajonal i redukton efektet negative nga globalizimi, ndërsa zhvillimi i vendeve përkon me politikat e BE-së, me qëllime mijëvjeçare të OKB-së dhe me strategjitë e OSBE-së. Bashkëpunimi ndërkombëtar zhvillimor përfshinë programe për parandalimin e konflikteve, për rehabilitim postkonfliktual dhe për ndihmë humanitare për ruajtjen e paqes.

Mbrojtja e sistemeve të informacionit në shoqëritë demokratike nënkupton zhvillim të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, në të cilën në bazë të respektimit të marrëveshjeve për mbrojtjen e të dhënave dhe respektimin e parimeve gjatë shkëmbimit të të dhënave shfrytëzohen mundësitë e shteteve dhe të shërbimeve private të informacionit-telekomunikacionit dhe të qendrave shkencore-kërkimore.

Ballafaqimi me terrorizmin, me krimin e organizuar ndërkufitar, me rrezikimin e institucioneve demokratike dhe me migracionet ilegale kanë një rrethanë të përbashkët. Nëse mungon kontrolli demokratik për zgjidhje, të cilat i aplikon sistemi i sigurisë dhe institucionet e tjera të shtetit, mund të rrezikohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Prandaj, politika e sigurisë në ballafaqimin me rreziqet e sigurisë duhet të parashikojë përforsim të demokracisë institucionale, të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të instrumenteve për (sa më shumë të jetë e mundur) kontroll të sistemit të sigurisë dhe për funksionimin papengësë të sistemit juridik.

7 REKOMANDIME PËR POLITIKËN E SIGURISË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Rekomandimet për politikën e sigurisë, kryesisht kanë të bëjnë me autoritetet politike dhe me sistemin e sigurisë. Rekomandimet janë në korrelacion me prioritetet e shtetit dhe i absollojnë të gjitha mjetet të cilat do të mund të ndihmonin në realizimin e prioriteteve të sigurisë. Rekomandimet kanë të bëjnë me arritjen e shkallës më të lartë të implementimit të masave ekzistuese dhe me inkorporimin e masave të reja të politikës së sigurisë me qëllim të ballafaqimit me kërcënimet ndaj sigurisë. Në këtë kontekst, ekzistojnë disa masa të cilat seriozisht do të ndikonin mbi formulimin dhe mbi orientimet e politikës së sigurisë.

7.1 Rekomandime politike

Autoritetet politike gjatë krijimit dhe zhvillimit të politikës së sigurisë duhet ta kenë parasysh **pozitën gjeografike (gjeostrategjike) të shtetit, perspektivën euroatlantike dhe marrëdhëniet ndëretnike** në Maqedoni, si mundësi të cilat e garantojnë zhvillimin e suksesshëm të sigurisë, politik dhe zhvillimin ekonomik të shtetit. Gjendja ekonomike, në masë të madhe, kushtëzohet nga udhëheqja me sukses e politikave vendase nga ana e autoriteteve politike sepse ekonomia është burimi kryesor i ruajtjes dhe mbindërtimit të sistemit të sigurisë.


Në aspekt të pozitës gjeostrategjike, Maqedonia ka pozicion qendror në rajonin e EJT dhe gjendet në drejtime të rëndësishme të komunikacionit mes Evropës dhe Azisë, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme për shkak të qarkullimit të njerëzve dhe mallrave. Korridoret 8 dhe 10 hapin mundësi për transportin e naftës dhe gazit nga rajoni Kaspik dhe të Kaukazit, si drejtime alternative për furnizim me energji⁸¹ për nevojat e rajonit dhe të Evropës.

Anëtarësimi dhe bashkëpunimi me partnerët nga BE-ja dhe NATO është shumë më shumë çështje politike sesa ekonomike.

⁸¹ Në muajin mars të vitit 2001, Kongresi i SHBA-së debatoi për konstruimin e naftë-përçuesit AMBO nga Deti i Zi (Burgas), përmes Bullgarisë dhe Maqedonisë deri në portin e Vlorës në Shqipëri. U parashikua që naftë-përçuesi ta furnizojë tregun e SHBA-ve me naftë në vlerë prej 600 milion USD në muaj, por realizimi i tij nuk u jetësua asnjëherë. Në gjysmën e dytë të vitit 2013 Maqedonia, bashkë me gjashtë vende të BE-së dhe katër vende të tjera të rajonit, e nënshkruan marrëveshjen për gazifikim me Rusinë (që është pjesë e Projektit "Rrjedha Jugore").

Politikat e sigurisë së BE-së e definojnë identitetin e saj të sigurisë, ndërsa anëtarësimi në NATO ka ndikim më të madh mbi sigurinë dhe mbi zhvillimin e vendit. Përkundër vetos nga Greqia, çështja e anëtarësimi të Maqedonisë në Samitin e NATO-s në Bukuresht, në vitin 2008, e vuri në dukje përçarjen e interesave ndërmjet Evropës dhe SHBA-ve.⁸² Boshllëku ndërmjet të ashtuquajturit “vakum i sigurisë” Maqedonia shpejt e plotësoi me marrëveshjet për partneritet strategjik me SHBA-të dhe me Turqinë në vitin 2008. Ky nuk është rast me BE, ku u gjet modeli për përfshirjen e shtetit në aktivitetet të cilat rezultojnë nga politikat e sigurisë së BE-së dhe nga statusi kandidat i vendit. Kjo e dyta është pozicion shumë më i pafavorshëm sepse participimi në grupet luftarake dhe në misionet e BE-së nuk kontribuuan për zgjidhje përfundimtare të qëllimeve strategjike të shtetit lidhur me eurointegrimet.


Në kuadër të hulumtimeve të realizuara, të anketuarit u pyetën që të deklarohen për atë se a ka Maqedonia partner strategjik në kuadër të integritimeve në BE dhe në NATO. Gjithashtu, ata që janë përgjigjur në mënyrë afirmative duhej ta identifikonin partnerin/partnerët të cilët e mbështesin Republikën e Maqedonisë në proceset e anëtarësimi në BE dhe në NATO.



Grafiku 21: Pasqyrë e përgjigjeve në pyetjen: A konsideroni se Republika e Maqedonisë ka partner/ë të vërtetë të cilët e mbështesin në proceset integruese për anëtarësim në BE dhe në NATO?” (2009)

⁸² Greqia, me lobim tek partnerët evropian dhe me kundërshtimin për pranimin e Maqedonisë në NATO arriti ta ndërpres zgjerimin e Aleancës kah Lindja, përkatësisht zgjerimin e NATOS me Ukrainën dhe Gjeorgjinë. Me këtë masë, Greqia i dha kohë Ruisë, e cila pas Luftës Ruso-Gjeorgjiane nga viti 2008, dhe me ndryshimet politike në Ukrainë nga viti 2010 (të cilat çuan në ridefinimin e politikës së shtetit në lidhje me anëtarësimin në NATO – si qëllim strategjik i përcaktuar dy vite më parë), arriti ta largojë NATO-n prej para portave të saj. Ndikimi i Ruisë mbi autoritetet ukrainase e përsëriti efektin e njëjtë edhe sa u përket aspiratave dhe marrëdhënieve të Ukrainës me BE.

Klasifikimi i përgjigjeve të hulumtimit nga vitit 2009 kryesisht u fokusua në përgjigjet: *nuk ka, ekzistojnë angazhime nga disa anëtare të BE-së dhe ka, por nuk kanë mjaftueshëm influencë dhe fuqi*. Matjen e këtij qëndrimi, të anketuarit e tregojnë me rezultatet e pyetjes në vijim e cila ka të bëjë me identifikimin e partnerit strategjik të Maqedonisë. Ato tregojnë se cilat vende qytetarët i shohin si vende me ndikim dhe si partnerë aktivë të Maqedonisë përmes mbështetjes së procesit eurointegruës. Nga të anketuarit – 23% e maqedonasve konsiderojnë e SHBA-të janë partnerë strategjikë të Maqedonisë, 19% konsiderojnë se është Sllovenia, ndërsa 15% janë prononcuar për Turqinë. Të anketuarit shqiptarë në vend të parë i vendosin SHBA-të (me 26%), pastaj vijon Shqipëria me 19% dhe në vendin e tretë është Kosova me 12%. Të anketuarit në përgjithësi, si zgjedhje të parë për partner strategjik nuk e kanë zgjedhur ndonjë vend të Evropës, gjë që edhe në vitin 2013 u tregua si problem për integrimet euroatlantike. Të anketuarit – shqiptarë qëndrimin e tyre e bazojnë mbi ndjenja personale dhe afërsinë me shqiptarët e Shqipërisë dhe Kosovës.⁸³ Tek maqedonasit vërehet numri i të anketuarve (6%) të cilët konsiderojnë se Rusia më tepër e mbështet Maqedoninë në integrimet euroatlantike sesa Gjermania dhe vendet e tjera anëtare të BE-së (pa Slloveninë). Qëndrimi i të anketuarve – maqedonas për Rusinë bazohet mbi prejardhjen e përbashkët sllave dhe mbi ngjashmërinë kulturore, por është i pabazë për shkak të kundërshtimit publik të Rusisë për zgjerimin e Aleancës.



Grafiku 22: Pasqyrë e përgjigjeve në pyetjen: A konsideroni se Republika e Maqedonisë ka partner/ë të vërtetë të cilët e mbështesin në proceset integruese për anëtarësim në BE dhe në NATO?” (2013)

⁸³ Lë përshtypje qëndrimi i të anketuarve – shqiptarë në dhënien e përgjigjeve për Shqipërinë dhe Kosovën, nga aspekti i fuqisë së tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare, sepse Shqipëria u bë anëtare e NATO-s në Samitin e Bukureshtit në vitin 2008, ndërsa në vitin 2009 nuk e mori statusin e kandidatit në BE (dhe kjo nuk ndodhi as në fund të vitit 2013), ndërsa Kosova ka probleme me njohjen e saj ndërkombëtare.

Në vitin 2013 dominojnë përgjigjet se Maqedonia ka vende-partnerë, por se ato nuk janë mjaftueshëm me ndikim dhe të fuqishme. Partneriteti strategjik me SHBA-të, përfshirë edhe anëtarësimin në Grupin e Adriatikut dhe me Turqinë nuk është mbështetje e mjaftueshme për inkuadrimin e vendit në NATO. Sikurse edhe në vitin 2009, hulumtimi në vitin 2013 tregon se 41% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve konsiderojnë se Sllovenia e mbështet më së shumti Maqedoninë për fillimin e negociatave me BE (44,4% e maqedonasve dhe 26,7% e shqiptarëve), në vend të dytë është Gjermania për të cilën janë prononcuar 16,1% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve (23,3% e shqiptarëve dhe 14,6% e maqedonasve) dhe në vend të tretë është Kroacia me 12,4% (13,3% e shqiptarëve dhe 12,3% e maqedonasve). Në lidhje me vendet-mbështetëse të Maqedonisë për inkuadrim në NATO, në vend të parë është Turqia, për të cilën janë prononcuar 38,9% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve (40,1% e maqedonasve dhe 27,6% e shqiptarëve), SHBA-të janë në vendin e dytë me 33,6% (34,5% e shqiptarëve dhe 33,5% e maqedonasve) dhe në vendin e tretë është Sllovenia për të cilën janë prononcuar 9% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve. Për Slloveninë janë deklaruar 11,4% e të anketuarve – maqedonas, ndërsa asnjë i anketuar - shqiptar. Për Shqipërinë janë prononcuar 0,6% e maqedonasve dhe 17,2% e shqiptarëve. Sa i përket partnerit strategjik të Maqedonisë për inkuadrim në NATO, pozicioni i SHBA-ve në vitin 2013, për dallim nga hulumtimi paraprak i vitit 2009, mund të shpjegohet me ndryshimin e prioriteteve në politikën e SHBA-ve lidhur me Ballkanin. Politika e SHBA-ve ndaj Maqedoniaë, gjatë kohës së Presidentit Bush dhe Presidentit Obama, ka dallime të dukshme. Pozicioni i Gjermanisë në lidhje me integrimin e Maqedonisë në BE dhe në NATO bazohet mbi atë se sipas mënyrës së udhëheqjes së politikës së jashtme, Maqedonia nuk arriti t'i ruaj simpatitë e Gjermanisë në afat më të gjatë kohor, si dhe të ndryshimeve të krijuara të reja në marrëdhëniet midis Maqedonisë dhe Bullgarisë – e cila tanimë një kohë të gjatë është në fokusin e politikës së jashtme gjermane në lidhje me Ballkanin.

Projektimi i politikës së jashtme të sigurisë të Republikës së Maqedonisë, në masë të madhe varet edhe nga marrëdhëniet

e shtetit me fqinjët. Problemi me emrin me Greqinë, gjendja e marrëdhënieve me Bullgarinë dhe kontestet e tjera me fqinjët kanë ndikim të madh mbi integrimet euroatlantike të vendit dhe mbi shkallën e konfliktualitetit të ndërlidhura me gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike. Proceset integruese vetvetiu janë specifike, për faktin se Maqedonia i plotësoi të gjitha kriteret për anëtarësim në NATO në vitin 2008,⁸⁴ ndërsa pesë vjet me radhë nuk mori datë për fillimin e negociatave edhe pse gjatë periudhës kohore 2009-2013 vendi mori rekomandim pozitiv nga KE-ja për progresin e vendit. Dy situatat janë pothuajse identike sepse për Maqedoninë u parashtruan kriteret plotësuese, të cilat janë jashtë kriterëve të cilat kërkoheshin/kërkohen nga vendet e tjera.

Në bazë të argumentimit teorik dhe rezultateve nga hulumtimi, autoritetet politike duhet të investojnë në zhvillimin e shkathtësive lidhur me inventivitetin dhe në kapacitetet për udhëheqjen e politikës racionale dhe efikase të sigurisë. Politika e jashtme e sigurisë duhet të orientohet kah partnerët potencial strategjikë në Evropë dhe veçanërisht tek Gjermania dhe Britania e Madhe – si vende të cilat disa herë e kanë dëshmuar kontributin e tyre ndaj integritimeve euroatlantike dhe ndaj sigurisë dhe stabilitetit të Maqedonisë. Integrimet euroatlantike paraqesin qëllim të përbashkët për pjesëtarët e të gjitha bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë, kështu që në to mund të shihet si bazë për lojalitetin e grupeve etnike ndaj shtetit, i cili do t'i zbuste ndjenjat e ndarjes etnike dhe mbylljes. Duke u përmbledhur gjendjet aktuale të politikës së brendshme dhe të sigurisë dhe ngjarjeve në BE dhe NATO, Maqedonia akoma nuk ka zgjidhje për t'i zgjidhur sfidat e politikës së jashtme të sigurisë. Ngecja në procesin e integritimeve Republikën e Maqedonisë e shpie në pozitë inferiore në raport me


⁸⁴ KE-ja në muajin mars të vitit 2008, i parashtrou Maqedonisë tetë kriteret, të cilat vendi duhej t'i plotësonte gjatë vitit të njëjtë, në mënyrë që të merr datë për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE. Së këtejmi, BE-ja kërkoi nga Maqedonia zbatimin e plotë të Marrëveshjes për Stabilizim Asocim, dialog midis partive politike (i cili u përmend në çdo Raport për progresin e Republikës së Maqedonisë që nga statusi kandidat i vitit 2005 dhe këtej, të hartuar nga ana e KE-së e cila duhej të jepte shenjë për fillimin e negociatave për anëtarësim), implementimin e Ligjit për polici, vazhdimin e luftës kundër korrupsionit, reformën në sistemin gjyqësor dhe të administratës publike, ndërmarrjen e masave kundër papunësisë dhe përmirësimin e biznes – klimës. Republika e Maqedonisë, në këto 8 pyetje i dha vetes obligim plotësues lidhur me zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare në vitin 2008, të cilat kaluan me dhunë dhe me incidente zgjedhore.

vendet e tjera të rajonit dhe shteti bëhet objekt i shantazheve bilaterale nga fqinjët.

Njëra nga detyrat më të rëndësishme për politikën e jashtme të sigurisë maqedonase është të kontribuojë në mënyrë aktive në drejtim të sigurimit të stabilitetit të rajonit, për transformimin demokratik të vendeve fqinje dhe për ruajtjen e promovimit të përgjithshëm të të drejtave të njeriut, me vështrim të posaçëm të minoriteteve etnike dhe kombëtare, në përputhje me normat dhe standardet evropiane. Kjo pjesë nënkupton mbështetje aktive të të drejtave të minoritetit maqedonas i cili jeton në vendet fqinje, si bazë për zhvillimin e suksesshëm rajonal, në përputhje me standardet evropiane dhe të OKB-së.

Prandaj, me qëllim të sigurimit të sigurisë, kapacitetet e autoriteteve politike duhet të orientohen kah shfrytëzimi i të gjitha qëllimeve politike të sigurisë, duke i shfrytëzuar mundësitë nga bashkëpunimi diplomatik, ekonomik dhe bashkëpunimi kulturor. Duhet të shfrytëzohet konsensusi i autoriteteve politike për çështjet lidhur me integrimet euroatlantike, me kontestin me emrin dhe me drejtimet e zhvillimit të bashkëpunimit më të gjerë rajonal të sigurisë. Megjithatë, ata nuk janë mjaft të qartë dhe transparent ndaj publikut për qëndrimet e tyre në lidhje me çështjet kryesore kombëtare.

Marrëdhënia e autoriteteve politike ndaj zbatimit të politikës së sigurisë kushtëzohet nga marrëdhëniet ndëretnike në shtet. Autoritetet politike, të cilët njëkohësisht janë formuar mbi bazë etnike, njëherësh janë kreatorë të stereotipave në grupin etnik. Roli i shtetit në një lloj të shoqërisë siç është ajo maqedonase është t'i harmonizojë marrëdhëniet ndërmjet grupeve të ndryshme etnike përmes programeve për integrim, për rritjen e sigurisë në bashkësi dhe për tejkalimin e dallimeve. Programet do të përfshinin stimulimin e qytetarëve për integrim në shoqëri përmes aktiviteteve zhvillimore ekonomike dhe përmes identifikimit të interesave të përbashkët të bashkësisë (për shembull, pjesëmarrje në ballafaqimin me krimin përmes identifikimit të kërcënimeve ndaj sigurisë, ndihmës për zhvillimin e bashkësisë lokale dhe ngjashëm). Fillimisht, këto programe duhet t'u dedikohen mjediseve rurale, ku jeton popullata joshumicë e shtetit, ndërsa më vonë të njëjtët duhet të realizohen në mbarë territorin e shtetit. Në këtë mënyrë do të shmanget dhënia e konotacionit etnik të programeve.



Grafiku 23: Pasqyrë e përgjigjeve në pyetjen: "Sipas Jush, siguria dhe stabiliteti i marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Maqedonisë a mund të çrregullohen nëse së shpejti Republika e Maqedonisë nuk bëhet anëtare e NATO-s dhe nuk merr ftesë për negociata me BE?" (2009)



Grafiku 24: Pasqyrë e përgjigjeve në pyetjen: "Sipas Jush, siguria dhe stabiliteti i marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Maqedonisë a mund të çrregullohen nëse së shpejti Republika e Maqedonisë nuk bëhet anëtare e NATO-s dhe nuk merr ftesë për negociata me BE?" (2013)

Edhe pse në hulumtimin e vitit 2009 nuk ka përgjigje dominuese për këtë çështje, megjithatë përgjigjja më e shpeshtë është: "Po, do të çrregullohen, por jo deri në masë serioze sa të shkaktojnë konflikt" tek maqedonasit dhe tek shqiptarët e tejkalon 30%. Deklarata e një funksionari të lartë të partisë në koalicionin në pushtet - BDI,⁸⁵ nuk shkaktoi aksione konkrete, ndërsa përfaqësuesit

⁸⁵ "Nëse deri më 7 dhjetor Qeveria nuk u dërgon sinjale pozitive përfaqësuesve ndërkombëtarë se do ta zgjidh kontestin me emrin, që është kusht për Maqedonisë për të fituar datë për negociata, atëherë shqiptarët, me ose pa maqedonasit do të hyjnë në NATO dhe BE. Nuk e di se si do të realizohet kjo. Shqiptarët do të radikalizohen sepse tek ata nuk ka dilema se janë për NATO dhe BE." – thotë Aliti. Ai përkujtoi se hyrja në institucionet euroatlantike janë pjesë e premtimeve të tyre në platformën zgjedhore. "Nuk ka pse të presim më shumë sepse nuk mund të lejojmë që shqiptarët të marrin pasaporta shqiptare, bullgare ose kosovare për të shkuar në Evropë. Ne e kemi mirë në pushtet, por patriotizmi nuk hahet." – thotë Aliti ("Dnevnik" më 3.11.2009).

politikë të shqiptarëve i kuptojnë maqedonasit për ndjeshmërinë e çështjes së kontestit me emrin.

Evropeizimi i kontinentit të vjetër mund të kontribuojë për tejkalimin e problemit të përkatësisë kombëtare, si burim i konflikteve ndëretnike dhe për thellimin e dallimeve ndëretnike, në mënyrë në të cilën hapet mundësia për krijimin e përkatësisë ose identitetit të ri kombëtar. Ideja e krijimit të identitetit evropian në Maqedoni ndikon mbi dëshirat e Maqedonisë për anëtarësim në institucionet evropiane (Ackerman 1999:66-67). Në pyetjen gazetareske: "*A ekziston identiteti evropian dhe si definohet i njëjti?*" në kontekst të asaj se në Ballkan tanimë një periudhë më të gjatë kohore debatohet për çështjen e identiteteve (për identitetin maqedonas, grek, serb dhe për identitete të tjerë) Uehter përgjigjet (2009):

- Çdo individ ka nivel të ndryshëm të identitetit. Ai/ajo kanë identitetin e vet si anëtar i familjes, si banor i qytetit e kështu me radhë. Shumë pak banorë të BE-së do të thonë se para së gjithash janë evropian. Ai njëherë do të thotë se është gjerman, për shembull, ndërsa më pas se është evropian. Dhe këtu nuk ka kontradikta, përkatësisht se duhet të zgjedhësh se a je evropian ose gjerman apo francez. Qytetarët e Evropës nuk kanë nevojë për një zgjedhje të tillë, por ata duhet të jenë qytetarë të cilët identifikohen me identitetin e tyre kombëtar dhe në të njëjtën kohë identifikohen edhe në nivel të BE-së. Ata mund të identifikohen edhe në nivel më kompleks, në kuadër të rajonit ose kombit. Në shtetet federale si Gjermania, për shembull, do t'u thonë se ai është nga Bavaria, se është gjerman dhe se është evropian dhe nuk ka kontradikta të këtyre identiteteve. Nëse dëshironi të bëheni anëtar i BE-së, ju duhet ta pranoni identitetin evropian, ndërkohë që ai nuk e përjashton identitetin maqedonas, identiteti i cili ka të bëjë me shtetin tuaj. Identiteti i qytetarëve të BE-së mbetet fuqishëm në identitetin që ndërlidhet me shtetet e tyre. Zhvillimi i identitetit kombëtar nuk është pengesë për integrim dhe gjithësesi, anëtarësimi në BE nuk kërkon ta braktisni sovranitetin.

Ideja e shqiptarëve për "Shqipëri të Madhe" ose federalizmi i Maqedonisë mund të tejkalohet me integrimin e të gjithë qytetarëve në sistemin e shtetit (si masë e parashikuar me Marrëveshjen Kornizë

të Ohrit), kështu që lëshimet që janë bërë në llogari të identitetit maqedonas duhet të rezultojnë me zhvillimin e përkatësisë dhe me perceptimin e Maqedonisë si shtet i qytetarëve të barabartë. Dallimet e thelluara etnike, të bazuara mbi marrëveshje formale, mund të çojnë deri në kufizimin territorial ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve. Përderisa kufizimi duket si solucioni më i lehtë, do të duhet të dëshmohet se ai madje fare nuk është as solucion. Ish Presidenti Trajkovski ishte i sigurtë në deklaratën e tij: “Ne nuk mund t’i retushojmë kufij, duke bërë bashkësi të vogla dhe shtete akoma më të varfra. Nuk mund të ekzistojmë si rajon nëse etnikumet bëhen konfirmim i vetëm për shtetësinë.” (Bildt 2001:154). Me ndarjen shkojnë edhe përvojat e hidhura nga rajoni.⁸⁶ Ndjenja për përkatësi ndaj një shteti duhet të jetë rezultat i angazhimit të shtetit për sigurimin e një jete modeste dhe për përparimin e qytetarëve të saj. Në suaza maqedonase, kjo do të thotë se subjektet politike, si faktorë kryesorë, duhet t’i tejkalojnë interesat e tyre personale dhe partiake dhe të angazhohen për integrimin e shpejtë të vendit në BE dhe në NATO, si bazë kryesore për garantimin e ekzistencës, zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit gjithëpërfshirës shoqëror në Republikën e Maqedonisë.

Reformat e ardhshme politike në Maqedoni duhet të lëvizin kah **depolitizimi dhe deetnizimi i shoqërisë** në llogari të zhvillimit ekonomik dhe të arritjes së mirëqenies shoqërore. Depolitizimi nënkupton miratimin e legjislacionit objektiv dhe të drejtë dhe inkorporimin e një shkalle të lartë të profesionalizmit në sektorin e sigurisë dhe në administratën shtetërore si tërësi. Këta janë faktorët kyç të cilët kontribuojnë për zbatim më objektiv të reformave, për besim më të madh në qeverinë, për ndërtim të shkallës më të lartë të vetëdijes publike dhe për kufizimin legjitim të fuqisë politike. Këto të fundit ndikojnë në reduktimin e rasteve të korrupsionit dhe të krimit të organizuar nga subjektet politike.

Aktorët ndërkombëtarë, të cilët morën pjesë në krijimin e Marrëveshjes së Ohrit, u përpoqën dhe arritën sukses që nga Republika e Maqedonisë të bëjnë një model të shoqërisë multietnike në formë të rregullimit shoqëror. Kjo është diçka që paraqet precedent

⁸⁶ Mbase ky është një leksion të cilin akoma nuk e kemi mësuar, nga ndarja efektive e BeH në tri etnitete kontraktuale dhe nga procesi i zgjidhjes së statusit të Kosovës, e cila në fillim të vitit 2008 shpalli pavarësinë e saj.

për ekspertët të cilët merren me shkencat politike, veçanërisht për ata specialitet i të cilëve është sistemi politik dhe rregullimi shoqëror i shteteve. Së këtejmi, parakusht kyç për zbatimin e politikës së sigurisë kombëtare është deetnizimi i Kushtetutës, përkatësisht ridefinimi i rregullimit shoqëror në civil e jo mbi baza etnike.

Autoritetet politike duhet të angazhohen për **azhurnimin me kohë dhe pranimin e shifrave objektive nga statistika shtetërore** në lidhje me përfaqësimin e grupeve etnike në popullsinë e përgjithshme, si bazë mbi të cilën fitohen të drejta plotësuese të përcaktuara me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Kjo është një nga çështjet më të ndjeshme, kur kemi parasysh se shoqëria maqedonase postkonfliktuale bazohet pikërisht mbi dispozitat nga Marrëveshja Kornizë. Autoritetet politike duhet t'i mbështesin institucionet kompetente në drejtim të pasqyrimin të realitetit të vërtetë në lidhje me përfaqësimin e grupeve etnike, e që dukshëm do t'i reduktojë mundësitë për manipulimin e rezultateve të regjistrimit. Kjo masë, përveç se e pasqyron fotografinë reale etnike të Maqedonisë, ajo kontribuon edhe për arritjen e modelit përkatës zgjedhor, i cili duhet t'i ulë tensionet gjatë zgjedhjeve dhe të mundësojë zhvillimin e tyre demokratik në mbarë territorin.

Subjektet politike duhet ta izolojnë ndikimin e tyre mbi **statusin dhe ta reduktojnë shkallën e politizimit të mediave (dhe administratës publike)**. Këtë karakteristikë shpeshherë e vë në pah bashkësia ndërkombëtare⁸⁷ për shkak se një pjesë e madhe e mediave janë të politizuara ose janë në pronësi të personave me ndikim të madh në politikë. Rivaliteti midis mediave dhe relacioni midis mediave dhe pushtetit, në kontekst të fuqisë së tyre për manipulimin e publikut, mund të shkaktojnë probleme serioze të sigurisë. Rekomandimet e vetme, në këtë pjesë, kanë të bëjnë me edukimin e domosdoshëm të gazetarëve për qasjen dhe mënyrën e raportimit lidhur me problemet ndëretnike dhe me sigurinë.

Si masë më e rëndësishme për zbatimin papengesë të politikës së sigurisë është të kërkohej **përgjegjësi nga liderët politikë dhe nga liderët e shoqërisë civile si faktorë të cilët kanë ndikim më të madh mbi menaxhimin me konfliktet ndëretnike dhe**

⁸⁷ Veçanërisht BE dhe SHBA. BE-ja i shënoi vërejtjet e veta në Raportet për progresin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa çështja e lirisë së mediave kohë pas kohe është pjesë përbërëse e raporteve të Kongresit të SHBA-ve.

me zbatimin e masave përkatëse kushtetuese, politike dhe masave socio-ekonomike. Në Republikën e Maqedonisë vështirë mund të flitet për përgjegjësinë e liderëve politikë (sidomos kur kemi parasysh faktin se shpesh aktivitetet e tyre për uljen e tensioneve paraqesin zgjidhje të detyrueshme nga ana e përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare), sepse ata disa herë kanë dëshmuar se në vend që t'i qetësojnë tensionet ndëretnike ata paraqiten si gjeneratorë të tensioneve. Së këtejmi, rekomandimet për autoritetet politike kanë të bëjnë me atë se reputacionin e tyre duhet ta ndërtojnë në drejtim të afrimit të diversiteteve në shoqëri të ndarë etnike dhe politike. Në këtë mënyrë do të kthehej besimi tek subjektet politike, ndërkaq kjo paraqet një nga faktorët kryesor për zbatimin konsekuent të politikës së sigurisë.

Politika e sigurisë e Maqedonisë duhet të korrespondojë me gjendjet në shoqëri. Në analizat për konfliktet, përmendet **liberalizmi social** si formë e rregullimit shoqëror e cila më lehtë mund të përballet me konfliktet. Së këtejmi, liberalizmi social tregon se kontaktet e drejtpërdrejta e zvogëlojnë mundësinë nga konfliktet përmes promovimit të mirëkuptimit të ndërsjellë. Kontaktet e këtilla transnacionale hasen në më tepër nivele, si për shembull, tek popullata studentore, njerëzit afaristë dhe turistët. Përmes kontakteve të këtilla, njerëzit e tjerë na duken paksa të huaj dhe pak antipatik (Naj Pomladiot 2008:77). Zgjedhja e një sistemi përkatës shoqëror, mund të paraqes mjet për arritjen e ekullibrit dhe për qetësimin e tensioneve. Njohja e pamjaftueshme e ndërsjellë e grupeve etnike, të cilat jetojnë në një shoqëri, gjithmonë mund të paraqes bazë për konflikt, i cili rrënjët i ka në paragjykimet dhe stereotipat të cilët mbizotërojnë në mesin e pjesëtarëve të grupeve të ndryshme etnike.

Rekomandimet për politikën e sigurisë të Republikës së Maqedonisë kanë **kontekst më të gjerë rajonal**, kështu që subjektet politike duhet ta marrin parasysh qasjen rajonale ndaj sigurisë. Qasja rajonale në krijimin e politikës së sigurisë është e rëndësishme për shkak se Ballkani paraqet një tërësi kompakte, në të cilën ndërldihen shumë interesa etnike dhe shtetërore në një hapësirë të vogël. Qasja e veçantë për krijimin e problemeve të sigurisë, në krijimin e politikës së sigurisë së një shtetit, pavarësisht

nga rajoni i tij, është krejtësisht e gabuar. Në këtë mënyrë, vlerësimet e sigurisë projektohen mbi bazë të korrelacionit midis sfidave të brendshme të Republikës së Maqedonisë me ngjarjet politike dhe të sigurisë në EJT, më gjerë në Evropë dhe me ngjarjet me të cilat preken partnerët strategjikë të Republikës së Maqedonisë. Krizat e sigurisë në zona të caktuara të rajonit (Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë, Sanxhak, Maqedoni etj.) dhe refleksioni i tyre mbi mbarë rajonin treguan se sa është i ndërlikur dhe i ndjeshëm rajoni për secilin nga këto ndryshime të sigurisë.

Prandaj, subjektet politike, gjatë krijimit dhe zbatimit të politikës së sigurisë, duhet t'i marrin parasysh presupozimet dhe skenarët e mundshëm (të cilët kanë implikime serioze mbi sigurinë e Maqedonisë), si vijojnë:

- Nëse vazhdon procesi i segregacionit të shteteve në bazë etnike, atëherë do të çonte në federalizim dhe shkëputje të plotë të pjesëve nga Maqedonia, BeH, Kosova dhe Serbia.

- Nëse shtetet-kandidate dhe aspiruese për anëtarësim në BE dhe në NATO ngecin në proceset integruese për shkak të mospërbushjes së normave për anëtarësim, për shkak të marrëdhënieve të tensionuara politike të brendshme dhe për shkak të ngecjes sa i përket zgjerimit, si rezultat i politikave të BE-së dhe NATO-s, një gjë e tillë mund të kontribuojë në kontekst të dallimeve ekonomike dhe zhvillimore ndërmjet BE dhe rajonit, të cilët kanë potencial të reflektohen mbi standardin jetësor, mbi fuqinë ekonomike dhe mbi investimet.

- Për shkak të jostabilitetit politik dhe mungesës së qasjes racionale në zgjidhjen e çështjeve lidhur me integrimet euroatlantike, është e mundur të vijë deri në tërheqjen e forcave të sigurisë të bashkësisë ndërkombëtare nga vatrat e krizës në rajon dhe në ndërprerjen e mbështetjes politike, me çka ruajtja e stabilitetit dhe e sigurisë do të lihet vetëm në kapacitetet e sigurisë dhe politikës kombëtare.

- Kontestet, të cilat ekzistojnë midis shteteve të caktuara (Maqedoni-Greqi, Greqi-Turqi, Serbi-Kosovë, Kroaci-Sllloveni), nuk guxojnë të çojnë deri në pezullimin e bashkëpunimit rajonal. Ky supozim meriton vëmendje të veçantë për shkak të rëndësisë së bashkëpunimit policor dhe ushtarak ndaj sigurisë rajonale.

Është pak e besueshme se bashkësia ndërkombëtare do të tërhiqet nga rajoni, për shkak të investimeve të mëdha gjatë dy dekadave të fundit në planin politik, të sigurisë dhe në planin ekonomik, si dhe për shkak të interesave ekonomike dhe sigurimit të tranzitimit të mallrave dhe energjisë në rajon. Përforcimi i kufijve të jashtëm të BE-së dhe të NATO-s përmes përforcimit të masave të sigurisë të vendeve-anëtare të cilat gjenden në margjinat e tyre, është një motiv më tepër për integrimin e fqinjëve të tyre me qëllim të zvogëlimit të mundësive për krijimin e “vrimes së sigurisë” në Evropë.

Në të ardhmen, autoritetet politike duhet ta inkurajojnë intensifikimin e shfrytëzimit të mundësive të bashkëpunimit policor evropian dhe rajonal dhe të kapaciteteve të iniciativave rajonale të sigurisë. Pavarësisht paragjyqimeve dhe stereotipave etnike dhe nacionaliste, Republika e Maqedonisë dhe shtetet e rajonit duhet të synojnë që në mënyrë më aktive të kontribuojnë për stabilitetin rajonal dhe për ballafaqimin me krimin transnacional. Bashkëpunimi në siguri dhe mbrojtje duhet t'i tejkalojë barrierat lidhur me pronësinë dhe besimin gjatë shkëmbimit të informatave dhe çështjes së të kuptuarit tradicional të sovranitetit kombëtar, në situata kur ekziston kërcënim i përgjithshëm nga krimi dhe nga kërcënime të tjera transnacionale. Një pjesë e këtyre rekomandimeve tanimë janë implementuar me formimin e trupave binacional dhe multinacional të sigurisë në kuadër të bashkëpunimit policor, por për një pjesë të zgjidhjeve të propozuara shtetet akoma manifestojnë shkallë të lartë të përmbajtjes. Këtyre supozimeve mund t'u shtohet rëndësia e evropeizimit të përmendur paraprakisht në kontekst rajonal. Nëse Evropa ka mësuar diçka nga periudha pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, është e sigurt se një nga leksionet është se integrimi ekonomik evropian aktualisht vetëm e rrit dezintegrimin në EJT. Të huajt e shtyjnë integrimin e Ballkanit... përpjekjet e këtilla janë të destinuara të dështojnë përkundër pasigurisë lokale dhe rezistencës politike. Vendeve të Ballkanit u nevojitet ndikimi gjë që do të ndodhë vetëm me përmbushjen e aspiratës së vetme të rajonit - *Europeizimin* (Woodward & Steil 1999: 97-98). Kohezionin, të cilin nuk mund ta arrijnë politikisht mes vete vendet e rajonit imponon që zgjidhja të arrihet përmes evropeizimit. Liberalizimi i vizave dhe hyrja në regjimin liberal ekonomik evropian, i cili do ta ngjallë

ekonominë duhet të kontribuojë për heqje dorë nga konfliktet e dhunshme dhe për bashkimin e kapaciteteve kombëtare të sigurisë gjatë ballafaqimit me kërcënimet ndaj sigurisë.⁸⁸

7.2 Rekomandime për sistemin e sigurisë

Rekomandimet e politikës së sigurisë, të cilat kanë të bëjnë me praktikuesit, njëherësh janë rekomandime dominante për avancimin e sistemit të sigurisë së shtetit. Zbatimi i politikës së sigurisë nënkupton mbështetje me forcë nga ana e resursit (autokton) të brendshëm ose nga ana e faktorit të jashtëm (partnerit të huaj). Në këtë kontekst, Republika e Maqedonisë ndërtoi sistemin e vet të sigurisë i cili tani për tani (fundi i vitit 2013) mbështetet mbi partneritetin me BE, NATO dhe me partneritetin strategjik me SHBA-të dhe Turqinë.

Në drejtim të rekomandimeve konsistojnë disa argumente të cilat më së miri e pasqyrojnë sistemin e sigurisë dhe gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë. Ato janë:

- Maqedonia në tërësi e ndërmerr përgjegjësinë për sigurinë e shtetit.
- Shteti për një kohë më të gjatë është pjesë e misionëve për menaxhmentin e krizës.
- Maqedonia rregullisht i harmonizon strategjitë e sigurisë me ato të BE-së dhe të NATO-s.
- Forcat maqedonase të sigurisë posedojnë forca të deklaruara të cilat kanë kapacitetet dhe janë të gatshme për shpërndarje të shpejtë dhe për operacione paqësore në kuadër të bashkëpunimit me fuqitë aleate.

Rekomandimi kryesor, sa i përket sistemit të sigurisë, ka të bëjë me përshtatjen e tij ndaj dinamikës së zhvillimit të rrezeve të sigurisë në lidhje me definicionin me të gjerë për sigurisë. Struktura aktuale e sistemit kombëtar të sigurisë korrespondon me nevojat dhe kërkesat e sigurisë të partnerëve strategjikë. Gjithashtu, angazhimi

⁸⁸ Zgjidhjet ekzistuese flasin për formimin e forcave të përbashkëta të sigurisë, forma të përbashkëta të bashkëpunimit policorë, qendra të përbashkëta për trajnim nga fusha e sigurisë, ndërsa në perspektivë inkorporimin e konceptit "mbrojtje e zgjuar" (a.q. smart defence) ku është përfshirë edhe Maqedonia.

i deritanishëm i përfaqësuesve maqedonas të sigurisë jashtë vendit dhe në kuadër të operacioneve të përbashkëta bazohet në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe Kartës së OKB-së.

Sfida më e madhe në të ardhmen sa i përket **mbrojtjes** do të jetë joshja dhe ruajtja e personelit kualitativ të MM dhe të ARM-së. Interesimi për shërbim në ARM është akoma i lartë, por me përmirësimin e gjendjes ekonomike të shtetit duhet të pritët që profesioni ushtarak të jetë gjithnjë e më pak atraktiv. Prandaj është e nevojshme që brenda një periudhe të shkurtë kohore të avancohet sistemi i administrimit me personelin në MM dhe në ARM, i cili do të mundësojë administrim efikas me karrierën e personelit ushtarak dhe civil, si dhe plotësimin përkatës të ARM-së (pika 7 nga Kapitulli V. Ristrukturimi i proceseve të brendshme të punës në Strategjia za odbranata na Republika Makedonija 2010). Përveç ballafaqimit me sfidat që ndërlidhen me resurset njerëzore, Strategjia identifikon edhe sfida të tjera të cilat rezultojnë nga standardi jetësor i personelit ushtarakë dhe civil, nga çështjet gjinore dhe nga sistemi i arsimit dhe trajnimit.

Edhe pse Maqedonia gjendet në fazën e dytë të reformave të sektorit të sigurisë, akoma **nuk janë të qarta orientimet për strukturimin e policisë në mikro nivel dhe në nivel të mesëm** – si nivele kryesore për operacionalizimin e aktiviteteve policore. Konstatimi bazohet në hulumtimet e bëra në kuadër të projektit evropian: “Kompozit: Studime krahasuese për policinë në BE” në të cilin gjatë periudhës kohore 2010-2014 perceptohen gjendjet aktuale në polici (Composite 2013). Në këtë pjesë, udhëheqësit e policisë paraqiten si faktorë kryesore të cilët kanë kapacitet të ndikojnë mbi procesin e riorganizimit dhe të profesionalizimit të policisë.

Mungesa e **kontinuitetit në krijimin e kuadrit për nevojat e sistemit të sigurisë**, e cila u paraqit si rezultat i suspendimit të punës të Akademisë Ushtarake (në vitin 2002) dhe mbylljes së Fakultetit të Sigurisë-Shkup, si institucion më relevant për arsimin e kuadrove për nevojat e policisë (në vitin 1995), u reflektua mbi profesionalizmin në atë mënyrë që u hap edhe çështja e profesionalizmit dhe politizimit të sistemit të sigurisë.

Sfidat e ardhshme me të cilat do të ballafaqohet sistemi i sigurisë ndërlidhen me ngritjen e shkallës së koordinimit inter-

agjencional. Kjo sidomos shprehet tek institucionet e formuara të reja (për shembull, ndërmjet QMK dhe Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim). Rregullimi ligjor i sistemit të ri për siguri kombëtare duhet t'i rirregullojë marrëdhëniet ndërmjet institucioneve dhe të mundësojë evaluim të aktiviteteve operative të politikës së sigurisë. Në përgjithësi, gjatë realizimit të aktiviteteve të politikës së sigurisë, imponohet nevoja për transformimin e subjekteve të sistemit të sigurisë, në përputhje me mënyrat reja të të menduarit, planifikimit dhe veprimit në fushën e sigurisë. Kjo çështje mund të trajtohet si pjesë e një reforme gjithëpërfshirëse të sektorit të sigurisë. Qasja ndahet në tri pjesë:

- *Ndryshimi i qëndrimeve tek pjesëtarët e sistemit të sigurisë me qëllim të promovimit të kulturës së sigurisë dhe "zero tolerancë" ndaj kryerësve të veprave kundër shtetit.* Në këtë pjesë është e domosdoshme të krijohen programe për ndërgjegjësimin e të gjithë pjesëtarëve të sistemit të sigurisë, në mënyrë që ata të inkurajohen që aktivitetet e politikës së sigurisë t'i perceptojnë si detyra dhe interes të çdo individi që të kontribuojë në drejtim të përmirësimit të sigurisë në shtet.

- *Ndryshimi i proceseve të cilat duhet të çojnë në unitet dhe harmonizim të kornizës për zbatimin e aktiviteteve të politikës së sigurisë.* Kjo pjesë, para së gjithash, ka të bëjë me zhvillimin e instrumenteve për bashkëpunim ndërinstitucional, në kuadër të sistemit të sigurisë, por edhe për një bashkëpunim më të gjerë lokal, rajonal dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Harmonizimi i qartë ligjor dhe përcaktimi i kompetencave në veprimin operativ mundësojnë që të shmanget mbivendosja e kompetencave dhe të veprimit të dy ose më shumë institucioneve të sistemit të sigurisë.

- *Ndryshimi i praktikës për efikasitet dhe efektivitet më të madh.* Zgjidhja kuantitative e problemeve të sigurisë, në mungesë të qasjes kualitative, nuk paraqet një zgjidhje të përhershme për zbatimin e politikës së sigurisë në nivel operativ dhe taktik. Veçanërisht, në problematikën që ka të bëjë me problemet ndëretnike duhet të merret parasysh suptiliteti i subjekteve (shtetëror dhe jo-shtetëror), dhe faktorët të cilët e shkaktojnë krijimin dhe përshkallëzimin e tensioneve ndëretnike.

Shuma e të gjitha rekomandimeve ekzistuese formale dhe joformale për politikën gjithëpërfshirëse të sigurisë të Republikës së Maqedonisë, e cila i identifikon të gjitha kërcënimet potenciale ndaj sigurisë dhe ndaj stabilitetit të Maqedonisë, duhet të përmbajë:

- Deetnizim të Kushtetutës, përkatësisht ridefinimin e Republikës së Maqedonisë si shoqëri civile në të cilën qytetari i gëzon të gjitha të drejtat, në vend të emërimit të pranuar “shoqëri multietnike” i imponuar me Marrëveshjen Kornizë i cili nuk mund të interpretohet si një model i rregullimit shoqëror;
- Autoritetet të ndërmarrin obligim për ridefinimin e prioritetëve shtetërore meqë të njëjtat nuk korrespondojnë me gjendjen faktike dhe me prioritetet e sigurisë;
- Zhvillim të përgjegjësisë individuale të të gjithë faktorët shoqërorë lidhur me sigurinë, veçanërisht tek subjektet politike dhe sistemi i sigurisë. Ata duhet t’u shmangen veprimeve të cilat vënë në pah se në vend ekziston pushtet i dyfishtë i ndarë në bazë etnike;
- Zbatim konsekuent i regjistrimit;
- Promovim të mekanizmave për zgjidhje pa dhunë të konflikteve, para së gjithash të atyre ndëretnike;
- Promovim të vlerave siç janë: toleranca, interkulturalizmi dhe tejkalimi i çështjeve sensitive etnike, fetare dhe kulturore përmes dialogut dhe mirëkuptimit;
- Mundësimin e sundimit të së drejtës, respektimin e parimeve të shtetit juridik dhe respektimin e të arriturave të shoqërisë demokratike;
- Harmonizim të drejtimeve për veprimin e bartësve të pushtetit në politikën e brendshme dhe të jashtme të sigurisë;
- Realizim të integriteteve euroatlantike dhe ruajtja e dinjitetit gjatë zgjidhjes së kontestit për emrin;
- Ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore me qëllim të avancimit të stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal me institucionet ndërkombëtare të sigurisë;
- Identifikim i qartë i problemeve të sigurisë që nënkupton kufizimin e konflikteve të përgjithshme shoqërore nga konfliktet e sigurisë;
- Evitimi i të gjitha llojeve të paragjyqimeve që kanë të bëjnë me

sigurinë e shtetit (për shembull, temat që kanë të bëjnë me: nënçmimin e grupeve etnike, letërkëmbimin e paargumentuar ndërpartiak për sigurinë dhe stereotipat për përfitimet e sigurisë nga anëtarësimi në BE dhe NATO);

- Përforsim i masave për luftë kundër terrorizmit, islamit radikal, proliferacionit me armë për shkatërrim në masë, kontrabandës me drogë dhe krimet të organizuar;
- Inkorporim të masave për mbrojtjen e konceptit të sigurisë nga manipulime të mundshme politike, për ngritjen e shkallës së profesionalizmit të sistemit të sigurisë dhe për gjetjen e modelit për seleksionimin e personave më adekuatë të cilët do të ishin pjesë e organeve politike përgjegjëse për çështjet e sigurisë.
- Punësimi në sistemin e sigurisë i kuadrit nga fusha e sigurisë dhe zhvillimi i institucioneve relevante (akademi, fakultete, qendra kërkimore);
- Krijimi i sistemit efikas, ekonomikisht i qëndrueshëm dhe kompakt të sigurisë me kompetenca qartë të specifikuar të të gjitha subjekteve dhe sistem në të cilin investohet në mënyrë të vazhdueshme.

KONKLUZION

Republika e Maqedonisë, nëse merren parasysh të gjitha veçoritë e saj në lidhje me territorin, numrin e popullsisë, pozicionin gjeostrategjik lidhur me rajonin specifik të sigurisë dhe me rregullimin shoqëror, në procesin e miratimit të dokumenteve strategjike nga fusha e sigurisë, hasi në vështirësi për t'i përkufizuar dhe klasifikuar prioritetet e sigurisë – të cilat bashkë me interesat kombëtare paraqesin parametra kryesor për krijimin dhe zbatimin e politikës së sigurisë.

Edhe pse forma aktuale e konceptit të sigurisë kombëtare ndihmon në drejtim të identifikimit të kërcënimeve ndaj sigurisë dhe rreziqeve ndaj paqes dhe stabilitetit të Maqedonisë, megjithatë masat për ballafaqimin me to nuk janë të zhvilluara sa duhet në kuadër të politikës së brendshme të sigurisë, politikës së mbrojtjes dhe politikës së jashtme të sigurisë. Çdo zgjidhje për ballafaqimin me problemet ndëretnike dhe me problemet e tjera duhet të jetë mjaftueshëm e mençur në mënyrë që të zgjasë për një periudhë të caktuar kohore, duhet të jetë rezultat i politikës së planifikuar të sigurisë, të jetë në përputhje me kapacitetet e sistemit të sigurisë, ta ketë pëlqimin e subjekteve politike dhe të mundësojë zbatim efikas të orientimeve të specifikuara në strategjitë e sigurisë.

Strukturat e ranguara lartë në sistemin e sigurisë duhet të angazhohen në drejtim të ruajtjes së kontinuitetit të arsimimit të kuadrove për nevojat e sigurisë dhe të inkorporohen standarde më të larta profesionale në kuadër të shërbimeve të sigurisë.

Shtetit i mungon fuqia ekonomike dhe prezenca ekonomike në fqinjësi në mënyrë që të mund ta kompletojë imazhin e sigurisë. Megjithatë, në një rajon specifik të ekspozuar në ndikime nga fuqi të mëdha, secili shtet i Ballkanit Perëndimor nuk mundet në mënyrë të qartë të ndërtojë politikë autonome të sigurisë, por mundet vetëm ta adaptojë politikën e sigurisë në mënyrë që të mos jetë kundërthënëse me interesat e tyre.

Parametrave të cekur u ndërlidhen ndryshimet e sigurisë në rajon, të cilat kryesisht bazohen në progresin e fqinjëve në integrimet euroatlantike dhe gjendjen status-kuo të Republikës së Maqedonisë në lidhje me këtë çështje. Veçanërisht çështja që

ka të bëjë me anëtarësimin e bllokuar në NATO shpie në pasiguri, ndërsa kësaj i ndërlidhen qëndrimet e shprehura qartë të fqinjëve sa i përket mbijetesës së kombit maqedonas dhe sa i përket çështjes së identitetit maqedonas. Gjithashtu, faktorët e cekur plotësohen me faktorët e brendshëm (profesionalizimin në kuadër të sistemit të sigurisë, mënyrën e udhëheqjes së politikës shtetërore, konsensusi politik në lidhje me çështjet dhe prioritetet e rëndësishme të sigurisë, përcaktimi i interesave kombëtare kundrejt interesave etnike etj.). të gjithë këta faktorë e vënë në pikëpyetje fuqinë e shtetit dhe kapacitetin e sistemit të sigurisë nëse shteti rrezikohet nga fuqia e fortë.

Hulumtimi i realizuar për qëllimet e Punimit dëshmoi se rregullimi i politikës së brendshme, të mbrojtjes dhe politikës së jashtme të Maqedonisë doemos duhet të bashkëveprojë me mekanizmat për parandalimin e konflikteve në mënyrë që të mundet në vazhdimësi t'u përgjigjet sfidave dhe kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë së shtetit. Dy parametrat kryesorë ndaj të cilëve janë orientuar qëllimet e politikës së sigurisë – proceset e integritit euroatlantik dhe marrëdhëniet ndëretnike, qytetarët i vlerësuan si më të rëndësishmit për tejkalimin e rreziqeve të sigurisë dhe prandaj duhet të jenë bazë për krijimin e politikave dhe strategjive të sigurisë.

Politika e sigurisë duhet t'i mbrojtë vlerat shoqërore dhe interesat e shtetit. Prandaj, politika e sigurisë duhet të synojë t'i shfrytëzojë mundësitë e politikës shtetërore dhe t'i integrojë praktikat më të mira të veta, qëllimet, përgjegjësitë dhe aktivitetet në përgjithësi, në mënyrë që të mund të krijojë strategji kryesore gjithëpërfshirëse për realizimin e vizioneve në fushën e sigurisë. Shembujt vendas dhe ndërkombëtar nga fusha e sigurisë duhet të na mësojnë si ta absolutojmë konfliktin në mënyrë më konstruktive para se ai ta absolutojë shtetin. Politika e sigurisë duhet të ndihmojë që më mirë të kuptohet e kaluara, pa rënë në kurthin e saj, të kuptohen tendencat bashkëkohore të sigurisë për konfliktin me qëllim të ballafaqimit të padhembshëm me sfidat dhe ndryshimet e sigurisë.

Shtojca nr.: Pyetësor anketues i hulumtimit

1. Gjinia

1. mashkullore
2. femërore

2. Arsimi

1. fillor
2. i mesëm
3. PLSH
4. PSP
5. Mr. i shkencave
6. Dr. i shkencave

3. Përkatësia kombëtare

1. Maqedonas
2. Shqiptarë
3. Turq
4. Serbë
5. Vlleh
6. Romë
7. Boshnjakë
8. Të tjerë

4. Moshë

1. 18-25 vjet
2. 26-35 vjet
3. 36-45 vjet
4. 46-55 vjet
5. mbi 55 vjet

5. Sipas Jush, cili nga qëndrimet e cekur e pasqyron qëndrimin Tuaj për "gjendje stabile të sigurisë"?

1. Gjendje stabile e sigurisë është gjendje e mungesës së kërcënimeve të cilat do ta cenonin integritetin territorial të Republikës së Maqedonisë;

2. Gjendje stabile e sigurisë është gjendje e mungesës së veprimeve të ngjashme me ngjarjet e vitit 2001;
3. Gjendje stabile e sigurisë është shkallë e reduktuar e krimit të organizuar dhe korrupsionit;
4. Gjendje stabile e sigurisë është harmonizimi i veprimit politik të partive politike me shenjë të ndryshme etnike në procesin e integrimi euroatlantike të Republikës së Maqedonisë;
5. Gjendje stabile e sigurisë janë marrëdhëniet e mira ndëretnike;
6. Gjendje stabile e sigurisë është gjendja e mirë ekonomike, standardi më i lartë i qytetarëve dhe siguria më e madhe sociale;
7. Gjendje stabile e sigurisë është respektimi i parimit të sundimit të së drejtës dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.

6. Si e vlerësoni gjendjen momentale të sigurisë në Republikën e Maqedonisë?

1. Stabile
2. Pjesërisht stabile
3. Jostabile, me tendencë për përmirësim
4. Jostabile
5. Nuk kam qëndrim

7. Si do t'i kualifikoni marrëdhëniet ndëretnike në Republikën e Maqedonisë?

1. Stabile me tendencë pozitive
2. Stabile
3. Të relaksuara
4. Kundërthënëse
5. Me tendencë për përkeqësim
6. Konfliktuale
7. Nuk kam qëndrim

Sipas Jush, cili nga faktorët e cekur ka ndikim mbi gjendjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë?	Ndikon	Nuk ndikon
8. Ndarja etnike e shoqërisë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9. Diskriminimi etnik	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10. Implementimi i Marrëveshjes së Ohrit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11. Çrregullimi i marrëdhënieve ndëretnike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12. Mostoleranca fetare	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13. Kontesti me emrin kushtetues	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14. Mos-integrimi në NATO	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15. Mungesa e ftesës për negociata për anëtarësim në BE	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16. Marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me fqinjët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17. Gjendja në Kosovë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18. Zhvillimi i ngadaltë ekonomik i shtetit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19. Krimi i organizuar dhe korrupsioni	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20. Shkalla e papunësisë dhe varfërisë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
21. Mosrespektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Sipas Jush, a ekziston konsensus politik ndërmjet partive politike në Republikën e Maqedonisë për:	Ekziston	Nuk ekziston
22. Negociatat me Greqinë për kontestin me emrin kushtetues të Republikës së Maqedonisë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
23. Marrëdhëniet me Bullgarinë		
24. Anëtarësimin në BE dhe në NATO si përcaktim strategjik	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
25. Prioritetet në politikën e jashtme (marrëdhëniet e mira fqinjësore, bashkëpunimi rajonal dhe ngjashëm)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
26. Kërkesat e bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

- 27. Sipas Jush, a konsideroni se qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të gatshëm ta pranojnë ndryshimin e emrit kushtetues për shkak të integriteteve euroatlantike të shtetit?**
1. Po, janë të gatshëm
 2. Janë të gatshëm, por vetëm një numër i vogël i qytetarëve
 3. Nuk kam qëndrim
 4. Nuk janë të gatshëm
- 28. Sipas Jush, siguria dhe stabiliteti i marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Maqedonisë a mund të çrregullohen nëse së shpejti shteti nuk bëhet anëtare e NATO-s dhe nuk merr ftesë për negociata me BE?**
1. Po, siguria dhe marrëdhëniet ndëretnike do të çrregullohen
 2. Po, do të çrregullohen, por jo deri në masë serioze sa të krijojnë konflikte
 3. Nuk do të çrregullohen
 4. Nuk kam qëndrim
- 29. A konsideroni se Republika e Maqedonisë ka partner/ë të mirëfilltë të cilët e mbështesin në proceset integruese për anëtarësim në BE dhe në NATO?**
1. Ka, por nuk janë mjaftueshëm me ndikim dhe fuqi
 2. Ka numër të mjaftueshëm të cilët kanë ndikim dhe fuqi
 3. Nuk ka
 4. Nuk kam qëndrim
- 30. Nëse në pyetjen nr. 29 jeni përgjigjur në mënyrë afirmative, sipas Jush, cili vend është mbështetësi më i madh i Republikës së Maqedonisë për anëtarësimin në BE?**
1. B. e Madhe
 2. Gjermania
 3. Italia
 4. Polonia
 5. Sllovenia
 6. Franca

7. Holanda
8. Kroacia
9. Çekia
10. Suedia
11. Vend tjetër, cili?_____

31. Nëse në pyetjen nr. 29 jeni përgjigjur në mënyrë afirmative, sipas Jush, cili vend është mbështetësi më i madh i Republikës së Maqedonisë për anëtarësimin në NATO?

12. B. E Madhe
13. Gjermania
14. Italia
15. Polonia
16. Sllovenia
17. Franca
18. Holanda
19. Kroacia
20. Çekia
21. Suedia
22. Vend tjetër, cili?_____

Shtojca nr.2: Maqedonia në raportet BE - NATO

19 dhjetor 2009: Hyri në fuqi liberalizimi i vizave për qytetarët e Maqedonisë.

7 dhjetor 2009: Këshilli i Ministrave të Punëve të Jashtme të BE-së e kushtëzoi Maqedonisë me zgjidhjen e kontestit të emrit për marrjen e datës dhe fillimin e negociatave për anëtarësim.

14 tetor 2009: Maqedonia mori rekomandim nga KE për negociata për anëtarësim.

3 prill 2008: Si rezultat i vetos greke, Maqedonia u kushtëzua ta zgjidhë çështjen e emrit që të bëhet anëtare e NATO-s.

6 mars 2008: Eurokomisari për zgjerim, Oli Ren në Shkup i prezantoi tetë kriteret (benchmarks) për përafrimin e Maqedonisë në BE.

30 janar 2006: Këshilli i BE-së e miratoi Partneritetin Evropian me Maqedoninë.

16 nëntor 2005: KE ia ndau Maqedonisë statusin kandidat për anëtarësim në BE.

14 shkurt 2005: Qeveria ia dorëzoi përgjigjet e Pyetësorit të KE Presidentit të KE Zhoze Manuel Baroso.

2 dhjetor 2004: Me operacionin ALTEA në BeH, BE e ndërmori misionin ushtarak nga NATO.

1 prill 2004: Hyri në fuqi Marrëveshja për Stabilizim Asocim, pasi u ratifikua nga të gjitha vendet-anëtare të BE-së.

22 mars 2004: Maqedonia në Dablin e paraqiti kërkesën për anëtarësim në BE.

19–25 nëntor 2003: Stërvitja e parë NATO-BE për menaxhimin me kriza, e bazuar në Angazhmanin "Berlin Plus".

29 korrik 2003: U miratua Strategjia e Përbashkët e BE dhe NATO për Ballkanin Perëndimor.

31 mars 2003: Në Maqedoni në vend të operacionit NATO, fillon operacioni i parë paqësor i BE-së i quajtur "*Konkordia*". BE menaxhoi me misionin "*Konkordia*" deri më 15.12.2003, pas së cilit vijoi misioni policor civil i BE-së operacioni *Proksima*, i cili vazhdoi deri në muajin dhjetor të vitit 2005.

17 mars 2003: Marrëveshje për më shumë dokumente për bashkëpunim, e ashtuquajtur paketa "Berlin Plus".

14 mars 2003: Marrëveshje ndërmjet NATO-s dhe BE-së për sigurinë e informatave.

16 dhjetor 2002: Deklarata e dy partnerëve PESM (ESDP).

16 dhjetor 2002: Fillimi i Misionit "Harmonia Aleate" me të cilin elementet operative të NATO-s në Maqedoni siguronin mbështetje për vëzhguesit ndërkombëtar, ndërsa elementet e tij këshillëdhënës u ndihmonin autoriteteve në kthimin e sigurisë në mbarë territorin. Misioni zgjati deri më 31.3.2003.

21–22 nëntor 2002: Në Samitin e Pragës, anëtarët e NATO-s shprehën gatishmëri BE-së t'i aprovojnë qasje deri te mjetet dhe kapacitetet e Aleancës, për aksionet në të cilat NATO nuk është e angazhuar ushtarakisht.

27 shtator 2001: Fillimi i Operacionit *Dhelpra e kuqërremtë* e NATO-s në Maqedoni, me mandat fillestar tremujor, i cili në mënyrë shtesë u vazhdua deri më 15.12.2002, me detyrë për t'i mbrojtur 280 vëzhguesit e BE-së dhe OSBE-së, të cilët e monitoronin implementim politik të Marrëveshjes paqësore.

27 gusht 2001: Filloi Misioni *Korrja e domosdoshme* e NATO-s në Maqedoni, e cila zgjati deri më 26.09.2001, për çarmatimin e shqiptarëve etnikë dhe shkatërrimin e armëve të tyre.

30 maj 2001: Takimi i parë formal i Ministrave të Punëve të Jashtme të NATO-s dhe BE-së, në Budapest.

9 prill 2001: Luksemburgu ishte nikoqir i nënshkrimit të Marrëveshjes për Stabilizim Asocim, ndërsa bashkë me të edhe Marrëveshjes së Përkohshme për Tregti dhe Çështje të Tregtisë ndërmjet Maqedonisë dhe BE-së.

24 janar 2001: Fillimi i marrëdhënieve të institucionalizuara NATO-BE, me realizimin e takimeve të përbashkëta, mes tjerash, edhe të ministrave të punëve të jashtme.

7 dhjetor 2000: Me Traktatin e Nicës, BE planifikoi zhvillimin operativ të PESM (ESDP), si politikë të pavarur të Bashkimit Evropian.

19 shtator 2000: Këshilli i Atlantikut Verior dhe Komiteti i Përkohshëm Politik dhe i Sigurisë i BE-së takohen për herë të parë.

mars 2000: Brukseli formoi Delegacionin e BE-së në Maqedoni, me çka marrëdhëniet u ngritën në nivel ambasadori.

24 janar 2000: BE i miratoi direktivat të cilat kanë të bëjnë me ngritjen e nivelit të bashkëpunimit midis Maqedonisë dhe BE-së dhe

fillimit formal të negociatave për anëtarësim potencial në BE.

10 dhjetor 1999: Në Samitin e Helsinkit, anëtarët e BE-së ranë dakord që deri në vitin 2003 të formojnë 15 brigada, me 50-60.000 ushtarë për të ashtuquajturat Detyra të Petersburgut. BE, gjithashtu, për herë të parë e formoi Komitetin Politik dhe të Sigurisë, si Komitet Ushtarak, ndërsa nga Bashkimi Evropë përdimor e ndërmori rolin për menaxhim me kriza.

3-4 qershor 1999: Këshilli Evropian në Keln vendos që BE-së t'ia akordojë mjetet dhe kapacitetet e nevojshme që ajo të mund t'i ndërmerr përgjegjësitë lidhur me PESM.

23-25 prill 1999: Në Samitin në Uashington, NATO vendos t'i zhvillojë "Aranzhmanet Berlin Plus".

3-4 dhjetor 1998: Britania e Madhe dhe Franca në Samitin në San Malo (St. Malo) e vërteton gatishmërinë për formimin e PESM.

21-22 mars 1998: Në Shkup u mbajt takimi i parë i Këshillit të Përbashkët për Bashkëpunim ndërmjet Maqedonisë dhe BE-së.

2 tetor 1997: Në Traktatin e Amsterdimit të BE-së u përfshinë të ashtuquajturat Detyrat e Petersburgut. BE gjithashtu e vërteton rolin BEP si pjesë përbërëse të zhvillimit të BE-së dhe parashikon integrimin e mundshëm të BEP në BE.

3 qershor 1996: Ministrat e punëve të jashtme të anëtareve të NATO-s për herë të parë ranë dakord për ndërtimin e "identitetit evropian të sigurisë dhe mbrojtjes", në kuadër të Aleancës, me qëllim që të rishpërndahen rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet Evropës dhe Amerikës Veriore. Gjithashtu, u vendos rritja e aftësive ushtarake të BE-së, se si NATO t'ia bartë kapacitetet e veta BEP, operacionet për menaxhim me kriza (që prej atëherë fillon përdorimi i nocionit "Berlin Plus").

22 dhjetor 1995: Maqedonia dhe BE-ja vendosën marrëdhënie diplomatike.

janar 1994: Në Samitin në Bruksel, NATO e mbështeti konceptin për forca të përbashkëta të kombinuara, që mundëson formimin e shtabeve të veçanta, por jo edhe shtabeve të ndara për operacione të cilat do t'i udhëheq BE-ja.

shkurt 1992: Me Traktatin e Mاستriht-it për formimin e "Politikës së përbashkët ndër-qeveritare të jashtme dhe të sigurisë PPJS (CFSP)", si dhe krijimin eventual të politikës së përbashkët të mbrojtjes.